



**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

**“AUDITIM FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIE”**

**“BASHKIA MALËSI E MADHE”**

**Tiranë, Shtator 2024**



## PËRMBAJTJA

<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	4
a. Përshkrim i shkurtër i Institucionit të audituar.....	4
f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:.....	5
3. Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	6
<b>II. HYRJA</b> .....	8
1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit.....	9
2. Identifikimi i çështjes.....	9
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	9
4. Përgjegjësitë e audituesve. ....	9
5. Kriteret e vlerësimit .....	10
6. Standardet e auditimit.....	11
7. Metodatat e auditimit.....	12
8. Dokumentimi i auditimit.....	14
<b>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b> .....	14
1. Informacion i përgjithshëm .....	14
2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit .....	14
2.1 Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik. ....	15
2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.....	27
2.4 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi. ....	40
2.5 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik. ....	59
2.5.2 Mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike. ....	108
2.6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e Pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.....	136
2.6 Të ndryshme të dala gjatë auditimit.....	141
<b>IV. GJETJE DHE REKOMANDIME</b> .....	141
<b>V. ANEKSET</b> .....	Error! Bookmark not defined.

## Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
TAK	Titullari i Autoritetit Kontraktor

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### a. Përshkrim i shkurtër i Institucionit të audituar.

Bashkia **Malësi e Madhe** është njësi vendore institucion i pavaruar, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe ish-komunave në afërsitë të tij, pra në total ka 6 njësi administrative si vijon: Njësia Administrative Koplík (qyteti), Njësitë Administrative Koplík, Gruemirë, Kastrat, Kelmend, Qendër dhe Shkrel.

**Misioni** i Bashkisë Malësi e Madhe është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

**Synimi kryesor** është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

**Buxheti i Bashkisë Malësi e Madhe** si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavaruar, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

Për vitin 2023 planifikimi përfundimtar i shpenzimeve ka qenë 1,397,075 mijë lekë, ndërkohë që realizimi ka qenë 1,276,436 mijë lekë ose në masën 91% me një diferencë mos realizimi në vlerën 120,639 mijë lekë. Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore ka qenë në vlerën 149,296 mijë lekë ndërsa realizimi në vlerën 130,279 mijë lekë ose në masën 87% me një diferencë mos realizimi në vlerën 19,017 mijë lekë.

### b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisve të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Malësi e Madhe si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

### c. Qëllimi i auditimit.

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime, me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Malësi e Madhe. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit;
- burimi i krijimit të të ardhurave dhe mbledhja e tyre;
- mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023;
- mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.
- Mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin e pronës publike.

### d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodogjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar transaksionet e likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodot e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

**e. Nga shqyrtimi i evidencave**, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 33 gjetje dhe ka dhënë 33 rekomandime, nga të cilat: masa organizative me 18 gjetje dhe 18 rekomandime, 7 gjetje-rekomandime shpërblim dëmi në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve në vlerën **5,698,374 lekë**, 3 gjetje-rekomandim si efekt negativ në vlerën **303,438,994 lekë** në fushën e prokurimit të fondeve publike dhe zbatimit të kontratave dhe 5 gjetje, si dhe 5 rekomandime në fushën e të ardhurave.

**f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.** Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

- ***Procedurat e zbatimit të kontratave të punimeve të ndërtimit***

- Në **7 raste** janë konstatuar punime të pakryera me një **dëm ekonomik në vlerën 5,698,374 lekë**

- ***Procedurat e prokurimit publik*** për punë publike, mallra dhe shërbime:

Është kryer auditimi i 12 procedurave të prokurimit me vlerë të fondit limit 311,595 mijë lekë, nga të cilat:

- Në 11 procedura, me fond limit 290,427,411 lekë pa TVSh, janë vendosur kriteret kualifikuese që nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet;

- Në 11 procedura, me fond limit 298,940,951 lekë pa TVSh, janë kualifikuar dhe shpallur fitues OE/BOE që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në DT, me pasojë lidhjen e kontratave për vlerën 344,475,253 lekë me TVSh, në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor në fuqi.

- ***Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave***

- Për vitin 2023, si periudhë nën auditim, realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Malësi e Madhe, janë realizuar në masën 87%, nga 149,296,000 lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 130,279,762 lekë;

- Për mos pagesën e detyrimeve tatimore deri në datën 31.12.2023, janë debitorë 10826 abonentë familjarë, në vlerën totale 50,439,387 lekë, nga e cila, vetëm për vitin 2023 është vlera e detyrimit 14,553,997 lekë.

- Për mos pagesën e detyrimeve tatimore deri në datën 31.12.2023, janë debitorë 323 subjekte fizikë/juridikë, në vlerën totale 36,121,603 lekë, nga e cila, vetëm për vitin 2023 është vlera e detyrimit 4,689,987 lekë.

- Për mos pagimin e taksës së infrasktrukturës janë debitorë në total 299 subjekte në vlerën 20,263,481 lekë, nga të cilët, për vitin 2023 janë 39 subjekte me vlerë të detyrimit 1.296,614 lekë.

- ***Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe regjistrimin e aseteve***

Nga auditimi rezultoi se, janë 452 pronave të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara 24 në pronësi dhe 428 në përdorim të Bashkisë Malësi e Madhe, listat përfundimtare të të cilave janë të miratuara me pesë VKM-të përkatëse. Nga këto prona janë hipotekuar 27 prona, ndërsa për pjesën tjetër të pronave nuk është bërë përditësimi i të dhënave të inventarit të këtyre pronave.

Nga Bashkia Malësi e Madhe nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve.

**h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:** Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Bashkia Malësi e Madhe në lidhje me *zbatimin e kontratave të punimeve të ndërtimit* të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, nga sipërmarrësit e punimeve arkëtimin e vlerës prej 5,698,374 lekë të faturuara dhe të paguara nga AK, të konstatuar dëm ekonomik nga mos kryerja e punimeve.

- Titullari I AK Bashkia Malësi e madhe, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e OE, të cilët nuk plotësojnë kriteret kualifikuese të përcaktuara në DT, me pasojë lidhjen e kontratës me OE të shpallur fitues në kundërshtim me legjislacionin e Prokurimit Publik, për vlerën 298,940,951 lekë.

- Bashkia Malësi e Madhe në lidhje me të ardhurat të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për:

- Arkëtimin e detyrimeve nga subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe familjarë në vlerën 106,824,471 lekë.

- Arkëtimin e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, në vlerën 20,263,481 lekë.

- Bashkia Malësi e Madhe në lidhje me *hartimin e pasqyrave financiare*:

- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Malësi e Madhe nëpërmjet inventarit fizik dhe kontabël të plotësojë të dhënat e aktiveve apo grupaktiveve AA të llogarive 210 “Toka, Troje, Terrene”, 211 “Pyje, Plantacione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” dhe të kryejë veprimet e sistemit në kontabilitet në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2024, për kalimin e vlerave të aktiveve sipas llojit përkatës, duke i evidentuar në llogaritë e përshtatshme sipas klasifikimit të Nomenklaturës së Llogarive të Planit Kontabël Publik, si dhe të bëhen korrektimet e nevojshme në llogaritjen e amortizimit..

### 3. Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

#### **I- Opinioni i auditimit financiar:**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Malësi e Madhe për vitin e ushtrimor 2023, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet në relacionin për llogaritë, që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmitë mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një *opinion të pa modifikuar/kualifikuar me theksim të çështjes* për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Malësi e Madhe, të cilat rezultojnë në opinionin tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “*Bazës për opinionin e pa modifikuar/kualifikuar me theksim të çështjes*”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale (pa anomali materiale), pozitën financiare të shoqërisë më 31 dhjetor 2023, në përputhje me bazën ligjore që rregullon raportimin financiar dhe atë buxhetor mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare, por ekzistojnë aspekte që duhen theksuar.

#### **Baza për opinionin e pa modifikuar/kualifikuar me theksim të çështjes:**

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar,

të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare-Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 16,048 mijë lekë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2023 kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare nuk përmbanin gabime materiale, por ekzistojnë aspekte që duhen nënvizuar, fakt ky që përbën bazën për opinion (ISA-705; ISSAI-1705). Këto aspekte nuk konsiderohen materiale, prandaj vetëm meritojnë evidentim, si theksim çështjesh, të trajtuara në paragrafin e mëposhtëm:

- Nga shqyrtimi i analizave të llogarive të Aktiveve Afatgjata në pasqyrat financiare në mbyllje të vitit 2023 rezultuan veprime të gabuara kontabël, të cilat ndikojnë në pasqyrimin e pasaktë dhe të pa plotë të gjendjes së këtyre aktiveve në llogaritë:

- Llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” konstatohet se në gjendjen e kësaj llogarie janë përfshirë në mënyrë të gabuar vlera prej 3,961,007 lekë e 2 aktiveve, të cilat sipas verifikimit të investimeve të kryera i përkasin llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”.

- Llog. 211 “Pyje, Plantacione” konstatohet se, në gjendjen e kësaj llogarie janë përfshirë 4 aktive me vlerë 10,743,076 lekë, që nuk kanë emërtime të plota dhe të sakta se kujt NJA apo apo objekt investimi i përkasin, si dhe mungojnë të dhëna të detajuara inventariale për to.

- Llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” konstatohet se, në gjendjen e kësaj llogarie janë përfshirë në mënyrë të gabuar vlera prej 3,664,911 lekë e 3 aktiveve, të cilat sipas verifikimit të investimeve të kryera i përkasin llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”. Gjithashtu në këtë gjendje janë përfshirë 11 aktive me vlerë 105,767,829 lekë, që nuk kanë emërtime të plota dhe të sakta se kuj NJA apo objekt investimi i përkasin, si dhe mungojnë të dhëna të detajuara inventariale për to.

- Bazuar në VKM nr.302, datë 11.05.2023 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura” dhe marrëveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësjetës Kanalizime Shkodër, Ujësjetës Kanalizime sha Malësi e Madhe i është bashkëngjitur Ujësjetës Kanalizime Shkodër. Referuar analizës të gjendjes së llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” rezulton se, nuk është zbritur vlera e investimeve të kryera në ujësjetës që duhej të transferohej tek Ujësjetës Kanalizime SHA Shkodër, për 24 aktive dhe pjesë aktivesh në vlerën 1,524,931,322 lekë (përfshirë investime në ujësjetës e rrjetin shpërndarës, KUZ, depo dhe pompa uji).

- Gjendja e llogarisë 475 “Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 116,204,628 lekë, vlerë e cila i përket llogarisë kundërparti 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit. Në fakt në llogarinë 475 “Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse” evidentohen të ardhurat që janë arkëtuara përpara ngjarjes ose veprimt qe krijon të ardhura, prandaj vlera prej 116,204,628 lekë e debitorëve duhej të ishte pjesë e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin ( detyrime)”.

- Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 8,335,985 lekë lekë të 28 faturave të papaguara të hershme, ndërkohë që gjendja e llogarisë 401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 233,514,778 lekë, e cila përbëhet nga vlera prej 99,003,050 lekë e 27 faturave detyrime të prapambetura të raportuara dhe në MF, nga vlera prej 132,242,857 lekë e 25 faturave të investimeve te buxhetuara për financim në periudhën 3-vjeçare (PBA), si dhe vlera prej 2,268,871 lekë e 13 faturave të pa likuiduara për mallra dhe shërbime të periudhës së fundvitit ushtrimor. Vlera pjesore prej 99,003,050 lekë e detyrimeve të krijuara në periudha kohe para nëntor-dhjetorit të vitit ushtrimor të mbyllur, duhet të jetë pjesë e gjendjes e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, pasi klasifikohen si detyrime të prapambetura.

-Debitorë të pa kontabilizuar në pasqyrat financiare të Bashkisë Malësi e Madhe në vlerën prej 10,617,581 lekë, që i përket subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve; subjekteve të pajisur me adresë sekondare dhe debitorëve nga qeradhënia e aseteve.

## **II. Opinioni mbi përputhshmërinë.**

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Malësi e Madhe, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës për periudhën 01.01.2023-31.12.2023.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Malësi e Madhe, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin “Baza për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni **të modifikuar** për përputhshmërinë.

### **Baza për dhënien e opinionit të modifikuar:**

Opinionin e dhënë e mbështesim në anomalitë e konstatuara, si më poshtë:

Nga auditimi i 12 procedurave të prokurimit me vlerë të fondit limit 311,595 mijë lekë u konstatua se:

- Në 11 procedura, me fond limit 290,427,411 lekë pa TVSh, janë vendosur kriteret kualifikuese që nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet;
- Në 11 procedura, me fond limit 298,940,951 lekë pa TVSh, janë kualifikuar dhe shpallur fitues OE/BOE që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në DT, me pasojë lidhjen e kontratave për vlerën 344,475,253 lekë pa TVSh, në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor në fuqi.
- Nga auditimi i zbatimit të kontratave në 9 objekte, rezultoi dëm ekonomik në vlerën 5,698,374 lekë pa TVsh, si rezultat i diferencave në volume pune;
- Për vitin 2023, si periudhë nën auditim, realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Malësi e Madhe, janë realizuar në masën 87%, nga 149,296,000 lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 130,279,762 lekë;
- Për mos pagesën e detyrimeve tatimore deri në datën 31.12.2023, janë debitorë 10826 abonentë familjarë, në vlerën totale 50,439,387 lekë, nga e cila, vetëm për vitin 2023 është vlera e detyrimit 14,553,997 lekë.
- Për mos pagesën e detyrimeve tatimore deri në datën 31.12.2023, janë debitorë 323 subjekte fizikë/juridikë, në vlerën totale 36,121,603 lekë, nga e cila, vetëm për vitin 2023 është vlera e detyrimit 4,689,987 lekë.
- Për mos pagimin e taksës së infrasktrukturës janë debitorë në total 299 subjekte në vlerën 20,263,481 lekë, nga të cilët, për vitin 2023 janë 39 subjekte me vlerë të detyrimit 1.296,614 lekë.

## **II. HYRJA**

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të programit të auditimit nr. 701/1 Prot., datë 31.05.2024, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 03.06.2024, deri më 19.07.2024, në institucionin Bashkia Malësi e Madhe u krye auditimi “Financiar dhe i Përputhshmërisë”. Auditimi mbuloi periudhën prej datës 01.01.2023 deri me datën 31.12.2023.

Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A.Z (Përgjegjës grupi)
2. I. SH, anëtar
3. G. K, anëtar
4. E. K, anëtar
5. S.D, anëtar.

## **1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit**

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Malësi e Madhe kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315);
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Malësi e Madhe është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

## **2. Identifikimi i çështjes.**

Projekt Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Malësi e Madhe, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

- Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.
- Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
- Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2023.
- Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 dhe zbatimin e kontratave 01.01.2023-31.12.2023.
- Mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin e pronës publike.

## **3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Malësi e Madhe, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

## **4. Përgjegjësitë e audituesve.**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të

Auditimit sipas INTOSAI-t, të cilat kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionit i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo Ligji i prokurimit publik, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e mëparshme;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).

Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidencat auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Malësi e Madhe, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

## **5. Kriteret e vlerësimit**

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Malësi e Madhe është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Malësi e Madhe. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152-2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”;
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- Ligjin nr.20/2020 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në

Republikën e Shqipërisë”;

- Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar  
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;

- VKM nr.500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe ransferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendor”

- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;

- VKM nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar;

- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave përndërtimet pa leje dhe vleravetë zbatueshme për legalizim;

-VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime;

- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;

- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar;

- VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, I ndryshuar;

- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

- UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;

- UMF nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;

- UMF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”;

- UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”;

- UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me MFE nr.05 datë 21.02.2022;

UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;

-Udhëzim i KM nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”;

-Manuali i Auditimit të Brendshëm në sektorin publik i miratuar me urdhrin e Ministrit të MFE nr. 100, dt. 16.10.2017.

- Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike

▪ *Rregullore e brendshme “Mbi procedurat e auditimit në KLSH”;*

▪ *Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së”;*

▪ *Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.*

▪ *Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;*

➤ *Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.*

## **6. Standardet e auditimit.**

Për kryerjen e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Malësi e Madhe grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

➤ ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;

- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC.

## **7. Metodatat e auditimit.**

Auditimi i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologjia e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe
- Peshat specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Ndjekja dhe zbatimi i hapave të mësipërm do të sjellin natyrshëm përcaktimin e elementëve kryesorë që do të ndiqen gjatë procesit të zbatimit të projektit të auditimit, nëpërmjet sigurimit të gjurmës së projektit të auditimit. Gjurma e auditimit është dokumentimi i procesit të realizimit të Projektit të Auditimit. Evidentimi i zbatimit të procedurave të auditimit nëpërmjet dokumentimit përfshin të gjitha fazat e kryerjes së Projektit të Auditimit që nga Planifikimi i Auditimit, Puna në Terren, Raportimi i Auditimit, Ndjekja e Rekomandimeve dhe Publikimi i Auditimit. Thëksojmë se nga ana jonë do të auditohen pothuajse të gjitha fondet, si më poshtë:

### ▪ Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

### ▪ Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

### ▪ Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

### ▪ Kontrolli i vlerësimeve

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

### ▪ Konfirmimi nga të tretët

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

- Kontrrolli sipas një treguesi

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, të cilat përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

- Intervista

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Malësi e Madhe me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

- Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim

- Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrolleve është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në modelin e riskut që aplikon KLSH-ja<sup>1</sup>.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të riskut të auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetentë dhe të mirë informuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

---

<sup>1</sup> Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm \* Risku i kontrollit \* Risku i Zbulimit

## 8. Dokumentimi i auditimit.

Mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “Dokumentimi i auditimit”, nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera tërëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akt Konstatimeve dhe Akt Verifikimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Projektraport Auditimi.

## III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

### 1. Informacion i përgjithshëm

Bashkia Malësi e Madhe kufizohet në pjesën veriore dhe perëndimore me Malin e Zi, si dhe pjesën jugore dhe lindore me Bashkinë Shkodër. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Koplikut. Bashkia Malësi e Madhe është pjesë e Qarkut Shkodër dhe përbëhet nga 6 njësi të qeverisjes vendore, Koplik, Gruemirë, Kastrat, Kelmend, Qendër dhe Shkrel. Në përbërjen e tyre këto njësi administrative përfshijnë gjithsej dy qytete Koplik dhe Bajz, si dhe 56 fshatra.

Bashkia	NjA	Qytete dhe fshatra përbërëse
Malësi e Madhe	Koplik	Qyteti Koplik
	Gruemirë	16 fshatra
	Kastrat	Qyteti Bajzë dhe 12 fshatra
	Kelmend	8 fshatra
	Qendër	8 fshatra
	Shkrel	12 fshatra

### Organizimi i Bashkisë Malësi e Madhe:

Bashkia NJA Qytete dhe fshatra përbërëse Malësi e Madhe Koplik Qyteti Koplik Gruemirë 16 fshatra Kastrat Qyteti Bajzë dhe 12 fshatra Kelmend 8 fshatra Qendër 8 fshatra Shkrel 12 fshatra Organizimi i Bashkisë Malësi e Madhe.

Bashkia Malësi e Madhe kufizohet në veri me kufirin me Republikën e Malit të Zi, në juglindje me Bashkinë Shkodër dhe perëndim me Liqenin e Shkodrës. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Koplikut. Sipas Censurit të vitit 2011, Bashkia Malësi e Madhe ka 30823 banorë, ndërsa në Regjistrin Civil popullsia e regjistruar është 56026 banorë. Bashkia ka një sipërfaqe prej 951.01 km<sup>2</sup>. Në bazë të popullsisë së numëruar nga censusi, densiteti i popullsisë së bashkisë është 32.41 banorë për kilometër katror ndërsa në bazë të regjistrit civil densiteti rezulton 58.91 banorë/ km<sup>2</sup>.

Të ardhurat kryesore të banorëve vijnë nga sektori i bimëve medicinale, në të cilin janë punësuar shumë prej banorëve të zonës. Gjithashtu, njësitë e tregtimit dhe shërbimeve janë një tjetër sektor ku janë punësuar shumë prej banorëve të qytetit të Koplikut. Sa i takon zonave rurale, të ardhurat fitohen kryesisht nga prodhimet bujqësore dhe blegtorale.

### 2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit

## 2.1 Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

Në zbatim të nënpikës 1.1 të programit të auditimit: “Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullorja e brendshme e miratuar;
2. Kod i brendshëm etik ose një kod sjellje, apo udhëzim për zbatimin e etikës;
3. Strukturën organike të institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
4. Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
5. Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;
6. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre;
7. Strategjinë dhe Regjistrin e Riskut;
8. Lista ose harta e proceseve të punës;
9. Raportet e Monitorimit;
10. Pyetësi i Vetëvlerësimit dhe a është dërguar në Ministrinë e Financave.

Drejtimet kryesore të auditimit të MFK-së janë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.
- Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi/ Komunikimi, si dhe Monitorimi.
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Malësi e Madhe, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i Kontrollit”, “Menaxhimi i Riskut”, “Aktivitetet e Kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

### **I. Komponenti “Mjedisi i Kontrollit”.**

- Mjedisi i kontrollit është bazë e menaxhimit të fondeve dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm i cili përmban:
  - ✓ **Në lidhje me parimin 1 “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”.**
  - Mjedisi i kontrollit është pjesë esenciale e menaxhimit financiar dhe atij të kontrollit, i cili garanton vendosjen e objektivave të nevojshme të cilat çojnë në realizimin e misionit të institucionit që është integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe e punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe performanca në punë; Struktura organizative, garantimi në ndarjen e detyrave, hierarkia dhe rregullat e përcaktuara

qartë, të drejtat, kompetencat dhe linjat e raportimit; Mënyra për mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore dhe profesionalizmi i punonjësve në tërësi.

- Struktura organizative, garantimi në ndarjen e detyrave, hierarkia dhe rregullat e përcaktuara qartë, të drejtat, kompetencat dhe linjat e raportimit.

- Është hartuar dhe miratuar Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë Malësi e Madhe me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Urdhër nr. 36 prot., datë 05.01.2023 rregullorja e brendshme “Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Malësi e Madhe dhe Njësi Administrative” pjesë e të cilës është dhe Kodi i Etikës. Mënyra sipas së cilës stafi njihet me rregulloren si dhe bazën ligjore në fuqi, zhvillohet në formë individuale, dhe jo në bazë të trajnimeve.

➤ Në nenin 24 të rregullores së brendshme janë përcaktuar veprimet që parandalohen, të gjitha detyrimet dhe normat e sjelljes. Ndërsa përsa i përket rasteve ku vihen re parregullsi, mashtrime, apo veprime korruptive, të cilat nuk janë përfshirë në Rregulloren e Brendshme, duhet thënë që mungon një procedurë e saktë për sinjalizimin dhe evidentimin e tyre. Ndërsa për ndëshkimin e rasteve që përbëjnë shkelje ndiqen procedurat e masave disiplinore, të parashikuara në legjislacionin për shërbimin civil dhe kodin e punës. Nga bashkia raportohet se nuk ka pasur raste të shkeljes së etikës.

- Përsa i përket programeve të trajnimit dhe përmirësimit të anës profesionale, punonjësit kanë mangësi në njohuritë e tyre në lidhje me kuadrin rregullator ligjor mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, veprime këto në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli III, pika 3.1.

- Ankesat që vijnë nga jashtë depozitohen zyrtarisht, pranë institucionit (në sportelet e Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun), duke i'u adresuar strukturave të Bashkisë sipas problematikave, të cilat duhet të trajtohen, ndërsa kërkesat dhe përgjigjet firmosen nga Drejtorët, sipas sektorit përkatës që ka shqyrtuar problematikën, në përputhje me Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e informimit” dhe Urdhrin e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore”. E gjithë procedura është e përcaktuar në pikën 14 të nenit 23 të Rregullores së Brendshme.

- Referuar Ligjit nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë”, vlerësimi i punonjësve, të cilët kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip njëherë në 6 muaj. Gjithashtu ka vlerësime vjetore dhe për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune me këtë procedurë merren burimet njerëzore.

- Është dërguar Raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për Bashkinë Malësi e Madhe për vitin 2023, me shkresën nr.628/1 prot, datë 28.02.2024.

Është dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik me shkresën nr. 628/2 prot., datë 28.02.2024 raportimimi mbi komponentët të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

**Në lidhje me parimin 2** “Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”.

Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA) Bordi apo Këshilli i Drejtuesve duhet të sigurojnë mbikëqyrjen dhe monitorimin mbi aktivitetin e çdo drejtori/sektori dhe të çdo punonjësi, me integritet personal dhe etikë profesionale, duke përjashtuar çdo konflikt interesi në kryerjen e detyrave funksionale, në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, dhe kontrollin”

Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë të saj.

- Ka raporte periodike të monitorimit të planit të veprimit për KB, analizës së veprimtarisë të Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme është përcaktuar mënyra e hartimit, miratimi, ndjekja e raportimi i realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NJA si dhe Drejtorët e Njësisë të Varësisë drejtuar Nënkrjetarëve të bashkisë sipas fushave që ata mbulojnë.

- Për çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse nuk janë mbajtur procesverbale e protokoll.

- Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

- Për vitin 2023 ka plan-veprimi për MFK, i cili të përfshijë aktivitete të planifikuara, afatet e realizimit, struktura përgjegjëse dhe lidhjen me komponentin e sistemit, mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

-Nga njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit janë hartuar çdo 4 - muaj, ka raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit të fondeve dhe analizat faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak.

- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit janë hartuar periodikisht dhe janë paraqitur pranë këshillit bashkiak si dhe në MFE. Ka Raportime periodike vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit të fondeve dhe analizat faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak.

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

- Ndërsa nga shoqëritë e përbashkëta, ku bashkia është aksionere dhe nga ndërmarrjet në varësi të saj, Bashkia merr raportime në lidhje me vendim-marrjen e këshillit drejtues, por mungojnë raportimet periodike për performancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat, përveç raportimeve financiare për efekt argumentimi subvencionit.

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga Auditi i Brendshëm ose i jashtëm nëpërmjet veprimtarisë audituese. -Këshilli Bashkiak me kompetencat e tij në përmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së Bashkisë.

✓ ***Në lidhje me parimin 3*** “Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”.

-Është hartuar Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Malësi e Madhe me Vendimin e Kryetarit nr. 36, datë 05.01.2022.

-Organigrama e Bashkisë Malësi e Madhe është e ndërtuar në mënyrë të tillë që, 2 nënkryetarë dhe 7 drejtuesit e Drejtorive kryesore, bashkë me Administratorët e NJA e Titullarët e institucioneve të varësisë, varen direkt nga Kryetari, ku dhe llogaridhënia është direkt tek Kryetari i Bashkisë në vijë horizontale. Nga niveli më i ulët specialist, përgjegjës sektori, llogaridhënia është në vijë vertikale.

-Në Rregulloren e Brendshme janë përfshirë baza ligjore, që i përket gjithë fushave të veprimtarisë së saj. Për çdo drejtori janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialisti.

-Ne Rregulloren e Brendshme nuk janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë.

-Mënyra e informimit të stafit punonjës me rregulloren e brendshme, është kryer me metodën shkresore dhe elektronike.

Për vitin 2023 është miratuar struktura sipas Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr.184 datë 19.12.2022 “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Bashkisë Malësi e

Madhe, Njësive Administrative dhe Funksioneve të Deleguara”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.73 datë 28.12.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar të nëpunësve civilë, të punonjësve administrativë për vitin 2023 të Bashkisë Malësi e Madhe, Njësive Administrative dhe Funksioneve të Deleguara” të ndryshuar dhe të miratuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr.61/1 prot datë 19.01.2023, gjithsej janë miratuar 502 pozicione pune. Sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak me nr.11 datë 20.07.2023 “Për disa ndryshime në VKB nr.73 datë 28.12.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar të nëpunësve civilë, të punonjësve administrativë për vitin 2023 të Bashkisë Malësi e Madhe, Njësive Administrative dhe Funksioneve të Deleguara” dhe të miratuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr.503/1 datë 31.07.2023, janë shtuar katër pozicione pune dhe numri total i miratuar i punonjësve të bashkisë është 506 punonjës. Për 103 pozicione pune, marrëdhëniet e punës rregullohen nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. 11 pozicione pune, janë të zgjedhur dhe funksionarë kabineti. 392 pozicione pune, janë punonjës administrativë (punonjës që kryejnë veprimtari administrative, sekretarie, mirëmbajtje, shërbimi, ruajtje, etj.) dhe marrëdhëniet e punës rregullohen nga ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Referuar procedurave për emërimin e punonjësve të shërbimit civil konstatohet se janë punësuar 62 punonjës me kontratë pune ose me akte emërimi të përkohshëm, pa zhvilluar procedura konkurimi.

**- Vakanca e pozicioneve të rëndësishme.**

- Në strukturën e Bashkisë nuk rezulton i emëruar Sekretari i Përgjithshëm, i cili është nëpunësi civil më i lartë i administratës së bashkisë, edhe pse në rregulloren e miratuar me Vendimin nr.36, datë 05.01.2023, pozicioni dhe detyrat e këtij funksionari janë të përcaktuara qartë. Vakanca e këtij pozicioni duke parë dhe rëndësinë e detyrave funksionale që ai ka, rrezikon të krijojë probleme në zhvillimin e një veprimtarie normale të përdishme nga Titullari i Bashkisë.

-Mungon vendimmarrja nga titullari i bashkisë për krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenin 12, pika (b) të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”

- Nga sa më lart konstatohet se për vitin 2023, ka mangësi për pozicionet kryesore drejtuese si dhe ka pasur ndryshime të shpeshta të strukturës, në numrin e saj, ç’ka në gjykimin e grupit të auditimit ndikon negativisht në performancën dhe realizimin e objektivave institucionale, duke mos pasur qëndrueshmëri në numrin e punonjësve dhe duke krijuar kështu paqartësi si pasojë e ndryshimeve të shpeshta.

-Bashkia Malësi e Madhe ka faqen e saj zyrtare në Web në të cilën janë paraqitur të gjitha informacionet e njësisë vendore si dhe dokumentat e rëndësishme.

-Mungon raporti i vlerësimit nga Njësia e Auditit të Brendshëm për përputhjen e rregullores me strukturën organike.

✓ **Në lidhje me parimin 4** “Njësia publike demonstron angazhimin në realizimin e kompetencave”.

-Nëpunësit e Bashkisë Malësi e Madhe i rregullojnë marrëdhëniet e punës në nivel drejtorie, përgjegjës sektori apo specialist, me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij, për sa i përket punonjësve administrative dhe terrenit (inspektor terreni, punonjës bujqësie, topograf, inxhinier pyjesh, inspektor pyje, kullota, punonjës sporti etj.) i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Referuar Kreut II, të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010, ku përcaktohet:

- Një procedurë transparente për rekrutim;
- Krite dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit;
- Një sistem trajnimi dhe kualifikimi;
- Një sistem për vlerësimin e performancës;

-Në rregulloren e brendshme të institucionit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune nuk është përcaktuar plani i rekrutimit të tyre. Nga informacioni i marrë nga grupi i auditimit pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore rezultoi se; rekrutimi i punonjësve është kryer në përputhje me ligjin e Shërbimit Civil. Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale e cila përmban të dhënat mbi krijimin e marrëdhënies së punës, arsimimin, kualifikimin, masa disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve në punë. Dokumente përkatëse që vërtetojnë gjëndjen familjare, diploma e shkollës së lartë, lista e notave, çertifikata për kualifikime të ndryshme, dëshmi e gjuhëve të huaja, etj.

-Nuk ka përshkrime detyrash individuale e cila do të evidentonte ngarkesën konkrete me punë, si dhe kërkesat lidhur me kualifikimet e nevojshme për secilin nëpunës.

- Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit. Programi vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit bëhet në bashkëpunim me ASPA (Shkolla e administratës publike).

- Për prokurimet publike u konstatuan mangësi në trajnimin periodik të burimeve njerëzore të përfshirë në komisionet e prokurimit publik, komisionet për blerjet e vogla, njësinë e prokurimeve dhe KVO-të për kontrata, mallra dhe punë.

- Për bashkinë, nëpunësi autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor.

- Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin, të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Financës.

✓ **Në lidhje me parimin 5** “Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”.

- *Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).*

- Çdo titullar i njësisë publike duhet të krijojë Grupin e Menaxhimit Strategjik, (në vijim GMS) me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë. GMS është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike, si dhe luan një rol kyç përsa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike. GMS duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë dhe të garantojë se komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit efektiv të riskut janë të pranishëm dhe se funksionojnë me efektivitet brenda njësisë.

-Në zbatim të nenit nr. 24 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar; ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore”, është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr.22 datë 28.01.2022 “Për ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin e Strategjive Buxhetore dhe Integrimin”. Lidhur me përbërjen e GMS, në përgjithësi ajo është sipas përcaktimit të bërë në pikën 30 të Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore”, ku drejtuesi i GMS është Kryetari i Bashkisë, si dhe ka përfaqësues nga të gjitha drejtoritë e Bashkisë.

- Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) rezultoi se në Bashkinë Malësi e Madhe nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”.

- Nuk administrohen procesverbalet e takimit të GMS, për të dokumentuar funksionimin e këtij grupi.

- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatori të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

- Në Rregulloren e Brendshme është parashikuar “Delegimi i kompetencave” në zbatim të ligjit 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative” si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokollit i institucionit rezulton se, nga NA për periudhën objekt auditimi ka patur raste për delegimin e detyrave.

## **II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”**

✓ *Në lidhje me parimin 6:* Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre.

Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative e veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes. Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësive dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Titullari i njësisë publike është përgjegjës për zhvillimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e riskut brenda njësisë së tij. Analizimin dhe rifreskimin e kontrolleve që synojnë minimizimin e riskut, sipas strategjisë së riskut. Koordinator i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Koordinator i Riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në përmbushje të përgjegjësisë së tij, nëpunësi autorizues mund të delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinimin e riskut, punonjësve që janë pjesë e strukturës së financës, funksion i cili i është deleguar drejtorit të financës.

Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vetëvendosura. Strategjia e riskut është përcaktuar si qasje organizative në drejtim të menaxhimit të riskut nga ana e titullarit të institucionit dhe e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë dhe më tej. Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si duhet të sillen institucioni i ndarjes se risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat për menaxhimin dhe për kontrollimin e risqeve, si duhet të trajtohen risqet në nivel strategjik, në nivel programi dhe në nivel aktiviteti, strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e tij, kriteret për përcaktimin e risqeve madhore, mekanizmat e regjistrimit të riskut si dhe kriteret për matjen e riskut.

- Nga Bashkia Malësi e Madhe përcaktohen objektiva sasior (vlerë monetare) vetëm në hartimin e PBA-ve dhe buxheteve vjetore. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se nga Bashkia Malësi e Madhe nuk ka plane operationale të punës, si dhe nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik i zhvillimit (afat 5 vjeçar) të Bashkisë Malësi e Madhe, sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr.68/2017 “Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.

-Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë, por këto mospërputhje janë të vogla, kryesisht në planin e buxhetit vjetor me planin e buxhetit të parashikuar në PBA.

✓ *Në lidhje me parimin 7:* “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.

-Në Bashkinë Malësi e Madhe nuk është krijuar strategjia e menaxhimit të riskut, si dhe nuk ka një strukturë të miratuar dhe një koordinator të deleguar të riskut.

-Nuk janë krijuar mekanizmat për vlerësimin e riskut.

-Sa më sipër konstatohet se, për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t'u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre. Këto mosveprime janë në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar ku citohet se: "Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut".

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk punon me sistem HRMIS, por me hedhje manualisht në programin Microsoft Office Excel. Hedhja, pasqyrimi i të dhënave personale dhe profesionale të çdo punonjësi të punësuar kryhen nëpërmjet programit Excel- it apo Word- it.

- Në Bashkinë Malësi e Madhe, po ashtu Drejtoria Ekonomike përmbajtjen e Kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave e cila kryhet nga sektori i financës, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Në bazë të këtij programi me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria e Ekonomike dhe hartimi i Pasqyrave Financiare, gjithashtu edhe Sektori i Tatim-Taksave operon me programin Excel për monitorimin e të ardhurave. Për çdo muaj dhe vit kryhen akt-rakordimet me Degën e Thesarit për të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe me Agjentët Tatimorë.

✓ **Në lidhje me parimin 8:** "Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime".

-Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

**Në lidhje me parimin 9:** "Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm".

- Bashkia Malësi e Madhe nuk ka një sistem të kontrollit të brendshëm.

### **III. Komponenti: "Aktivitetet e Kontrollit"**

✓ **Në lidhje me parimin 10:** "Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli".

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, krahas detyrave, janë identifikuar pak a shumë edhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, si procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj.

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Drejtori i financës, hartimi dhe regjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit të Financës, ndërsa Autorizimi i pagesës nga NA.

- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit të komisionit të përlllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/punimeve/shërbimeve.

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurmën e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumenta autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacione takt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj., të vulosura nga dega e Thesarit dhe kalimin e veprimit financiar, pasi ka bërë çeljen e fondeve sipas kërkesës së institucionit, duke konfirmuar fondet disponibël.

- Nuk ka gjurmë auditimi mbi aktivitetin e përputhshmërisë të njësisë të strukturave të prokurimit të cilat veprojnë në Bashkinë Malësi e Madhe.

- Për planifikimin e territorit u konstatua mosrespektimi i kuadrit rregullator në fushën e dhënies të lejes së ndërtimit.

- Në Rregulloren e Brendshme për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë të urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e Zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit në bashkinë Malësi e Madhe. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.

- Në përgjithësi për procedurat e inventarizimit, vlerësimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të AAGJM, ka gjurmë auditimi, pasi ekziston dokumentacioni i firmosur nga komisionet dhe punonjësit përkatës si: Urdhri i NA për ngritjet e komisionit të inventarizimit, vlerësimin dhe nxjerrjes jashtë përdorimi si dhe për asgjësimin e tyre. Ekzistojnë fletët e inventarit, relacioni i vlerësimin për aktivet për nxjerrje jashtë përdorimi, procesverbale dhe relacionet për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve dhe procesverbalet për asgjësimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi. Janë prerë dokumentet bazë (fletë-daljet) dhe kryer veprimet kontabël përkatës.

-Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Malësi e Madhe, kurse një pjesë e taksave dhe tarifave arkëtohen nëpërmjet agjentëve tatimorë sipas marrëveshjes së Bashkisë Malësi e Madhe të bërë me këta agjentë. Për këto të ardhura në përgjithësi janë bërë akt-rakordimet përkatëse periodike dhe vjetore dhe janë kontabilizuar.

-Bashkia Malësi e Madhe në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresën ga Bashkia.

-Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 4, pika 20.

✓ ***Në lidhje me parimin 11:*** “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”.

- Bashkia Malësi e Madhe nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

-Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të IT, i cili varet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

-Në Bashkinë Malësi e Madhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish, si dhe nuk ka sisteme kompjuterike të liçencuara.

-Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT.

-Në strukturën e Bashkisë Malësi e Madhe është vetëm 1 specialist IT, duke sjellë që i njëjti person të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të IT-së, si instalimin e softuerit,

programimin, testimin, menaxhimin e Serverit qendror, sigurimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve TIK etj.

✓ **Në lidhje me parimin 12:** “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.

-Në rregulloren e brendshme nuk janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë të Drejtorëve dhe Përgjegjësve të sektorëve, ku vihen re mbivendosje/mbingarkesë të funksioneve.

- Me vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve merret Drejtoria e Financës, duke i'u referuar dispozitave ligjore në fuqi dhe rregullores së brendshme.

- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e list pagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e Drejtorisë Ekonomike.

- Nuk ushtrohet auditim mbi kontabilitetin dhe PF. Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (pra Udhëzimit të MFE nr.8 datë 09.08.2018 “Për hartimin e PF”). Nga Auditi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

#### **IV. Komponenti: “Informimi dhe Komunikimi”**

✓ **Në lidhje me parimin 13:** “Njësia publike merr, gjeneron dhe përdorin formacion cilësor”. Bashkia Malësi e Madhe disponon faqen e saj zyrtare në [ëëë.bashkiamalësiemadhe.gov.al](http://ëëë.bashkiamalësiemadhe.gov.al) ku pasqyrohet aktiviteti i saj si Rregullorja e Brendshme, broshura, planet e performancës, projekte të brendshme dhe të huaja, bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit, aktivitete, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, buxheti vjetor, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve. Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin e prokurimeve, raporte të auditimit, institucionet e varësisë.

Në Bashkinë Malësi e Madhe janë kryer konsultime me publikun dhe palët e interesit për hartimin e “Projekt Paketës Fiskale 2023”, si dhe për prezantimin e programeve “Buxhetore Afatmesme”.

✓ **Në lidhje me parimin 14:** Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor.

Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me shkrim, postë elektronike dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik.

✓ **Në lidhje me parimin 15:** Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm.

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në nenin nr. 23 “Marrëdhëniet me publikun”.

Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme.

- Grupi auditues konstaton se nuk e kanë të gjithë punonjësit mundësinë e përdorimit të emailit zyrtar të institucionit duke qenë se sistemi ofron një numër të kufizuar adresash email-i.

### **-Komponenti: “Monitorimi dhe Raportimi”**

✓ **Në lidhje me parimin 16:** “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”.

- Proçedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion nuk konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, nuk administrohen plotësisht raportimet e drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili duhet të hartohet çdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

- Bashkia Malësi e Madhe lidhur me pyetësin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë, ka raportuar në MFE, brenda afateve të përcaktuara në nenin 18 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

- Në Bashkinë Malësi e Madhe mungojnë rregullat të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

-Në Bashkinë Malësi e Madhe aktivitetet e vlerësimit të njësisë nuk janë në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë raportet e zbatimit për planet e menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të përfomancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave të përshtatshmerisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

✓ **Në lidhje me parimin 17:** “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”.

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

### **2.1.2 Mbi vlerësimin e veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm.**

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit: “Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm. *Nënpika 1.2 dhe 1.3 Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm dhe Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.*”

#### **“Baza Ligjore”**

-Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;

-Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016,

VKM nr. 83, datë 03.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, me VKM nr. 353/2016.

-Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”.

Tabela nr. AB1, Struktura e Auditit të Brendshëm me të dhënat sipas tabeles.

		Të dhëna për Audituesita Brendshëm	
		Ekspierenca e	Zhvillimi Profesional

Nr.	Emër mbiemër	Pozicioni	Arsimi	PunësVitet e Punës nëAB	Certifikimi			TrajnimenëfushëneAB	
					I Pa certifikuar	Në proces certifikimi	I certifikuar në vitin	NgaInst. Kombëtare ose Ndërkombëtare	Publikime në fushën e AB
1	TT	Përgjegjës	Master Ekonomi	7			30.09.2017	06-08 .04. 2022 Financat Lokale 12-16.12.2022 Trajnim i vazh/ Nga DRAB	
2	Sh Sa larguar Dt.22.05.2023	Audituese	Master Ekonomi	7			06.07.2018	06-08 .04. 2022 Financat Lokale 12-16.12.2022 Trajnim i vazh/ Nga DRAB	
3	D Xh	Audituese	Master Jurist	4			Vendim nr.39, datë 01.10.2021	12-16.12.2022 Trajnim i vazh/ Nga DRAB	
4	J H Emëruar Dt.03.10.2023	Audituese	Master Ekonomi	-	-				

*Burimi: Bashkia Malësi e Madhe Njësia e Auditit të Brendshëm.*

### **Plani strategjik:**

Planet Strategjike dhe Vjetore të NJAB të Bashkisë Malësi e Madhe janë përcjellë në Ministrinë e Financave brenda afateve të përcaktuara në Ligjin 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, në “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” Për vitin 2023 është miratuar nga Titullari i Bashkisë me shkresën nr.2929 dt. 05.10.2022 plani vjetor dhe ai strategjik për vitet 2023-2025 të veprimtarisë së Auditit të Brendshëm dhe i është dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.

**Raportimi:**Për veprimtarinë e NJAB në Bashkisë Malësi e Madhe për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike. Janë hartuar dhe dërguar në NJQHAB te MFE raportet periodike vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB, përkatësisht për vitin 2023 me shkresën nr.518 prot., datë 15.02.2024. Për veprimtarinë e NJAB në Bashkinë Malësi e Madhe për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike.

**Karta e AB:** Karta e Auditimit të Njesisë AB dhe Urdhëri i Titullarit për miratimin e saj, është ngritur me Urdhërin e Titullarit nr.2233 Prot., datë 07.09.2022.“Për miratimin e kartës së Auditit të Brendshëm” dhe Karta e Auditit të Brendshëm dhe e dërguar pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave me nr.2233 prot date 07.09.2022

**Plani Vjetor:** Për vitin 2023 është miratuar me nr.prot 2929 data:05.10.2022.

### **Për vitin 2023 janë planifikuar 8 auditime janë realizuar 5 auditime si më poshtë:**

- Program angazhimi për Drejtorinë e të Ardhurave, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore) nr.2191 prot., datë 29.08.2023.
- Program angazhimi për Sektorin e Ujitjes dhe Kullimit nr. 1286/2 prot., datë 30.05.2023
- Program angazhimi për Sektorin e M.Z.SH nr.599 prot., datë 27.03.2023.
- Program angazhimi për Sektorin e Mirëmbajtjes të Rrugëve Rurale., nr.33/2 datë 23.01.2023.
- Program angazhimi për Sektorin e Shërbimeve Sociale dhe Ndihmës Ekonomike nr. Prot.1478/2 datë 03.07.2023
- Drejtoria e Finances
- Fondet I.P.A
- Zbatimi i Rekomandimeve

Në tabelën e mëposhtme janë të shprehura në numër të dhënat sipas raportimit si më poshtë:

*Tabela nr. AB2 Të dhënat sipas raportimit.*

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT	
			Nga te realizuarat, sipas llojit

		Auditime ta planifikuara	Auditime te realizuara	Perputh	Financ	Kombinuar	Performace	Tematik	Teknologjisë së informacionit	Zbatim Rekomandime
1	Viti 2023	8	5	5						1

Burimi : *Bashkia Malësi e madhe*

Nga të dhënat sipas raportimit për vitin 2023 janë planifikuar të realizohen 8 auditime përputhshmërie ku 1 nga auditimet ka si tematikë zbatimin e rekomandimeve të lëna nga viti i mëparshëm. Nga auditimet e planifikuara, janë realizuar 5 auditime sipas programeve si më sipër.

Në tabelën e mëposhtme janë të shprehura në numër rekomandimet në bazë të auditimeve të kryera:

*Tabela nr. AB3 Rekomandimet e shprehura në numër.*

Nr.	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT			
		Rekomandime te shprehura ne numër			
		Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
1	Viti 2023	23	15	8	

Burimi : *Bashkia Malësi e madhe*

Nga 5 auditimet e kryera janë dhënë gjithësej 23 rekomandime, nga të cilat 15 rekomandime janë zbatuar dhe 8 rekomandime janë në proces zbatimi.

*Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:*

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura u konstatua se në lidhje me vlerësimin e brendshëm të cilësisë, që kryhet nga vetë NjAB, konstatohet se anekset “Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë” dhe “vetëvlerësimin periodik” nuk janë plotësuar sipas përcaktimeve në pikën 7.1.1 në Kapitullin VII të MAB, të cilat nuk mbulojnë në të gjitha fazat e auditimit si dhe i mungon komponenti i tretë “Reagimet e subjektit të audituar”. Në disa dosje nuk ka gjurmë, nuk dokumentohet dhe nuk administrohet në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Raportit Përfundimtar nga pala e audituar (e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektit të audituar dhe personat e përfshirë në auditim). Gjithashtu në disa dosje të auditimit mungon Memo e planifikimit, pra Projekt Drafti i programit të auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit. Nga Përgjegjësi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm nuk është vepruar konform me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin III, pika 3.2 “Plani vjetor i Auditimit”, që kryhet nga vetë nga kjo njësi. Në programet e auditimit nuk është përfshirë si drejtim “Vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm”, si pasojë audituesit e brendshëm nuk kanë marrë në shqyrtim identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Mungesa e planeve të veprimit ka sjellë mungesën e monitorimit nga NJAB për zbatimin e rekomandimeve nga ana e subjekteve të audituara brenda afateve të përcaktuara, në moszbatim të përcaktimeve të kreut 4.1.13.1 dhe 4.1.13.2 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit”, paragrafi 3, si dhe “Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve”, paragrafi 4; mosraportimit të subjekteve të audituara në moszbatim të Kreut 4.1.13.3 “Përgjegjësitë e njesisë për të zbatuar rekomandimet e auditimit të brendshëm” të “Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”. Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk janë marrë masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Titullarit të njesisë publike në arritjen e objektivave, pasi planet vjetore nuk janë hartuar bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, veprime në kundërshtim me nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Mungon dhënia e opinionit në Projekt Raport dhe Raportin Përfundimtar të Auditimeve për të gjithë auditimet e kryera sipas Standardi 2450 - Opinionet e Përgjithshme, në kundërshtim me Urdhërin nr.4, datë 10.01.2020 i Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”. Nuk është realizuar

planit auditimeve sipas numrit të miratuar. Nga 8 auditime të parashikuara janë realizuar vetëm 5 prej tyre. Gjithashtu konstatohet se, nuk mbahen elektronikisht dosjet e përhershme për çdo njësi publike të audituar me qëllim për t'i shërbyer auditimit pasardhës, veprim që bie në kundërshtim me MAB, Kapitulli nr. VI, pika 6.3.

*Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar më sipër, llojin e mangësive të identifikuar si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, ngarkohen me përgjegjësi: Z. T. T, me cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të NJAB.*

## **2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.**

Në zbatim të Programit të Auditimit cituar më sipër, pika 2, u auditua *planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 993, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjet vjetore për buxhetin e shtetit të vitit 2023, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.*

Dokumentacioni që u shqyrtua për auditimin e kësaj pike të programit të auditimit është si vijon:

- PBA 2023-2025;
- Projekt-buxhetin e miratuar për vitin 2023;
- Vendimet e KB "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë" për vitin 2023;
- Vendime të tjera të KB, në lidhje me ndryshimet buxhetore;
- Situacioni i shpenzimeve për vitin 2023 i rakorduar me Degën e Thesarit;
- Situacioni i të ardhurave për vitin 2023 i rakorduar me Degën e Thesarit;
- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit;
- Raportimet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë lidhur me detyrimet e prapambetura të Bashkisë;
- Informacion shkresor i përgatitur nga subjekti bazuar në kërkesat e hartuara nga grupi i auditimit.

Baza Ligjore:

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 7.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 115/2021, datë 24.11.2021 "Për buxhetin e vitit 2022";
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisve të vetëqeverisjes vendore";
- Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore";
- Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025";
- VKB nr. 6, datë 18.01.2021, "Për miratimin e buxhetit për vitin 2023", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresë nr. 105/1 prot., datë 24.01.2024.

### **1. Programimi i PBA-së 2023-2025**

Për hartimin e PBA-së 2023-2025 nga Bashkia janë ndjekur dhe zbatuar hapat e mëposhtëm:

- VKB nr. 66, datë 29.12.2021, "Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetit vjetor";
- Urdhër nr. 19, datë 22.02.2022, "Ngritja e grupit të menaxhimit strategjik (GMS) për vitin 2022";

- Urdhër nr. 20, datë 22.02.2022, “Për ngritjen e EMP për hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2023-2025”;
- Me shkresën nr. 2647 prot., datë 13.09.2022 është dërguar në MFE “PBA për periudhën 2023-2025”, dhe relacioni bashkëlidhur;
- VKB nr. 4, datë 28.02.2022 “Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm (FPT) 2023-2025 të Bashkisë Malësi e Madhe”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresë nr. 185/1 prot., datë 23.03.2022;
- VKB nr. 26, datë 27.06.2022 “Mbi miratimin e projektit të parë të PBA (FPT) 2023-2025 të Bashkisë Malësi e Madhe” konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresë nr. 427/1 prot., datë 08.07.2022;
- VKB nr. 32, datë 29.07.2022 “Për miratimin përfundimtar të shpenzimeve të PBA 2023-2025 të Bashkisë Malësi e Madhe” konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresë nr. 525/1 prot., datë 11.08.2022;
- Me shkresën nr. 12043 prot., datë 20.06.2022 është dërguar në MFE “Mendimet mbi Buxhetin Afatmesëm 2023-2025”.

## 2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura

Për vitin 2023 në Bashkinë Malësi e Madhe buxheti është hartuar kryesisht mbi bazën e 16 programeve, përkatësisht: Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi, Shërbimet e Policisë Vendore, Shërbimet bujqësore, Inspektimi, Ushqimi dhe Mbrojtja e Konsumatorëve, Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimi, Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave, Rrjeti Rrugor Rural, hërbime Publike Vendore, Sporti dhe Argëtimi, etj.

Rezulton se buxheti i viteve 2023-2025 është miratuar sipas procedurave dhe kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar.

Tabela nr. II.2.1: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2023

Planifikimi i të ardhurave 2023		Planifikimi i shpenzimeve 2023	
Burimi i të ardhurave	Vlera në 000/ lekë	Emërtimi i zërave	Vlera në 000/ lekë
Të ardhura të planifikuara për vitin 2023	149,296	Art. 600 Paga	291,353
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm e të planifikuara për shpenzim për vitin 2023	53,220	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	49,050
<b>Total të ardhurat e veta</b>	<b>202,516</b>	Art.602 Shpenzime operative	136,308
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar.	69,838	Art.604 Transferime korrente të brendshme	1,800
Të ardhura të trashëguara nga granti i kushtëzuar (transferua specifike 600, 601, 602 etj.).	21,809	606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë	11,268
Grant i ri i çelur për llogari të vitit 2023	350,041	Art.230-231 Investime	308,615
Transferte specifike e çelur për llogari të vitit 2023	158,190	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	4,000
<b>Total të ardhura nga transfertat e buxhetit të shtetit</b>	<b>599,878</b>		
<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>802,394</b>	<b>TOTALI SHPENZIMEVE</b>	<b>802,394</b>

Burimi: Bashkia Malësi e Madhe

Tabela nr. II.2.2: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve me ndryshimet e buxhetit për vitin 2023

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2023	Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2023
---	--

Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB	Buxheti shtesë/pakësim, miratuar me VKB	Vlera në 000/lekë	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB	Buxheti shtesë/pakësim, miratuar me VKB	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)
	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>1+2</b>		<b>3</b>	<b>4</b>	<b>3+4</b>
Të ardhura të planifikuara për vitin 2023	149,296		149,296	Art. 600 Paga	291,353	20,056	311,409
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe të planifikuara për shpenzim për vitin 2023	53,220	1,330	54,550	Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	49,050	3,391	52,441
<b>Total të ardhurat e veta</b>	<b>202,516</b>	<b>1,330</b>	<b>203,846</b>	Art. 602 Shpenzime operative	136,308	800	137,108
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar	69,838	3,750	73,588	Art. 604 Transferime korrente të brendshme	1,800	220	2,020
Të ardhura të trashëguara nga transferata specifike	21,809		21,809	Art. 606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë	11,268		11,268
Transferata e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2023	350,041	15,124	365,165	Art. 230-231 Investime	308,615		308,615
Transferata specifike e çelur për llogari të vitit 2023	158,190	4,263	162,453	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	4,000		4000
<b>Total të ardhurat nga transferatat e buxhetit të shtetit</b>	<b>599,878</b>	<b>23,137</b>	<b>623,015</b>				
<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>802,394</b>	<b>24,467</b>	<b>826,861</b>	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>802,394</b>	<b>24,467</b>	<b>826,861</b>

*Burimi: Bashkia Malësi e Madhe*

### Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2023

Për vitin 2023 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **1,397** milion lekë, ndërsa realizimi në vlerën **1,276** milion lekë, ose në masën **91%**.

Nga këto janë realizuar nga të ardhurat e veta 97 milion lekë dhe vlera e mbuluar nga FZHR është **1,180** milion lekë, ose **92%**. Nga këto, fondi i pagave (llogaria 600) është realizuar me 86%, sigurime shoqërore dhe shëndetësore (llogaria 601) është realizuar me 100%, shpenzimet operative (llogaria 602) është realizuar me 94%, transferata korrente të brendshme (llogaria 604) është realizuar me 27%, transferata tek buxhetet familjare (llogaria 606) është realizuar 100%, projekte (llogaria 230) është realizuar 0% dhe fondi i investimeve (llogaria 231) është realizuar me 91%. Realizimi i buxhetit sipas zërave paraqitet në mënyrë më të detajuar në tabelën në vijim.

*Tabela nr. II.2.3: Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2023*

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Malësi e Madhe për vitin 2023, në mijë lekë						
Nr.	Përshkrimi i shpenzimeve Bashkia pa njësitë vartëse	Plani 2023	Fakti 2023	Realizimi në %	Vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta (fakti)	Vlera e mbuluar nga FZHR dhe granti (fakti)
1	Artikulli - 600 Paga	317,236	302,905	95%	40,955	261,950
2	Artikulli – 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	53,665	50,004	93%	243	49,761
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	152,788	118,341	77%	6,893	111,448
4	Artikulli - 604 Transferata korrente të brendshme	4,822	822	17%	600	222
5	Artikulli - 606 Transferime tek buxhetet familjare (PAK)	276,338	270,501	98%	0	270,501
6	Artikulli - 230 Projekte	2,500	2,500	100%	2,500	0
7	Artikulli - 231 Investime	589,726	531,362	90%	45,663	485,700
	<b>TOTAL</b>	<b>1,397,075</b>	<b>1,276,436</b>	<b>91%</b>	<b>96,854</b>	<b>1,179,582</b>

*Burimi: Bashkia Malësi e Madhe*

Nga bashkia, ndarja e plan buxhetit dhe detajimi në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli, është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve, nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së pakushtëzuar sektoriale, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuara nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve. Gjatë këtij viti, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar dhe rialokimeve të kryera nga vetë bashkia, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, me VKB nr. 12, datë 20.07.2023, nr. 15, datë 03.08.2023, VKB nr. 25, datë 29.09.2023 dhe VKB nr. 10, datë 20.07.2023.

Sa më sipër, janë sipas përcaktimit të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 47<sup>2</sup>, ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 44<sup>3</sup>, Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore" shtojca 4, pika c.

### ***3. Saktësia e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit***

Për vitin 2023 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **1,397** milion lekë, ndërsa realizimi në vlerën **1,276** milion lekë, ose në masën **91%**.

**Nga këto janë realizuar nga të ardhurat e veta 97 milion lekë dhe vlera e mbuluar nga FZHR është 1,180 milion lekë, ose 92%.**

Nga Drejtorja e Financës dhe Buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordimet përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me VKB, ose të diktuar nga grandet e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nënartikulli, u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore.

Në zbatim të detyrimeve ligjore për monitorimin e zbatimit të buxhetit, ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 44 dhe ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 48, Bashkia Malësi e Madhe ka përgatitur:

1. Raportin e monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e vitit 2023 dhe e ka dërguar me shkresë në MFE nr. 621/1 prot., datë 23.05.2023;
2. Raportin e monitorimit të buxhetit për 8-mujorin e vitit 2023 dhe e ka dërguar me shkresë në MFE nr. 2478 prot., datë 29.09.2023;
3. Raportin e monitorimit të buxhetit për 12-mujorin e vitit 2023 dhe e ka dërguar me shkresë në MFE nr. 566 prot., datë 23.02.2024.

<sup>2</sup> Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore bën një analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brendamuajit qershor të çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, edhe propozimet përkatëse përndryshimin e vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, që ka miratuar buxhetin evitit. Procedura e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve të vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore është e njëjtë me atë të vendimit për miratimin e buxhetit vjetor.

<sup>3</sup> Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport i paraqitet këshillit jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

**4. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve, çelja e fondeve dhe realizimi i tyre. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.**

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion, nga Njësia e Prokurimit dhe Drejtoria Ekonomike për periudhën raportuese objekt i procesit të auditimit (nga data 01.01.2023-31.12.2023) u konstatua se Autoriteti Kontraktor (Bashkia Malësi e Madhe) ka parashikuar gjithsej 162 procedura prokurimi me fond limit 638,837,009 lekë dhe janë realizuar 114 blerje me vlerë fondi limit për 469,615,352 lekë, për të cilat edhe ka lidhur 114 kontrata me vlerë 431,271,454 lekë.

**5. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve**

**Në Bashkinë Malësi e Madhe vlera e detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 99,003,050 lekë.**

**Nga auditimi konstatohet se,** sipas të dhënave të paraqitura në Ankesin nr. II.4.1 bashkëlidhur Projektraportit të auditimit, detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2022 janë në vlerën 92,178 mijë lekë, janë krijuara gjatë vitit 2023 detyrime në vlerën 44,512 mijë lekë dhe janë shlyer në vlerën 37,687 mijë lekë. Duke rezultuar **detyrime të prapambetura deri 31.12.2023 në vlerën 99,003 mijë lekë.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", neni 34, pika 1, "Jo më vonë se data 31 janar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet për shqyrtim e miratim në këshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për: a) dy vitet para vitit buxhetor; b) vitin buxhetor; c) tre vitet e ardhshme buxhetore...", neni 40, pika 3, "Projektbuxheti vjetor përfshin...informacion mbi gjendjen/stokun e borxhit të njësisë së vetëqeverisjes vendore...detyrimet kontingjente dhe mundësinë e shfaqjes së tyre si detyrime në vitin buxhetor pasardhës". Udhëzim i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 101, "Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve, më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim".

**Mbi likuidimin e vendimeve gjyqësore në Bashkinë Malësi e Madhe**

Nga auditimi rezulton se Bashkia Malësi e Madhe nuk ka detyrime për vendime gjyqësore në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", neni 34, pika 1 dhe neni 40, pika 3

**Vështirësia Financiare e Bashkisë Malësi e Madhe**

Në UMFE nr.26, datë 27.03.2019 "Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore", trajtohet shkalla e vështirësisë financiare dhe menaxhimi i këtyre vështirësive.

Gjithashtu në ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", datë 27.04.2017, kreu XI vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre, neni 55 Probleme Financiare, pika 1. Për Bashkinë Malësi e Madhe, totali i shpenzimeve të miratuara nga të ardhurat e veta me VKB për vitin 2023 ka vlerën 681,939,102 lekë, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura më 31.12.2023, ka vlerën 99,003,050 lekë, sipas raportimit në MFE me shkresë nr. 566 prot., datë 23.02.2024. Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimeve totale të miratuara, ka vlerën 14.52%, shifër që e klasifikon Bashkinë Malësi e Madhe në njësi të qeverisjes vendore pa probleme financiare, paraqitur si në tabelën mëposhtë:

NR	Emërtimi	Stoku në vlerë	Shpenzime vjetore	
----	----------	----------------	-------------------	--

			faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së
<b>I</b>	<b>Borxhe (a+b)</b>	<b>0</b>		
<b>a</b>	<b>Hua afatgjatë</b>	<b>0</b>		
a,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
<b>b</b>	<b>Hua afatshkurtër</b>	<b>0</b>		
b,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
<b>II</b>	<b>Detyrimet e prapambetura</b>	<b>99,003,050</b>		<b>14.52%</b>
<b>Llogaria ekonomike</b>	<b>Emërtimi</b>			
4864100	Vendime Gjyqësore			
4864200	Det.Prap. Sherbime			
4864201	D.P.Ener.Elektirke			
4864300	Det.Prap.Mirëmbajtje			
4864400	Det.Prap. Investime	99,003,050		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra			
4864900	Det.Prap.Të Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqërore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shëndet			
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronësime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
<b>III</b>	<b>Totali (I+II)</b>	<b>99,003,050</b>	<b>681,939,102</b>	<b>14.52%</b>

### **3. Burimi i krijimit të të ardhurave dhe mbledhja e tyre.**

Në zbatim të Programit të Auditimit, për auditimin e burimit të krijimit të të ardhurave dhe vlerësimit të mbledhjes së tyre bazuar në kuadrin rregullator në fuqi, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Vendim i Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale për vitin 2023
- Vendim i Këshillit Bashkiak për miratimin e buxhetit për vitin 2023.
- Rregjistri i taksapaguesve privat dhe familjar.
- Rakordimet me agjentët tatimor.
- Evidenca e planifikimit të të ardhurave.
- Aktet e rakordimit me degën e thesarit për të ardhurat.
- Regjistrat e subjekteve debitorë në 31.12.2023.

- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, në lidhje me çështjen e të ardhurave.

### **Organizimi i Strukturës së Taksave**

Për vitin 2023, pranë Bashkisë Malësi e Madhe është krijuar dhe ka funksionuar Drejtoria e të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifave Vendore me përbërje Sektorin e Taksave dhe Sektorin e Shërbimit të Transportit. Sektori i taksave në aktivitetin e tij për arkëtimin e disa prej llojeve të të ardhurave bashkëpunon edhe me sektorë të tjerë pranë Bashkisë, si ai i pronave, pyjeve, urbanistikës, infrastrukturës, si dhe me inspektorët e taksave për çdo Njësi Administrative, ku roli i këtyre sektorëve është hartimi i autorizimit për arkëtim Roli i sektorit të taksave dhe tarifave vendore është hartimi i faturës për arkëtim, dokument i cili i shërben subjektit për kryerjen e pagesës, duke vijuar me ndjekjen e arkëtimit/marrjen e masave të nevojshme për ekzekutimin e pagesave/detyrimeve të krijuara. Ky sektor për vitin 2023 ka patur 14 punonjës në organikë. *Struktura e Drejtorisë e të ardhurave pasqyruar në Aneksin nr. A1*

### **Taksat dhe tarifave të aplikuara dhe arkëtuara nga Bashkia Malësi e Madhe.**

Paketat fiskale të Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2023 janë miratuar me VKB nr.68, datë 21.12.2022, si dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr. 945/1 prot., datë 04.01.2023.

Mbështetur në paketat fiskale të mësipërme në Bashkinë Malësi e Madhe, sipas sektorëve përkatës, për vitin 2023 janë aplikuar/mbledhur 28 lloje taksash dhe tarifash.

Veç taksave dhe tarifave të mësipërme Bashkia Malësi e Madhe ka arkëtuar të ardhura nga disa lloje burimesh të ndryshme, si gjopa nga policia bashkiake, lënda drusore, produkte bujqësore, kontratat e qiradhënies. etj.

Për vitin 2023, subjektet mbi të cilat janë aplikuar taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Malësi e Madhe dhe Njësitë Administrative, ndahen në 3 kategori:

1. Biznes (I madh, mesëm, vogël dhe ambulant);
2. Familjarë;
3. Institucione.

*Llojet e subjekteve mbi të cilët janë aplikuar taksat dhe tarifave vendore*

Nr	Lloji	2023
1	Biznesi i Madh	126
2	Biznesi i Vogël	403
3	Ambulant (Hapësirat e tregut)	2
4	Institucione	21
	<b>Total</b>	<b>552</b>

*Burimi: Bashkia Malësi e madhe.*

### **Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve**

Për vitin 2023 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Malësi e Madhe është miratuar me VKB-në nr. 68, datë 21.12.2022 “Mbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”, konfirmuar nga Prefekti Shkodër me shkresën nr. 945/1 prot., datë 04.01.2023.

Referuar të dhënave të paraqitura për periudhën nën auditim realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Malësi e Madhe për vitin 2023 janë realizuar në masën 87%, nga 149,296,000 lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 130,279,762 lekë.

-Për vitin 2023 peshën kryesore të të ardhurave e zënë të ardhurat nga taksa e regjistrimit të automjeteve me 20,960,860 lekë, ose 16 % ndaj totalit të të ardhurave të realizuara, duke vijuar me të ardhurat nga tarifa e pastrimit në vlerën 15,307,309 lekë, ose 11.7 % ndaj totalit, taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 13,237,746 lekë, ose 10 % ndaj totalit. *Tabela e planifikimit dhe realizimit të të ardhura Pasqyruar në aneksin nr. A2.*

### **Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet**

Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga zyra e vendore e ASHK Malësi e Madhe, u auditua dokumentacioni për vitin 2023, i paraqitur nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Zhvillimit Urban. Në Bashkinë Malësi e Madhe deri në 31.12.2023, disponohen shkresat përcjellëse dhe listat me emrat përkatës që ju janë miratuar Lejet e Legalizimit për ndërtimet pa leje ndërtimi brenda territorit të Bashkisë. Nga ZVASHK Malësi e Madhe, janë dërguar dokumentet për çdo person që ka ndërtuar objekt banimi apo social ekonomik në territorin e Njësisë Administrative të Bashkisë, ku përcaktohet edhe detyrimi për të paguar vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Bashkia Malësi e Madhe, nuk janë marrë të gjitha mast për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore objekt legalizimi. Në vijim paraqiten pasqyra sintetike e numrit të debitorëve dhe vlerës së tyre, për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit.

#### **Detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për lejet e legalizimit-viti 2023**

<b>Debitor TNI deri në 31.12.2023</b>		
<b>31.12.2023</b>	<b>299</b>	<b>20,263,481</b>
Nga të cilat krijuar në 2023	39	1,296,614
Nga të cilat progresive deri në 31.12.2022	260	19,118,724

#### **Burimi: Bashkia Malësi e Madhe**

Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i objekteve informale, u konstatua se në fund të vitit 2022 vlera debitore nga mos pagesa e taksasës së ndikimit në infrastrukturë është 19,118,724 lekë për 260 subjekte, nga të cilat janë krijuar gjatë vitit 2023 për 39 subjekte në vlerën 1,296,614 lekë, dhe në fund të vitit 2023 progresive është për 299 subjekte në vlerën 20,263,481 lekë detyrim i cili është i njohur në kontabilitet, duke mbetur detyrim i pa arkëtuar. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Sektori i të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifave Vendore Bashkia Malësi e Madhe, nuk janë marrë masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe Drejtorisë së të Ardhurave Bashkia Malësi e Madhe, me qëllim që subjektet të cilët rezultojnë debitorë si rrjedhojë e mospagesës së TNI, t'i përcillen në sektorët përkatës me qëllim mbledhjen e borxhit, për të ndjekur procedurat ligjore përkatëse, për arkëtimin e TNI nga legalizimi i objekteve informale. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 3.c dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim"

#### **Administrimi i taksave dhe tarifave vendore**

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Malësi e Madhe kryhet në programin Excel. Drejtoria e të ardhurave nuk kryhen regjistrim manual të të dhënave (nuk disponon regjistra fizik). Çdo informacion që grumbullohet nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Malësi e Madhe i administrojnë në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Drejtorisë së të ardhurave. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Drejtorisë së të ardhurave për të cilat mund të ketë

gabimë në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të DTTV. Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: “Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”.

Situata e lëvizjes së subjeteve të cilat ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe bazuar në ndryshimin e xhiros si dhe të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit paraqiten si më poshtë:

*Evidenca e gjendjes së numrit të bizneseve për vitin 2023.*

Nr.	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja	Regjistrime	Mbyllur	Gjendja në fund të periudhës 2023
			Në fillim 01.01.2023	Reja	Aktiviteti	
1	Biznes i vogël	2023	410	31	36	405
2	Biznes i madh	2023	108	21	3	126
3	Institucione	2023	21	0	0	21
	<b>TOTAL</b>		<b>539</b>	<b>52</b>	<b>39</b>	<b>552</b>

*Burimi : Bashkia Malësi e madhe*

### **Mbi Agjentët Tatimorë.**

Për periudhën objekt auditimi, rezulton se nuk janë mbajtur akt-rakordimet çdo muaj me agjentët tatimorë. Të ardhurat nga ASHK-ja nuk derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Malësi e Madhe (*brenda datës 5 të çdo muaji*)

Gjithashtu rakordimi nuk është mbajtur dhe me DRSHTRR Shkodër në lidhje me numrin e mjeteve që ka në përdorim kjo njësi vendore, sa nga këto mjete janë aktiv në gjendje pune, sa nuk janë në gjendje pune, sa paguajnë dhe sa nuk paguajnë dhe nëse derdhjet në buxhet bëhen sipas afateve ose jo. Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Malësi e Madhe, paraqiten si vijon:

*Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Malësi e Madhe*

Agjenti Tatimor	Lloji i Taksës	2023
Drejtoria rajonale e tatimeve	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	219,693
D.R.SH.T rrugor	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	20,960,860
Z.V.R.P.P (AKSH)	Taksa e kalimit të pronësisë	60,819
DPT & DPD	Renta Minerare	89,989
<b>TOTALI</b>		<b>21,331,361</b>

*Burimi: Bashkia Malësi e Madhe*

Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave të cilat vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, u konstatua se ka një nivel të lartë mosrealizimi. Bashkia Malësi e Madhe nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. Për sa më sipër, Bashkia Malësi e Madhe nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Malësi e Madhe, nuk masa për evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjybitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura.

Këto veprime janë në kundërshtim me Neni 117 të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore”, ku parashikohet se “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”.

### **Menaxhimi i borxhit**

### Subjektet Debitorë.

Nga auditimi i dokumentacionit të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore u konstatua se gjendja e debitorëve progresiv për subjektet fizik/juridik paraqitet si mëposhtë:

*Tabela nr.6. Debitor (Biznesi dhe institucione) sipas Njësive Administrative*

Njësia Administrative	Progresive deri në 31.12.2022		Maturimi		Arketimet	Debi e krijuar brenda vitit 2023	Progresive deri në 31.12.2023	
	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Vlerë	Vlerë	Nr	Vlerë
Koplik	124	8,946,315	92	3,489,195	1,762,665	1,726,530	128	10,672,845
Qender	25	3,159,350	18	1,049,950	832,280	217,670	18	3,377,020
Kastrat	92	11,342,230	48	1,879,480	1,248,044	631,436	89	11,973,666
Gruemirë	36	5,136,275	37	2,781,131	749,036	2,032,095	36	7,168,370
Shkrel	25	1,435,635	21	1,140,872	1,577,025	-436,153	20	999,482
Kelmend	21	1,411,811	23	767,328	248,919	518,409	28	1,930,220
<b>Total</b>	<b>323</b>	<b>31,431,616</b>	<b>239</b>	<b>11,107,956</b>	<b>6,417,969</b>	<b>4,689,987</b>	<b>319</b>	<b>36,121,603</b>

*Burimi : Bashkia Malësi e Madhe, Përpunuar nga grupi i auditimit.*

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Bashkia Malësi e Madhe lidhur me gjendjen e debitorëve progresiv për subjektet fizik/juridik, në fund të vitit 2022 rezultojnë në një numër prej 323 subjekte në vlerën 31,431,616 lekë, si rrjedhojë detyrim i krijuar gjatë vitit 2023 rezultojnë për 239 subjekte në vlerën 4,689,987 lekë. Në fund të vitit 2023 konstatohet një numër debitorësh prej 319 subjektësh me vlerë debitorë prej 36,121,603 lekë.

### Taksat dhe Tarifat Familjare

Përsa i përket taksave dhe tarifave vendore për abonentët familjarë në Bashkinë Malësia e Madhe ku familjarët ngarkohen me taksa dhe tarifa për Tokën, Banesën, Ndrëhimin dhe Shërbimet Publike nga Sektori i Taksave dhe tarifave vendore Vendore. Në tabelën e mëposhtme janë të identifikuar familjet debitorë: Familje debitorë (territori i Bashkisë Malësi e Madhe dhe NJA) sipas llojit të taksës/tarifës. *Tabela nr.7*

Nr	Njësi Administrative	Familje Debitorë në fillim të vitit 2023	Familje gjithësej të taksuara dhe tarifuar për vitin 2023	Familje Debitorë krijuar brenda vitit 2023	Progresive deri në fund të vitit 2023
		Nr	Nr	Nr	Nr
1	KOPLIKU	2,063	385	1,839	1,839
2	Qender	1,081	260	1,140	1,140
3	Kastrat	2,437	486	2,443	2,443
4	Gruemira	2,594	707	2,795	2,795
5	Shkrel	946	253	1,433	1,433
6	Kelmend	1,122	169	1,176	1,176
	<b>TOTALI</b>	<b>10,243</b>	<b>2,260</b>	<b>10,826</b>	<b>10,826</b>

*Burimi : Bashkia Malësi e Madhe*

Duke iu referuar tabelës si më lart rezultojnë se, kemi të bëjmë me një numër prej 10,243 familje debitorë në fillim të vitit 2023, nga të cilat janë taksuar dhe tarifuar për vitin 2023 gjithësej 2,260 familje, ashtu sikurse shikohet nga vitit në viti numri i familjeve debitorë është rritur në masën 9.4 %.

Më poshtë në mënyrë të detajuar pasqyrohen Familjet debitorë pranë territorit të Bashkisë Malësi e Madhe dhe Njësive Administrative sipas llojit të taksës/tarifës.

*Tabela nr.8 Familje debitorë territori i Bashkisë Malësi e Madhe dhe NJA sipas llojit të taksës/tarifës*

Nr.	Lloji i Taksës dhe Tarifës	Debitor deri në fillim të vitit	Maturimi	Arkëtimet	Debitorët krijuar brenda vitit	Totali Debi
		2023	2023	2023	2023	Progresive
1	Ndërtesë	11,781,623	9,939,784	3,712,294	6,227,490	18,009,113
2	Truall	1,789,141	814,000	212,310	601,690	2,390,831
3	Tarife Pastrimi	14,354,482	10,253,000	6,306,610	3,946,390	18,300,872
4	Tarife Ndrëhim	1,253,930	438,600	221,700	216,900	1,470,830
5	Tarife Gjellërimi	607,025	271,000	111,050	159,950	766,975
6	Toke	6,099,189	4,850,000	1,448,423	3,401,577	9,500,766
	<b>Totali</b>	<b>35,885,390</b>	<b>26,566,384</b>	<b>12,012,387</b>	<b>14,553,997</b>	<b>50,439,387</b>

*Burimi : Bashkia Malësi e Madhe, Përpunuar nga grupi i auditimit.*

Sa më sipër rezultojnë se, në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive janë 10,243 familje debitorë në vlerën 35,885,390 lekë, ku për vitin 2023 janë taksuar 2,260 familje për vlerën 26,566,384

lekë dhe ngga vlera e taksuar janë kryer arkëtime në vlerën 12,012,387 lekë. Si rrjedhojë e situatës e cituar më lart, janë krijuar detyrime për 10,826 familje gjatë vitit 2023 për vlerën 14,553,997 lekë, ndërsa në total debitorë në fund të vitit 2023 janë 10,826 familje në vlerën 50,439,387 lekë.

Nga auditimi konstatohet se detyrimi tatimor në Bashkinë Malësi e Madhe është në vlerën 106,824,471 lekë vlerë e cila përbëhet nga debitorët e bizneseve, debitorët nga familjarë dhe debitorët për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet.

Dinamika E Debitoreve	Viti	Nr.	Vlera
1-3 vite	2021-2023	311	11,817,101
3-5 vite	2018-2020	218	7,961,636
mbi 5 vite	Para 2018	207	20,169,524
Debitore pa shprese arketimi		84	11,566,272

*Burimi : Bashkia Malësi e Madhe, Përpunuar nga grupi i auditimi.*

Duke analizuar debitorët sipas moshës së krijimit konstatohet se, për një periudhë nga 1 deri në 3 vite rezulton një numër prej 311 debitorësh për 11,817,101lekë.

-Debitorë për një periudhë nga 3 deri në 5 vite rezulton një numër prej 218 debitorësh për vlerën 7,961,636 lekë.

-Debitorë mbi 5 vite rezulton një numër prej 207 debitorësh për vlerën 20,169,524lekë. Debitorë pa shpresë arketimi janë 84 debitorë, për vlerën 11,566,272 lekë.

#### Masat e marra për uljen e borxhit

Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Malësi e Madhe është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Tatim Taksave lidhur me zbatimin e hapave që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar bizneset debitorë që kryejnë aktivitetin e tyre pranë Bashkisë Malësi e Madhe.

Nga auditimit konstatohet se, pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2023, nuk janë nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të sipër cituar ndaj debitorëve të Bashkisë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.

#### Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve

-Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Malësi e Madhe mbi arkëtimin e taksës së licencimit për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve për konsumatorët fundorë, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

-Dosjet e licencimit të subjekteve, me përmbajtje: Licenca e dhënë për ushtrim aktiviteti, Ekstrakti i regjistrimit në QKB (në të cilin pasqyrohet lloji aktivitetit dhe vendet e ushtrimit të aktivitetit nga subjekti në Bashkinë Malësi e Madhe, që korrespondon me vitin 2023), Akti teknik i lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial; Leje mjedisore për ushtrim aktiviteti, Raporti teknik i lëshuar nga shërbimi i zjarrëfikses, Projekti teknik i vendit ku do të ushtrohet aktiviteti, vendosja e depozitave, Autorizimet për pagesë, Faturat e arkëtimit dhe pagesa e kryer nga subjekti;

-Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;

-Ligj nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

-Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar;

-VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017;

-VKM nr. 212, datë 16.3.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)”;

-Referuar të dhënave nga databasat e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial, (institucioni që inspekton subjektet e tregtimit të karburanteve).

Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitetet me seli në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe dhe në Njësitë Administrative, na u vendosën në dispozicion 8 dosje të subjekteve që ushtrojnë aktivitetet në tregtimin e karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, pasqyruar si më poshtë vijon:

Nr.	Subjekti	Adresa	Nipti	Pajisur me Licence		Licence		Pagesa e kryer	Rinovuar Licenca (nëse në vitin 2023 i ka mbaruar afati)	Tarifa e aplikuar nga Bashkia	Pagesa e kryer	Debitor	
				Po	Jo	Fillon	Mbaron						
1	A. Shpk	Vukpalaj Nj.A.Kasrat	J.....A	Po		25.01.2022	24.01.2023	200,000	07.02.2023-06.02.2024	200,000	200,000	800,000	
2	E.Shpk	Polvar Nj.A.Qendër	M.....J	Po		06.07.2022	05.07.2023	200,000	13.11.2023- 12.11.2024			800,000	
3	Ge.Shpk	Rruga Nacionale Shkodër- Han i Hoti Nj.A.Qendër	K.....T	Po		15.12.2022	14.12.2023	200,000	18.12.2023-17.12.2024	200,000	200,000	800,000	
4	K.Shpk	Pjetrosan Nj.A.Kasrat	K.....O	Po		29.12.2022	28.12.2023	200,000			200,000	800,000	
5	"Xh.2006" Shpk	Aliaj Nj.A.Kasrat	K.....B	Po		01.12.2019	31.11.2024	1,000,000					
6	"O . Shpk"	Boriç i Madh Nj.A.Gruemirë	J.....I	Po		19.12.2019	18.12.2024	1,000,000					
7	"M. Shpk"	Grizhe Nj.A.Gruemirë	L.....F	Po		23.10.2022	23.10.2023	1,000,000	01.11.2023-31.10.2024	200,000	200,000	800,000	
8	"J.Shpk"	Hot Nj.A.Kasrat	L.....D		Jo							1,000,000	
9	"Ol. Shpk	Grilë Nj.A.Gruemirë	L.....A		Jo							1,000,000	
10	"K.-B Shpk	Hani i Hotit Nj.A.Kasrat	L.....K		Jo							1,000,000	
11	"LdOil Shpk	Dober Nj.A.Qendër	L.....T		Jo							1,000,000	
12	"R. Shpk	Koplik i Sipërm Nj.A.Qendër	L.....M		Jo							1,000,000	
13	"B.	Llazan Nj.A.Koplik	K.....P	Po		07.12.2023	06.12.2024	200,000				800,000	
14	"K.Shpk"	Rrethrotullimi Bajzë- Koplik Nj.A.Koplik	L.....O		Jo							1,000,000	
<b>Totali</b>													<b>10,000,000</b>

**Burimi:** Sektori i taksave Përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga shqyrtimi i dosjeve të mësipërme, konstatohet se, në 6 (gjashtë) raste për licencat e dhëna, janë dhënë me një afat vlefshmërie deri në 1 (një) vit, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në Kreun II.12. në paketën fiskale të vitit 2023, ku është përcaktuar se afati i vlefshmërisë së licencës është 5 vite nga momenti i lëshimit, për të cilin aplikohet tarifa prej 1,000,000 lekë. Gjithashtu duke iu referuar të dhënave të paraqitura nga sektori i Taksave konstatohet se, janë 7 subjekte të cilët kanë ushtruar aktivitetet për tregtimin e karburanteve përgjatë vitit 2023, të cilët nuk kanë qenë të pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit. Si pasojë e situatës së krijuar janë krijuar detyrime nga 14 (katërmëdhjetë) subjekte në vlerën 10,000,000 lekë vlerë e cila nuk është e njohur në kontabilitet, dhe përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhe.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, i ndryshuar me ligjin nr. 71.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4 “Neni 20-Autorizimet pika 2. VKM nr. 344, Datë 19.4.2017 Për Disa Ndryshime Në VKM nr. 970, Datë 2.12.2015, neni 15.1 dhe neni 15.2.

**Përlogaritje të grupit të auditimit të tarifës së pastrimit nga subjekte që kanë ushtruar aktivitet në fushën e ndërtimit me NIPT sekondar në Bashkinë Malësi e Madhe dhe NJA, me fonde publike.**

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Malësi e Madhe mbi arkëtimin e tarifës së pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit nga Bashkia Malësi e Madhe, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

- VKB për miratimin e paketave fiskale 2023;
- Evidenca e prokurimeve me fonde publike 01.01.2023 - 31.12.2023;
- Faturimi i detyrimit dhe pagesa.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi dhe sipas dokumenteve të paraqitura nga zyra e prokurimeve dhe nga Sektori i të Ardhurave Vendore, Bashkia Malësi e Madhe, u auditua dokumentacioni për subjektet e ndërtimit (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Malësi e Madhe), të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike.

Nga të dhënat rezulton se në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe, kanë kryer punime ndërtimi kryesisht sistemim-asfaltime 29 subjekte, nga të cilët 8 subjekte ndërtimi janë me seli administrative në Bashkinë Malësi e Madhe dhe 21 subjekte janë me adresë sekondare. Nga auditimi konstatohet se për 29 subjektet është faturuar vlera prej 301,261 lekë, nga e cila është arkëtuar vlera prej 95,265 lekë, duke mbetur vlera debitore progresive prej 205,996 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhe. Gjithashtu konstatohet se, nga kryqëzimi i informacionit me drejtorinë e financës vlera debitore e cituar më lart nuk është regjistruar në kontabilitet. Këto veprime janë në kundërshtim me Shkronjën “a” e pikës 5 të nenit 35 në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Pikën 10 e nenit 3 dhe pika 2 në nenin 18 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”. *Të dhënat mbi OE fitues dhe Debitorë janë të pasqyruar në aneksin nr. A4 në kapitullin Anekse.*

**Subjektet të cilët nuk janë regjistruar në OKB .**

Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave në Bashkinë Malësi e Madhe nga Taksat dhe Tarifave Vendore, bazuar në dokumentet e mbajtur nga inspektorët e taksave, konkretisht aktkonstatimet mbi kontrollet e ushtruara në terren, ka rezultuar se në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe ushtrojnë aktivitetet 13 subjekte me objekt veprimtarie të ndryshme pa u regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB). Nga inspektimet e kryera me datë, 18.09.2023 nga Sektori i Taksave dhe i Tarifave Vendore pranë Bashkisë Malësi e Madhe, u konstatua se 4 (katër) subjekte ushtrojnë veprimtarinë e tyre pa u regjistruar në QKB, kryesisht lloji aktivitetit Parukeri, Butik dhe Tregëtim artikujsh të ndryshëm, me adresë Koplík. Me datë 13.04.2023, nga inspektimet e kryera janë konstatuar 3 (tre) subjekte që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këtë formë, kryesisht lloji aktivitetit Bar-Kafe, Riparime elektroshtëpiake. Nga inspektimet në periudha të ndryshme të vitit 2023 nga inspektorët e taksave, janë mbajtur aktkonstatimet e datës 26.04.2023 dhe të datës 08.05.2023, ku për muajin Prill janë konstatuar 4 (katër) subjekte të cilët nuk janë pajisur me NIPT, subjekte këto me lloj aktiviteti Bar-Kafe, Fruta- Perime, Tregëtim artikuj të ndryshëm. Në muajin Maj janë konstatuar 2 (dy) subjekte me lloj aktiviteti Bar-Kafe me adresë Koplík. Duke iu referuar situatës së cituar më lart, ajo çfarë konstatohet nga grupi i auditimit është se, nga Drejtoria e të Ardhurave është hartuar shkresa me lëndën “Kërkesë për bashkëpunim”, drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, për marrjen e masave ligjore për subjektet informale të konstatuara, që kryejnë aktivitet ekonomik në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe. Nga auditimi konstatohet se, ky

dokument nuk ka marrë formën zyrtare, ku të jetë protokolluar dhe dërguar tek organet kompetente për vazhdimin e procedurave të mëtejshme. *Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 Për Procedurat Tatimore Në Republikën e Shqipërisë i Ndryshuar, nenet 5, 40, 41. Ligjin Nr.9632, Datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore i Ndryshuar, neni 4. Ligji Nr. 9723, Datë 3.5.2007 Për Regjistrimin E Biznesit, neni 22. Rregulloren e brendshme miratuar me vendim të kryetarit nr. 36 datë 05.01.2023 neni 80 pika,5,6,8,9 neni 81 pika 3.*

-Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar më sipër, llojin e mangësive të identifikuara si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, mbajnë përgjegjësi; *Zj. E. L., Drejtor i Drejtorisë së Taksave, Zj. D. Sh, Përgjegjëse i Drejtorisë së Taksave; Zj. E.S, Inspektor Taksash; Zj. K. H, Inspektor Taksash; Z. V. V, Inspektor Taksash ; Zj. A. R, Inspektor Taksash NJA Gruemire; Z. E. B, Inspektor Taksash NJA Qendër.*

*Z. E. L, Inspektor Taksash NJA Kastrat; Z. T. V, Inspektor Taksash NJA Kastrat.*

*Z. T.Bj, Inspektor Taksash NJA Shkrel; Z. E S, Inspektor Taksash NJA Kelmend.*

-Përgjegjësi për vjeljen në kohë dhe administrimin e të ardhurave ka edhe Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas kërkesave të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 42 “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 2, ku përcaktohet se:

*“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa dhe është përgjegjës për mbledhjen në kohë të të ardhurave vendore.”*

#### **2.4 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;

3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë;

3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

Për auditimin e pikës 3 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Pasqyrat financiare të vitit 2023 të shoqëruar me formatet 1-9.

2. Dokumente kontabël si: ditaret e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj, centralizatori, bilanci vërtetues.

3. Dokumentacioni i kryerjes së inventareve të aktiveve 2023, libri i aktiveve.

4. Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur për vitin 2023.

6. Akt-rakordimet me Degën e Thesarit Malësi e Madhe në mbyllje të vitit buxhetor 2023.

8. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “excel” si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditaret,shpenzimet te ardhurat etj.).

***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:***

• ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2023 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Malësi e Madhe” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE

nr.5, datë 21.02.2022, Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- ***Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.***

Bashkia Malësi e Madhe për vitin 2023 nuk ka hartuar Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, pasi nuk ka në varësi njësi shpenzuese me nipt më vete, pasi Agjencia e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Arsimit Kulturës i janë bashkuar Aparatit të Bashkisë.

- ***Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare***

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Malësi e Madhe për vitin ushtrimor 2023 me shkresë përcjellëse nr.prot.extra datë 21.03.2024. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është nënkryetari i Bashkisë Malësi e Madhe dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është drejtori i Financës. Pra në këtë rast kemi delegime të këtyre detyrave.

- ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”
- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj .Eshtë mbajtur centralizator

për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera , duke kaluar nga ditarët në centralizator deri në bilancin vërtetues. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vertetesi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdheruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrjedaljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

• ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2023 deri më datën 31.12.2023.

*Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim*

**Përkatësia:** Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

**Plotësia:** Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar, përveç rastit të kontratave të investimeve në vlerë të plotë dhe vlerës së faturave të palikujduara për investime në fund të vitit ushtrimor 2023

**Saktësia:** Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme

**Periudha:** Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël, përveç disa rasteve të shpenzimeve të kryera për investime, të cilat nuk janë regjistruar në momentin e celjes së fondeve dhe mbërritjes së faturës.

**Klasifikimi:** Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

**Ligjshmëria dhe rregullsia:** Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

*Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës*

**Ekzistenca:** Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë.

**Të drejtat dhe detyrimet:** Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

**Plotësia:** Të gjitha asetet dhe fondet e veta janë regjistruar, detyrimet janë regjistruar të gjitha në mbyllje të vitit ushtrimor, dhe janë të paraqitura të plota në bilanc. por janë pa regjistruar faturat e muajit dhjetor 2023 pasi janë brenda afatit 30 ditor.

**Vlerësimi dhe alokimi:** Aktivitet, pasivet dhe fondet e veta janë të përfshira në pasqyrat financiare me shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, si dhe rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

*Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese*

**Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet:** Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

**Plotësia:** Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare nuk janë përfshirë.

**Klasifikimi dhe kuptueshmëria:** Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara, si dhe janë mbajtur shënimet shpjeguese, të cilat shprehin paqartësitë e ndodhura .

**Saktësia dhe vlerësimi:** Informacioni financiar dhe të tjera në përgjithësi është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasinë e duhur.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës dhe pronave Publike.

**Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në celje për vitin 2023 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022.**

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

**Konkluzion:** Nga verifikimi i shifrave të paraqitura në formatin nr.5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2023”, krahasuar me akt-rakordimin vjetor të thesarit për shpenzimet dhe të ardhurat, si dhe me veprimet kontabël në llogarinë e 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara.

**Totali i Aktivit** për vitin 2023 është në vlerën 4,660,892,148 lekë dhe i paraqitur në formatin 1 dhe i zberthyer në llogari si më poshtë:

**Formati nr.1      Aktivi i Bilancit 2023      Në lekë**

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	EMERTIMI		
		Ushtrimi I Mbyllur 2023	Ushtrimi Paraardhes 2022	
1	A	<b>A K T I V E T</b>	4.660.892.148	4.825.895.452
2		<b>I.Aktivët Afat shkurtra</b>	627.615.294	684.907.345
3		<b>1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre</b>	221.874.101	195.647.038
4	531	Mjete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjete monetare ne Banke		
6	520	Disponibilitete ne Thesar	221.874.101	195.647.038
7	50	Letra me vlere		
8	532	Vlera te tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
11		<b>2.Gjendje Inventari qarkullues</b>	<b>11.942.402</b>	<b>11.301.565</b>
12	31	Materiale	468.018	1.136.808
13	32	Inventar I imet	11.474.384	10.164.757
14	33	Prodhim ne proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provigjone per zhvlersimin e inventarit (-)		
21		<b>3.Llogari te Arketushme</b>	<b>393.798.791</b>	<b>147.780.917</b>
22	411	Kliente e llogari te ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	5.529.118	5.529.118
24	431	Tatime e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetsore		
29	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
30	44	Institucione te tjera publike		
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitorë te ndryshem	116.204.628	55.045.701
33	4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	272.065.045	87.206.098
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		

35	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
36		<b>4.Te tjera aktive afatshkurtra</b>		
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		
42		<b>II.Aktivet Afat gjata</b>	<b>4.033.276.854</b>	<b>4.140.988.107</b>
43	<b>20</b>	<b>1.Aktive Afatgjata jo materiale</b>	<b>9.479.631</b>	<b>11.625.840</b>
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime	9.479.631	11.625.840
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	<b>21</b>	<b>2.Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>3.377.796.659</b>	<b>3.418.740.822</b>
48	210	Toka, T,roje, Terene	9.342.194	9.342.194
49	211	Pyje, Plantacione	15.388.760	15.388.760
50	212	Ndertesa e Konstruksione	734.244.794	744.013.244
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	2.566.635.613	2.588.416.017
52	214	linstalime teknike, makineri e paisje	23.596.910	22.145.799
53	215	Mjete Transporti	13.982.071	22.218.385
54	216	Rezerva Shteterore		
56	218	Inventar ekonomik	14.606.317	17.216.423
57	24	Aktive afatgjata te demtuara		
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
59	25-26	<b>3.Aktive Afatgjata Financiare</b>		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
62		<b>4.Investime</b>	<b>646.000.564</b>	<b>710.621.445</b>
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale	12.187.169	9.687.169
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	633.813.395	700.934.276

#### A. AKTIVE AFATSHKURTRA.

**Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”** në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 178,189,932 lekë, e cila rakordon me rubrikën VI “ Teprica e likujditeteve ne fund te vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte”.

- **Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”**, sipas bilancit në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 178,189,932 lekë, gjendje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në formatin nr.5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2023”.

**Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues”** të aktiveve qarkulluese paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 11,301,565 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 11,942,402 lekë , ku diferenca e tyre në rritje në vlerën prej - 640,837 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

- **Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”** paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,136,808 lekë dhenë mbyllje të vitit 2023 në vlerën 468,018 lekë, me një diferencë në zbritje për vitin ushtrimor prej - 668,790 lekë, e cila përfaqëson ulje të gjendjes së mallrave ne fund te vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët ”** paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 10,164,757 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 11,474,384 lekë me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 1,309,627 lekë, e cila përfaqëson rritje te inventarit te imët për vitin 2023.

**Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme”** paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 147,780,917 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 393,798,791 lekë, ku kemi rritje të vlerës në krahasim me vitin paraardhës, si rezultat i sistemim/kontabilizimeve në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” të diferencave të faturave për mallra, shërbime dhe investime të realizuara brenda vitit 2023, të buxhetuara në PBA.

- **Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”**, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 55,045,701 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 116,204,628 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 ka pësuar një rritje prej 61,158,927 lekë. Në këtë rritje ka ndikuar shtimi i vlerës së debitorëve të taksave familjare, të cilat i janë sjellë financës këtë vit për herë të parë për ti evidentuar. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar dhe gjendja e debitorëve të taksave në vlerën 106,824,471 lekë, që zënë 92% % te vlerës debitore. Pjesa tjetër janë detyrimet e lindura nga rekomandimet “shpërblim dëmi” të lëna nga KLSH në vite, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërkitimit. Analiza e gjendjes së llog.468 “Debitorë të ndryshëm” dhe lëvizjet e pësuar në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në Aneks:

**Gjendja e llogarise 468“Debitore te ndryshem” me date 31.12.2023**

NR	DEBITORET LLOGARIA 468	GJENDJA ME 01.01.2023	Shtesa per vitin 2023	Paksime per vitin 2023	Gjendja me 31.12.2023
	<b>BASHKIA MALESI E MADHE</b>				0
1	<b>Taksa vendore familjar(Lista)</b>		<b>50.439.387</b>		<b>50.439.387</b>
2	Taksa te paarketuara biznesi Bashkia Qender	7.332.365	5.103.145	1.762.665	<b>10.672.845</b>
3	Taksa te paarketuara biznesi Njesia Qender	2.115.930	2.093.370	832.280	3.377.020
4	Taksa te paarketuara biznesi Njesia Kastrat	10.587.825	2.633.886	1.248.045	11.973.666
5	Taksa te paarketuara biznesi Njesia Gruemire	4.334.245	3.583.161	749.036	7.168.370
6	Taksa te paarketuara biznesi Njesia Shkrel	977.120	1.599.387	1.577.025	999.482
7	Taksa te paarketuara biznesi Njesia Kelmend	1.199.335	979.804	248.919	1.930.220
8	Takse ndikimi ne infrastrukture e paarketuar	19.118.724	1.296.614	151.857	20.263.481
	<b>Shuma debitor taksa</b>	<b>45.665.552</b>	<b>17.289.367</b>	<b>6.569.827</b>	<b>56.385.084</b>
	<b>Subjekte (shpërblim dëmi nga auditit i jashtëm)</b>				
9	Florinda Hila gjoba ( 2008 +2009)	550.000			550.000
10	Fatbardha Mema gjoba 2009	50.000			50.000
11	Faik Shegaj gjoba( 2008 + 2009)	505.900			505.900
12	Majlinda Bozo	1.000.000			1.000.000
13	Gezim Isufaj	897.360			897.360
14	Mirsad Sh.p.k	1.240.267			1.240.267
15	D Sh.p.k ( Auditim Prefektura Shtator 2015)	717.220			717.220
16	"S"Sh.p.k	2.131.854			2.131.854
17	St Sh.p.k.	257.000			257.000
18	Karl G Kontruksion	380.548			380.548
	<b>Shuma Subjekte</b>	<b>7.730.149</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>7.730.149</b>
	<b>Gjoba IVMT</b>				
19	DRICONS Sh.p.k	50.000			50.000
20	ARENA MK	50.000			50.000
21	INFRACONSULT	50.000			50.000
22	INFRACONSULT	500.000			500.000
23	Besim Hyseni	500.000			500.000
24	Pjerin Noçaj	500.000			500.000
	<b>Shuma Gjoba IVMT</b>	<b>1.650.000</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1.650.000</b>
	<b>Totali</b>	<b>55.045.701</b>	<b>67.728.754</b>	<b>6.569.827</b>	<b>116.204.620</b>

- **Gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”** në aktiv të bilancit përfaqëson detyrimet afatshkurtra për vitin ushtrimor, që trashëgohen në vitin pasardhës. Gjendja e kësaj llogarie në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 272,065,045 lekë, e cila rakordon me shumën e gjendjeve të llogarive të detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit si: llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën 233,514,778 lekë, llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 21,878,914 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 1.059.854 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 6,400,313 lekë, llog.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 875,201 lekë dhe llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 8,335,985 lekë.

## **II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE**

### **Auditimi i aktiveve afatgjata materiale**

**1.Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale**, janë që të sigurohemi se:

Aktivitet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

## **2. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:**

- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjëndjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;

- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**;

- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;

- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranura dhe udhëzimeve përkatëse.

- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;

- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

## **3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:**

**a.** Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivitet e blera janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël, nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);

- Për Aktivitet e marra falas janë kryer teste për 3 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;

- Aktivitet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

**b.** Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Proçedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranura;

- Përdor referencat ose tekNt më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifikë, etj.);

- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 “**Aktivitet Afatgjata**” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 4,140,988,107 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 4,033,276,854 lekë, ku diferenca përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,924,715,576 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 4,569,536,849, të cilat janë të pasqyruara më poshtë, sipas llogarive analitike.

**Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale”** që përbëhet nga:

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”** në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 11,625,840 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në shumën prej 9,479,631 lekë, diferenca është vlera e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 11,625,840 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 11,625,840 lekë. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar në Aneks.

<b>AKTIVE TE QENDRUESHME</b>	Gjendja	Shtesa	Gjendja	Statusi
<b>TE PATRUPEZUARA</b>	31/12/2022	2023	31/12/2023	
STUDIME OSE KERKIME				

1	Hartimi I planit vendor Qyteti Koplík	479.989		479.989	Ne Proces
2	Studim Projektim I Rrugës Bratosh-Vrith	4.373.117		4.373.117	Ne Proces
3	studim projektim stadiumi I Koplíkut	6.772.734		6.772.734	Ne Proces
	<b>SHUMA</b>	<b>11.625.840</b>	<b>0</b>	<b>11.625.840</b>	

Referuar tabelës vlëra bruto prej 11,625,840 lekë i përket 3 projekteve, të cilat janë për investime në rrugë, sport, ujësjellsa, vlëra e të cilave nuk është kontabilizuar si pjesë e aktivitetit, pasi janë në proces dhe pritet të vihen në funksionim në vitet e mëvonshme.

*U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitin 2023.*

**Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “Aktivet afatgjata materiale”** paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,418,740,822 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në shumën totale prej 3,377,796,659 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,913,089,736 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 4,557,911,008 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- **Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”** paraqitet me vlerë neto si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 9,342,194 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 është në të njëjtën vlerë prej 9,342,194 lekë. Analiza e gjendjes së llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” paraqiten në Aneks.

Nr	Emërtimi i aktivitetit	Gjendja në fund të vitit 2022	Shtesa	Pakësime	Gjendja në fund të vitit 2023
	<b>Shuma</b>	<b>9,342,194</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>9,342,194</b>
1	Rikonstrukcion Oborri Sh.9-Vjecare viti 2008	2,074,403			2,074,403
2	Sistemim Oborri Sh.9-Vjecare viti 2009	3,306,784			3,306,784
3	Projektim sistemim asfaltim rruga Gruemire-Limaj	2,179,103			2,179,103
4	Projekte Sist. Asf. Rruga Kastrat-Rrapsh	1,781,904			1,781,904

**Konkluzion:** Në analizën e gjendjes së llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” paraqitet me vlerë neto si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 9,342,194 lekë. Në gjendjen e kësaj llogarie është përfshirë në mënyrë të gabuar vlëra prej 2,179,103 lekë e aktivitetit “Projektim sistemim asfaltim rruga Gruemire-Limaj” dhe vlëra prej 1,781,904 lekë e aktivitetit “Projekti sistemim-asfaltim rruga Kastrat-Rrapsh”, të cilat sipas verifikimit të investimeve të kryera i përkasin llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, veprim në kundërshtim me përcaktimet e UMF nr. 8, datë 9.03.2018, kapitulli II, pika 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, ku në pikën 11 përcaktohet se: *Përmbledhja e llogarive në klasa është mbështetur në analizën funksionale të veprimeve që ato përshkruajnë. Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik është paraqitur në aneksin 1 të udhëzimit*” dhe me Nomenklaturën e Llogarive të planit kontabël publik.

**Konkluzion: Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione”** paraqitet në vlerë bruto dhe neto si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 15,388,760 lekë. Referuar analizës së kësaj llogarie rezulton se, janë 4 aktive me vlerë 10,743,076 lekë që nuk kanë emërtime të plota dhe të sakta se kuj NJA apo zone i përkasin, si dhe mungojnë të dhëna të detajuara inventariale për to. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30. Analiza e kësaj llogarie paraqitet në Aneks.

	Emërtimi i aktivitetit	Gjendja në fund të vitit 2022	Shtesa	Pakësime	Gjendja në fund të vitit 2023
	<b>Shuma</b>	<b>15,388,760</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>15,388,760</b>
1	Mbjellje shelgu bregu liqenit Sterbeq-Jubice	477.660			477.660
2	Gjelb.teritori publik shk.9-vjec.Kamice	478.224			478.224

3	Mbjellje plepa fsh.Lohe Poshtme	158.304		158.304
4	Pyllzim me selvi varrezat Jubice	479.016		479.016
5	Pyje kullota plantacione	2.429.238		2.429.238
6	Pyje kullota plantacione	2.276.989		2.276.989
7	Ndertim lulishte Komuna	3.429.858		3.429.858
8	Gjelb.teritori publik	2.606.991		2.606.991
9	Gjelbrim territorit te Komunes Gruemire	3.052.480		3.052.480

- **Gjendja e llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 744,013,244 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 734,244,794 lekë. Ndërsa gjendja me kosto historike, sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,014,655,500 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,042,025,411 lekë. Gjatë vitit 2023 janë bërë shtesat në vlerën 27,369,911 lekë, e përbërë nga vlera 21,317,042 lekë e investimeve të kryera me pagesë brenda sistemit dhe 6,052,869 lekë AAGJM jashtë sistemi të krijuara nga transferimet kapitale te objekteve pranë Bashkisë nga institucione të tjera. Analiza e gjendjes së llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione” dhe ndryshimet për vitin 2023 paraqiten në Aneks.

- **Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,588,416,017 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 2,566,635,613 lekë. Ndërsa gjendja me kosto historike, sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,588,416,017 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 3,202,326,495 lekë. Gjatë vitit 2023 janë bërë shtesat në vlerën 613,910,478 lekë, e përbërë nga vlera 566,979,601 lekë që përfaqëson investime të kryera me pagesë brenda sistemit në “Furnizimi i me ujë i zonës së Koplikut Qendër dhe Kopluk i Sipërm” dhe pjesa tjetër investime në rrugë dhe KUZ, si dhe nga vlera 46,930,877 lekë investime te kryera jashtë sistemi. Analiza e gjendjes së llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, si dhe ndryshimet per vitin 2023 paraqiten në Aneks.

**Konkluzion: Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** paraqitet me kosto historike në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 613,910,478 lekë. Referuar analizës së kësaj llogarie rezulton se, janë në gjendjen e kësaj llogarie janë përfshirë në mënyrë të gabuar vlera prej 2,524,911 lekë e aktivitet “Projekt i urës lidhëse te fshatrave Vermosh- Velan-Velipoje”, vlera prej 780,000 lekë e aktivitet “Projektet” dhe vlera prej 360,000 lekë e aktivitet “Projekt rruga fundi i Brinjes”, të cilat sipas verifikimit të investimeve të kryera i përkasin llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”. Gjithashtu në këtë gjendje janë përfshirë 11 aktive me vlerë 105,767,829 lekë, që nuk kanë emërtime të plota dhe të sakta se kuj NJA apo objekt investimi i përkasin, si dhe mungojnë të dhëna të detajuara inventariale për to. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30. Rastet në mënyrë të detajuar paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emertimi I aktivitet	Gjendja në 31.12.2022	Shtesat gjate vitit 2023	Gjendja në 31.12.2023
	<b>Shuma</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>101,488,530</b>
11	Projekt I ures lidhese te fshatrave Vermosh- Velan-Velipoje	2524911		2524911
47	Mirembajtje ujesjellesa	478617		478617
48	Rikonstruksion rrugesh +urash	2745900		2745900
54	Mirembajtje ujesjellesash	650160		650160
55	Rik.=ndertim objektesh	1500732		1500732
56	Supervizion punimesh	232800		232800
57	Projektet	780000		780000
38	Konstruksione te veprave	72363721		72363721
5	Rruge	1989240		1989240
1	Ura	7944210		7944210
27	Mirembajtje rrugesh	1015450		1015450
28	Projekt rruga fundi I Brinjes	360000		360000
40	Mirmbajtje ujesjellesi	2144600		2144600

45	Kostruksione I rrjeteve Elektrike	14702399	14,702,399
----	-----------------------------------	----------	------------

**Konkluzion:** Bazuar në VKM nr.302, datë 11.05.2023 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura” dhe marrëveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësllës Kanalizime Shkodër, Ujësllës Kanalizime sha Malësi e Madhe i është bashkëngjitur Ujësllës Kanalizime Shkodër. Referuar analizës të gjendjes së llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” rezulton se, nuk është zbritur vlera e investimeve të kryera në ujësllës që duhej të transferohej tek Ujësllës Kanalizime SHA Shkodër, për 24 aktive dhe pjesë aktivesh në vlerën 1,524,931,322 lekë (përfshirë investime në ujësllës e rrjetin shpërndarës, KUZ, depo dhe pompa uji) në kundërshtim me VKM nr.153, datë 03.04.1993 “Për kalimin e objekteve, të mjeteve kryesore, të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore” i ndryshuar, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. Në mënyrë të përmbledhur këto aktive paraqiten në Aneks.

Nr sipas kotabilit	Nr rendor	Emertimi I aktivitet	Gjendja në 31.12.2022	Shtesat gjate vitit 2023	Gjendja në 31.12.2023
		<b>Njesia Administrative Koplík</b>	678544748		729497460
21	1	KUZ Llazan	1978488		1978488
22	2	KUB Koplík	7207029		7207029
23	3	KUZ Koplík	2322094		2322094
24	4	Ujesjellesi lagjja Mehaj	6973628		6973628
36	5	Furnizimi i me ujë i zonës së Koplíkut Qendër dhe Koplík i Sipërm	0	440096368	440096368
		<b>QENDER</b>			
6	6	KUZ Bogiq	15953369		15953369
11	7	KUB Palvar	3905531		3905531
28	8	Ujesjellesi Komuna Qender	158967400		158967400
		<b>KËLMEND</b>			
14	9	Ujesjellesi Tamare	170000		170000
35	10	Rik.ujesjelles Broje	397529		397529
36	11	Rik.ujesjellesi Vermosh	447005		447005
37	12	Rik.ujesjellesi Nikc-Kale	396216		396216
38	13	Rik. Ujesjellesi Vukel	498651		498651
39	14	Ujesjellesi Qafe Berdeleceit	1376606		1376606
		<b>KASTRAT</b>			
50	15	Kontrate Furnizimi me uje fshatrat Gradec-Pjetroschan	0	97686355	97686355
		<b>SHKREL</b>			
2	16	Ujesjellesi Shkrel	5607204		5607204
3	17	Ujesjellesi Rec-KolNj	9563733		9563733
4	18	Ujesjellesi Rec-Razem	1788278		1788278
33	19	Ndertim.ujesjells Boge	4619529		4619529
		<b>GRUEMIRË</b>			
38	20	Ndertim Ujesjellesi Balshaj	12152689		12152689
39	21	Mirembajtje ujesjellesi Kurte	299880		299880
41	22	Ndertim ujesjellesi Kcar I Poshtem	6366488		6366488
42	23	Ndertim ujesjellesi Grude Fushe	8399350		8399350
43	24	Ndertim ujesjellesi Gjorm I Poshtem	8260442		8260442
		<b>SHUMA</b>			<b>1,524,931,322</b>

- **Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 22,145,799 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 23,596,910 lekë, ku diferenca është amortizimi i përllogaritur i vitit ushtrimor për këtë grup aktivesh. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 61,978,174 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 70,085,805 lekë, për të cilat ka inventar fizik. Në këtë grupaktivesh shtesat për vitin 2023 janë ne shumën 8,699,781leke, dhe pakësimet në vlerën prej 592,1501 lekë, e cila përbëhet nga nxjerrjet jashtë përdorimit të këtyre aktiveve në vlerën 592,150 lekë të vitit 2023. Analiza e gjendjes së

Ilogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, si dhe ndryshimet nga viti 2022 në vitin 2023 paraqitet në Aneks.

**Inventari kontabël i llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, me datë 31.12.2023**

Nr	Emertimi I aktivitet	Gjendja në 31.12.2022	Pakesime gjate vitit 2023	Shtesat gjate vitit 2023	Gjendja në 31.12.2023
1	Paisje dhe shpenzimet instaluese te telekomuNcionit	9.573.854	-		9.573.854
2	Paisje mence		280.800		280.800
3	Paisje qe sigurojne energji	<b>8.981.250</b>	<b>189.600</b>		9.170.850
4	Paisje dhe instrumente laboratorike	8.680.114	-		8.680.114
5	Instalimi i sistemit te kompjuterave	2.186.073	-	257.430	1.928.643
6	Paisje dhe instalimi i kondicionereve	1.132.067	237.600	-	1.369.667
7	Makineri printimi dhe grafimi	36.768	-	-	36.768
8	Paisje dhe instalime portuale	<b>720.000</b>	-		720.000
9	Paisje dhe makineri per kopshtarine	543.600	-	334.720	208.880
10	Paisje per mbrojrjen ndaj zjarrit	622.800	-		622.800
11	Paisje pastrimi per rruget	22.652.974	7.951.800		30.604.774
12	Paisje per Policine	592.800	-		592.800
13	Paisje per sistemin e sigurimit	<b>132.470</b>	-		132.470
14	Paisje audio-vizuale	5.733.097	39.981		5.773.078
15	Mjete dhe paisje te tjera teknike	390.307	-		390.307
	<b>Shuma</b>	<b>61.978.174</b>	<b>8.699.781</b>	<b>592.150</b>	<b>70.085.805</b>

- **Gjendja e llogarisë 215 “Mjete Transporti”** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 22,218,385 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 13,982,071lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 120,693,223 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 130,628,312 lekë. Shtesat gjatë vitit 2023 janë në vlerën 9,935,089 lekë. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e këtyre aktiveve nga viti 2022 deri në fund të vitit 2023 paraqiten në Aneks:

- **Gjendja e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik”** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 17,216,423 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 14,606,317 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 102,615,869 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 88,114,032 lekë. Në këto gjendje përfshihet shtesa me pagesë në vlerën prej 1,177,680 lekë e pajisjeve dhe transferimet kapitale nga institucionet e tjera qendrore në vlerën 6,506,436 lekë, për të cilat janë ndjekur procedurat financiare e ligjore për evidentimin e tyre. Pakësimet janë në vlerën 22,185,953 lekë, që përfaqësojnë aktivet e inventarit ekonomik të nxjerrë jashtë përdorimi për llogari të vitit 2023.Në mënyrë të përmbledhur aktivet e llog. 218 “Inventar Ekonomik” dhe ndryshimet nga viti 2022-2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emertimi I aktivitet	Gjendja në 31.12.2022	Shtesa gjatë vitit 2023	Pakësimet gjatë vitit 2023	Gjendja në 31.12.2023
	<b>INVENTAR EKONOMIK</b>	<b>102615869</b>	<b>7684116</b>	<b>22185953</b>	<b>88114032</b>
1	Orendi zyre	54865548	5801161	8480937	52185772
2	Fotokopje	2700877	900000	659850	2941027
3	Pajisje kompjuteri	23576047	352323	7506108	16422262
4	Te tjera pajisje zyre	21473397	630632	5539058	16564971
	<b>Aktive ne proces</b>	<b>625121740</b>		<b>-228849195</b>	<b>396272545</b>

- **Gjendja e aktiveve afatgjata** në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet per vitin 2023 paraqiten në Formatin nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata ( kosto historike)” të PF si më poshtë:

Nr. Refer Llog	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
20	I. AAGJ/O MATERIALE	11,625,840	0	0	0	2,146,209	0	0	9,479,631	0	9,479,631
202	Studime dhe kerkime	11,625,840	0	0	0	2,146,209	0	0	9,479,631	0	9,479,631
21-28	II. AAGJ/ MATERIALE	<b>3,913,089,736</b>	<b>494,348,914</b>	<b>3,418,740,822</b>	<b>667,599,375</b>	<b>704,085,041</b>	<b>22,778,103</b>	<b>18,319,606</b>	<b>4,557,911,008</b>	<b>1,180,114,349</b>	<b>3,377,796,659</b>
210	Toka,troje, Terene	9,342,194		9,342,194					9,342,194	0	9,342,194
211	Pyje,Kullota Plantacione	15,388,760		15,388,760					15,388,760	0	15,388,760
212	Ndertime e Konstruksione	1,014,655,499	270,642,255	744,013,244	27,369,911	37,138,361			1,042,025,410	307,780,616	734,244,794
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	2,588,416,017	0	2,588,416,017	613,910,478	635,690,882			3,202,326,495	635,690,882	2,566,635,613
214	Ins tekn,makiner,pais,vegla	61,978,174	39,832,375	22,145,799	8,699,781	7,038,078	592,150	381,558	70,085,805	46,488,895	23,596,910

215	Mjete transporti	120,693,223	98,474,838	22,218,385	9,935,089	18,171,403			130,628,312	116,646,241	13,982,071
218	Inventar ekonomik	102,615,869	85,399,446	17,216,423	7,684,116	6,046,317	22,185,953	17,938,048	88,114,032	73,507,715	14,606,317
24	Aktive Qend trupëz te demtu	0		0					0	0	0
28	Caktime	0		0					0	0	0
<b>T O T A L I ( I + II )</b>		<b>3,924,715,576</b>	<b>494,348,914</b>	<b>3,418,740,822</b>	<b>667,599,375</b>	<b>706,231,250</b>	<b>22,778,103</b>	<b>18,319,606</b>	<b>4,567,390,639</b>	<b>1,180,114,349</b>	<b>3,387,276,290</b>

- **Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale** paraqitet në bilanc në vlerën 1,180,114,349 lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9. Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.8, datë 9.3.2018”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 36. Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje te periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit.

### **Inventarizimi i aktiveve për vitin 2023 Bashkia Malësi e Madhe**

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2023 për Bashkinë Malësi e Madhe.

Nga Titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit për vitin 2023 kanë dalë urdhrat nr.169, 170,171,172,173,174,175,datë 04.12.2023 “Per ngritjen e komisioneve te inventarizimit, këto komisione mbasi kane kryer Inventarizimin kanë mbajtur procesverbale te datave 18/19.012.2023.

Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive për Bashkinë Malësi e Madhe. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit Dhjetor 2023 dhe rezultojnë pa diferenca.

Në rubrikën e rezultati/shënime nga komisionet e inventarizimit janë evidentuar aktivet që propozohen për nxjerrje jashtë përdorimi. Në fund të procesit të inventarizimit nga grupet e inventarizimit janë hartuar Procesverbale përmbledhës te datave i datës 18/19.12.2023 për gjithë inventarin e AAGJM, ku përshkruhen mënyra e ruajtjes së këtyre aktiveve dhe konfirmimi i rezultatit të inventarit. Kryetari i Bashkisë me vendimet nr. 241/242/243/244/245/245.1 date 19.12.2023 ka vendosur për nxjerrjen jashtë përdorimit te materialeve si dhe me Urdhër nr. 192, datë 26.12.2023 ka ngritur komisionin për asgjësimin e tyre sipas paragrafit 111 të Udhëzimit nr:30, datë 27/12/2011 të Ministrisë së Financave. Në këtë dokument, komisioni është shprehur se, këto aktive janë të konsumuara e nuk kanë më vlerë përdorimi dhe nuk mund të riparohen, si dhe janë listuar materialet që propozohen për t’u nxjerrë jashtë përdorimi, sipas proces-verbalit të Komisionit të Vlerësimit e të sistemuara, sipas llogarive përkatëse, si më poshtë:

Nr	EMERTIMI	Vlefte
1	Konvikti	17382
2	Sherbimet Publike	217193.3
	<b>Llog.214”Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”</b>	<b>234,575.3</b>

Nr	EMERTIMI	Vlefte
1	Administrata Malësi e Madhe	341675
2	Nj.Administrative Gostim	1088067.6
3	Nj.Administrative Mollas	257005
4	Nj.Administrative Klos	581468
5	Nj.Administrative Shales	766772
6	Ujesjellesi	128900
	<b>SHUMA llog. 218 “inventar ekonomik”</b>	<b>3,034,987.6</b>

Nr	EMERTIMI	Vlefte
1	Administrata Malësi e Madhe	285196.24

2	Nj.Administrative Gostim	223310.7
3	Ujesjellesi	74037.2
4	Nj.Administrative Klos	49436
2	Nj.Administrative Shales	219569
	<b>SHUMA llog. 327 "inventor i imët"</b>	<b>851,549.19</b>

**Konkluzion:** Referuar të dhënave të kontabilitetit dhe inventarit fizik gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) të klasës 21 për vitin 2023 është në vlerën 4,557,911,008 lekë, ku janë pasqyruar të gjitha lëvizjet e aktiveve gjatë vitit 2023 për shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktiv. Në inventarët kontabël të aktiveve materiale gjendje në llogaritë: 210 "Toka, Troje, Terrene" është në vlerën 9,342,194 lekë; 211 "Pyje, Plantacione" në vlerën 15,388,760 lekë, 212 "Ndërtesa Konstruksiione" në vlerën 1,042,025,410 lekë; 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" në vlerën 3,202,326,495 lekë; 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" në vlerën 70,085,805 lekë janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera gjatë vitit 2023 për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Rregjistri historik nuk është i plotë me të gjithë të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me për çdo aktiv në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" kapitulli III, pika 30, me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik" Pika 2. Klasa 2, "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël).

- Gjendja e llog. 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 633,813,395 dhe gjendja e llog. 230 "Shpenzime në proces për rritjen e AJM" në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 12,187,169. Ne total llog 23 ne pasqyrat Financiare te viti 2023 paraqitet 646,000,564 lekë. Analiza e llogarisë 23 "Investime" paraqitet në Aneks.

#### Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M E R T I M I	në lekë	
			Ushtrimi I Mbyllur 2023	Ushtrimi Paraardhes 2022
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	437.482.960	193.481.230
66		I.Pasivet Afat shkurtra	437.482.960	193.481.230
67		1. Llogari te Pagushme	321.278.332	193.481.230
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	233.514.778	
69	42	Detyrime ndaj personelit	21.878.914	19.109.968
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	1.059.854	913.539
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		60.574.819
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	6.400.313	5.536.197
76	436	Sigurime Shendetsore	875.201	769.736
77	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	43.684.169	45.700.313
82	467	Kreditore te ndryshem	8.335.985	60.876.658
83	4341	Operacione me shtetin( detyrime	5.529.118	
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		<b>2.Te tjera pasive afatshkurtra</b>	<b>116.204.628</b>	<b>0</b>
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese	116.204.628	
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		

90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
91		<b>II.Pasivet Afat Gjata</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provigjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	<b>C</b>	<b>AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)</b>	<b>4.223.409.188</b>	<b>4.302.236.397</b>
97	<b>D</b>	<b>FONDI I KONSOLIDUAR :</b>	<b>4.223.409.188</b>	<b>4.302.236.397</b>
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	4.045.219.256	4.152.289.672
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	178.189.932	149.946.725
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime		
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshmne		
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
105	107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim		
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
107		Te Tjera		
108	<b>E</b>	<b>TOTALI I PASIVEVE(B+C)</b>	<b>4.660.892.148</b>	<b>4.495.717.627</b>

**Pasivet afatshkurtra.** Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 437,482,960 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- **Gjendja e llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Gjendja e kësaj llogarie në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 233,514,778 lekë, vlerë e cila përfaqëson faturat e investimeve të buxhetuara me periudha 3-vjeçare (PBA), likuidimi i të cilave është planifikuar në 2 vitet e ardhshme 2024-2025 si dhe fatura të palikuiduara për mallra dhe shërbime të periudhës së fundvitit ushtrimor. Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie rezulton se, përbëhet nga 66 fatura të palikujduara ndaj të tretëve, borxh i krijuar në vitet 2022-2023, ku në mënyrë të detajuar paraqitet në Aneks.

**Analiza e llogarisë 401 “Furnitorë e llogari të lidhura me to (mallra e shërbime)”**

Emërtimi i i Objektivit të Prokurimit	Emërtimi i Subjektit Kreditor	Numri dhe data e faturës	Vlera e kredisë (detyrimit) 31.12.2022	Shtesat gjatë vitit 2023	Shlyerjet gjatë vitit 2023	Vlera e detyrimit me 31.12.2023
Sist. Asfaltim Rruga e Reçit-Qafgrade	L	21/03.11.2022	8,148,768		2,156,400	5,992,368
Dif.Sist. Asfaltim Rruga Kcar I poshter	L	20/31.10.2022	4,259,056		4,000,000	259,056
Sist. Asfaltim Rruga Kcar I poshter	L	23/14.11.2022	2,734,380			2,734,380
Sist. Asfaltim Rruga e Spitali ne Koplik	L	24/14.11.20220	1,940,280			1,940,280
Dif. Sist. Asfaltim Rruga e Spitali ne Koplik	L	22/11.11.2022	26,989			26,989
Dif. Sist. Asfaltim Rruga Zeqir memaj	L	25/15.11.2022	5,201,488		3,000,000	2,201,488
Dif. Sist. Asfaltim Rruga Bogiq	S	100838/09.11.2022	7,173,985		4,000,000	3,173,985
Dif. Sist. Asfaltim Rruga Ktosh ne Qender	S	100837/09.11.2022	5,651,109		3,000,000	2,651,109
Dif. Sist. Asfaltim Rruga e Xhamise ne Boric	K	13/10.11.2022	37,771		37,771	-
Dif. Riveshje me asfalt Rrethrotull Vrake-Qender	N	72/15.11.2022	9,921,631		6,336,000	3,585,631
"Sistemim Asfaltim Rruga Lagje e re Ndrecaj Bajze	S	100844/25.11.2022	2,937,637		1,500,000	1,437,637
"Sistemim Asfaltim Rruga e Liqenit ne Culaj	S	100849/12.12.2022		1,270,704		1,270,704
"Sistemim Asfaltim Rruga e Liqenit ne Culaj	S	100846/02.12.2022		2,560,476		2,560,476
Sist. Asfaltim Rruga Bogiq	S	100843/25.11.2023		2,312,098		2,312,098
Sist. Asfaltim Rruga Ktosh ne Qender	S	100842/25.11.2022		1,047,278		1,047,278
"Sistemim Asfaltim Rruga e Cenaj Rrogom	S	100847/02.12.2022		1,824,553		1,824,553
"Sistemim Asfaltim Rruga e Cenaj Rrogom	S	100848/12.12.2022		6,911,116		6,911,116
"Sistemim Asfaltim Rruga Zeqir Memaj	L	30/29.12.2022		2,779,282		2,779,282
Sistemim Asfaltim Rruga Unaze Mehaj	K	16/13.12.2022		1,941,669		1,941,669
Studim projektim I disa Rrugeve	Z	39/11.10.2022	3,100,000		2,500,000	600,000
"Sistemim Asfaltim Rruga Kastrat-Rapshe	L	6/31.03.2023		12,467,916		12,467,916
Riveshje me asfalt Rrethrotullim Vrake-Qender	N	80/12.12.2022		6,054,278		6,054,278
Sist. Asfaltim Rruga e Xhamise ne Boric	K	17/13.12.2022		967,029		967,029
"Sistemim Asfaltim Rruga Linaj Kurte	Alb	10.31.03.2023	13,392,000		5,083,848	8,308,152
Superv. Sistemim Asfaltim Rruga Zeqir Memaj	No	5/20.01.2023		195,341		195,341
Sistemim Asfaltim Rruga Linaj Kurte	Alb	11/07.04.2023		4,167,600		4,167,600
Kolaudim Sistemim Asfaltim Rruga Zeqir Memaj	L	1/02.02.2023		13,067		13,067
Ndertim Impjanti I ngrohjeve	M	20/27.04.2023	27,652,730		6,073,162	21,579,568

<b>Totali i detyrimit e prapambetura</b>			<b>92,177,824</b>	<b>44,512,407</b>	<b>37,687,181</b>	<b>99,003,050</b>
Sistemim Asfaltim Rruga Koplik Siper - Luis	L	9/23.05.2023		4,149,348		4,149,348
Sistemim Asfaltim Rruga Koplik Siper - Luis	L	16/17.07.2023		6,253,980		6,253,980
Sistemim Asfaltim Rruga Veçëçiku	L	8/22.05.2023		2,376,757		2,376,757
Sistemim Asfaltim Rruga Veçëçiku	L	14/05.06.2023		2,556,120		2,556,120
Sistemim Asfaltim Rruga Gjuraj- Koplik Siper	L	10/29.05.2023		99,871		99,871
Sistemim Asfaltim Rruga Gjuraj- Koplik Siper	L	15/26.06.2023		10,805,938		10,805,938
Riparim Rruga Fshati Omaraj	A	20/04.07.2023		875,600		875,600
Riparim Rruga Fshati Omaraj	A	21/19.07.2023		7,924,200		7,924,200
Sistemim Asfaltim Rruga Drekaç	A	18/27.06.2023		5,418,940		5,418,940
Riparim Rruga Rrash Vorfe -Vorfe	S	30/10.06.2023		335,308		335,308
Riparim Rruga Rrash Vorfe -Vorfe	S	32/15.06.2023		4,761,827		4,761,827
Sistemim asfaltim rruga e Lohes Faza 2,	S	29/10.06.2023		310,256		310,256
Sistemim asfaltim rruga e Lohes Faza 2,	S	61/07.07.2023		8,561,497		8,561,497
Sist Asfal Rruga Koplik Razem per tek Rug e Reçit	S	28/10.06.2023		154,732		154,732
Sist Asfal Rruga Koplik Razem per tek Rug e Reçit	S	62/07.07.2023		17,968,987		17,968,987
Sist Asf Rr Fermentimit Hotaj e Kurtaj lagje Palvar	C	45/21.06.2023		10,479,445		10,479,445
Sistemim asfaltim rrugas Syri i Gjonit	N	01/15.06.2023		5,712,490		5,712,490
Sistemim Asfaltim Rruga Sterkuje	C	75/11.09.2023		15,506,400		15,506,400
Sistemim asfaltim rruga e Kishes Selces	A	23/18.08.2023		1,513,317		1,513,317
Sistemim asfaltim rruga e Kishes Selces	A	24/23.08.2023		1,892,952		1,892,952
Sist Asfal Rr Koplik-Sterbeq-Jubice-Kamice 2023	L	21.30.10.2023		226,564		226,564
Sist Asfal Rr Koplik-Sterbeq-Jubice-Kamice 2024	L	24/18.12.2023		5,518,008		5,518,008
Sist Asfal Rr Grude Fushe poshte ne drejtim Liqeni	N	26/11.10.2023		10,661,606		10,661,606
Sistemim asfaltim rruga e Shen Pali Shen Pjetri	P	23/22.12.2023		4,889,470		4,889,470
Pamje panoramike Vrith	S	96/14.11.2023		3,289,244		3,289,244
<b>Total fatura 3-Vjecare</b>		-	-	<b>132,242,857</b>	-	<b>132,242,857</b>
Aktiviteti I Fundvitit 2023	B	Nr.34 dt.30.01.2023		872,400		872,400
Kolaudim Sistemim asfaltim rruga Rrash -Vorfe	L	nr. 35 dt. 15.09.2023		19,304		19,304
Supervizim Siste asfaltim rruga Rrash vorfe-Vorfe	N	nr.59 dt. 15.09.2023		121,497		121,497
Supervizim Sist asfal Rr Degezim I rruges Koplik	N	nr. 60 dt. 15.09.2023		327,679		327,679
Supervizim Sistemim asfaltim rruga e Lohes faza 2	N	nr.55 dt. 15.09.2023		184,876		184,876
Kolaudim Sistemim asfaltim rruga fshati Omaraj	F	nr. 35 dt. 21.09.2023		16,087		16,087
Kolaudim Sistemim asfaltim rruga Kisha e Selces	F	nr. 43 dt. 23.11.2023		9,875		9,875
Kolaudim Sistemim asfaltim rruga Grude Fushe	F	nr. 44 dt. 23.11.2023		17,850		17,850
Kolaudim Sistemim asfaltim rruga Sterkuje	B	nr. 18 dt. 13.11.2023		26,430		26,430
Supervizim Sistemim asfaltim rruga Grude Fushe	L	nr. 58 dt. 23.11.2023		208,655		208,655
Supervizim Sistemim asfaltim rruga Kisha e Selces	L	nr. 59 dt. 23.11.2023		93,222		93,222
Supervizim Sistemim asfaltim rruga Sterkuje	L	nr. 53 dt. 23.11.2023		274,995		274,995
kontroll teknik kaldaja	E	nr.629 dt.12.12.2023		96,000		96,000
		0	-	<b>2,268,871</b>	-	<b>2,268,871</b>
<b>total 401</b>		-	<b>92,177,824</b>	<b>179,024,135</b>	<b>37,687,181</b>	<b>233,514,778</b>

- **Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit”** paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën 21,878,914 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2024.

- **Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”** paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën kontabël 1,059,854 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2023 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2024.

- **Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore”** paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën 6,400,313 lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës janar 2024. lekë.

- **Gjendja e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore”** në fund të vitit 2023 është në vlerën kontabël 875,201lekë, e cila përbëhet nga sigurimet shëndetësore 1.7% nga punëdhënësi në vlerën 875,201lekë.

**Konkluzion: Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin ( detyrime)”** paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 5,529,118 lekë, e cila rakordon me llogarinë kundërpartit 423,429 “personeli, paradhënie, deficite, gjoba”, që përfaqësojnë gjoba dhe zhdëmtime të lëna nga kontrollet ndër vite, në Ish Bashkinë Koplik dhe Komunat para vitit 2015, kur janë bërë pjesë përbërëse e Bashkisë Malësi e Madhe.

- **Gjendja e llogarisë 475 “Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhëse”** paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 116,204,628 lekë, vlerë e cila i përket llogarisë kundërpartit 468

“Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit. Në fakt në llogarinë 475 “Të ardhura për tu regjistruar vitet pasardhëse” evidentohen të ardhurat që janë arkëtuar përpara ngjarjes ose veprimt qe krijon të ardhura, prandaj vlera prej 116,204,628 lekë e debitorëve duhej të ishte pjesë e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin ( detyrime)”. Llogaria 4341 ”Operacione me shtetin (detyrime)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022, Kreu III, pika 3.1 “Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, nënpika 32, Aneksi nr.1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, pika 3.3 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4), rubrika : “Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin”

- **Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 43,684,169 lekë. Për këtë gjendje të llog. 466 është bërë rakordimi në degën e Thesarit Malësi e Madhe.

- **Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”** përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara. Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 60,876,658 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 8,335,985 lekë me një diferencë në zbritje prej 52,540,673 lekë në krahasim me vitin 2022 si rezultat sistemimesh kontabël të kryera. Nga analiza e kësaj gjendje rezulton se, janë kryesisht detyrimet të lindura nga punë publike të kryera te pa paguara. Bashkia duhet të mos marrë angazhime për punë publike jashtë kapaciteteve të saj. Kryesisht këto detyrime kanë ardhur nga kontrata shumëvjeçare. Analiza e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqitet në Aneks:

Nr.	Emërtimi i i Objektivit	Emërtimi i	Numri dhe data e faturës	Gjendje 31.12.2022	Paguat 2023	Shtesa	Gjendje 31.12.2023
		Subjektit				2023	
1	Keshilltar shperblime Dhjetor 2023			819,190	819190	941383	941,383
2	Trajtim ushqimore Futbollista Dhjetor 2022			1,001,600	1001600	780800	780,800
3	Ndihma ekonomike Mb Financiare 6%			100,000	100,000		0
4	Ndihma ekonomike Dhjetor 2023			1,752,000	1752000	3290966	3,290,966
5	Paaftesia Shperblim			1584000	1584000		0
6	OSHEE	OSHEE		479,806	479806	607342	607,342
7	Ujesjelles Malesi e Madhe			15,144	15144	49740	49,740
8	Albaposta	Posta Shqipetare		265,457	265457	186291	186,291
9	Depozitim I mbetjeve urbane	Nderkomunale Bushat		200,679	200679	392976	392,976
10	Rikonstruk Ish godina e Keshillit te Rrethit	C	18.06.2008	331169			331,169
11	Rik.Ish godina e Keshillit te Rrhethit	C	24.12.2007	246759			246,759
12	Rik. Rruga Balshaj difer. e pa-likujduar,fat.-Dukaj shpk-Curri-sh.pk- K58507709L)	D	31.12.2013	96836			96,836
13	Rrethim varreza Ketosh difer. e pa-likujduar,fat.ser-Dukaj shpk- K58507709L)	D	31.12.2013	72938			72,938
14	Rruga Cek Dedaj	Rr	31.12.2014	214279			214,279
15	Projekte	R.g	01.07.2015	120000			120,000
16	Rik.rr.Reç-Lohe	Rr	31.08.2014	177558			177,558
17	Rik.Trotuar Dedaj	Rr	31.03.2014	148782			148,782
18	Ura Makaj-difer.e pa likujduar		31.03.2014	148446			148,446
19	Pastrim Mbeturina	Rr	15.12.2014	99300			99,300
20	Paisje Zyre	M	16.05.2014	83580			83,580
21	Rik.rrug-Qafe -Berd.(2007)	A	21/30.11.07(31.3.08)	19876			19,876
22	Rik.rruga Vermosh(2007)	A	21/30.11.07(31.03.08)	19876			19,876
23	Rik.rruga Vermosh(2007)	A	21/30.11.07(31.03.08)	14913			14,913
24	Rik.rrug.Josonove(2007)	A	21/30.11.07(31.03.08)	19802			19,802
25	Rik.Shtese Komunes(2007)	A	17.10.07(31.03.08)	53649			53,649
26	Rikon.ura Kelmend	L	31.03.2009(11.12.08)	39558			39,558
27	Hapje .rruga Gjenovic	L	31.03.2009(11.12.08)	104616			104,616
28	Ndertim ura Sheu i Todrit	L	16.07.2009	74550			74,550

**Konkluzion:** Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 8,335,985 lekë të 28 faturave të papaguara të hershme, ndërkohë që gjendja e llogarisë 401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 233,514,778 lekë, e cila përbëhet nga vlera prej 99,003,050 lekë e 27 faturave detyrime të prapambetura të raportuara dhe në MF, nga vlera prej 132,242,857 lekë e 25 faturave të investimeve të buxhetuara për financim në periudhën 3-vjeçare (PBA), si dhe vlera prej **2,268,871 lekë** e 13 faturave të pa likuiduara për mallra dhe shërbime të periudhës së fundvitit ushtrimor. Vlera pjesore prej **99,003,050 lekë** e detyrimeve të prapambetura të krijuara në periudha kohe para nëntor-dhjetorit të vitit ushtrimor të mbyllur, duhet të jetë pjesë e gjendjes e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu III pika 3.1 nën pikë 42, Aneksi 1 pika 3.3/c, ku përcaktohet se: “c) Konstatohen e paguhen shpenzime korrente e kapitale:

- Debitohet klasa 6 ose 23 (sipas analizave përkatëse);
- Kreditohet 401, 404, 467 e të tjera me analiza, kur detyrimi paguhet më vonë”.

**Analizë e llogarive** sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e përfomancës financiare” të PF të vitit 2023 paraqitet në Aneks.

**Formati nr.2 “Pasqyra e përfomancës financiare”**

Nr. rreshti	Nr. Llogarij e	P E R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E	VITI	VITI
			USHTRIMOR	I MEPARSHEM
a	b	c	1	2
			715228705.7	676036764.8
<b>1</b>	<b>A</b>	<b>TE ARDHURAT</b>	<b>1</b>	<b>8</b>
<b>2</b>	<b>70</b>	<b>LTE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET</b>	<b>69594250.88</b>	<b>62230390.88</b>
<b>3</b>	<b>700</b>	<b>1.Tatimi mbi te Ardhurat</b>	<b>118034.00</b>	<b>313178.00</b>
<b>4</b>	<b>7000</b>	Tatim mbi te ardhurat personale		
<b>5</b>	<b>7001</b>	Tatim mbi Fitimin		
<b>6</b>	<b>7002</b>	Tatim mbi Biznesin e vogel	118,034	313,178
<b>7</b>	<b>7009</b>	Te tjera Tatime mbi te ardhurat		
<b>8</b>	<b>702</b>	<b>2.Tatimi mbi Pasurine</b>	<b>34,899,856.00</b>	<b>31,670,652</b>
<b>9</b>	<b>7020</b>	Tatim mbi Pasurinë e paluajtshme	34,899,856.00	31,663,152.00
<b>10</b>	<b>7021</b>	Tatim mbi shitjen e pasurisë se paluajtshëm		
<b>11</b>	<b>7029</b>	Te tjera tatime mbi Pasurinë		7,500
<b>12</b>	<b>703</b>	<b>3.Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit</b>	<b>34546410.88</b>	<b>30192960.88</b>
<b>16</b>	<b>7033</b>	Takse mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	13,357,180.00	12,943,029.00
<b>17</b>	<b>7035</b>	Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	21,189,230.88	17,249,931.88
<b>18</b>	<b>704</b>	<b>4.Takse mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtarë</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>24</b>	<b>708</b>	<b>6.Te tjera Tatime e Taksa kombëtarë</b>	<b>29950.00</b>	<b>53600.00</b>
<b>25</b>	<b>709</b>	<b>7.Gjoha e Kamat vonesa</b>		
<b>26</b>	<b>75</b>	<b>II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>34</b>	<b>71</b>	<b>III.TE ARDHURA JO TATIMORE</b>	<b>35261064.00</b>	<b>31070639.00</b>
<b>35</b>	<b>710</b>	<b>1.Nga ndërmarrjet dhe pronësia</b>	<b>11642133.00</b>	<b>7022254.00</b>
<b>38</b>	<b>7109</b>	Te tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	11642133.00	7022254.00
<b>39</b>	<b>711</b>	<b>2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare</b>	<b>23239651.00</b>	<b>23951574.00</b>
<b>40</b>	<b>7110</b>	Tarifa administrative dhe rregullatorë	19270041.00	19442181.00
<b>41</b>	<b>7111</b>	Te ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	1333480.00	1391820.00
<b>42</b>	<b>7112</b>	Takse per veprime gjyqësorë e noteriale		
<b>43</b>	<b>7113</b>	Te ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	126000.00	145000.00
<b>44</b>	<b>7114</b>	Te ardhura nga biletat		
<b>45</b>	<b>7115</b>	Gjoha, kamatëvonesa, sekuestime e zhdëmtime	2510130.00	2972573.00
<b>46</b>	<b>7116</b>	Te ardhura nga transferimi pronës, Legalizimi i ndërtimeve pa leje		
<b>47</b>	<b>719</b>	<b>3.Te tjera te ardhura jo tatimore</b>	<b>379280.00</b>	<b>96811.00</b>
<b>48</b>	<b>76</b>	<b>IV.TE ARDHURA FINANCIARE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>53</b>	<b>72</b>	<b>V.GRANTE KORENTE</b>	<b>589765202.1</b>	<b>568902849.0</b>
<b>54</b>	<b>720</b>	<b>1.Grant korent I Brendshem</b>	<b>9</b>	<b>0</b>
<b>55</b>	<b>7200</b>	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	347674662.00	341825309.00

56	7201	Nga Buxheti per NJQP (Vendore)	188955783.19	190975650.00
59	7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale	11,701,389	9,138,929
60	7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
61	7206	Financim I pritshe nga buxheti	31,312,568	26,962,961
62	7207	Sponsorizime te brendshme( nga te trete)	10120800	
63	7209	Te tjera grante korente te brendshme		
64	721	<b>2.Grant korent I Huaj</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
66		Nga Organizata Nderkombetare		
67		<b>VI.TE ARDHURA TE TJERA</b>	19,324,290	14,705,919
72	787	Terheqje nga seksioni I investimeve	19324289.64	14705919.00
73	73	<b>VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE</b>	<b>1,283,899</b>	<b>-873,033</b>
74	B	<b>SHPENZIMET</b>	<b>677008442.0</b>	<b>635283697.0</b>
75	600	<b>I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE</b>	<b>179593730.0</b>	<b>148776848.0</b>
76	6001	Paga, personel I perhershëm	166248113.00	146588805.00
77	6002	Paga personel I Perkohshëm	10618156.00	2188043.00
78	6003	Shperblime	556,461	
79	6009	Shpenzime te tjera per personelin	2,171,000	
80	601	<b>II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE</b>	<b>33,284,244</b>	<b>25,911,393</b>
81	6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	29821422.00	23361967.00
82	6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore	3462822.00	2549426.00
83	602	<b>III.BLERJE MALLRA E SHERBIME</b>	<b>116739712.0</b>	<b>114648033.0</b>
84	602	Mallra dhe sherbime te tjera	1,359,767	358,174
85	6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	805280.00	2052374.00
86	6021	Materiale dhe sherbime speciale	9109516.00	12200973.00
87	6022	Sherbime nga te trete	57339362.00	59345476.00
88	6023	Shpenzime transporti	17538970.00	15108502.00
89	6024	Shpenzime udhetimi	532500.00	772171.00
90	6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	11964254.00	7576410.00
91	6026	Shpenzime per qeramarrje	439295.00	0.00
92	6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale		4178150.00
93	6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua	4320419.00	3609167.00
94	6029	Shpenzime te tjera operative	13330349.00	9446636.00
95	603	<b>IV.SUBVECIONE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
101		<b>V.TRANSFERIME KORENTE</b>	<b>346106857.0</b>	<b>346820456.0</b>
102	604	<b>1.Transferime korente te brendshme</b>	<b>4,882,448</b>	<b>7,897,230</b>
103	6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise		
106	6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse	4,882,448	7,897,230
107	605	<b>2.Transferime korente me jashte</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
112	606	<b>3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe</b>	<b>341,224,409</b>	<b>338,923,226</b>
113	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
114	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	341224409.00	338923226.00
115		<b>VI.SHPENZIME FINANCIARE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
116	65	<b>1.Shpenzime Financiare te brendshme</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
125		<b>VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
130	63	<b>VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT</b>	<b>1283899.00</b>	<b>-873033.00</b>
131		<b>IX.SHPENZIME TE TJERA</b>		
132	85	<b>TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES (Rezultati I Veprimtarise se vititUshtrimor)</b>	<b>38220263.71</b>	<b>40753067.84</b>

**Analiza e llogarive të të ardhurave** për vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 924,248,491 lekë, dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Malësi e Madhe paraqitet më poshtë:

**Gjendja e llogarisë sintetike 70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 44,278,630lekë, i cili kuadron me aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 219,693 lekë e cila përfshin *taksën mbi Biznesin e vogël*, e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 10,094,851 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë **7029 “Te tjera tatime mbi Pasurinë”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 60,819 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

d. Gjendja e llogarisë **7033 “Taksa mbi përdorimin mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 20,723,125lekë e cila përfshin taksa e mjeteve te përdorura.

e. Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 13,180,142lekë e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin. etj.

- Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 25,320,162 lekë, i cila kuadron me aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 7,436,483 lekë, e cila përfshin taksën e ndikimit në infrastrukturë, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet, i cili kuadron me aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë **711 “Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 17,883,679 lekë, e cila përfshin tarifatat e parkimit, kamatëvonesa, tarifa transporti, licenca etj. Kjo vlerë me aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”** është në vlerën prej 272,065,045 lekë dhe rakordon me detyrimet e evidentuara dhe kontabilizuar në llogaritë e detyrimeve për furnitorë të klasës 4. Kjo vlerë përmban faturat e kontratave 3-vjeçare, faturat e dhjetorit si dhe diferencat e faturave te ngelura ne proces likuidimi nga ish Komunat.

**Analiza e shpenzimeve** në vitin 2023 , të cilat në total janë në vlerën 677,008,442 746,058,559 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë **600 ‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’** për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 306,775,165lekë në përputhje me aktrakordimin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë **601 ‘Kontribute për sigurime’** për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 52,972,690 lekë në përputhje me aktrakordimin me thesarin

- Gjendja e llogarisë **602 “Blerje mallra e shërbime”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 105,329,795 lekë në përputhje me aktrakordimin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korente te brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 8,549,231lekë në përputhje me aktrakordimin me thesarin.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime per buxhetet familjare e individë”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 273,072,515 lekë, e cila rakordon me aktrakordimin me Thesarin.

**Per vitin 2023** totali i te ardhurave ne vlere është 924,248,491 lekë dhe totali shpenzimeve është 746,058,559 lek . Diferenca e tyre ne vlerën 178,189,932 rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”

Gjithashtu gjendja e llogarisë **63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”** është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2023 është në vlerën -640,837 lekë .

#### **Formati nr.6 “Investimet dhe burimet e financimit”**

- Zëri "Burimet për investime" Formati 6, i plotësuar për shumën 119,886,583 lekë në analizë tregon burimet e investimit, vlera prej 81,265,186 lekë fonde të akorduara nga buxheti per investime, vlera prej 3,634,952 lekë investime te dhuruara nga donatore vendas. Vlera prej 34,986,445 leke përfaqëson fondet per investimet nga te ardhurat e veta te Bashkisë

- Zëri “**Shpenzime per Aktive Afatgjata materiale**” formati 6 e plotësuar për shumën 207,396,002 lekë në analizë rakordon me pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata” kolona 4 formati 7/b.

Nga testi kontrollit për vitet 2023 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:

Rregullariteti i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore në njësinë administrative. Gjendja e arkës nuk e kalon limitin e arkës. Për të gjitha arkëtimet ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit.

Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kreut III pika 34 dhe 35 gjerat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 “Për limitin e arkës”.

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë z. T.M në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe z.T.M me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, në cilësinë e nëpunësit zbatues.

## **2.5 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.**

### 1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nga auditimi ka rezultuar se, janë hartuar regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023. Mbas miratimit në sistem të regjistrit nga APP, me shkresa përcjellëse janë dërguar në Degën e Thesarit, regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitet objekt auditimi mbështetur në VKB përkatëse “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Malësi e Madhe”. Gjithashtu në të gjitha rastet e shtesave dhe pikësimeve është dërguar regjistri përkatës. Në këto regjistra janë pasqyruar shtesat dhe ndryshimet e bëra sipas VKB – ve përkatëse, në përputhje me VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik”, është bërë brenda afateve të përcaktuara.

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Malësi e Madhe (regjistrat e parashikimit dhe realizimit), për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

**Për vitin 2023:** Bashkia Malësi e Madhe ka zhvilluar gjithsej **9** procedura prokurimi me vlera të larta, me vlerë të fondit limit: 294,404,399 lekë Tvsh, vlerë të kontratës: 268,971,598 lekë pa Tvsh, diferencë midis tyre prej: **25,432,801** lekë pa Tvsh.

- “E Hapur e thjeshtuar”, **27** procedura, me fondin limit në total prej: 142,752,825 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura pa Tvsh në total prej: 132,178,946 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumën prej: **10,573,879** lekë pa Tvsh.

- Shërbim konsulence **1** procedurë, me fondin limit në total prej: 8,333,283 lekë pa Tvsh, kontrata e lidhur prej 8,103,900 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumën prej 229,383 lekë pa Tvsh.

- “Blerje me vlerë të vogël”, **64** procedura, me fondin limit në total prej: 21,004,850 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura në total prej: 17,567,697 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumën prej: **3,437,153** lekë pa Tvsh;

- “Blerje me vlerë të vogël nën 100 mijë lekë”, **13** procedura, me fondin limit në total prej: 1,186,500 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura në total prej: 1,055,600 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumën prej: **130,900**lekë pa Tvsh;

Nga sa sipër, Bashkia Malësi e Madhe për vitin 2023 ka zhvilluar gjithsej 114 procedura prokurimi me vlera të larta, me vlerë të fondit limit: 466,495,357lekë Tvsh, vlerë të kontratës: 426,822,141 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumën prej 39,804,115 lekë pa Tvsh.

Viti 2023					
Lloji i procedurës	Nr.	Fondi limit pa Tvsh	Kontrata me Tvsh	Fondi total i kursyer pa Tvsh	% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit
<i>Procedurë e hapur;</i>	9	294,404,399	322,765,918.2	25,432,800	<b>8.64%</b>
<i>Procedurë e hapur e thjeshtuar;</i>	27	142,752,825	158,614,735	10,573,879	<b>7.4%</b>
<i>Shërbim konsulence</i>	1	8,333,283	9,724,680	229,383	<b>2.8%</b>
<i>Prokurim me vlerë të vogël</i>	64	21,004,850	21,081,236.5	3,437,153	<b>16.3%</b>
<i>Prokurim me vlerë të vogël nën 100 mijë lekë</i>	13	1,186,500	1,266,720	130,900	<b>11%</b>
<b>SHUMA</b>	<b>114</b>	<b>466,495,357</b>	<b>426,822,141</b>	<b>39,804,115</b>	<b>8.53%</b>

Investimet e prokuruarra për vitin 2023 janë 24 procedura, me vlerë totale të fondit limit 391,449,981 lekë pa TVSh

#### **Pasqyra e investimeve të prokuruarra për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023**

Nr	Objekti	Fondi limit	Oferta fituese	Diferenca ne leke pa tvsh	Operatori fitues
1	Sistemim asfaltim rruga Gjuraj-Koplik i Siperim	11,834,401	11,763,090	71,311	L
2	“Rikonstruksion i shkollës "Muhamet Hasmuja", Ktosh”	55,292,325	49,681,700	5,610,625	M&E
3	“Sistemim asfaltim rruga Sterkuje”	16,351,499	15,032,680	1,318,819	C
4	Sistemim Asfaltim Rruga Koplik-Sterbeq-Jubice-Kamice	65,702,263	58,901,485	6,800,778	L
5	“Ura lidhëse për fshatrat Vermosh-Velan-Velipojë”	65,253,232	59,407,228	5,846,004	N&n
6	“Sistemim asfaltim rruga çulaj - Skaq”	21,168,455	18,056,550	3,111,905	S
7	Sistemim Asfaltim Rruga “Degëzim rruga Koplik-Razëm, për tek rruga e Reçit”	20,462,474	19,732,240	730,234	OE “S” ShPK
8	“Sistemim asfaltim rruga Rrash - Vorfe”	5,688,817	5,625,959	62,858	OE “S” ShPK
9	“Sistemim asfaltim rruga Rohes, Faza 2”	9,784,193	9,677,321	106,872	OE “S” ShPK

10	“Sistemim asfaltim rruga Koplik Sipër - Lujs	11,424,160	11,344,770	79,390	L
11	“Sistemim asfaltim Fermentimit Hotajve dhe Kurtaj në lagjen Palvar”	12,654,952	11,808,578	846,374	C
12	Sistemim Asfaltim Rruga Veleçiku	5,280,036	5,224,150	55,886	L
13	Sistemim Asfaltim Rruga Dreka	6,916,110	6,848,560	67,550	A
14	Sistemim asfaltim rruga Syri i Gjonit	6,097,725	6,024,800	72,923	N.
15	Sistemim Asfaltim rruga Grude Fushe poshte ne drejtim te liqenit	11,990,150	11,777,000	213,150	N.
16	Sistemim Asfaltim Rruga Shen Pali e Shen Pjetri (Bajze)	7,325,812	5,733,558	1,592,254	BOE P & S. shpk
17	Ndertim mur mbajtes Goraj	3,231,034	3,119,700	111,334	BOE “B.019” shpk & N.
18	Sistemim asfaltim rruge fshati Omaraj	9,784,193	9,371,272	412,921	A
19	Sistemim Asfaltim Rruga per tek varrezat Koplik	5,280,036	4 735 065,2	544,970,8	RR
20	Rikonstruksion godina e zjarrfikese	8,254,909	7,885,019	369,890	M&N
21	Riparim me asfalt rrugë të brendshme (riveshje me asfalt)	16,351,499	15,183,437,5	1,168,061,5	C
22	Pamje panoramike Vrrith	2,839,222	2,742,160	97,062	S shpk
23	Sistemim Asfaltim rruga e Kishes Selce	4,053,499	3,975,391	78,108	A
24	Mirembajtje objekte 2023	8,428,985	7,585,653	843,332	B

Nga procedurat e prokurimit të mësipërme, nga grupi i auditimit janë audituar 10 procedura (42% e numrit total), me fond limit total prej 283,782,370 lekë pa TVSh, ose 72.5% e fondit limit në total. Gjithashtu janë audituar edhe dy procedura mallra/shërbime në vlerë 27,813,533 lekë pa TVSh, të cilat zënë 6% të totalit të prokurimeve të realizuaranë vitin 2023.

### Pasqyra prokurimit të audituara për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023

Nr	Objekti	Fondi limit	Oferta fituese	Diferenca ne leke pa tvsh	Operatori fitues
1	“Blerje karburanti, për vitin 2024”	21,167,700	21,167,700	0	G.C
2	“Rikonstruksion i shkollës "Muhamet Hasmuja", Ktosh”	55,292,325	49,681,700	5,610,625	M&E
3	“Sistemim asfaltim rruga Sterkuje”	16,351,499	15,032,680	1,318,819	C
4	Sistemim Asfaltim Rruga Koplik-Sterbeq-Jubice-Kamice	65,702,263	58,901,485	6,800,778	L
5	“Ura lidhëse për fshatrat Vermosh-Velan-Velipojë”	65,253,232	59,407,228	5,846,004	N&n
6	“Sistemim asfaltim rruga çulaj - Skaq”	21,168,455	18,056,550	3,111,905	S
7	Sistemim Asfaltim Rruga “Degëzim rruga Koplik-Razëm, për tek rruga e Reçit”	20,462,474	19,732,240	730,234	OE “S” ShPK
8	“Sistemim asfaltim rruga Rrash - Vorfe”	5,688,817	5,625,959	62,858	OE “S” ShPK
9	“Sistemim asfaltim rruga Rohes, Faza 2”	9,784,193	9,677,321	106,872	OE “S” ShPK
10	“Sistemim asfaltim rruga Koplik Sipër - Lujs	11,424,160	11,344,770	79,390	L

11	“Sistemim asfaltim Fermentimit Hotajve dhe Kurtaj në lagjen Palvar”	12,654,952	11,808,578	846,374	C
12	“Blerje kosha (kontenier) për mbetje”	6,645,833	6,626,500	19,333	OE “N.N.Z.K.Sh.

Problematikat e zbuluara nga auditimi I procedurave të prokurimit, në mënyrë të hollësishme për çdo procedurë, janë si më poshtë:

### **1. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje karburanti (Gazoil 10 ppm), për nevojat e Bashkisë Malësi e Madhe”**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje karburanti, për vitin 2024”, Nr. REF-89645-12-05-2023.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 3273, datë 01.12.2023	1. Urdhër Prokurimi Nr. 3273, datë 01.12.2023	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 3273/1, datë 01.12.2023
2. Lloji i Procedurës – “E hapur, mallra”	Njësia e Prokurimit 1. E.A, jurist 2. F.B, Inxhinier mekanik 3. F.C, Ekonomist	1. A.R, Kryetar 2.J.N 3. P.C
5. Fondi Limit (pa TVSh) 21,167,700 lekë pa TVSH,	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE G.C me marzh fitimi 20 lekë/litër, sipas kontratës nr. 135/6, datë 26.01.2024 me afat deri në 31.12.2024.	7. Diferenca me fondin limit
8. Data e hapjes së tenderit Datë 21.12.2023	9. Burimi Financimit Nga Buxheti i Bashkisë	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

#### **Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:**

Kjo procedurë është “E Hapur, mallra”, me vlerë 20,650,500 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit dhe të ardhurat e Bashkisë Malësi e Madhe.

#### **Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi**

Në dosjen e prokurimit administrohen kërkesat për karburant nga sektorë të ndryshëm të Bashkisë Malësi e Madhe, sipas të cilave është bërë realizimi i kësaj procedure prokurimi. Regjistri i parashikimit të prokurimeve 2023, bashkëlidhur Urdhrit të Prokurimit.

#### **Mbi përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike**

Në dosje administrohet argumentimi i fondit limit dhe hartimi i specifikimeve teknike.

Nga auditimi i dokumenteve të administruar në dosje, rezulton se është ngritur një komision për përlllogaritjen e fondit limit, i përbërë nga znj. V.Z, E.H dhe P.G (sipas Urdhrit ne. 116, datë 09.08.2023, i cili nuk administrohet në dosje). Ky komision ka administruar kërkesat për karburant nga sektorë të ndryshëm të Bashkisë Malësi e Madhe, sipas të cilave, nevoja për karburant për Bashkinë Malësi e Madhe është 122600 litra karburant diesel, e cila me çmimin 197.4 lekë/litër me TVSh, që ka dalë nga të dhënat e marrë nga bursa “PLATTS” e datës 12.10.2023, shkon në vlerën totale 20,167,700 lekë me TVSH, si dhe 6124 litra benzinë me çmimin 195.95, e cila shkon në 1,000,000 lekë pa TVSH. Fondi limit në total është 21,167,700 lekë pa TVSH.

Hartimi i Kriteve të kualifikimit, është bërë nga Njësia e Prokurimit me procesverbailin e datës 05.12.2023.

#### **Mbi përcaktimin e kriteve të kualifikimit:**

Kriteret e kualifikimit dhe specifikime teknike janë përcaktuar nga Njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, datë 05.12.2023.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit rezultojnë argumentuar nëpërmjet procesverbalit datë 05.12.2023, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, sipas të cilës “Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit”.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se ato janë konform natyrës dhe volumit të objektit që prokurohet.

### **Mbi vlerësimin e ofertave**

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur, mallra”. Nisur nga procesverbali i hapjes së ofertave nr. 327/3, datë 21.12.2023 dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe ka marrë pjesë në procedurë 1 OE, i kualifikuar.

Nr.	OE pjesëmarrës	Marzhi I fitimit
1	G.C	20 lekë/litër

Burimi i të dhënave: Bashkia Malësi e Madhe  
Punoi: KLSH

Në dosje administrohet procesverbali për vlerësimin e ofertave me nr. 135 prot, datë 10.01.2024 dhe procesverbali për vlerësimin e dokumentacionit fizik me nr. 135/1 prot, datë 16.01.2024.

Nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën me nr. 135/3 prot, datë 18.01.2024, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. T.M me shkresën nr. 135/4, datë 18.01.2024.

Pas njoftimit të fituesit, është lidhur kontrata me shkresën nr. 135/6, datë 26.01.2024 me vlerë 25,401,240 lekë me TVSh dhe marzh fitimi 20 lekë/litër, me OE G.C.

Nga auditimi në SPE i dokumentacionit të paraqitur nga OE G.C, si dhe dokumentacioni fizik i paraqitur nga shoqëria pas shpalljes si ofertë e vlefshme (i gjithë dokumentacioni i OE nuk është i numerizuar), rezultoi se:

- Në dy bilance të njëpasnjëshme (2021 dhe 2022) ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit (me humbje).

- Nga bashkitë ky operon, bazuar në ekstraktin e QKB-së, mungon vërtetimi për shlyerjen e taksave vendore në Bashkitë Tiranë dhe Fier.

Sa sipër, ky OE duhet skualifikuar.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme...”.

Me skualifikimin e OE G.C, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 nr. 914, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, sipas të cilit “1. *Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur: në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme...*”, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK propozimin për anulimin e kësaj procedure. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 25,401,240 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së T.M, J.N dhe P.C dhe Titullari i AK, z. T.M.

*Nga ana e subjektit, për këtë procedurë nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

## **2. Procedura e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i shkollës "Muhamet Hasmuja", Ktosh”, Bashkia Malësi e Madhe**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i shkollës "Muhamet Hasmuja", Ktosh”, Bashkia Malësi e Madhe, Nr. REF-76322-07-28-2023.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 1694 , datë 14.07.2023	1. Urdhër Prokurimi Nr. 1694, datë 14.07.2023	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 1694/1, datë 14.07.2023
2. Lloji i Procedurës – “E hapur, punë”	Njësia e Prokurimit 1. E.A Jurist 2. G.I Ing. Ndertimi 3. E.L Ekonomist	1. A.R, Kryetar 2. J.N 3. R.C
5. Fondi Limit (pa TVSh) 55,292,325 lekë pa TVSH,	6. Oferta fituese (pa TVSh) M&Eme ofertë 49,681,700 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 1694/10, datë 02.10.2023 me afat 9 muaj.	7. Diferenca me fondin limit 5,610,625 lekë, ose 10.1 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 25.08.2023	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë dhe Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

### **Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:**

Kjo procedurë është “E Hapur”, me vlerë 55,292,325 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit. Financimi është 26,897,130 lekë për vitin 2023, vlera prej 27,540,316 lekë për vitin 2024 dhe vlera prej 11,913,344 në vitin 2025.

### **Mbi përcaktimin e krverjes së këtij investimi**

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet asnjë shkresë, sipas të cilës duhet të kishte filluar realizimi i procedurës së prokurimit të objektit.

### **Mbi projektpreventivin e zbatimit:**

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga shoqëria “N S” Shpk në vitin 2023. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 9 muaj nga fillimi i punimeve.

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet**

**publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...”.

#### Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Për hartimin e specifikimeve teknike, si dhe për përlllogaritjen e fondit limit për këtë procedurë, NjP është bazuar në projektin e hartuar nga projektuesi.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DT nga Njësia e Prokurimit, është mbajtur procesverbalit pa nr prot, datë 02.08.2023, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se:

1- Në pikën 6 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 4 inxhinierë të ndryshëm (inxhinier ndërtimi, inxhinier elektrik, inxhinier mekanik, inxhinier hidroteknik) të jenë në licencë, si dhe staf mbështetës një arkitekt dhe 1 teknik ndërtimi. Këto kriterë janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përputhje me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet (arkitekti dhe tekniku).

2. Në kriterin për makineritë dhe pajisjet janë kërkuar gjithashtu edhe kokore, karroca dore, jelek për veshje, tabela sinjalizuese, etj, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën e objektit që prokurohet.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet dhe nuk kanë nxitur konkurrencën. Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi specialistin e fushës në NjP z. G.

#### Mbi përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga projektuesi i objektit. Nga verifikimi me zgjedhje sipas vlerave më të larta, i disa prej zërave të preventivit të ofertës (vetëm ato me nr analize sipas manualeve), rezultoi se çmimet janë vendosur përgjithësisht sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

#### Situata 2

##### Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur”. Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 25.08.2023. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	M&E	49,681,700
2	E.C	Pa ofertë

Burimi i të dhënave: SPE

Punoi: KLSH

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën me nr. 1694/7 prot, datë 12.09.2023, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. T.M me shkresën nr. 1694/8, datë 12.09.2023.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se OE “E.C” ShPK, është skualifikuar nga KVO-ja me të drejtë, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në DT.

Nga verifikimi në SPE dhe në dokumentet e paraqitura në letër nga M.E, rezulton se:

1. Mungon deklarata e drejtuesit teknik z. E.Z, i caktuar si drejtues projekti me deklaratën e BOE, që është dakord me angazhimin në mënyrë të vazhdueshme për nevoja të institucionit.
2. Në marrëveshjen e bashkëpunimit është cituar që OE M ka marrë përsipër të kryejë 31.5% të punimeve, ndërkohë që nga shuma e punimeve që është cituar që do të bëjë (kapitulli A), rezulton të jetë 40.9% e punimeve.
3. OE M ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore vetëm nga Bashkia Shkodër, ndërkohë që ka sjellë eksperiencë të ngjashme dhe ka aktivitet edhe në Bashkinë Malësi e Madhe.
4. OE E ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore vetëm nga Bashkia Kamëz, ndërkohë që ka sjellë eksperiencë të ngjashme dhe ka aktivitet edhe në Bashkinë Tiranë, Durrës dhe Mat.

Sa sipër, kualifikimi i këtij BOE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”.

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Neni 98, pika 1/b, sipas të cilit “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur: ...

b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme”, KVO nuk duhet të kishte shpallur fitues këtë OE dhe duhet të kishte kërkuar anulimin e procedurës së prokurimit dhe propozimin për një procedurë të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e kontratës me vlerë 59,618,040 lekë me TVSH, me një OE, i cili është shpallur fitues në pajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së A.R, J.N dhe R.C dhe Titullari i AK, z. T.M.

*Nga ana e subjektit, për këtë procedurë nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

### **3. Procedura e prokurimit me objekt “Sistemim asfaltim rruga Sterkuje””, Bashkia Malësi e Madhe**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim rruga Sterkuje”, Bashkia Malësi e Madhe, Nr. REF-65199-04-06-2023.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 983 , datë 05.04.2023	1. Urdhër Prokurimi Nr. 983 , datë 05.04.2023	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. Nr. 983/1, datë 05.04.2023
2. Lloji i Procedurës – “E hapur, punë”	Njësia e Prokurimit 4. E.A Jurist 5. G.I Ing. Ndertimi 6. F.C Ekonomist	1. A.R, Kryetar 2. J.N 3. P.C
5. Fondi Limit (pa TVSh) 16,351,499 lekë pa TVSH,	6. Oferta fituese (pa TVSh) “C” me ofertë 15,032,680 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 983/8, datë 29.06.2023 me afat 2 muaj.	7. Diferenca me fondin limit 1,318,819 lekë, ose 8.1 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 25.08.2023	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë dhe Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

### **Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:**

Kjo procedurë është “E Hapur”, me vlerë 16,351,499 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit. Financimi është 4,221,799 lekë për vitin 2023, vlera prej 7,500,000 lekë për vitin 2024 dhe vlera prej 7,900,000 në vitin 2025.

### **Mbi projektpreventivin e zbatimit:**

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga shoqëria “L” në vitin 2023. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 2 muaj nga fillimi i punimeve.

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...**”.

### **Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:**

Për hartimin e specifikimeve teknike, si dhe për përlogaritjen e fondit limit për këtë procedurë, NjP është bazuar në proektin e hartuar nga projektuesi.

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga NjP nëpërmjet Procesverbalit, pa nr. prot, datë 06.04.2023.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DT nga Njësia e Prokurimit, është mbajtur procesverbalit pa nr prot, datë 06.04.2023, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se:

1- Në pikën 6 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 2 inxhinierë të ndryshëm (inxhinier ndërtimi, inxhinier topograf) të jenë në licencë, si dhe staf mbështetës një teknik ndërtimi. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet (tekniku).

2. Në kriterin për makineritë dhe pajisjet është kërkuar Fabrike asfaltbetoni jo me larg se 70 km nga objekti (e pajisur me leje mjedisore III.1.B, kur është në pronesi), e cila për largësinë nuk është e argumentuar teknikisht.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet dhe nuk kanë nxitur konkurrencën. Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi NjP.

### **Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike**

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga projektuesi i objektit. Nga verifikimi me zgjedhje sipas vlerave më të larta, i disa prej zërave të preventivit të ofertës (vetëm ato me nr analize sipas manualeve), rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

## **Situata 2**

### **Mbi vlerësimin e ofertave**

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur”. Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 24.04.2023. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	C	15,032,680
2	D	Pa ofertë

Burimi i të dhënave: SPE  
Punoi: KLSH

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën me nr. 983/5 prot, datë 30.05.2023, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. T.M me shkresën nr. 983/6, datë 02.06.2023.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se D, është skualifikuar nga KVO-ja me të drejtë, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në DT.

Nga verifikimi në SPE dhe në dokumentet e paraqitura në letër nga “C, rezulton se:

1. Është paraqitur bitumatriçe, në vend të autobitumatriçes.
2. Mungojnë fotot e ekskavatorit, rulit vibrues.
3. Fabrika e asfaltit, me të cilin është lidhur kontrata e furnizimit, është më shumë së 70 km nga objekti.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”.

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Neni 98, pika 1/b, sipas të cilit “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur: ...

*b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme”, KVO nuk duhet të kishte shpallur fitues këtë OE dhe duhet të kishte kërkuar anulimin e procedurës së prokurimit dhe propozimin për një procedurë të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e kontratës me vlerë 18,039,216 lekë me TVSH, me një OE, i cili është shpallur fitues në papajftueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së T.M, J.N dhe P.C dhe Titullari i AK, z. T.M.*

*Nga ana e subjektit, për këtë procedurë nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

### **4. Procedura e prokurimit me objekt “Sistemim Asfaltim Rruga Koplík-Sterbeq-Jubice-Kamice”, Bashkia Malësi e Madhe**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim Asfaltim Rruga Koplík-Sterbeq-Jubice-Kamice”, Bashkia Malësi e Madhe, Nr. REF-62197-03-10-2023.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 735 , datë 10.03.2023	1. Urdhër Prokurimi Nr. 735 , datë 10.03.2023	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave

2. Lloji i Procedurës – “E hapur, punë”	Njësia e Prokurimit E.A Jurist G.I Ing. Ndertimi F.C Ekonomist	1. Urdhër Nr. 735/1 , datë 10.03.2023 1. A.R, Kryetar 2. J.N 3. P.C
5. Fondi Limit (pa TVSh) 65,702,263 lekë pa TVSH,	6. Oferta fituese (pa TVSh) BL & “N me ofertë 58,901,485 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 735/10, datë 10.07.2023, me afat 3 muaj.	7. Diferenca me fondin limit 6,800,778 lekë, ose 10.4 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 14.04.2023	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë dhe Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

### **Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:**

Kjo procedurë është “E Hapur”, me vlerë 65,702,263 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit.

### **Mbi projektpreventivin e zbatimit:**

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga BOE Z” ShPK & E ShPK në vitin 2023. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 3 muaj nga fillimi i punimeve.

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...**”.

### **Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:**

Për hartimin e specifikimeve teknike, si dhe për përlllogaritjen e fondit limit për këtë procedurë, NjP është bazuar në proektin e hartuar nga projektuesi.

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga NjP nëpërmjet Procesverbalit, pa nr. prot, datë 02.08.2023.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DT nga Njësia e Prokurimit, është mbajtur procesverbalit pa nr prot, datë 02.08.2023, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se:

1- Në pikën 6 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 2 inxhinierë (inxhinier ndërtimi, inxhinier topograf) të jenë në licencë, si dhe staf mbështetës dy teknikë ndërtimi dhe një murator. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përputhje me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet (teknikët e ndërtimit).

2. Në kriterin për makineritë dhe pajisjet janë kërkuar 2 herë vibrator, të cilat nuk janë në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet.

3- Nuk është kërkuar që Operatori Ekonomik operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë makinë frezimi/skarifikimi për asfaltin, kontratë furnizimi me inerte, beton, etj.

4- Nuk është kërkuar që Operatori Ekonomik të ketë shlyer taksat vendore.

5- Në kriterin për makineritë dhe pajisjet është kërkuar Fabrike asfaltobetoni jo me larg se 70 km nga objekti (e pajisur me leje mjedisore III.1.B, kur është në pronesi), e cila, për largësinë, nuk është e argumentuar teknikisht.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet dhe nuk kanë nxitur konkurrencën. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi NjP.

#### **Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike**

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga projektuesi i objektit (Z.E). Nga verifikimi me zgjedhje sipas vlerave më të larta, i disa prej zërave të preventivit të punimeve (vetëm ato me nr analize sipas manualeve), rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

#### **Mbi vlerësimin e ofertave**

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur”. Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 31.05.2023. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 9 OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	L.N	58,901,485
2	D	Pa ofertë
3	OE “S” ShPK	61,915,630
4	OE “U” ShPK	61,651,715
5	S	45,935,320
6	OE “N” ShPK	61,144,500
7	OE “K” ShPK	62,269,317
8	OE “E” ShPK	53,787,060
9	C	60,277,625

Burimi i të dhënave: SPE  
Punoi: KLSH

Nga operatorët pjesëmarrës në këtë procedurë, janë skualifikuar 2 OE, “D” ShPK dhe S ShPK, duke kualifikuar si OE fitues “E Konstruksion” ShPK. Pas verifikimit të dokumentacionit fizik të “E Konstruksion” ShPK, rezultoi se edhe ky OE nuk zotëronte dokumentacionin e përcaktuar në DT dhe për pasojë është skualifikuar me procesverbëalin e rivlerësimit nr. 735/5, datë 14.06.2023. Nga sa sipër, OE e skualifikuar nga KVO-ja janë si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	D	Pa ofertë
2	S	45,935,320
3	OE “E” ShPK	53,787,060

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave për OE të skualifikuar, u konstatua se nga KVO-ja janë skualifikuar OE për arsyet e mëposhtme:

**I. D**, nr. NIPT-i: K.....R:

Mungese e theksuar dokumentacioni. Ka paraqitur vetem Ekstratkt QKB-je.

**II. E**, nr. NIPT-i: K.....I:

Pas verifikimit të dokumentacionit fizik u konstatua mungese e theksuar dokumentacioni:

1. Mungojne kontrata e punes, diploma dhe cv per Ing. Ndertimi dhe Ing. Topograf/gjeodet

2. Mungon kontratat e punes, CV, dokumenti certifikues i kerkuar dhe dokumenti qe verteton kualifikimin (deftese dhe/ose diplome) per teknik ndertimi.
3. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë nuk ka paraqitur: Leje qarkullimi, siguracion, kolaudim, taksa, Certificate/licence transporti.
4. Për stafin e paraqitur Manovrator, Shofer etj. mungojne deshmite dhe dokumentacioni justifikues
5. Nje pjese e dokumentave jane fotokopje dhe te panoterizuara.

### III. S. shpk, nr. NIPT-i: J.....Q:

Ofertë anomalisht e ulët. Pas shqyrtimit të dokumentacionit për justifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “S” ShPK. Komisioni i vlerësimit të ofertave, arsyeton se shpjegimi narrativ i paraqitur për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nuk përbën prova të mjaftueshme në funksion të argumentimit të: anës ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit; metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, apo origjinaliteti i shërbimit të propozuar.

- Argumentimi i dhënë nga ofertuesi "S" Sh.p.k në rastin konkret në formën e “Deklaratës” nuk krijon bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

- Analizat teknike të çmimeve mungojne për disa zëra punimesh.

- Për një pjesë të analizave teknike të çmimeve të paraqitura janë bërë ndryshime në sasi te analizat teknike të çmimeve në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”

Janë kualifikuar 6 OE si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	L.N	58,901,485
2	OE “S” ShPK	61,915,630
3	OE U.ShPK	61,651,715
4	OE “N” ShPK	61,144,500
5	OE K.ShPK	62,269,317
6	C	60,277,625

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën me nr. 735/7 prot, datë 04.07.2023, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. T.Mme shkresën nr. 735/8 prot, datë 04.07.2023.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave për OE të skualifikuar, u konstatua se nga KVO-ja janë skualifikuar OE për arsyet e mëposhtme:

1. D ka hedhur në sistam vetëm QKB, për pasojë është skualifikuar me të drejtë nga KVO-ja.
2. OE SShPK ka paraqitur ofertë ekonomike anomalisht të ulët, pasi oferta e tij është më e ulët se vlera 49,500,032 lekë, e cila është 0.85 x mesataren e ofertave të kualifikuara.

Me shkresën datë 03.05.2023, KVO ka kërkuar argumentimin e ofertës ekonomike, bazuar në nenin 93 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Me shkresën pa datë, nga OE S ShPK është bërë sqarimi dhe argumentimi i ofertës ekonomike, duke bashkëlidhur 10 analiza të çmimeve nga 41 zëra që janë gjithsej në preventiv. Nga verifikimi i këtyre analizave rezultoi se nga OE, në dy zëra pune, është ndryshuar sasia në nënzërin “punëtori”, në krahasim me analizat teknike të çmimeve në kundërshtim me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. *Sa sipër, arsyetimi i KVO-së për skualifikimin e këtij OE për shkak se nuk ka sjellë prova të mjaftueshme për argumentimin e ofertës ekonomike, është i drejtë.*

3. Nga verifikimi në dosjen fizike dhe në dokumentet e paraqitura në letër nga OE “E Konstruksion” ShPK, i skualifikuar, rezulton se:

- Dokumentacioni nuk është i inventarizuar/numerizuar;
- Dokumentet e paraqitura janë me mangësitë e konstatuara nga KVO.

Sa sipër, ky OE është skualifikuar me të drejtë.

Nga verifikimi në SPE dhe në dokumentet e paraqitura në letër nga OE fitues L ShPK & N ShPK, rezulton se:

1. Autobitumatriçja e marrë me qera nga shoqëria “Vllaznimi” me targa AA.....ZG, është e pajisur me certifikatë transporti për vete dhe jo për të tretë; (në rast se ky mjet është paraqitur për autobot, nisur nga nga kodi C3 në lejen e qarkullimit, është cisternë për transportin e mallrave të ndezshme dhe nënproduktet e naftës)
2. Mungon ekskavatori me goma;
3. Mjetet e marra me qera që nuk shënohen në regjistra publikë (grejder, ruli, vinçi kullë,) nuk e kanë të shkruar në kontratën e qeramarrjes objektin e kontratës që prokurohet, siç kërkohet në pikën 2.3.8 të DT.
4. Si inxhinier gjeodet, i kërkuar si drejtues teknik në pikën 2.3.5 të DT, është paraqitur z. M.II, i diplomuar për inxhinier miniere markshejder, i cili është në licencën e L, ndërsa topografi i paraqitur nga firma N ShPK, nuk është në licencë si drejtues teknik.
5. Autobitumatriçja e marrë me qera nga shoqëria “A-Klas-beton Asfalt” me targa AA .. UL, është e pajisur me certifikatë transporti për vete dhe jo për të tretë, si dhe certifikatën e kontrollit teknik të pavlefshme.

Sa sipër, kualifikimi i këtij BOE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”.

Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Neni 92, pika 3, KVO nuk duhet të kishte kualifikuar dhe shpallur fitues këtë OE. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e kontratës me vlerë 70,681,782 lekë me TVSH, me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së A.R, J.N dhe P.C dhe Titullari i AK, z. T.M.

*Nga ana e subjektit, për këtë procedurë nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

## **5. Procedura e prokurimit me objekt “Ura lidhëse për fshatrat Vermosh-Velan-Velipojë”, Bashkia Malësi e Madhe**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ura lidhëse për fshatrat Vermosh-Velan-Velipojë”, Bashkia Malësi e Madhe, Nr. REF-74020-06-30-2023.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 1567, datë 30.06.2023	1. Urdhër Prokurimi Nr. 1567, datë 30.06.2023	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 1567/1, datë 30.06.2023
2. Lloji i Procedurës – “E hapur, punë”	Njësia e Prokurimit E.A Jurist G.I Ing. Ndertimi F.C Ekonomist	1. A.R, Kryetar 2. J.N 3. R.C

5. Fondi Limit (pa TVSh) 65,253,232 lekë pa TVSH,	6. Oferta fituese (pa TVSh) N&n me ofertë 59,407,228 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 1567/11, datë 13.10.2023 me afat 3 muaj.	7. Diferenca me fondin limit 5,846,004 lekë, ose 9 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 31.07.2023	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë dhe Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 6 OE b) S'kualifikuar 2 OE për mungesë dokumentacioni fizik, c) Kualifikuar 4 OE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

### **Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:**

Kjo procedurë është “E Hapur”, me vlerë 65,253,232 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit. Financimi është 48,792,641 lekë për vitin 2023, vlera prej 29,511,237 lekë për vitin 2024.

### **Mbi projektpreventivin e zbatimit:**

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga BOE “L.A” ShPk në vitin 2023. Projekti i administruar në dosjen fizike ka pranimit nga ing. J.N dhe miratim (nënshkrim, vulë) nga Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe, z. T.M. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 9 muaj nga fillimi i punimeve. Në dosjen e prokurimit administrohet Oponenca Teknike, në përputhje me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike**, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...”.

Në këtë oponencë janë lënë rekomandime, të cilat nuk janë marrë në konsideratë nga Autoriteti Kontraktor, duke hedhur në SPE të njëjtin projekt që është paraqitur për oponencë. Ky veprim ka ardhur si pasojë e hapjes së procedurës pa patur Oponencë Teknike, pasi oponenca është me nr. 1332/1 prot, datë 12.09.2023 (rreth 2 muaj e gjysëm nga shpallja e procedurës). Ky veprim ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit.

### **Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:**

Për hartimin e specifikimeve teknike, si dhe për përlllogaritjen e fondit limit për këtë procedurë, NjP është bazuar në proektin e hartuar nga projektuesi.

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga NjP nëpërmjet Procesverbalit, pa nr. prot, datë 12.07.2023.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DT nga Njësia e Prokurimit, është mbajtur procesverbalit pa nr prot, datë 12.07.2023, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se:

**1- Në pikën 6 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 5 inxhinierë të ndryshëm (inxhinier ndërtimi, inxhinier topograf, inxhinier gjeolog, inxhinier hidroteknik dhe inxhinier mjedisi) të jenë në licencë, si dhe staf mbështetës 4 inxhinierë të tjerë (inxhinier ndërtimi, inxhinier topograf, inxhinier gjeolog, inxhinier hidroteknik), dy teknikë ndërtimi, katër muratorë dhe një teknik topograf. Ky kriter është i**

**paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet (inxhinieri hidroteknik, inxhinieri i mjedisit), gjithë stafi mbështetës, teknikët e ndërtimit, tekniku topograf dhe dhe muratorët).**

2. Në kriterin për certifikatat ISO është kërkuar PASS 99: 2012 (Sistem i integruar i menaxhimit), e cila nuk është në përpjestim me natyrën e objektit që prokurohet.

4- Është kërkuar Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jete i pajisur me licence nga QKL me kod III.2.B me emertimin e veprimtarise “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve inerte”, **nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve në objektin që prokurohet dhe nuk është e argumentuar teknikisht.**

*Konstatohet se për këtë objekt nuk është kërkuar që fabrika e asfaltobetonit të mos jetë më shumë se 70 km larg objektit që do të realizohet.*

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe kane **krijuar mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.** Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi NjP.

### **Mbi përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike**

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga projektuesi i objektit (L.A”ShPK). Nga verifikimi me zgjedhje sipas vlerave më të larta, i disa prej zërave të preventivit të ofertës (vetëm ato me nr analize sipas manualeve), rezultoi se çmimet janë vendosur përgjithësisht sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Nga verifikimi i preventivit të administruar në dosje u konstatua si më poshtë:

Në preventiv është vendosur gjithashtu një paketë asfaltike me 10 cm binder dhe 8 cm asfaltobeton, për të cilën nuk është dhënë argumentimi teknik në projekt, i cili është dhënë si rekomandim edhe në opionencën teknike të dhënë në datën 12.09.2023.

*Sa sipër ngarkohen me përgjegjësi projektuesi “L” ShPK, me përfaqësues ing. N dhe pranuesi i projektpreventivit ing. J.N.*

### **Mbi vlerësimin e ofertave**

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur”. Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 25.08.2023. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 6 OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	BOE N&N	59,407,228
2	OE “A”ShPK	51,432,612
3	BOE S.ShPK & L	60,548,124
4	C	63,643,922
5	BOE “RR & C”	59,998,365
6	S	55,478,314.5

Burimi i të dhënave: SPE

Punoi: KLSH

Nga operatorët pjesëmarrës, janë skualifikuar pas paraqitjes së dokumenteve fizikë, 2 OE si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	OE A.shpk	51,432,612
2	S	55,478,314.5

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave për OE të skualifikuar, u konstatua se nga KVO-ja janë skualifikuar OE për arsyet e mëposhtme:

**I. A.shpk**, nr. NIPT-i: J.....C:

**Ne fazen e paraqitjes se dokumentacionit fizik:**

1. Nuk ka paraqitur dokumenta per Automjetin Autobot uji.
2. Nuk ka paraqitur dokumenta per Automjetin Autobitumatriçe.
3. Nuk ka paraqitur dokumenta per Automjetin Autobetoniere
4. Nuk ka paraqitur dokumenta per Fabrike betoni.
5. Nje pjese e dokumentave jane fotokopje dhe te panoterizuara.

**II. S.shpk**, nr. NIPT-i: J.....D:

**Ne fazen e paraqitjes se dokumentacionit fizik:**

1. Nuk ka paraqitur dokumenta per 2 Autobetoniere
2. Nuk ka paraqitur dokumenta per 2 Pompe betoni
3. Sigurimi i ofertes i paraqitur fizikisht eshte per objektin “Sistemim Asfaltim rruga Grude Fushe poshte ne drejtim te liqenit”

Nga auditimi i në SPE dhe dokumentacioni fizik, rezultoi se:

1. OE A.shpkShPK, i ftuar nëpërmjet sistemit për paraqitjen e dokumentacionit fizik, si OE me ofertë të vlefshme, është skualifikuar me të drejtë për arsyet e cituara nga KVO, pas kontrollit të dokumentacionit fizik.
2. S, i ftuar nëpërmjet sistemit për paraqitjen e dokumentacionit fizik, si OE me ofertë të vlefshme e renditur e dyta, është skualifikuar me të drejtë për arsyet e cituara nga KVO, pas kontrollit të dokumentacionit fizik.

Janë kualifikuar 4 OE si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	<b>BOE N&amp;N</b>	<b>59,407,228</b>
2	BOE SShPK & L	60,548,124
3	C	63,643,922
4	BOE “RR & C”	59,998,365

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën me nr. 1567/8 prot, datë 13.09.2023, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. T.M me shkresën nr. 1567/9 prot, datë 13.09.2023.

Nga verifikimi në SPE dhe në dokumentet e paraqitura në letër nga BOE fitues “N ShPK & N 2014” ShPK (respektivisht me 59.1 % dhe 40.9% të punimeve), rezulton se:

1. Dosja e dokumenteve fizikë, nuk është e numerizuar.
2. Eksperienca e ngjashme është e pamjaftueshme, pasi BOE ka paraqitur eksperiencat e mëposhtme:
  - “Ndërrhyrja për shmangien e përmbytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë”, me vlerë të realizuar të kontratës 41,257,208 lekë me TVSh, ku “Nka realizuar 63.9 % të objektit dhe “N” ShPk ka realizuar 36.1 % të objektit. Nisur nga fakti që OE N duhet të përmbushë eksperiencën me 50% të vlerës së objektit që prokurohet, pra 39,151,939 lekë me TVSh, kjo eksperiencë e paraqitur, përveçse nuk është e ngjashme me objektin që prokurohet, nuk përmbush kërkesën për vlerën e përcaktuar në DT. Po kështu, edhe OE “N” ShPk, i cili duhet të përmbushë punime

në vlerë 16,013,143 me TVSh (40.9% x 50% e vlerës së objektit) dhe në këtë eksperiencë ka kryer 14,893,852 lekë me TVSh, nuk plotëson kriterin e vendosur në DT.

- "Rikualifikimi urban i Tamarës dhe rikonstruksioni i rrugës së Vermoshit", me vlerë të realizuar të kontratës 75,570,070 lekë pa TVSh, nga të cilat "Segmenti rrugor Vermosh – Doganë" 13,997,876 lekë pa TVSh, "Mbrojtja lumore" 13,126,222 lekë pa TVSh, "Ura sipas rrugës ekzistuese" 7,514,924 lekë pa TVSh dhe "Rikonstruksion fasadash, çatish.." 40,931,047 lekë pa TVSh dhe ku N ShPK, si pjesë e BOE fituese, ka realizuar 75 % të objektit. Nisur nga fakti që "Rikonstruksion fasadash, çatish.." nuk është eksperiencë e ngjashme, edhe kjo eksperiencë e paraqitur nga OE "N" Shpk, nuk plotëson kërkesën e vendosur në DT.

- "Rehabilitim i kanalit ujitës Postribë", me vlerë të realizuar të kontratës 49,451,922 lekë me TVSh, i realizuar nga OE "N" ShPK. Nisur nga situacioni i punimeve, kjo eksperiencë e paraqitur nuk është e eksperiencë ngjashme.

- "Argjinatura e lumit Drin, krahu i djathtë i rrjedhës Ishull Shëngjin" me vlerë të realizuar të kontratës 58,284,320 lekë me TVSh, ku "Nka realizuar 63.84 % të objektit dhe "N" ShPk ka realizuar 12.56 % të objektit (një OE tjetër ka realizuar 23.6% të objektit). Nisur nga fakti që kjo eksperiencë e paraqitur, nuk është e ngjashme me objektin që prokurohet, nuk plotësohet kriteri i vendosur në DT për eksperiencën e ngjashme.

3. OE "N" ShPK, i cili do të kryejë 40.9% të volumit të punës dhe 50% të punimeve të betonit, nuk disponon pikën NS 9 të licencës profesionale "Punime strukturore speciale".

4. Autobitumtricja e marrë me qera me targë AA...L dhe pompa e betonit me targë AA...GJ, certifikatën e transportit e kanë të cilësuar për vete dhe jo për të tretë.

5. Z. M.F, i punësuar si hidroteknik (sipas kontratës) dhe si gjeolog (sipas formularit nr. 8), është inxhinier shpim prodhimi dhe jo gjeolog.

Sa sipër, kualifikimi i këtij BOE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme".

Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", Neni 92, pika 3, KVO nuk duhet të kishte kualifikuar dhe shpallur fitues këtë BOE. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e kontratës me vlerë 71,288,673.6 lekë me TVSH, me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së A.R, J.N dhe R.C dhe Titullari i AK, z. T.M.

*Nga ana e subjektit, për këtë procedurë nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

## **6. Procedura e prokurimit me objekt "Sistemim asfaltim rruga Çulaj - Skaq", Bashkia Malësi e Madhe**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Sistemim asfaltim rruga Çulaj - Skaq", Bashkia Malësi e Madhe, Nr. REF-74017-06-30-2023.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 1555 , datë 30.06.2023	1. Urdhër Prokurimi Nr. 1555 , datë 30.06.2023	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 1555/1, datë 30.06.2023
2. Lloji i Procedurës – "E hapur, punë"	Njësia e Prokurimit E.A Jurist G.I Ing. Ndertimi F.C Ekonomist	1. A.R, Kryetar 2. J.N 3. R.C

5. Fondi Limit (pa TVSh) 21,168,455 lekë pa TVSH,	6. Oferta fituese (pa TVSh) S me ofertë 18,056,550 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 1555/8, datë 26.09.2023 me afat 2 muaj.	7. Diferenca me fondin limit 3,111,905 lekë, ose 14.7 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 25.07.2023	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë dhe Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 6 OE b) S'kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 4 OE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

### **Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:**

Kjo procedurë është “E Hapur”, me vlerë 21,168,455 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit. Financimi është 5,354,969 lekë për vitin 2023, vlera prej 8,847,177 lekë për vitin 2024 dhe vlera prej 11,200,000 në vitin 2025.

### **Mbi projektpreventivin e zbatimit:**

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga shoqëria L në vitin 2023. Projekti i administruar në dosjen fizike ka miratim (nënshkrim, vulë) nga Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe, z. T.M. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 2 muaj nga fillimi i punimeve.

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...**”.

### **Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:**

Për hartimin e specifikimeve teknike, si dhe për përlllogaritjen e fondit limit për këtë procedurë, NjP është bazuar në proektin e hartuar nga projektuesi.

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga NjP nëpërmjet Procesverbalit, pa nr. prot, datë 06.07.2023.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DT nga Njësia e Prokurimit, është mbajtur procesverbalit pa nr prot, datë 06.07.2023, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se:

1- Në pikën 6 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 2 inxhinierë të ndryshëm (inxhinier ndërtimi, inxhinier topograf) të jenë në licencë, si dhe staf mbështetës një teknik ndërtimi. Ky kriterë është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet (tekniku).

2. Në kriterin për makineritë dhe pajisjet është kërkuar Fabrike asfaltbetoni jo me larg se 70 km nga objekti (e pajisur me leje mjedisore III.1.B, kur është në pronesi), e cila për largësinë nuk është e argumentuar teknikisht.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet dhe nuk kanë nxitur konkurrencën. Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me

pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi NjP.

### **Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike**

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga projektuesi i objektit. Nga verifikimi i zërave të preventivit të fondit limit (vetëm ato me nr analize sipas manualeve), rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

### **Mbi vlerësimin e ofertave**

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur”. Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 25.07.2023. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 6 OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	C	15,431,086
2	BOE A&K	20,262,700
3	L	20,502,700
4	OE N ShPK	17,729,400
5	RRShPk	19,254,485
<b>6</b>	<b>S</b>	<b>18,056,550</b>

Burimi i të dhënave: SPE

Punoi: KLSH

Janë skualifikuar nga KVO, OE të mëposhtëm, për arsyet si vijon:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	C	15,431,086
2	OE N ShPK	17,729,400

Per arsyet e mëposhtme:

**I. C** me nr. NIPT-i: J.....S :

Oferte anomalisht e ulët. Operatori ekonomik C nuk ka paraqitur argumentim të ofertës ekonomike .

**II. N. shpk** me nr. NIPT-i: J.....U:

1.Mungon Sigurimi i ofertes.

2. Nuk ka paraqitur Fabrike asfaltbetoni

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave për OE të skualifikuar, u konstatua se:

1. Cka paraqitur ofertë ekonomike anomalisht të ulët, pasi oferta e tij është më e ulët se vlera 15,896,279 lekë, e cila është 0.85 x mesataren e ofertave të kualifikuara.

KVO ka kërkuar argumentimin e ofertës ekonomike, bazuar në nenin 93 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Cnuk ka bërë sqarimin dhe argumentimi e ofertës ekonomike. Sa sipër, arsyetimi i KVO-së për skualifikimin e këtij OE, është i drejtë.

2. OE “N “ ShPK nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës, si dhe në formularin nr. 8, ka deklaruar se ka marrë me qera fabrikë betoni dhe jo asfaltbetoni, siç kërkohet në DT. Sa sipër, arsyetimi i KVO-së për skualifikimin e këtij OE, është i drejtë.

Janë kualifikuar 4 OE si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	BOE A&K	20,262,700
2	L	20,502,700
3	RRShPk	19,254,485
<b>4</b>	<b>S</b>	<b>18,056,550</b>

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën me nr. 1555/5 prot, datë 08.09.2023, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. T.M me shkresën nr. 1555/6 prot, datë 08.09.2023.

Nga verifikimi në SPE dhe në dokumentet e paraqitura në letër nga OE fitues “St” ShPK, rezulton se:

1. Në formularin nr. 8, në Pjesën II, pika A, citohet “Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat, **taksat lokale** dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së”, ndërsa OE “St” ka deklaruar “Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. Lloji i dokumentit: Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore për tatimpaguesit e-sig02/a; Vërtetim për pagim detyrimesh”. Sa sipër, është shmangur deklarimi në lidhje me taksat lokale.
2. Z. L.K është paraqitur si topograf, nderkohë është i diplomuar për inxhinier markshejder.
3. Në kontratën e bërë me shoqërinë “E.” për marrjen me qera të asfaltoshtues, nuk është i përcaktuar objekti që prokurohet, siç kërkohet në pikën 2.3.8/b të DT.
4. Për mjetin Autovitumatriçe, të marrë me qera nga shoqëria A.K, nuk është paraqitur licenca e transportit për të tretët, siç kërkohet në pikën 2.3.8/b të DT.
5. Fabrika e asfaltit, me të cilin është lidhur kontrata e furnizimit, është më shumë se 70 km nga objekti.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”.

Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Neni 92, pika 3, KVO nuk duhet të kishte kualifikuar dhe shpallur fitues këtë OE. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e kontratës me vlerë 21,667,860 lekë me TVSH, me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së T.M, J.N dhe R.C dhe Titullari i AK, z. T.M.

*Nga ana e subjektit, për këtë procedurë nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

## **7. Procedura e prokurimit me objekt “Sistemim Asfaltim Rruga “Degëzim rruga Koplík-Razëm, për tek rruga e Reçit”, Bashkia Malësi e Madhe**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim Asfaltim Rruga “Degëzim rruga Koplík-Razëm, për tek rruga e Reçit”, Bashkia Malësi e Madhe, Nr. REF-61318-03-03-2023.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 651 , datë 03.03.2023	1. Urdhër Prokurimi Nr. 651 , datë 03.03.2023	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 651/1, datë 03.03.2023
2. Lloji i Procedurës – “E hapur, punë”	Njësia e Prokurimit E.A Jurist G.I Ing. Ndertimi F.C Ekonomist	1. A.R, Kryetar 2. J.N 3. P.C

5. Fondi Limit (pa TVSh) 20,462,474 lekë pa TVSH,	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE "S" ShPK me ofertë 19,732,240 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 651/10, datë 09.05.2023 me afat 2 muaj.	7. Diferenca me fondin limit 730,234 lekë, ose 3.6 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 28.03.2023	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë dhe Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b) S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 3 OE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

### **Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:**

Kjo procedurë është "E Hapur", me vlerë 20,462,474 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit. Financimi është 5,554,969 lekë për vitin 2023, vlera prej 9,000,000 lekë për vitin 2024 dhe vlera prej 10,000,000 në vitin 2025.

### **Mbi projektpreventivin e zbatimit:**

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga shoqëria "N Studio" ShPK në vitin 2022. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 2 muaj nga fillimi i punimeve.

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...".

### **Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:**

Për hartimin e specifikimeve teknike, si dhe për përlllogaritjen e fondit limit për këtë procedurë, NjP është bazuar në projektin e hartuar nga projektuesi.

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga NjP nëpërmjet Procesverbalit, pa nr. prot, datë 03.03.2023, dhe ndryshuar me dy njoftime të datave 10.03.2023 dhe 20.03.2023.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DT nga Njësia e Prokurimit, është mbajtur procesverbalit pa nr prot, datë 03.03.2023, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se:

1- Në pikën 6 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 2 inxhinierë të ndryshëm (inxhinier ndërtimi, inxhinier topograf) të jenë në licencë, si dhe staf mbështetës një teknik ndërtimi. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet (tekniku).

Përsa sipër, kriteri i vendosur nuk është në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet. Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi NjP.

### **Mbi përlllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike**

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga projektuesi i objektit. Nga verifikimi i zërave të preventivit të fondit limit (vetëm ato me nr analize sipas manualeve), rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

### **Mbi vlerësimin e ofertave**

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur”. Në dosje administrohet procesverbali për hapjen datë 28.03.2023 dhe vlerësimin e ofertave, datë 07.04.2023. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 3OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	L	20,113,740
2	<b>OE “S” ShPK</b>	<b>19,732,240</b>
3	OE D	19,897,045

Burimi i të dhënave: SPE

Punoi: KLSH

Nuk ka patur OE të skualifikuar nga KVO.

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën me nr. 651/7 prot, datë 25.04.2023, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. T.M me shkresën nr. 651/8 prot, datë 25.04.2023.

Nga verifikimi në SPE dhe në dokumentet e paraqitura në letër nga OE fitues “S” ShPK, rezulton se:

1. Në formularin nr. 8, në Pjesën II, pika A, citohet “*Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat, taksat lokale dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së*”, ndërsa OE “S” ka deklaruar “*Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. Lloji i dokumentit: Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore për tatimpaguesit e-sig02/a; Vërtetim për pagim detyrimesh*”. Sa sipër, është shmangur deklarimi në lidhje me taksat lokale.
2. Grejderi i paraqitur është vetëm me faturën nr. 6, datë 30.03.2016 dhe si mjet me rrota nuk ka dokumentacionin që duhet të ketë një automjet që targohej (Leje qarkullimi, siguracion, certifikatë kolaudimi, etj.).
3. Për mjetin autovinç që kërkohet në pikën 2.3.8 të DT, është paraqitur një vinç teleskopik, që nuk mund të përdoret për ngritjen e materialeve që do të përdoren në objekt.
4. Për kamionin me targa AA ... IL, i marrë me qera nga N Z dhe mjetin Autovitumatriçe me targa AA ...LT, i marrë me qera nga “E” ShPk, nuk është paraqitur licenca e transportit për të tretët, siç kërkohet në pikën 2.3.8/b të DT.
5. Kamioni me targa SH 8994 E është paraqitur me leje qarkullimi në emër të “S” ShPK dhe me të gjithë dokumentacionin tjetër në emër të S. ShPK.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme*”.

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Neni 92, pika 3, sipas të cilit “*Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni,*

vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, KVO nuk duhet të kishte shpallur fitues këtë OE. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e kontratës me vlerë 23,678,688 lekë me TVSH, me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së T.M, J.N dhe P.C dhe Titullari i AK, z. T.M.

*Nga ana e subjektit, për këtë procedurë nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

## 8. Procedura e prokurimit me objekt “Sistemim asfaltim rruga Rrash - Vorfe”, Bashkia Malësia e Madhe.

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim rruga Rrash - Vorfe”, Bashkia Malësia e Madhe. REF-60302-02-24-2023</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 04, nr. 545 prot., datë 22.02.2023	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> Urdhër nr. 04, datë 22.02.2023 Njësia e Prokurimit 1. E.A, Jurist (Personi përgjegjës) 2. G Ing. Ndërtimi 3. F.C, Ekonomist	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 545/1 prot., datë 22.02.2023 1. T.M, Kryetar (Financier) 2. J.N – Ing. Ndërtimi 3. P.C - Jurist
<b>2. Lloji i Procedurës –</b> “E hapur e Thjeshtuar”		
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 5,688,817 lekë.	<b>6. Oferta fituese (pa Tvsh)</b> <b>5,625,959</b> lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 62,858 (pa Tvsh)
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 10.03.2023 <b>Afati i realizimit 60 ditë</b>	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti afatmesëm i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE; b) S’kualifikuar 1 OE; c) Kualifikuar 2 OE,
<b>11. Ankimime për DT;</b>	<b>12. Përgjigje Ankesës</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës</b>
<b>b. Kontrata nr. 447/8 prot., datë 18.04.2023</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës 18.04.2023</b>	<b>15. Vlera e kontratës</b>	<b>13,613,724 lekë me Tvsh</b>

**Projekt preventivi:** Në dosjen e prokurimit gjenden projekt preventivi i realizuar në Dhjetor 2022 nga OE “N Studio” Shpk, përfaqësuar nga administratori z. E.N dhe M.T-Ing. Ndërtimi; G.N-Arkitekthe; K.N – Ing. Hidroteknik; K.N Ing. Hidroteknik dhe A.B– Ing. Gjeologe dhe P.D– Ing. Ndërtimi.

### Hartimi i dokumenteve të tenderit:

Me urdhërin e prokurimit nr. 4 e nr. 545 prot., datë 22.02.2023 është ngarkuar Njësia e Prokurimit me përbërje:

1. E.A- Jurist (Personi përgjegjës)
2. G – Ing. Ndërtimi
3. F.C - Ekonomist

Në dosje gjenden; “Formularët e deklaramit të konfliktit të interes” të nënshkruar nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit nënshkruar më datë 22.02.2023.

Njësia e Prokurimit më datë 27.02.2023 ka hartuar Procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim. Me nr. 545/2 prot., datë 27.02.2023 Njoftimi i shkurtuar i kontratës,

**Në DT është kërkuar:** Në seksionin 2.10 pika 1, të DT, AK ka përcaktuar: Fondi limit i kontratës: **5,688,817** (pesë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë) **lekë pa Tvsh** dhe 6,826,580 (gjashtë milion e tetëqind e njëzet e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) **lekë me Tvsh.**

**Për vitin 2023:** 1,654,016 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e kater mijë e gjashtëmbëdhjetë) **lekë me Tvsh.**

**Për vitin 2024:** 2,672,564 (dy milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër) **lekë me Tvsh.**

**Për vitin 2025: 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë) lekë me Tvsh.**

Në lidhje me financimin e kontratës është përcaktuar fondi limit dhe është zhvilluar procedura e prokurimit jo në përputhje pikës 2 të nenit 85 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku citohet: “Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor”.

**Në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik në DT është kërkuar: Ofertuesi duhet te jete i pajisur me Certifikatë:**

ISO 9001:2015 - Certifikate për sistemimin e menaxhimit të Cilësisë;

ISO 45001:2018 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)

Certifikatat duhet të jenë në gjuhën e ofertës, dhe në përputhje me natyrën e objektit që tenderohen.

Në rast bashkimi operatorësh, këto certifikata duhet ti ketë secili operator ekonomik në bazë të përqindjes së punimeve që merr përispër në akt-marrëveshje.

Kërkesa në që “Certifikatat duhet të jenë në gjuhën e ofertës”, është përjashtuese për OE/BOE që plotësojnë gjithë kapacitetet teknioke për realizimin e kontratës, ky kriter nuk ka lidhje me kapacitetin teknik të konkuresve.

**Në pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik në DT është kërkuar: “OE ofertuesi duhet të ketë të përfshirë në stafin e tij, të certifikuar nga një organ i akredituar çertifikues personeli (Trup Certifikues), jo më pak se:**

a. Manovratorë 5 (pesë)

b. Shofer 3 (tre)

Për këta të paraqiten kontratat e punës, CV dhe dokumenti certifikues i sipërpërkërkuar.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. OE i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart) ”.

**Në pikën 2.3.8 të kapacitetit teknik në DT është kërkuar: “Dëshmi për makineritë dhe paisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion ofertuesit, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (në pronësi ose me qira):**

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Eskavator me goma 0.25m3	1 cope	Në pronësi ose me qera
2	Kamion me veteshkarkim min. 10 ton	1 cope	Në pronësi ose me qera
3	Grejder	1 cope	Në pronësi ose me qera
4	Rul me vibrim	1 cope	Në pronësi ose me qera
5	Autobot uji	1 cope	Në pronësi ose me qera
6	Rul me Kompresor	1 cope	Në pronësi ose me qera
7	Asfaltshtruese	1 cope	Në pronësi ose me qera
8	Autobitumatrice	1 cope	Në pronësi ose me qera
9	Vibrator Thellesie	1 cope	Në pronësi ose me qera
10	Betoniere 500l	1 cope	Në pronësi ose me qera
11	Armatura	20 m <sup>3</sup>	Në pronësi ose me qera
12	Fabrike asfaltbetoni (e pajisur me leje mjedisore III.1.B, kur eshte ne pronesi)	1 cope	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. OE i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

**Për sa trajtuar më sipër,** argumentimi i kryer nga NjP për pikat: **nr. 2.3.4’ 2.3.7 dhe nr. 2.3.8,** nuk është i bazuar teknikisht dhe ligjrisht për arsye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrumin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës, (duke paramenduar që mjetet lejohet të jenë me qira së bashku me manovratorët dhe shoferët) veprim në

kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 1, neni 3, neni 21, pika 1 dhe pika 5, neni 83, pika 2, gërma “b” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, neni 2, neni 7, pika 3, neni 40, pika 3, neni 78, pika 2.

**Konkluzion:** Në aplikimin e kritereve janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e procedurës, me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kriteret duhet të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** Titullari i AK, z. T.M e z. E.A, z. G dhe z. F.C - Ekonomist, në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

#### **- Zhvillimi i procedurës.**

Me urdhërin e veçantë nr. 4, nr. 545/1 prot., datë 22.02.2023 “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave” me përbërje:

1. T.M, Kryetar - Financier
2. J.N, Anëtar - Inxhinier
3. P.C, Anëtar- Jurist

Në dosje gjenden; “Formularët e deklaratimit të konfliktit të interesit” të nënshkruar nga Komisionin i Vlerësimit të Ofertave më datë 10.03.2023.

KVO ka hartuar procesverbalin e datë 10.04.2023, ku konstatohet që në në SPE për këtë procedurë kanë marrë pjesë 3 (tre) OE.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës, paraqitur në SPE për këtë procedurë KVO me nr. 545/3 datë 02.03.2023 ka hartuar procesverbalin “Për vlerësimin e ofertave dhe dokumentacionit”

**1. L,** (me Nipt: J.....L) vlerë ekonomike të ofertës **5,653,799** (pesë milion e gjashtëqind pesëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë) **lekë pa Tvsh,**

**2. OE “S” Shpk,** (me Nipt: L.....J) vlerë ekonomike të ofertës **5,625,959** (pesë milion e gjashtëqind njëzetë e pesë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë) **lekë pa Tvsh,**

**3. OE “D. - 05” Shpk,** (me Nipt: K.....B) vlerë ekonomike të ofertës **5,429,530** (pesë milion e katërqind njëzetë e nëntë mijë e pesëqind e tridhjetë) **lekë pa Tvsh,**

KVO më datë 05.04.2023 ka hartuar procesverbalin “Për vlerësimin e dokumentacionit fizik”

**Nuk ka OE të skualifikuar.**

KVO me procesverbalin e datës 05.04.2023, ka shpallur fitues OE Di kualifikuar i pari, janë paraqitur dokumentacionet fizike nga OE fitues dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit ka rezultuar që OE “D” Shpk ka paraqitur dokumentacion në SPE me mangësi duke çuar kështu, në skualifikimin e tij për arsyet e mëposhtme:

1. Mungon kontrata e punës, diploma dhe CV për Ing. Topograf/Gjeodet.
2. Mungon kontrata e punës, CV, dokumenti certifikues i kërkuar dhe dokumenti që vërteton kualifikimin (dëftesë dhe/ose diplomë) për teknik ndërtimi.
3. Automjeti Autobot Uji AA...OD. Mungon siguracioni, kolaudimi i mjetit dhe certifikata e transportit.
4. Automjeti Autobitumatriçe AA...DD. Mungon siguracioni, kolaudimi i mjetit dhe certifikata e transportit.
5. Një pjesë e dokumenteve janë fotokopje dhe të panoterizuara.

KVO ka skualifikuar OE D Shpk, dhe të kualifikojë OE të renditur i dyti OE “S” Shpk, që duhet të paraqes dokumentacionin fizik për shpalljen e fituesit.

KVO me nr. 545/4 prot., datë 05.04.2023 ka hartuar procesverbalin “Për rivlerësimin e ofertave”, ka shpallur fitues OE “S” Shpk.

KVO me procesverbalin e datës 13.04.2023, ka shpallur fitues OE “S” Shpk i kualifikuar i pari, janë paraqitur dokumentacionet fizike nga OE fitues dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit ka rezultuar që OE “S” Shpk ka paraqitur dokumentacion të rregullt dhe në përputhje me deklaratimet në SPE. Me nr. 545/5 prot., datë 13.04.2023 “Formular i Njoftimit të Fituesit” (paraparak).

Me nr. 545/6 prot., datë 24.04.2023, nga KVO është formuluar/nënshkruar “Raporti përmbledhës” miratuar nga Titullari i AK me vendimin nr. 545/7 prot., datë 24.04.2023.

Me nr. 545/8 prot., datë 25.04.2023 “Formular i Njoftimit të Fituesit” (Në përfundim të afateve të ankimimit).

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 545/9 prot., datë 03.05.2023, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Malësia e Madhe, të përfaqësuar nga Titullari i Autoriteti Kontraktor z. T.M OE “S” Shpk, të përfaqësuar nga administratori z. Xh.V me objekt: “Sistemim asfaltim rruga Rrash Vorfe - Vorfe”, Bashkia Malësia e Madhe, në përputhje me projekt-zbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **5,625,959** (pesë milion e gjashtëqind njëzetë e pesë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë) **lekë pa Tvsh** (6,751,150.80 lekë me Tvsh).

Me urdhërin nr. 67 e nr. 545/10 prot., datë 03.05.2023 “Për caktimin e personave përgjegjës për zbatimin e kontratës” është caktuar z. J.N, me detyrë Inxhinier Ndërtimi.

Në dosjen e procedurës së prokurimit gjendet me nr. 54511 prot., datë 03.05.2023 Plani i zbatimit të kontratës.

Formulari i njoftimit të publikimit të kontratës së nënshkruar fituesit me nr. 545/12 prot., datë 08.05.2023.

Lidhur me OE “S” Shpk, rezulton se nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues me të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK.

Për mjetin Autobotmatrice, është paraqitur kontrata nr. 2632 rep., nr. 1454 kol., datë 13.09.2021 me OE “E” Sha. Renault; Targa AA...LT; Leje Qarkullimi TR.....5; Shasi VF640FA0000000569; Cerifikata me nr. 20129, datë 23.09.2022 “Për transpor ndërkombëtar mallrash për llogari të vet” lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor”; Siguracioni i mjetit ka përfunduar më datë 05.04.2023.

Nga auditimi i vetëdeklarimit të administratorit të OE S” Shpk, për personelin që disponon për realizimin e kontratës rezulton që :

Janë paraqitur 15 punonjës (përveç Z. R.K) të cilët janë deklaruar në procedurën e prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim rruga e Lohes, Faza 2”, Bashkia Malësia e Madhe.

Për mjetet në pronësi dhe me qira janë deklaruar po ashtu të njëjta mjete.

1. Asfaltoshtruesë – Faturë tatimore me nr. 6, datë 30.03.2016.
2. Grejder – Faturë tatimore me nr. 6, datë 30.03.2016.
3. Autobot Uji; Targa AA....SE; Leje Qarkullimi SH....7; Shasi 5...4.
4. Eskavator; Targa AA....RF; Leje Qarkullimi SH....7; Shasi 3....8.
5. Fabrik Asfalti – Kontratë shitje.
6. Armaturë – Faturë tatimore nr. 782, datë 15.05.2017
7. Kamion Targa AA....RA; Leje Qarkullimi SH....7; Shasi w.....5.
8. Rrul Vibrimi – Faturë doganore
9. Rrul Vibrimi – Faturë doganore
10. Rrul Kompresor – Faturë tatimore
11. Betoniere – Faturë tatimore
12. Vibrator Betoni - – Faturë tatimore

Mjetit Grejder i mungojnë dokumentacioni për mjetet që shënohen në regjistra publikë

#### **Për mjetet me qira janë deklaruar:**

Për sa trajtuar më sipër OE “S” Shpk nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar.

KVO nuk duhet ti kishte propozuar Titullarit të Autoritetit Kontraktor të shpallte fitues OE “S” Shpk por anulimin e procedurës së prokurimit publik, për arsye se asnjë nga OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SPE i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE “S” Shpk dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE R. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit”.

**Konkluzioni:** Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kritere jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të OE “S” Shpk, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **5,625,959 lekë pa Tvsh**.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** z. T.M Kryetar i Bashkisë Malësi e Madhe në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, z. E.A, z. G e F.C në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. T.M, z. J.N e z. P. Ç në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

*Nga ana e subjektit, për këtë procedurë nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

## 9. Procedura e prokurimit me objekt “Sistemim asfaltim rruga e Lohes, Faza 2”, Bashkia Malësi e Madhe.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim rruga Rohes, Faza 2”, Bashkia Malësi e Madhe. REF-60299-02-24-2023		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 03, nr. 543 prot., datë 22.02.2023	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> Urdhër nr. 03, datë 22.02.2023 Njësia e Prokurimit 1. E.A, Jurist (Personi përgjegjës) 2. G Ing. Ndërtimi 3. F.C, Ekonomist	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 543/1 prot., datë 22.02.2023 1. T.M, Kryetar (Financier) 2. J.N – Ing. Ndërtimi 3. P.C - Jurist
<b>2. Lloji i Procedurës –</b> “E hapur eThjeshtuar”		
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 9,784,193 lekë.	<b>6. Oferta fituese (pa Tvsh)</b> <b>9,677,321 lekë</b>	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 106,872(pa Tvsh)
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 10.03.2023 <b>Afati i realizimit 60 ditë</b>	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti afatmësëm i Bashkisë	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE; b) S’kualifikuar 1 OE; c) Kualifikuar 2 OE,
<b>11. Ankimime për DT;</b>	<b>12. Përgjigje Ankesës</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës</b>
<b>b. Kontrata nr. 543/9 prot., datë 09.05.2023</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës 09.05.2023</b>	<b>15. Vlera e kontratës</b>	11,612,785.2 lekë me Tvsh

**Projekt preventivi,** është realizuar në shkurt 2023 nga OE “N Studio” Shpk, përfaqësuar nga administratori z. E.Ndhe M.T-Ing. Ndërtimi; N.B– Ing. Ndërtimi, G.N-Arkitekthe; K.N Ing. Hidroteknik, A.B– Ing.Gjeologe; N.D – Ing. Mekanik; M. Sh – Ing. Elektik, dhe B. K– Topograf;.

### **Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Me urdhërin e prokurimit nr. 03 e nr. 543 prot., datë 10.02.2023 është ngarkuar Njësia e Prokurimit me përbërje:

1. E.A- Jurist (Personi përgjegjës)
2. G I – Ing. Ndërtimi
3. F.C - Ekonomist

Në dosje gjenden; “Formularët e deklarimit të konfliktit të interes” të nënshkruar nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit nënshkruar më datë 22.02.2023.

Njësia e Prokurimit më datë 27.02.2023 ka hartuar Procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim. Me nr. 543/2 prot., datë 27.02.2023 Njoftimi i shkurtuar i kontratës,

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me pikë 1 e nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike”, e pikës të nenit 85, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

**Në DT është kërkuar:** Në seksionin 2.10 pika 1, të DT, AK ka përcaktuar: **1. Fondi limit** i kontratës: **9,784,193** (një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e katër mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa Tvsh dhe **11,741,032** (njëmbëdhjetë milion e shtatëqind e dyzet e një mijë e tridhjetë e dy) lek me Tvsh.

**Për vitin 2023:** 2 741 032 (dy milion e shtatëqind e dyzet e një mijë e tridhjetë e dy) lekë me Tvsh.

**Për vitin 2024:** 4,000,000 (katër milion) lekë me Tvsh.

**Për vitin 2025:** 5,000,000 (pesë milion) lekë me Tvsh.

Në lidhje me financimin e kontratës është përcaktuar fondit limit dhe është zhvilluar procedura e prokurimit jo në përputhje pikës 2 të nenit 85 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku citohet: “Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor”.

**Në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik në DT është kërkuar:** *Ofertuesi duhet të jete i pajisur me Certifikatë:*

*ISO 9001:2015 - Certifikate për sistemimin e menaxhimit të Cilësisë;*

*ISO 45001:2018 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)*

*Certifikatat duhet të jenë në gjuhën e ofertës, dhe në përputhje me natyrën e objektit që tenderohen.*

*Në rast bashkimi operatorësh, këto certifikata duhet të ketë secili operator ekonomik në bazë të përqindjes së punimeve që merr përispër në akt-marrëveshje.*

Kërkesa në që “Certifikatat duhet të jenë në gjuhën e ofertës”, është përjashtuese për OE/BOE që plotësojnë gjithë kapacitetet teknioke për realizimin e kontratës, ky kriter nuk ka lidhje me kapacitetin teknik të konkuresve.

**Në pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik në DT është kërkuar:** *Ofertuesi duhet të ketë një punësim mesatar jo më pak se 22 (njëzet e dy) punonjës (numër i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për kryerjen e punimeve në kohë, sipas analizës, bazuar në preventivin dhe grafikun e punimeve), për periudhën Nëntor 2022 – Janar 2023. Kjo do të vërtetohet me:*

*-Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën përkatëse;*

-Listë pagesat e punonjësve për periudhën përkatëse të konfirmuar nga Administrata Tatimore (në formë elektronike);

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. OE i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

**Në pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik në DT është kërkuar:** “OE ofertuesi duhet të ketë të përfshirë në stafin e tij, të certifikuar nga një organ i akredituar certifikues personeli (Grup Certifikues), jo më pak se:

a. Manovratorë 5 (pesë)

b. Shofer 3 (tre)

Për këta të paraqiten kontratat e punës, CV dhe dokumenti certifikues i sipërpërkërkuar.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. OE i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart). ”.

**Në pikën 2.3.8 të kapacitetit teknik në DT është kërkuar:** “Dëshmi për makineritë dhe pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion ofertuesit, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (në pronësi ose me qira):

Nr	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Eskavator me goma 0.25m3	1 cope	Në pronësi ose me qera
2	Kamion me vetëshkarkim min. 10 ton	1 cope	Në pronësi ose me qera
3	Grejder	1 cope	Në pronësi ose me qera
4	Rul me vibrim	2 cope	Në pronësi ose me qera
5	Autobot uji	1 cope	Në pronësi ose me qera
6	Rul me Kompresor	1 cope	Në pronësi ose me qera
7	Asfaltoshtruese	1 cope	Në pronësi ose me qera
8	Autobitumatrice	1 cope	Në pronësi ose me qera
9	Vibrator Thellesie	1 cope	Në pronësi ose me qera
10	Betoniere 500l	1 cope	Në pronësi ose me qera
11	Vinc kulle	1 cope	Në pronësi ose me qera
12	Armatura	20 m <sup>3</sup>	Në pronësi ose me qera
13	Fabrike asfaltbetoni (e pajisur me leje mjedisore III.1.B, kur është në pronësi)	1 cope	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. OE i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: Leje qakullimi, siguracion, kolaudim, taksa, Certifikatë/licencë transporti si dhe kontratën përkatëse të qerasë dhe licencën e transportit për të tretët (nëse është me qera), e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. OE i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fatura tatimore përkatëse fotot, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. OE i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

b) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar OE duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me

plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. OE i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

c) OE duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

d) OE duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

**Për sa trajtuar më sipër**, argumentimi i kryer nga NjP për pikat: **nr. 2.3.4’ 2.3.7 dhe nr. 2.3.8**, nuk është i bazuar teknikisht dhe ligjrisht për arsye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrumin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës, (duke paramenduar që mjetet lejohet të jenë me qira së bashku me manovratorët dhe shoferët) veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 1, neni 3, neni 21, pika 1 dhe pika 5, neni 83, pika 2, gërma “b” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, neni 2, neni 7, pika 3, neni 40, pika 3, neni 78, pika 2.

**Konkluzion:** Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e neni 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** Titullari i AK, z. T.M e z. E.A, z. G dhe z. F.C - Ekonomist, në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

#### **- Zhvillimi i procedurës.**

Me urdhërin nr.03 nr. 543/1 prot., datë 22.03.2023 “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave” me përbërje:

1. T.M, Kryetar - Financier
2. J.N, Anëtar - Inxhinier
3. P.C, Anëtar- Jurist

Në dosje gjenden; “Formularët e deklarimit të konfliktit të interesit” të nënshkruar nga Komisionin i Vlerësimit të Ofertave më datë 10.03.2023.

KVO ka hartuar procesverbalin e datë 10.03.2023, ku konstatohet që në në SPE për këtë procedurë kanë marrë pjesë 3 (tre) OE.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës, paraqitur në SPE për këtë procedurë KVO me nr. 543/3 datë 02.03.2023 ka hartuar procesverbalin “Për vlerësimin e ofertave dhe dokumentacionit e paraqitur”

**1. L**, (me Nipt: J.....L) vlerë ekonomike të ofertës **9,718,901** (nëntë milion e shtatëqind tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e një) **lekë pa Tvsh**,

**2. OE “S” Shpk**, (me Nipt: L.....J) vlerë ekonomike të ofertës **9,677,321** (nëntë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë shtatë mijë e treqind e njëzetë e një) **lekë pa Tvsh**,

**3. OE D .Shpk**, (me Nipt: K.....B) vlerë ekonomike të ofertës **9,436,881** (nëntë milion e katërqind tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind tetëdhjetë një) **lekë pa Tvsh**.

Është shpallur fitues OE D i kualifikuar i pari

### **Nuk ka OE të skualifikuar.**

KVO më datë 05.04.2023 ka hartuar procesverbalin “Për vlerësimin e dokumentacionit fizik”, janë paraqitur dokumentacionet fizike nga OE fitues dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit ka rezultuar që OE “D” Shpk ka paraqitur dokumentacion me mangësi duke çuar kështu, në skualifikimin e tij për arsyet e mëposhtme:

1. Mungon kontrata e punës, diploma dhe CV për Ing. Topograf/Gjeodet.
2. Mungon kontrata e punës, CV, dokumenti certifikues i kërkuar dhe dokumenti që vërteton kualifikimin (dëftesë dhe/ose diplomë) për teknik ndërtimi.
3. Automjeti Autobot Uji AA...D. Mungon siguracioni, kolaudimi i mjetit dhe certifikata e transportit.
4. Automjeti Autobitumatriçe AA...DD. Mungon siguracioni, kolaudimi i mjetit dhe certifikata e transportit.
5. Një pjesë e dokumenteve janë fotokopje dhe të panoterizuara.

KVO ka skualifikuar OE D Shpk, dhe të kualifikojë OE të renditur i dyti OE “S” Shpk, që duhet të paraqes dokumentacionin fizik për shpalljen e fituesit.

KVO me nr. 545/4 prot., datë 05.04.2023 ka hartuar procesverbalin “Për rivlerësimin e ofertave”, ka shpallur fitues OE “S” Shpk.

KVO me procesverbalin e datës 06.04.2023, “Për vlerësimin e dokumentacionit”, pas shqyrtimit të dokumentacionit ka rezultuar që OE “S” Shpk ka paraqitur dokumentacion të rregullt dhe në përputhje me deklaratimet në SPE. Me nr. 543/5 prot., datë 13.04.2023 “Formular i Njoftimit të Fituesit” (paraprak).

Me nr. 543/6 prot., datë 24.04.2023, nga KVO është formuluar/nënshkruar “Raporti përmbledhës” miratuar nga Titullari i AK me vendimin nr. 543/7 prot., datë 24.04.2023.

Me nr. 543/8 prot., datë 25.04.2023 “Formular i Njoftimit të Fituesit” (Në përfundim të afateve të ankimit).

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 543/9 prot., datë 09.05.2023, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Malësia e Madhe, të përfaqësuar nga Titullari i Autoriteti Kontraktor z. T.M me OE “S” Shpk, të përfaqësuar nga administratori z. Xh.V me objekt: “Sistemim asfaltim rruga Lohes, Faza 2”, Bashkia Malësia e Madhe, në përputhje me projektzbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është 9,677,321 (nëntë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë shtatë mijë e treqind e njëzetë e një) lekë pa Tvsh (11,612,785.2 lekë me Tvsh).

Me urdhërin nr. 73 e nr. 543/10 prot., datë 09.05.2023 “Për caktimin e personave përgjegjës për zbatimin e kontratës” është caktuar z. J.N, me detyrë Inxhinier Ndërtimi.

Në dosjen e procedurës së prokurimit gjendet me nr. 543/11 prot., datë 09.05.2023 Plani i zbatimit të kontratës.

Formulari i njoftimit të publikimit të kontratës së nënshkruar fituesit me nr. 543/12 prot., datë 11.05.2023.

Lidhur me OE “S” Shpk, rezulton se nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues me të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK.

Për mjetin Autobitumatrice, është paraqitur kontrata nr. 2632 rep., nr. 1454 kol., datë 13.09.2021 me OE “E.. 2001” Sha. Renault; Targa AA830LT; Leje Qarkullimi T....5; Shasi V....9; Cerifikata me nr. 20129, datë 23.09.2022 “Për transpor ndërkombëtar mallrash për llogari të vet” lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor”; Siguracioni i mjetit ka përfunduar më datë 05.04.2023.

1. z. R.A me profesion Ing. Ndërtimi, i punësuar pranë shoqërisë, në rolin e Drejtuesit Teknik.– me kod profesioni në listëpagesat 2142.29 - Inxhinier zbatimimi në ndërtim

2. Z. A.d me profesion Ing. Topograf, i punësuar pranë shoqërisë, në rolin e Drejtuesit Teknik. – me kod profesioni në listëpagesat 2165.03 - Gjeometër gjeodezie
3. Z. B Q me profesion Manovrator, i punësuar pranë shoqërisë, në rolin e Manovratorit. - me kod profesioni në listëpagesat 8332.11 - Drejtues të makinave të rënda
4. Z. Gj B me profesion Manovrator, i punësuar pranë shoqërisë, në rolin e Manovratorit. - me kod profesioni në listëpagesat 8332.11
5. Z. I B me profesion Manovrator, i punësuar pranë shoqërisë, në rolin e Manovratorit. - me kod profesioni në listëpagesat 8332.11
6. Z. I Xhme profesion Manovrator, i punësuar pranë shoqërisë, në rolin e Manovratorit. - me kod profesioni në listëpagesat 8332.11
7. Z. N.K me profesion Manovrator, i punësuar pranë shoqërisë, në rolin e Manovratorit. - me kod profesioni në listëpagesat 8332.11 Drejtues të makinave të rënda
8. Z. S. D me profesion Manovrator, i punësuar pranë shoqërisë, në rolin e Manovratorit. – me kod profesioni në listëpagesat 7231.23 - **Teknik të shërbimeve të mirëmbajtjes së automjeteve**
9. Z. A. Rr.me profesion Shofer i punësuar pranë shoqërisë, në rolin e Shoferit. - me kod profesioni në listëpagesat 8332.14 - Shofer kamioni
10. Z. E. M me profesion Shofer i punësuar pranë shoqërisë, në rolin e Shoferit. – me kod profesioni në listëpagesat 8322.01 - Shofer
11. Z. I. V me profesion Shofer i punësuar pranë shoqërisë, në rolin e Shoferit. – me kod profesioni në listëpagesat 2151.01 – i korespondon profesionit **Inxhinier elektrik**
12. Z. S.Sh me profesion Shofer i punësuar pranë shoqërisë, në rolin e Shoferit. - me kod profesioni në listëpagesat 8322.01 - Shofer
13. Z. I.t P, me profesion Teknik Ndërtimi i punësuar pranë shoqërisë, në rolin e Teknik Ndërtimi. – me kod profesioni në listëpagesat 3119.15 - Teknik ndërtimi
14. Z. H. P, me profesion Hekurkthyesi punësuar pranë shoqërisë, në rolin e Hekurkthyesit. – me kod profesioni në listëpagesat 7114.04. - Hekurkthyes
15. Z. R K, me profesion Karpentier, i punësuar pranë shoqërisë, në rolin e Karpentierit. – me kod profesioni në listëpagesat 4321.01 - Magazinier

Për sa trajtuar më sipër OE “S” Shpk nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO nuk duhet ti kishte propozuar Titullarit të Autoritetit Kontraktor të shpallte fitues OE “S” Shpk por anulimin e procedurës së prokurimit publik, për arsye se asnjë nga OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SPE i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE “S” Shpk dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE R. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit”.

**Konkluzioni:** Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kritere jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të OE “S” Shpk, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **9,677,321 lekë pa Tvsh.**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** z. T.M Kryetar i Bashkisë Malësi e Madhe në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, z. E.A, z. G e F.C në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. T.M, z. J.N e z. P.C në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

*Nga ana e subjektit, për këtë procedurë nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

## 10. Procedura e prokurimit me objekt “Sistemim asfaltim rruga Koplik Sipër - Lujs”, Bashkia Malësia e Madhe.

Për auditimin e kësaj procedure u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Regjistri i prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2023-31.12.2023.
- Dokumentacioni i OE, shpallur fitues, paraqitur në sistemin elektronik të APP.
- Dosja e procedurës së prokurimit sipërcituar.
- Dokumentacioni i prokurimit në sistemin elektronik të APP-së.
- Përlllogaritja e fondit limit.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim rruga Koplik Sipër - Lujs”, Bashkia Malësia e Madhe. REF-59314-02-16-2023		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 01, nr. 447 prot., datë 13.02.2023	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> Urdhër nr. 01, datë 13.02.2023 Njësia e Prokurimit 1. F.C, Jurist Ekonomist 2. G Ing. Ndërtimi 3. E.A, Jurist(Personi përgjegjës)	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 447/1 prot., datë 13.02.2023 1. T.M, Kryetar (Financier) 2. J.N – Ing. Ndërtimi 3. P.C - Jurist
<b>2. Lloji i Procedurës –</b> “E hapur e thjeshtuar”		
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 11,424,160 lekë.	<b>6. Oferta fituese (pa Tvsh)</b> <b>11,344,770 lekë</b>	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 79,390 (pa Tvsh)
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 02.03.2023 <b>Afati i realizimit</b> 90 ditë	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti afatmesë m i Bashkisë	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE; b) S’kualifikuar 1 OE; c) Kualifikuar 2 OE,
<b>11. Ankimime për DT;</b>	<b>12. Përgjigje Ankesës</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës</b>
<b>b. Kontrata nr. 447/8 prot., datë 18.04.2023</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> 18.04.2023	<b>15. Vlera e kontratës</b>	<b>13,613,724 lekë me Tvsh</b>

**Projekt preventivi:** Në dosjen e prokurimit gjenden: OE “N Studio” Shpk, përfaqshuar nga administratori z. E.N dhe M.T-Ing. Ndërtimi; G.N-Arkitekthe; K.N – Ing. Hidroteknik; K.N Ing. Hidroteknik dhe A.B– Ing. A.B.

### Hartimi i dokumenteve të tenderit:

Me urdhërin e prokurimit nr. 01 e nr. 447 prot., datë 13.02.2023 është ngarkuar Njësia e Prokurimit me përbërje:

1. E.A- Jurist (Personi përgjegjës)
2. G.I – Ing. Ndërtimi
3. F.C - Ekonomist

Në dosje gjenden; “Formularët e deklaramit të konfliktit të interes” të nënshkruar nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit nënshkruar më datë 13.02.2023.

Njësia e Prokurimit më datë 23.06.2023 ka hartuar Procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

Me nr. 447/2 prot., datë 17.02.2023 Njoftimi i shkurtuar i kontratës,

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me pikë 1 e nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike”, e

pikës të nenit 85, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

**Në DT është kërkuar:** Në seksionin 2.10 pika 1, të DT, AK ka përcaktuar: Fondi limit: 11,424,160 (njëmbëdhjetë milion e katërqind e njëzet e katër mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 13,708,992 (trembëdhjetë milion e shtatëqind e tetë mijë e nëntëqind e njëzet e dy) lekë me Tvsh.

**Për vitin 2023:** 3,208,992 (tre milion e dyqind e tetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë me tvsh.

**Për vitin 2024:** 6,400,000 (gjashtë milion e katërqind mijë) lekë me Tvsh.

**Për vitin 2025:** 4,100,000 (katër milion e njëqind mijë) lekë me Tvsh.

Në lidhje me financimin e kontratës është përcaktuar fondi limit dhe është zhvilluar procedura e prokurimit jo në përputhje pikës 2 të nenit 85 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku citohet: “Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor”.

**Në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik në DT është kërkuar:** Ofertuesi duhet të jete i pajisur me Certifikatë:

ISO 9001:2015 - Certifikate për sistemimin e menaxhimit të Cilësisë;

ISO 45001:2018 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)

Certifikatat duhet të jenë në gjuhën e ofertës, dhe në përputhje me natyrën e objektit që tënderohen.

Në rast bashkimi operatorësh, këto certifikata duhet ti ketë secili operator ekonomik në bazë të përqindjes së punimeve që merr përispër në akt-marrëveshje.

Kërkesa në që “Certifikatat duhet të jenë në gjuhën e ofertës”, është përjashtuese për OE/BOE që plotësojnë gjithë kapacitetet teknioke për realizimin e kontratës, ky kriter nuk ka lidhje me kapacitetin teknik të konkuresve.

**Në pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik në DT është kërkuar:** “Ofertuesi duhet të ketë një punësim mesatar jo më pak se 20 (njëzet) punonjës (numër i nevojshëm dhe i mjaftueshem për kryerjen e punimeve në kohë, sipas analizës, bazuar në preventivin dhe grafikun e punimeve), për periudhën Nëntor 2022 – Janar 2023. Kjo do të vërtetohet me:

-Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj per periudhen perkatese;

- Listë pagesat e punonjesve për periudhën përkatëse të konfirmuar nga Administrata Tatimore (ne forme elektronike);

(Kjo kërkesa do ta konsiderohet e parmbushur gjata fazas sa ofertimit me plotasimin e formularit të vetëdeklarimit. OE i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)”.

**Në pikën 2.3.7. të kapaciteti teknik në DT është kërkuar:** “OE ofertuesi duhet të ketë të përfshirë në stafin e tij, të certifikuar nga një organ i akredituar certifikues personeli (Trup Certifikues), jo më pak se:

a. Manovratorë 6 (gjashtë)

b. Shofer 4 (katër)

Për këta të paraqiten kontratat e punës, CV dhe dokumenti certifikues i sipërpërkëruar.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. OE i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

**Në pikën 2.3.8 të kapaciteti teknik në DT është kërkuar:** “Dëshmi për makineritë dhe paisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion ofertuesit, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (në pronësi ose me qira):

N.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Eskavator me goma 0.25m <sup>3</sup>	1 cope	Në pronësi ose me qera
2	<b>Kamion me veteshkarkim min. 10 ton</b>	2 cope	Në pronësi ose me qera
3	Grejder	1 cope	Në pronësi ose me qera
4	Rul me vibrim	2 cope	Në pronësi ose me qera
5	Autobot uji	1 cope	Në pronësi ose me qera
6	Rul me Kompresor	1 cope	Në pronësi ose me qera
7	Asfaltshtruese	1 cope	Në pronësi ose me qera
8	Autobitumatrice	1 cope	Në pronësi ose me qera
9	Fabrike asfaltobetonit (e pajisur me leje mjedisore III.1.B, kur është në pronësi)	1 cope	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. OE i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)*

*a). Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: Leje qakullimi, siguracion, kolaudim, taksa, Certifikate/licencë transporti si dhe kontratën përkatëse të qerave dhe licencën e transportit për të tretët (nëse është me qera), e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. OE i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)*

*Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimi, fatura tatimore përkatëse fotot, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. OE i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)*

*b). Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar OE duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. OE i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)*

*c). OE duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.*

*d). OE duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.*

**Për sa trajtuar më sipër,** argumentimi i kryer nga NjP për pikat: **nr. 2.3.4’ 2.3.7 dhe nr. 2.3.8,** nuk është i bazuar teknikisht dhe ligjrisht për arsye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës, *(duke paramenduar që mjetet lejohet të jenë me qira së bashku me manovratorët dhe shoferët)* veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 1, neni 3, neni 21, pika 1 dhe pika 5, neni 83, pika 2, gërma “b” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, neni 2, neni 7, pika 3, neni 40, pika 3, neni 78, pika 2.

**Konkluzion:** Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e neni 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kriteret duhet të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** Titullari i AK, z. T.M e z. E.A, z. G dhe z. F.C - Ekonomist, në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.

### **- Zhvillimi i procedurës**

Me urdhërin e veçantë nr. 447/1 prot., datë 13.06.2023 “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave” me përbërje:

1. T.M, Kryetar - Financier
2. J.N, Anëtar.
3. P.C, Anëtar.

Në dosje gjenden; “Formularët e deklaramit të konfliktit të interes” të nënshkruar nga Komisionin i Vlerësimit të Ofertave më datë 02.03.2023.

KVO ka hartuar procesverbalin e datë 02.03.2023, ku konstatohet që në në SPE për këtë procedurë kanë marrë pjesë 3 (tre) OE.

Me nr. 473/2 prot., datë 13.03.2023, është hartuar procesverbali i vlerësimit të ofertave ku konstatohet që kanë marrë pjesë:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE/BOE pjesëmarrës, paraqitur në SPE për këtë procedurë KVO më datë 22.03.2023 ka hartuar procesverbalin “Për vlerësimin e ofertave dhe dokumentacionit fizik”

1. **L**, (me Nipt: J.....L) vlerë ekonomike të ofertës **11,344,770** (*njëmbëdhjetë milion e treqind e dyzetë e katër mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë*) **lekë pa Tvsh**
2. **OE “S” Shpk**, (me Nipt: L.....J) vlerë ekonomike të ofertës **11,404,160** (*njëmbëdhjetë milion e katërqind e katër mijë e njëqind e gjashtëdhjetë*) **lekë pa Tvsh.**
3. **D**, (me Nipt: K.....R) vlerë ekonomike të ofertës – Nuk ka paraqitur ofetrë.

### **Janë skualifikuar OE/BOE ofrues të mëposhtëm:**

1. **D**, skualifikohet për arsyet e mëposhtme:

Mungesë e theksuar e dokumentacionit, OE ka paraqitur vetëm vërtetim xhiroje, OE e tjerë kanë paraqitur dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor dhe ekonomik.

KVO ka shpallur fitues L i kualifikuar i pari, janë paraqitur dokumentacionet fizike nga OE fitues dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit ka rezultuar që L, ka paraqitur dokumentacion të rregullt dhe në përputhje me deklaramet në SPE.

Me nr. 447/4 prot., datë 23.03.2023 “Formular i Njoftimit të Fituesit” (paraparak).

Me nr. 447/5 prot., datë 03.04.2023, nga KVO është formular/nënshkruar “Raporti përmbledhës” miratuar nga Titullari i AK me vendimin nr. 447/6 prot., datë 03.04.2023.

Me nr. 447/7 prot., datë 04.04.2023 “Formular i Njoftimit të Fituesit” (Në përfundim të afateve të ankimimit).

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 447/8 prot., datë 18.04.2023, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Malësia e Madhe, të përfaqësuar nga Titullari i Autoriteti Kontraktor z. T.M L, të përfaqësuar nga administratori z. B. L me objekt: “Sistemim asfaltim rruga Koplik Sipër-Lujs”, Bashkia Malësia e Madhe, në përputhje me projekt-zbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **11,344,770** (*njëmbëdhjetë milion e treqind e dyzetë e katër mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë*) **lekë pa Tvsh** (14,115,708 lekë me Tvsh).

Në dosjen e procedurës së prokurimit gjendet me nr. 447/10 prot., datë 08.04.2023 Plani i zbatimit të kontratës.

Me urdhërin nr. 49 e nr. 447/9 prot., datë 18.04.2023 “Për caktimin e personave përgjegjës për zbatimin e kontratës” janë caktuar: z. J.N, me detyrë Inxhinier Ndërtimi

Formulari i njoftimit të publikimit të kontratës së nënshkruar fituesit me nr. 447/11 prot., datë 24.04.2023.

Lidhur me L, rezulton se ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues me të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK.

**Për mjete me qera, referuar vetëdeklarimit të administratorit të L të datës 13.03.2023. “Për disponimin e mjeteve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, ka deklaruar. Që disponon 25 punonjë, në fakt në periudhën për periudhën Nëntor 2022 – Janar 2023, referuar listë pagesat e punonjësve për periudhën përkatëse ka 21 punonjës.**

**Ka deklaruar:**

1. Z. T.D, me profesion manovrator i punësua pranë shoqërisë, në rolin e drejtuesit për mjetet e rënda. Nga auditimi i listëpagesave të paraqitura ky person nuk figuron.
2. Z. R.R, me profesion manovrator të punësua pranë shoqërisë, në rolin e drejtuesit për mjetet e rënda. Nga auditimi i listëpagesave të paraqitura ky person nuk figuron.
3. Z. E.N, me profesion manovrator i punësua pranë shoqërisë, në rolin e drejtuesit për mjetet e rënda. Nga auditimi i listëpagesave të paraqitura ky person nuk figuron.
4. D.R, me profesion Shofer i punësua pranë shoqërisë, në rolin e shoferit për kamion. Nga auditimi i listëpagesave të paraqitura ky person nuk figuron.
5. Z. E.N, me profesion Shofer i punësua pranë shoqërisë, në rolin e shoferit për kamion. Nga auditimi i listëpagesave të paraqitura ky person figuron me kod të profesionit 7112.05, që i korespondon profesionit Murator për murr tulle.
6. Z. A.A, me profesion Hidraulik i punësua pranë shoqërisë, në rolin e Hidraulikut. Nga auditimi i listëpagesave të paraqitura ky person nuk figuron me kod të profesionit 7112.02, që i korespondon profesionit Karpentier.
7. Z. V.Z, me profesion Hekurkthyes i punësua pranë shoqërisë, në rolin e hekrkthyesit. Nga auditimi i listëpagesave të paraqitura ky person nuk figuron.
8. z. N.A, me profesion Muirator i punësua pranë shoqërisë, në rolin emuratorit. Nga auditimi i listëpagesave të paraqitura ky person nuk figuron me kod të profesionit 7112.02, që i korespondon profesionit Karpentier.

**Për mjete me qera, referuar vetëdeklarimit të administratorit të L të datës 13.03.2023 ka paraqitur: Kontrata me nr. 3703 rep., nr. 1433 kol., datë 01.03.2023 e lidhur me OE “A-K-B A’ Shpk për:**

Mjeti Autobitumatriçe Targa AA...UL; Leje Qarkullimi L.....14; Shasi N.....; Taksat vendore kanë përfunduar më datë 17.02.2023; Siguracioni i mjetit ka përfunduar më datë 05.04.2023. Mjetit i mungon certifikata për transport mallrash.

**Kontrata me nr. 548 rep., nr. 233 kol., datë 28.02.2023 e lidhur me OE “V” Shpk, për: Mjeti Autobot Uji, Targa; AA...ZG; Leje Qarkullimi K.....20; Shasi; E....9. Certifikata me nr. 09, datë 11.10.2022 “Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet” nga Bashkia Tropojë.**

Për sa trajtuar më sipër L nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO nuk duhet ti kishte propozuar Titullarit të Autoritetit Kontraktor të shpallte fitues L por anulimin e procedurës së prokurimit publik, për arsye se asnjë nga OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

Mosdisponimi, apo mos ngarkimi në SPE i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e L dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE R. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin

e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit”.

**Konkluzioni:** Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kriterë jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të L, pasi nuk është në kushtet e plotësisimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **11,344,770 lekë pa Tvsh**.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** z. T.M Kryetar i Bashkisë Malësi e Madhe në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, z. E.A, z. G e F.C në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. T.M, z. J.N e z. P.C në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

*Nga ana e subjektit, për këtë procedurë nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

## 11. Procedura e prokurimit me objekt “Sistemim asfaltim rruga Fermentimit Hotajve dhe Kurtaj në lagjen Palvar”, Bashkia Malësia e Madhe.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim Fermentimit Hotajve dhe Kurtaj në lagjen Palvar”, Bashkia Malësia e Madhe. REF-62196-03-10-2023		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 17, nr. 734 prot., datë 10.03.2023	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> Urdhër nr. 01, datë 13.02.2023 Njësia e Prokurimit 1. E.A, Jurist (Personi përgjegjës) 2. G Ing. Ndërtimi 3. F.C, Ekonomist	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 734/1 prot., datë 10.03.2023 1. T.M, Kryetar (Financier) 2. J.N – Ing. Ndërtimi 3. P.C - Jurist
<b>2. Lloji i Procedurës –</b> “E hapur”		
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 12,654,160 lekë.	<b>6. Oferta fituese (pa Tvsh)</b> <b>11,808,578 lekë</b>	<b>7. Diferenca me fondin limit 845,582</b> (pa Tvsh)
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 30.03.2023 <b>Afati i realizimit 90 ditë</b>	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti afatmesëm i Bashkisë	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE; b) S’kualifikuar 1 OE; c) Kualifikuar 2 OE,
<b>11. Ankimime për DT;</b>	<b>12. Përgjigje Ankesës</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës</b>
<b>b. Kontrata nr. 447/8 prot., datë 18.04.2023</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës 18.04.2023</b>	<b>15. Vlera e kontratës</b>	<b>13,613,724 lekë me Tvsh</b>

**Projekt preventivi:** Në dosjen e prokurimit gjenden: OE L, përfaqësuar nga administratori z. N në Vitin 2023.

### Hartimi i dokumenteve të tenderit:

Me urdhërin e prokurimit nr. 17 e nr. 734 prot., datë 10.02.2023 është ngarkuar Njësia e Prokurimit me përbërje:

1. E.A- Jurist (Personi përgjegjës)
2. G.I– Ing. Ndërtimi
3. F.C - Ekonomist

Në dosje gjenden; “Formularët e deklaramit të konfliktit të interes” të nënshkruar nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit nënshkruar më datë 06.04.2023.

Njësia e Prokurimit më datë 13.03.2023 ka hartuar Procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

Me nr. 734/2 prot., datë 13.03.2023 Njoftimi i shkurtuar i kontratës,

Në dosjen e procedurës së prokurimit gjendet me nr. 734/3 prot., datë 27.03.2023 :Njoftimi për ndryshimine DT”, bashkangjitur shtojca për ndryshimine DT formuluar/nënshkryar nga Njësia e Prokurimit dhe miratuar nga Titullari i AK.

Shtojcë për ndryshimin e DT “Sistemim asfaltim rruga e Fermentimit Hotajve dhe Kurtaj në lagjen Palvar”.

I mbajtur me datë 27.03.2023 në Bashkinë Malësi e Madhe, për modifikimin e dokumenteve standarte te tenderit me objekt: “Sistemim asfaltim rruga e Fermentimit Hotajve dhe Kurtaj në lagjen Palvar”, sipas rekomandimit të APP-së (me postë elektronike), nga Njësia e Prokurimit Bazuar në nenin 75 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 24 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Njësia e Prokurimit vendosi të modifikojë DT.

#### **-Vlerësimi i kriterëve.**

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me pikë 1 e nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike”, e pikës të nenit 85, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

**Në DT është kërkuar:** Në seksionin 2.10 pika 1, të DT, AK ka përcaktuar: **Fondi limit** i kontratës: **12,654,952** (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa Tvsh dhe **15,185,942** (pesëmbëdhjetë milion e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e dyzet e dy) lekë me Tvsh.

**Për vitin 2023:** 3,685,942 (tre milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e dyzet e dy) lekë me Tvsh.

**Për vitin 2024:** 6,000,000 (gjashtë milion) lekë me Tvsh.

**Për vitin 2025:** 5,500,000 (pesë milion e pesëqind mijë) lekë me Tvsh.

Në lidhje me financimin e kontratës është përcaktuar fondi limit dhe është zhvilluar procedura e prokurimit jo në përputhje pikës 2 të nenit 85 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku citohet: “Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor”.

**Në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik në DT është kërkuar:** Ofertuesi duhet të jete i pajisur me Certifikatë:

ISO 9001:2015 - Certifikate për sistemimin e menaxhimit të Cilësisë;

ISO 45001:2018 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)

Certifikatat duhet të jenë në gjuhën e ofertës, dhe në përputhje me natyrën e objektit që tenderohen.

Në rast bashkimi operatorësh, këto certifikata duhet ti ketë secili operator ekonomik në bazë të përqindjes së punimeve që merr përispër në akt-marrëveshje.

Kërkesa në që “Certifikatat duhet të jenë në gjuhën e ofertës”, është përjashtuese për OE/BOE që plotësojnë gjithë kapacitetet teknioke për realizimin e kontratës, ky kriter nuk ka lidhje me kapacitetin teknik të konkuresve.

**Në pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik në DT është kërkuar:** Ofertuesi duhet të kete një punësim mesatar jo me pak se 16 (gjashtëmbëdhjetë) punonjes (numer i nevojshem dhe i mjaftueshem per kryerjen e punimeve ne kohe, sipas analizes, bazuar ne preventivin dhe grafikun e punimeve) , per periudhen Dhjetor 2022 – Shkurt 2023. Kjo do te vertetohet me:

-Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj per periudhen perkatëse;

-Listë pagesat e punonjesve për periudhën perkatese te konfirmuar nga Administrata Tatimore (ne forme elektronike);

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

**Në pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik në DT është kërkuar:** “OE ofertuesi duhet të ketë të përfshirë në stafin e tij, të certifikuar nga një organ i akredituar çertifikues personeli (Grup Certifikues), jo më pak se:

a. Manovratorë 5 (pesë)

b. Shofer 3 (tre)

Për këta të paraqiten kontratat e punës, CV dhe dokumenti certifikues i sipërpërkërkuar.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. OE i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart”).

**Në pikën 2.3.8 të kapacitetit teknik në DT është kërkuar:** “Dëshmi për makineritë dhe paisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion ofertuesit, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (në pronësi ose me qira):

Nr	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Eskavator me zinxhir 0.5m3	1 cope	Në pronësi ose me qera
2	Kamion me veteshkarkim min. 10 ton	2 cope	Në pronësi ose me qera
3	Grejder	1 cope	Në pronësi ose me qera
4	Rul me vibrim	1 cope	Në pronësi ose me qera
5	Autobot uji	1 cope	Në pronësi ose me qera
6	Rul me Kompresor	1 cope	Në pronësi ose me qera
7	Asfaltoshtruese	1 cope	Në pronësi ose me qera
8	Autobitumatrice	1 cope	Në pronësi ose me qera
9	Vibrator Thellesie	1 cope	Në pronësi ose me qera
10	Betoniere 500l	1 cope	Në pronësi ose me qera
11	Armatura	50 m <sup>2</sup>	Në pronësi ose me qera
12	Fabrike asfaltobetonit jo me larg se 40 km nga objekti (e pajisur me leje mjedisore III.1.B, kur eshte ne pronesi)	1 cope	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. OE i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: Leje qakullimi, siguracion, kolaudim, taksa, Certifikatë/licencë transporti si dhe kontratën përkatëse të qerasë dhe licencën e transportit për të tretët (nëse është me qera), e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. OE i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fatura tatimore përkatëse fotot, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. OE i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

b) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar OE duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. OE i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara

publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

c) OE duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

d) OE duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

**Për sa trajtuar më sipër**, argumentimi i kryer nga NjP për pikat: **nr. 2.3.4’ 2.3.7 dhe nr. 2.3.8**, nuk është i bazuar teknikisht dhe ligjrisht për arsye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrumin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës, (duke paramenduar që mjetet lejohet të jenë me qira së bashku me manovratorët dhe shoferët), veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 1, neni 3, neni 21, pika 1 dhe pika 5, neni 83, pika 2, gërma “b” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, neni 2, neni 7, pika 3, neni 40, pika 3, neni 78, pika 2.

**Konkluzion:** Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** Titullari i AK, z. T.M e z. E.A, z. G dhe z. F.C - Ekonomist, në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit.

#### **- Zhvillimi i procedurës.**

Me urdhërin e veçantë nr. 734/1 prot., datë 10.03.2023 “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave” me përbërje:

1. T.M, Kryetar - Financier
2. J.N, Anëtar - Inxhinier
3. P.C, Anëtar- Jurist

Në dosje gjenden; “Formularët e deklaramit të konfliktit të interesit” të nënshkruar nga Komisionin i Vlerësimit të Ofertave më datë 02.03.2023.

KVO ka hartuar procesverbalin e datë 06.04.2023, ku konstatohet që në në SPE për këtë procedurë kanë marrë pjesë 1 (një) OE.

Me nr. 734/4 prot., datë 07.04.2023, është hartuar procesverbali i vlerësimit të ofertave ku konstatohet që kanë marrë pjesë C.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës, paraqitur në SPE për këtë procedurë KVO më datë 22.03.2023 ka hartuar procesverbalin “Për vlerësimin e ofertave dhe dokumentacionit fizik”

**1. C**, (me Nipt: J62719018L) vlerë ekonomike të ofertës **11,808,578 (njëmbëdhjetë milion e tetëqind tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa Tvsh**

**Nuk ka OE të skualifikuar.**

KVO ka shpallur fitues Ci kualifikuar i pari, janë paraqitur dokumentacionet fizike nga OE fitues dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit ka rezultuar që Cka paraqitur dokumentacion të rregullt dhe në përputhje me deklaramet në SPE.

Me nr. 734/5 prot., datë 13.04.2023 “Formular i Njoftimit të Fituesit” (paraprak).

Me nr. 734/6 prot., datë 14.04.2023, nga KVO është formular/nënshkruar “Raporti përmbledhës” miratuar nga Titullari i AK me vendimin nr. 734/7 prot., datë 14.04.2023.

Me nr. 734/8 prot., datë 1904.2023 “Formular i Njoftimit të Fituesit” (Në përfundim të afateve të ankimimit).

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 734/9 prot., datë 24.04.2023, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Malësia e Madhe, të përfaqësuar nga Titullari i Autoriteti Kontraktor z. T.M me C, të përfaqësuar nga administratori z. F me objekt: “Sistemim asfaltim rruga Fermentimit Hotajve dhe Kurtaj në lagjen Palvar”, Bashkia Malësia e Madhe, në përputhje me projekt-zbatimin e objektit, specififikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **11,808,578** (njëmbëdhjetë milion e tetëqind tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë) **lekë pa Tvsh** (14,170,293 lekë me Tvsh).

Me urdhërin nr. 52 e nr. 734/10 prot., datë 24.04.2023 “Për caktimin e personave përgjegjës për zbatimin e kontratës” është caktuar z. J.N, me detyrë Inxhinier Ndërtimi.

Në dosjen e procedurës së prokurimit gjendet me nr. 734/11 prot., datë 24.04.2023 Plani i zbatimit të kontratës.

Formulari i njoftimit të publikimit të kontratës së nënshkruar fituesit me nr. 734/12 prot., datë 28.04.2023.

Lidhur me C, rezulton se ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues me të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK.

*Nga ana e subjektit, për këtë procedurë nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

## 12. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje kosha (kontenier) për mbetje”, Bashkia Malësia e Madhe.

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje kosha (kontenier) për mbetje”, Bashkia Malësia e Madhe. REF-60971-03-01-2023</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 06, nr. 589 prot., datë 27.02.2023	<b>3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b> Urdhër nr. 06, datë 27.02.2023 Njësia e Prokurimit 1. E.A, Jurist (Personi përgjegjës) 2. E.V Ing. Mekanik 3. E.L Ekonomist <b>KLLFL</b> 1. V.Z 2. E.H 3. Z.H	<b>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr. 589/1 prot., datë 27.02.2023 1. T.M, Kryetar (Financier) 2. J.N – Ing. Ndërtimi 3. P.C - Jurist
<b>2. Lloji i Procedurës –</b> “E Hapur e Thjeshtuar”		
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 6,645,833 lekë.	<b>6. Oferta fituese (pa Tvsh)</b> <b>6,626,500</b> lekë	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 19,333 (pa Tvsh)
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> Datë 13.03.2023 <b>Afati i realizimit</b> 30 (tridhjetë) ditë	<b>9. Burimi Financimit</b> Buxheti i Bashkisë	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE; b) S’kualifikuar 1 OE; c) Kualifikuar 1 OE,
<b>11. Ankimime për DT;</b>	<b>12. Përgjigje Ankesës</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës</b>
<b>b. Kontrata nr. 589/8 prot., datë 11.04.2023</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës 11.04. 2023</b>	<b>15. Vlera e kontratës</b>	<b>7,951,800 lekë me Tvsh</b>

**Projekt preventivi:** Në dosjen e prokurimit gjenden: Kërkesa me nr. 557 prot., datë 23.02.2023 “Për blerjen e koshave (kontenier) të mbetjeve që Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane i është drejtuar Njesisë së Prokurimit.

Me procesverbalin nr. 557/1 prot., datë 24.04.2023, Komisioni i Përllogaritjes së Fondit Limit i ngritur me Urdhërin nr. 10, datë 13.01.2023 i përbërë nga znj. V.z (kryetare), znj. E.H (anëtare) e znj. Z H (anëtare) ka realizuar testimin e tregut duke marr tre oferta (OE “B“ Shpk, “B 2019” Shpk dhe “N” Shpk) dhe ka përllogaritur fondin limit në vlerën 6,645,833 lekë pa Tvsh (7,975,000 lekë me Tvsh),

### **Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Me urdhërin e prokurimit nr. 06 e nr. 589 prot., datë 27.02.2023 është ngarkuar Njësia e Prokurimit me përbërje:

1. E.A- Jurist (Personi përgjegjës)
2. F.B – Ing. Mekanik
3. E.L- Ekonomiste

Në dosje gjenden; “Formularët e deklarimit të konfliktit të interes” të nënshkruar nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit nënshkruar më datë 27.02.2023.

Njësia e Prokurimit më datë 02.03.2023 ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim.

Me nr. 589/2 prot., datë 02.03.2023 Njoftimi i shkurtuar i kontratës.

### **- Zhvillimi i procedurës.**

Me urdhërin e veçantë nr. 589/1 prot., datë 27.02.2023 “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave” me përbërje:

1. T.M, Kryetar - Financier
2. J.N, Anëtar.
3. P.C, Anëtar.

Në dosje gjenden; “Formularët e deklarimit të konfliktit të interes” të nënshkruar nga Komisionin i Vlerësimit të Ofertave më datë 10.03.2023.

KVO ka hartuar procesverbalin e datë 13.03.2023 i hapjes së ofertave ku konstatohet që në në SPE për këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 (dy) OE.

Bahkangjitur procesverbalin i datës 13.03.2023 për vlerësimin e mostrave (kontenier) e paraqitur nga OE ofertues **N.N.Z.K.Sh.**

Me nr. 589/3 prot., datë 23.03.2023, është hartuar procesverbalin i vlerësimit të ofertave ku konstatohet që kanë marrë pjesë:

**1. OE “N.N.Z.K.Sh.** (me Nipt: J.....G), me vlerë ekonomike të ofertës **6,626,500** (gjashtë milion e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e pesëqind) lekë pa Tvsh.

**2. OE “A I C” Shpk** (me Nipt: K.....D) me vlerë ekonomike të ofertës **5,510,000** (pesë milion e pesëqind e dhjetë mijë) lekë pa Tvsh.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE/BOE pjesëmarrës, paraqitur në SPE për këtë procedurë KVO më datë 22.03.2023 ka hartuar procesverbalin “Për vlerësimin e ofertave dhe dokumentacionit fizik”

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar OE për arsyet mëposhtëm:**

**OE “A I C” Shpk.**

1. Nuk plotëson pikën 2.3.5. të Kapacitetit Teknik: OE ofertues në këtë procedurë, duhet të paraqesin pranë Bashkisë Malësi e Madhe, në ditën dhe orën e përcaktuar për hapjen e ofertave, nga 1 (një) mostër të mallit objekt prokurimi.

2. Nuk plotëson pikën 2.3.7 OE ofertues nëse nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim të prodhuesit/distributorit të autorizuar për mallin e kërkuar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim distributori OE ta vërtetoj këtë duke paraqitur kontratë premtimi, letër angazhimi/akt-marreveshje lidhur mes kompanisë prodhuese dhe distributorit të autorizuar.

Me nr. 589/4 prot., datë 28.03.2023 KVO ka shpallur fitues OE “N.N.Z.K.Sh. të kualifikuar (paraprak), janë paraqitur dokumentacionet fizike nga OE fitues dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit ka rezultuar që OE “N.N.Z.K.Sh., ka paraqitur dokumentacion të rregullt dhe në përputhje me deklarimet në SPE. KVO ka vendosur që për vazhdimin e procedurës dhe kalimin në fazën dytë të OE “N.N.Z.K..

Me nr. 589/5 prot., datë 05.04.2023, nga KVO është formuluar/nënshkruar “Raporti përmbledhës” miratuar nga Titullari i AK me vendimin nr. 589/6 prot., datë 05.04.2023.

Me nr. 589/7 prot., datë 05.04.2023 “Formulari i Njoftimit të Fituesit” (Në përfundim të afateve të ankimit).

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 589/8 prot., datë 11.04.2023, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Malësia e Madhe, të përfaqësuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. T.Mme OE “N.N.Z.K.Sh., të përfaqësuar nga administratori z. Z.K me objekt: “*Blerje kosha (kontenier) për mbetjet*”, Bashkia Malësia e Madhe, në përputhje me projektzbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **6,626,500 (gjashtë milion e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e pesëqind) lekë pa Tvsh** (7,951,800 lekë me Tvsh).

Me urdhërin nr. 45 e nr. 589/9 prot., datë 11.04.2023 “Për caktimin e personave përgjegjës për zbatimin e kontratës” është caktuar: Z. A.C me detyrë Inxhinier Mekanik.

Në dosjen e procedurës së prokurimit gjendet me nr. 589/11 prot., datë 24.04.2023 Formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar.

Lidhur me OE “N.N.Z.K.Sh., rezulton se ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues me të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK.

**OE “N.N.Z.K.Sh., nuk plotëson pikën 2.3.3.** të kapacitetit teknik në DT. *OE, duhet të disponojë një kamion me vinç me kapacitet bartës të paktën 3.5 ton për transportin e mallrave, të cilin duhet ta ketë në pronësi ose me qira.*

*Për këtë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: Leje qakullimi, siguracion, kolaudim, taksa, Certificate/licencë për transport mallrash (për të tretët)”, pasi për plotësimin e këtij kriteri është paraqitur:*

**Kontrata me nr. 49 rep., nr. 23 kol., datë 10.03.2023, e lidhur me OE “A.A” Shpk** për mjetin Kamion Mercedes Benz Targa AB..FH; Leje Qarkullimi SH....1; Shasi EDB67401415801745 (Autovinç). Mjeti ka certifikatë me nr. 21877, datë 04.11.2022 “Për transport ndërkombëtar mallrash për llogari të vet” lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Shkodër. Mjeti ka kapacitetin mbajtës më të vogël se 3.5 ton (7490 kg-4,095kg =3,395 kg.

Mungon Shtojca 8 “**Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit**”

Për sa trajtuar më sipër OE “N.N.Z.K.Sh. nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO nuk duhet ti kishte propozuar Titullarit të Autoritetit Kontraktor të shpallte fitues OE “N.N.Z.K.Sh. por anulimin e procedurës së prokurimit publik, për arsye se asnjë nga OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SPE i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE “N.N.Z.K.Sh. dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE “N.N.Z.K.Sh.. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit”.

**Konkluzioni:** Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kritereve, ku evidentohet kritere jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të OE “N.N.Z.K.Sh., pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **6,626,500 lekë pa Tvsh.**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:** z. T.M Kryetar i Bashkisë Malësi e Madhe në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, z. T.M, z. J.N e z. P.C në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

*Nga ana e subjektit, për këtë procedurë nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

### **Procedura e prokurimit “Blerjet me vlerë të vogël”**

Në zbatim të Programit të Auditimit cituar më sipër, pika 5, “Mbi planifikim dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve për periudhën 01.01.2023-31.12.2023”u audituan edhe blerjet me vlerë të vogël . Për auditimin e kësaj procedure u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Regjistri i prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2023-31.12.2023;
- Dokumentacioni i OE, shpallur fitues, paraqitur në sistemin elektronik të APP;
- Dosja e procedurës së prokurimit sipërcituar;
- Dokumentacioni i prokurimit në sistemin elektronik të APP-së.

#### ***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezulton se:***

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion, nga Njësia e Prokurimit dhe Drejtoria Ekonomike për periudhën raportuese objekt i procesit të auditimit (nga data 01.01.2023-31.12.2023) u konstatua se; Autoriteti Kontraktor (*Bashkia Malësi e Madhe*) ka parashikuar gjithsej 162 procedura prokurimi me fond limit 638,837,009 lekë dhe janë realizuar 114 blerje me vlerë fondi limit për 467,681,857 lekë, për të cilat edhe ka lidhur 115 kontrata me vlerë 513,453,290 lekë. Janë realizuar gjithsej 64 procedura prokurimi “Vlerë e vogël”, me vlerë të fondit limit 21,004,850 lekë dhe janë lidhur 64 kontrata me vlerë 21,081,237 lekë.

Me analizë të hollësishme për blerjet e realizuara me procedurë “Vlerë e vogël”, për secilin urdhër prokurimi dhe urdhër shpenzim në periudhën raportuese ushtrimore, periudhë objekt auditimi në lidhje me dokumentacioni autorizues dhe vërtetues bashkëlidhur procedurës së prokurimit e urdhër shpenzimit në mënyrë kronologjike u përzgjedhën dhe u konstatua sa më poshtë;

Është ngritur Komisioni për blerjet e vogla me urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, me nr. 17, datë 23.01.2022 me përbërje si vijon:

1. Z. T.M – Kryetar
2. Z. E.A – Anëtar
3. Z. Br.B– Anëtar

1. Me shkresë nr. 1168 prot., datë 05.05.2023 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Sigurim jete për efektivët e PMNZSH”, me **urdhër prokurimi nr. 13, datë 11.05.2023**, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit nr. 1168/1 prot., datë 08.05.2024, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 699,300 lekë. Bashkëlidhur, fatura nr. 6946, datë 25.05.2023, Kontrata e Shërbimit me objekt “Blerje siguracion jete për punonjësit e MZSH-së”, ftesa për ofertë me datë zhvillimi 12.05.2023, proces verbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim datë 11.05.2023 dhe proces verbali i njoftimit të fituesit datë 17.05.2023.

Gjithashtu, me Urdhër Shpenzimin nr. 233, datë 06.06.2023 është likuiduar subjekti subjekti “A J” Sh A për vlerën 699,300 lekë. Nga auditimi konstatohet se nuk është hartuar procesverbali i marrjes në dorëzim veprimet në kundërshtim me nenin 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Mungon komisioni i marrjes në dorëzim.

2. Me shkresë nr. 1166 prot., datë 03.05.2023 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “siguracionin e mjeteve”, me **urdhër prokurimi nr. 12, datë 11.05.2022**, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit nr. 1166/1 prot., datë 08.05.2023, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 691,306 lekë. Bashkëlidhur, fatura nr. 68663, datë 24.05.2023, proces verbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim datë 11.05.2023, ftesa për ofertë me datë zhvillimi 12.05.2023 dhe proces verbali i njoftimit të fituesit datë 17.05.2023. Gjithashtu, me Urdhër Shpenzimin nr. 232, datë 06.06.2023 është likuiduar subjekti subjekti “A” Sh A për vlerën 691,306 lekë.

Nga auditimi konstatohet se nuk është hartuar procesverbali i marrjes në dorëzim veprimet në kundërshtim me nenin 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Mungon komisioni i marrjes në dorëzim.

3. Me shkresë nr. 2068 prot., datë 17.08.2023 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Aktivitete kulturore “Festa e Reçit””, me **urdhër prokurimi nr. 27, datë 18.08.2023**, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit nr. 2068/1 prot., datë 22.08.2023, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 500,000 lekë. Bashkëlidhur, fatura nr. 12, datë 27.08.2023, Proces Verbali për certifikim shërbimi për objektin “Organizim i Festës së Reçit” dhe proces verbali i njoftimit të fituesit datë 22.08.2023. Gjithashtu, me Urdhër Shpenzimin nr. 235, datë 29.08.2023 është likuiduar subjekti subjekti sh.për vlerën 455,760 lekë.

Nga auditimi konstatohet se nuk janë përcaktuar specifikime teknike për shërbimin, prezantimin dhe organizimin, etj. Gjithashtu, konstatohet se nuk është hartuar procesverbali i marrjes në dorëzim apo data dhe vendi i dorëzimit të mallrave veprimet në kundërshtim me nenin 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Mungon komisioni i marrjes në dorëzim.

4. Me shkresë nr. 1963 prot., datë 08.08.2023 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Aktivitete kulturore “Dita e mërgimtarëve”, me **urdhër prokurimi nr. 26, datë 09.08.2023**, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit nr. 1963/1 prot., datë 08.08.2023, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 800,000 lekë. Bashkëlidhur, fatura nr. 10, datë 16.08.2023, Proces Verbali për certifikim shërbimi për objektin “Dita e mërgimtarëve” dhe proces verbali i njoftimit të fituesit datë 11.08.2023. Gjithashtu, me Urdhër Shpenzimin nr. 336, datë 17.08.2023 është likuiduar subjekti subjekti sh.për vlerën 719,748 lekë.

Nga auditimi konstatohet se nuk janë përcaktuar specifikime teknike për shërbimin, prezantimin dhe organizimin, etj. Gjithashtu, konstatohet se nuk është hartuar procesverbali i marrjes në dorëzim apo data dhe vendi i dorëzimit të mallrave veprimet në kundërshtim me nenin 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Mungon komisioni i marrjes në dorëzim.

5. Me shkresë nr. 3090/1 prot., datë 22.11.2023 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Kripë”, me **urdhër prokurimi nr. 75, datë 04.12.2023**, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit nr. 3090 prot., datë 22.11.2023, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 800,000 lekë. Bashkëlidhur, ftesa për ofertë me datë zhvillimi 05.12.2023, proces verbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim datë 04.12.2023, fatura nr. 28, datë 20.12.2023, fletë hyrje datë 20.12.2023, proces verbali marrje në dorëzim me datë 20.12.2023. Gjithashtu, me Urdhër Shpenzimin nr. 592, datë 21.12.2023 është likuiduar subjekti subjekti sh.për vlerën 856,800 lekë.

6. Me shkresë nr. 3063/1 prot., datë 30.11.2023 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Aktivitete për festën e fundvitit”, me **urdhër prokurimi nr. 73, datë 04.12.2023**, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit pa datë, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 800,000 lekë. Bashkëlidhur, ftesa për ofertë me datë zhvillimi 05.12.2023, proces verbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim datë 04.12.2023, fatura nr. 34, datë 30.12.2023, njoftimi i fituesit me datë 06.12.2023, Proces Verbali për certifikim shërbimi për objektin “Aktivitete për festën e fundvitit”, kontratë shërbimi nr. 3280 prot., datë 27.12.2023. Gjithashtu, me Urdhër Shpenzimin nr. 12, datë 11.01.2024 është likuiduar subjekti subjekti sh.për vlerën 872,400 lekë. Konstatohet se nuk është hartuar procesverbali i marrjes në dorëzim apo data dhe vendi i dorëzimit të mallrave veprimet në kundërshtim me nenin 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Mungon komisioni i marrjes në dorëzim.

7. Me shkresë nr. 393/1 prot., datë 07.02.2023 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Furnizim me ushqime për konviktin Tamarë”, me **urdhër prokurimi nr. 5, datë 16.02.2023**, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit nr. 393/1, datë 07.02.2023, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 1,000,000 lekë. Bashkëlidhur, ftesa për ofertë me datë zhvillimi 17.02.2023, njoftimi i fituesit datë 17.02.2023, fletë hyrje nr. 7, datë 15.06.2023, proces verbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim datë 14.02.2023, fatura nr. 51, datë 15.06.2023, njoftimi i fituesit me datë 17.02.2023, shërbimi për objektin “Furnizim me ushqime për konviktin Tamarë”, kontratë shërbimi nr. 481/1 prot., datë 24.02.2023. Gjithashtu, me Urdhër Shpenzimin nr. 258, datë 22.06.2023 është likuiduar subjekti subjekti “B” për vlerën 369,264 lekë. Konstatohet se nuk është hartuar procesverbali i marrjes në dorëzim apo data dhe vendi i dorëzimit të mallrave veprimet në kundërshtim me nenin 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Mungon komisioni i marrjes në dorëzim.

8. Me shkresë nr. 939/1 prot., datë 24.05.2023 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Dita e Turizmit Malor”, me **urdhër prokurimi nr. 15, datë 25.05.2023**, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit datë 24.05.2023, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 700,000 lekë. Bashkëlidhur, ftesa për ofertë me datë zhvillimi 26.05.2023, njoftimi i fituesit datë 30.05.2023, proces verbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim datë 25.05.2023, fatura nr. 6, datë 04.06.2023, Proces Verbali për certifikim shërbimi për objektin “Dita e Turizmit Malor”, datë 04.06.2023. Gjithashtu, me Urdhër Shpenzimin nr. 229, datë 05.06.2023 është likuiduar subjekti subjekti sh.për vlerën 641,280 lekë.

9. Me shkresë nr. 71 prot., datë 26.09.2023 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Rehabilitimi i qendrës së qytetit Koplik”, me **urdhër prokurimi nr. 45, datë 26.09.2023**. Bashkëlidhur, proces verbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim datë 26.09.2023, kontratë sipërmarrje nr. 2441/1 prot., datë 09.10.2023, ftesa për ofertë me datë zhvillimi 27.09.2023, preventiv punimesh datë 18.09.2023 me vlerë 1,000,000 lekë, relacion teknik, njoftimi i fituesit datë 27.09.2023, fatura nr. 95, datë 26.10.2023, Situacion përfundimtar datë 26.10.2023, Proces Verbali marrje në dorëzim datë

30.10.2023. Gjithashtu, me Urdhër Shpenzimin nr. 572, datë 18.12.2023 është likuiduar subjekti subjekti C për vlerën 954,936 lekë.

10. Me shkresë nr. 37/1 prot., datë 13.09.2023 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Transport Sportista”, me **urdhër prokurimi nr. 44, datë 26.09.2023**, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit nr. 2332/2 prot., datë 13.09.2023, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 563,000 lekë. Bashkëlidhur, proces verbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim datë 25.09.2023, kontratë transporti nr. 2424/1 prot., datë 02.10.2023, ftesa për ofertë me datë zhvillimi 26.09.2023, njoftimi i fituesit datë 26.09.2023, fatura nr. 11, datë 20.12.2023, Proces Verbali për certifikim shërbimi për objektin “Transport Sportista”, datë 20.12.2023. Gjithashtu, me Urdhër Shpenzimin nr. 591, datë 21.12.2023 është likuiduar subjekti subjekti “M T ShPK” për vlerën 666,000 lekë.

11. Me shkresë nr. 13 prot., datë 27.01.2023 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Transport Sportista”, me **urdhër prokurimi nr. 2, datë 02.02.2023**, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit nr. 300/1 prot., datë 30.01.2023, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 528,000 lekë. Bashkëlidhur, proces verbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim datë 14.02.2023, kontratë transporti nr. 346/1 prot., datë 15.02.2023, ftesa për ofertë me datë zhvillimi 06.02.2023, njoftimi i fituesit datë 06.02.2023, fatura nr. 1, datë 05.05.2023. Gjithashtu, me Urdhër Shpenzimin nr. 203, datë 10.05.2023 është likuiduar subjekti subjekti “M T ShPK” për vlerën 524,000 lekë. Konstatohet se nuk është hartuar Proces Verbali për certifikim shërbimi për objektin “Transport Sportista”, veprimet në kundërshtim me nenin 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Mungon komisioni i marrjes në dorëzim.

12. Me shkresë nr. 75 prot., datë 07.12.2023 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Riparim i rrjetit elektrik”, me **urdhër prokurimi nr. 76, datë 07.12.2023**, preventiv punimesh datë 06.12.2023 me vlerë 1,000,000 lekë. Bashkëlidhur, proces verbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim datë 07.12.2023, ftesa për ofertë me datë zhvillimi 11.12.2023, Proces Verbali i verifikimit të punimeve dhe marrjes në dorëzim të punimeve për objektin “Riparim i rrjetit elektrik” nr. 3333/3 prot., datë 26.12.2023, njoftimi i fituesit datë 14.12.2023, fatura nr. 30, datë 22.12.2023, kontratë sipërmarrje nr. 3333/1 prot., datë 19.12.2023. Gjithashtu, me Urdhër Shpenzimin nr. 611, datë 28.12.2023 është likuiduar subjekti subjekti sh.për vlerën 1,048,800 lekë.

13. Me shkresë nr. 3092/1 prot., datë 23.11.2023 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Blerje materiale të ndryshme sportive për shkollat”, me **urdhër prokurimi nr. 72, datë 30.11.2023**, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit datë 23.11.2023, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 219,600 lekë. Bashkëlidhur, proces verbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim datë 30.11.2023, ftesa për ofertë me datë zhvillimi 01.12.2023, Proces Verbali marrjes në dorëzim për objektin “Blerje materiale të ndryshme sportive për shkollat” datë 12.12.2023, fletë hyrje nr. 55, datë 12.12.2023, njoftimi i fituesit datë 06.12.2023, fatura nr. 25, datë 12.12.2023. Gjithashtu, me Urdhër Shpenzimin nr. 565, datë 18.12.2023 është likuiduar subjekti për vlerën 215,760 lekë.

14. Me shkresë nr. 2831 prot., datë 31.11.2023 është bërë kërkesë për prokurim me objekt “Blerje materiale sportive për shkollat”, me **urdhër prokurimi nr. 64, datë 02.11.2023**, me proces verbal të llogaritjes së fondit limit datë 01.11.2023, referuar çmimeve të tregut, me fond limit 420,000 lekë. Bashkëlidhur, proces verbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim datë 02.11.2023, ftesa për ofertë me datë zhvillimi 03.11.2023, Proces Verbali marrjes në dorëzim për objektin “Blerje materiale sportive për shkollat” datë 14.11.2023, fletë hyrje nr. 46, datë 14.11.2023, njoftimi i fituesit datë 09.11.2023, fatura nr. 20, datë 14.11.2023. Gjithashtu, me Urdhër Shpenzimin nr. 496, datë 17.11.2023 është likuiduar subjekti subjekti sh.për vlerën 412,800 lekë.

### **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Z. T.M, Kryetar i Bashkisë Malësi e Madhe;
2. Z. T.M, në cilësinë e Komisionit për blerjet e vogla;
3. Z. E.A, në cilësinë e Komisionit për blerjet e vogla;
4. Z. B. B, në cilësinë e Komisionit për blerjet e vogla.

*Nga ana e subjektit, për këtë procedurë nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

### **2.5.2 Mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.**

Për auditimin e zbatimit të kontratave të punimeve u analizuan regjistri i realizimit të investimeve që i përket periudhës së auditimit të përputhshmërisë 01.01.2023 deri me datën 31.12.2023 dhe kontrata të realizuara që periudha e garancisë së punimeve është brenda periudhës së audituar.

Për periudhën e auditimit në Bashkinë Malësi e Madhe u audituan **8** (tetë) dosje/objekte të prokuruar (Tabela në vijim), në vlerën totale të kontratave **274,437,828 lekë me Tvsh**, mbi zbatimin e kontratave për punë publike.

Në zbatim të pikës 5.2 të Programit të Auditimit në Bashkinë Malësi e Madhe, nga audituesit e KLSH-së z. A Z dhe z. G K u krye auditimi i zbatimit të punimeve në objektet:

Nr	Objekti	Vl. Kontratës	Sipërmarrësi
1	Rikonstruksion godina e zjarrfikëses	9,462,023	M& "N" ShPK
2	Sistemim Asfaltim rruga Koplik i Sipërm - Lujs	13,613,724	L ShPK
3	Sistemim Asfaltim rruga "Degezim i rrugës Koplik Razëm, për tek rruga e Reçit"	23,678,688	"S" ShPK
4	"Sistemim Asfaltim rruga Kastrat - Rrapshe", Bashkia Malësi e Madhe	69,096,177.6	L ShPK & "St.j" ShPK
5	"Sistemim Asfaltim rruga Gjuraj – Koplik i Sipërm",	14,115,708	L ShPK
6	"Sistemim Asfaltim rruga Sterkuje", Bashkia Malësi e Madhe	18,039,216	C ShPK
7	Sistemim Asfaltim Rruga Koplik-Sterbeq-Jubice-Kamice	70,681,782	L ShPK & N ShPK
8	Ndertim i impjantit te ngrohjes ne shkollat e Mesme Koplik- Bajze - Gruemire	38,884,234	"M,I" ShPK
9	"Sistemim Asfaltim rruga Linaj Kurte"	30,480,000	"A & "K ShPK

**Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave për punë publike, u konstatua si vijon:**

#### **1. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve në objektin: "Rikonstruksion godina e Zjarrëfikëses", Bashkia Malësi e Madhe**

##### Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 990/10 prot datë 29.06.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. T.M dhe BOE M& "N" ShPK, me përfaqësues z. V.M, me licencë profesionale NZ 5373/3. Vlera e kontratës është 9,462,023 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 60 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1346/1 prot, datë 29.06.2023, është lidhur kontrata me OE “N Studio” SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1846/7 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 122,982 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas shkresës me nr. nr. 2847/1, datë 14.11.2023 është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria LShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0985/7.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, në dosje nuk administrohet ndonjë urdhër për ngritjen e grupit të punës. Është hartuar Certifikata e Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., datë 01.08.2023, i nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi, kolaudatori i punimeve, si dhe nga ing. J.N dhe Kryetari i Bashkisë z. T.M për Investitorin.

### Projektpreventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Deklaratë për kryerje punimesh me nr. 1090/1 prot, datë 20.04.2023. Ky veprim është në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit”.

Në dosjen e zbatimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike**, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...”.

Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Malësi e Madhe, z. T.M.

- Projekti i zbatimit është hartuar nga OE “N Studio” në vitin 2023.

### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 29.06.2023 dhe kanë përfunduar me datë 28.08.2023, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

- Në dosjen teknike administrohet projekti i azhurnuar dhe korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Pas kërkesë propozimit të Mbikëqyrësit të punimeve me nr. 447/14 prot., datë 17.05.2023, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen/pakësohen prej 888,307/ 736,918 lekë pa TVSH dhe përdorimi i fondit rezervë në vlerën 151,389 lekë pa TVSh..

Në dosje nuk gjendet asnjë dokument justifikues në lidhje me zërin e maskuar të punës “Shpim pusi 100-120 ml komplet + aksesore + pompë”, me vlerë të situacionuar 2,550,000 lekë pa TVSh.

Janë miratuar katër zëra të rinj, konform manualit të çmimeve në fuqi.

Nga verifikimi në terren u konstatua se është realizuar mbulimi i parapetit të tarracës, jo me pllakë b/a granili me çmimin 4500 lekë/m<sup>2</sup> siç është situacionuar, por me llamarinë xingato, e cila në manualin e çmimeve është me çmimin 1432 lekë/m<sup>2</sup>. Për këtë zë të ri pune nuk është bërë negociim çmimi. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,

4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion godina e Zjarrëfikëses”, Bashkia Malësi e Madhe				
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 990/10 prot datë 29.06.2023	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 9,462,023 lekë <b>BOE fitues M &amp; N ShPK</b>		<b>16.Likuiduar deri dt</b>	
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> -Vlera me tvsh 13,612,320 lekë -Vlera pa tvsh 11,343,600 lekë	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 60 ditë , Zbatuar 60 ditë. Fillimi punimeve: 26.06.2023 Përfundimi punimeve : 2.08.2023		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Nuk ka	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE “N Studio” SHPK	Licenca Nr: MK 1846/7	Kontrata me nr. 1346/1 prot, datë 29.06.2023	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> L ShPK	Licenca Nr: MK 0985/7	Kontrata nr. 2847/1, datë 14.11.2023	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
<b>22.Akt Kolaudimi</b> Pa datë	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim</b> , datë 20.11.2023		<b>24. Fletë Hyrja</b> Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **292,925 lekë pa tvsh.**

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

1. Z. E.N me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. N me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

*Nga ana e subjektit, për sa trajtuar në lidhje me zbatimin e kontratës për këtë objekt, nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**2. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve në objektin: “Sistemim Asfaltim rruga Koplík i Sipërm - Lujs”, Bashkia Malësi e Madhe,**

**Kontratat**

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 447/8 prot datë 18.04.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. T.M dhe Operatorit Ekonomik L ShPK, me përfaqësues z. B.L, me licencë profesionale NZ 0804/10. Vlera e kontratës është 13,613,724 lekë me tvsh. Financimi është 3,208,992 lekë për vitin 2023, vlera prej 6,400,000 lekë për vitin 2024 dhe vlera prej 4,004,732 në vitin 2025. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 90 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 900/13 prot, datë 18.04.2023, është lidhur kontrata me OE “N Studio” SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1846/7.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas shkresës me nr. 2172/1, datë 12.09.2023 është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria LShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0985/7.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, në dosje nuk administrohet ndonjë urdhër për ngritjen e grupit të punës. Është hartuar Certifikata e Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., datë 01.08.2023, i nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi, kolaudatori i punimeve, si dhe nga ing. J.N dhe Kryetari i Bashkisë z. T.M për Investitorin.

### Projektpreventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Deklaratë për kryerje punimesh me nr. 1090/1 prot, datë 20.04.2023. Ky veprim është në mospërputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 11/1, “Punime që duhet t’u kërkohet leja e ndërtimit”, sipas të cilit ky objekt duhet të ishte pajisur me leje ndërtimi infrastrukture.

Në dosjen e zbatimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...**”.

Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Malësi e Madhe, z. T.M.

- Projekti i zbatimit është hartuar nga OE “N Studio” në vitin 2023.

### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 18.04.2023 dhe kanë përfunduar me datë 17.07.2023, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

- Në dosjen teknike administrohet projekti i azhurnuar dhe korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Pas kërkesë propozimit të Mbikëqyrësit të punimeve me nr. 447/14 prot., datë 17.05.2023, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen/pakësohen prej 73,850/75,020 lekë pa TVSH.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

<b>Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Sistemim Asfaltim rruga Koplík i Sipërm - Lujs”, Bashkia Malësi e Madhe</b>				
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 447/8 prot datë 18.04.2023	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 13,613,724 lekë <b>OE fitues L ShPK</b>		<b>16.Likuiduar deri dt</b>	
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> <b>-Vlera me tvsh 13,612,320 lekë</b> <b>-Vlera pa tvsh 11,343,600 lekë</b>	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 60 ditë , Zbatuar 59 ditë. Fillimi punimeve: 28.04.2023 Përfundimi punimeve : 26.06.2023		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Nuk ka	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE “N Studio” SHPK	Licenca Nr: MK 1846/7	Kontrata me nr. 900/13 prot, datë 18.04.2023	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> LShPK	Licenca Nr: MK 0985/7	Kontrata nr. 2172/1, datë 12.09.2023	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
<b>22.Akt Kolaudimi</b> Datë 15.09.2023	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim, datë</b> 15.09.2023		<b>24. Fletë Hyrja Nr.... datë</b> .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **201,000 lekë pa tvsh.**

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

1. Z. E.N me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. N me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Për këtë objekt është paraqitur observacioni me nr. 1385/65 prot., datë 29.08.2024, protokolluar në KLSH me nr. 701/6, datë 02.09.2024, nga ing. E.N, si administratori dhe drejtuesi teknik i mbikëqyrësit të punimeve “N Studio” ShPK, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit: 1. Zëri 6 Shtrese stabilizanti 10 cm**

Në librezën e masave të objektit “Sistemim Asfaltim rruga Koplík i Sipërm - Lujs”, janë trajtuar me detaje volumet e zërave të punimeve “Shtresë çakulli, mbeturinë kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri” dhe “Shtrese stabilizanti 10 cm për rrugën”. Në situacion këto dy volume janë deklaruar më pak se në librin e masave, për arsye të fondit limit të kufizuar në vlerën 1,428,400 lekë (paraqitur në tabelë). Në situacion, bankina e zbritur nga ana juaj është 201,000 lekë (670 m<sup>2</sup> x 300 lekë/m<sup>2</sup>). Bankina u shtrua me shtresë zhavorri, so nje mënyrë për të organizuar mirëmbajtjen e tyre, duke qenë se shtresat e zhavorrit ishin të bollshme dhe ky material siguron qëndrueshmëri më të madhe gjatë periudhës së rreshjeve... Ndërkohë, volumet e raportuara të stabilizantit I referohen edhe rreth 150 ml rrugë më tepër, pasi me këmbënguljen e administratorit të Nj.A Qendër dheme miratimin e Bashkisë Malësi e Madhe, duhej bërë lidhja e lagjes Lujs me rrugën Koplík – Koplík I Sipërm.

**Qëndrimet e Grupit të Auditimit:** Në lidhje me këtë observacion, grupi I auditimit sqaron se mbikëqyrësi I punimeve që ka observuar për këtë pjesë të projektraportit, është njëkohësisht edhe projektuesi I këtij objekti dhe avantazhet që ka bankina me zhavorr dhe lidhjen e lagjes Lujs me rrugën Koplík – Koplík I Sipërm, duhet t’i kishte marrë në konsideratë gjatë hartimit të projektit. Ky pretendim nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

**3. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve në objektin: “Sistemim Asfaltim rruga “Degezim i rrugës Koplík Razëm, për tek rruga e Reçit”, Bashkia Malësi e Madhe.**

**Kontratat**

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 651/10 prot datë 09.05.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. T.M dhe Bashkimit të Operatorit Ekonomik “S” ShPK, me përfaqësues z. Xh.V, me licencë profesionale NZ 7099/6. Vlera e kontratës është 23,678,688 lekë me tvsh. Financimi është 5,554,969 lekë për vitin 2023, vlera prej 9,000,000 lekë për vitin 2024 dhe vlera prej 9,123,719 në vitin 2025. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 60 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 984/21 prot, datë 09.05.2023, është lidhur kontrata me OE “N Studio” SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1846/7 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 327,679 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 2178/1 prot, datë 12.09.2023 është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria “L” ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0985/7.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, në dosje nuk administrohet ndonjë urdhër për ngritjen e grupit të punës. Është hartuar Certifikata e Marrjes së Përkohshme në dorëzim me nr. 2178/2 prot., datë 15.09.2023, i nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi, kolaudatori i punimeve, si dhe për Investitorin, nga ing. J.N dhe Kryetari i Bashkisë z. T.M.

**Projektpreventivi**

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Deklaratë për kryerje punimesh me nr. 19, datë 26.04.2023. Ky veprim është në mospërputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 11/1, “Punime që

duhet t'u kërkohej leja e ndërtimit", sipas të cilit ky objekt duhet të ishte pajisur me leje ndërtimi infrastrukture.

Në dosjen e zbatimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...**".

Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Malësi e Madhe, z. T.M.

- Projekti i zbatimit është hartuar nga shoqëria "N Studio" ShPK në vitin 2022.

#### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 09.05.2023 dhe kanë përfunduar me datë 07.07.2023, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

- Në dosjen teknike administrohet projekti i azhurnuar dhe korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Pas kërkesë propozimit të sipërmarrësit të punimeve "S" SHPK dhe Mbikëqyrësit të punimeve, protokolluar me nr. 651/16 prot., datë 29.05.2023, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen/pakësohen prej 293,880 lekë pa TVSH.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

<b>Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Sistemim Asfaltim rruga "Degezim i rrugës Koplik Razëm, për tek rruga e Reçit", Bashkia Malësi e Madhe</b>				
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 651/10 prot datë 09.05.2023	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 23,678,688 lekë <b>OE fitues "S" ShPK</b>		<b>16.Likuiduar deri dt</b>	
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> <b>-Vlera me tvsh 23,678,688 lekë</b> <b>-Vlera pa tvsh 19,732,240 lekë</b>	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 60 ditë , Zbatuar 59 ditë. Fillimi punimeve: 09.05.2023 Përfundimi punimeve : 07.07.2023		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Nuk ka.	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE "N Studio" SHPK	Licenca Nr: MK 1846/7	Kontrata me 984/21 prot, datë 09.05.2023	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> "L" ShPK	Licenca Nr: MK 0985/7	Kontrata nr. 2178/1 prot, datë 12.09.2023	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
<b>22.Akt Kolaudimi</b> Datë 15.09.2023	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim</b> , nr. 2178/2 prot., datë 15.09.2023		<b>24. Fletë Hyrja</b> Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **474,775 lekë pa tvsh.**

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

1. Z. E.N me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. N me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Për këtë objekt është paraqitur observacioni me nr. 1385/65 prot., datë 29.08.2024, protokolluar në KLSH me nr. 701/6, datë 02.09.2024, nga ing. E.N, si administratori dhe drejtuesi teknik i mbikëqyrësit të punimeve “N Studio” ShPK, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit: 1. Zëri 1+2 Gërmim dheu me ekskavator + Transport 1 km**

Ne llogaritjen e këtij zëri të bërë nga ana juaj është thënë se zeri 240 m<sup>3</sup> është librezuar në kapitullin e veprave të artit ndërsa fakti për gërmimin e veprave të artit është fleta nr.50 tek librezat e masave dhe është 96 m<sup>3</sup> vetëm për hapsirën e urës. Volumi 240 m<sup>3</sup> në fletën Nr.2 të librezat e masave është prishja e baterisë së tombinëve ekzistuese ndërtuar shumë vite më përpara. Duhej kryer kjo prishje me lartësi mesatare 2m dhe gjatësi mesatare 20 m për tu ulur në kuotën e themeleve të urës së re (pasi sipas projektit të parë këto themele do të binin mbi tombino në kuotën e asfaltit ekzistues) Prandaj këto gërmimi janë Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet për trupin e rrugës (për trupin e rrugës)”, fl nr. 2 tek libri I masave, ndërsa vetëm hapësira e urës përfshi shpatullat me volum 96 m<sup>3</sup> është pasqyruar saktë tek gërmimi për vepra arti, fl nr. 50 e librit të masave.

Prishja e baterisë së tombinos ishte e domosdoshme për të liruar hapësirën e dritës poshtë urës (nëse shohim vizatime në projekt, profile tërthor të urës, kuota +0.00, niveli I poshtëm I rrjedhjes është marrë mbi baterinë e tombinëve, pasi e tillë ka qenë gjendja e përroit në momentin kur është hartuar projekti) dhe gërmimi I themeleve të shpatullave të burës, do të ishte mbi tombinot ekzistuese. Prandaj për të inkastruar themelet e urës në tokën natyrale në shtratin e përroit, është gërmuar dhe transportuar komplet bacteria e Përroit...

Lidhur me çka bëjmë me dije në këtë observacion, nëse verifikohen me kujdes në vend, volume do të jenë sipas librit të masave, ndaj nuk jemi dakord që volume janë marrë 2 herë...

**Qëndrimet e Grupit të Auditimit:** Në lidhje me këtë zë pune, Grupi i auditimit sqaron se volumi I gërmimit, I marrë në faqen 50 të librit të masave, është pikërisht gërmimi në progresivin ku është ndërtuar ura dhe nuk ka gërmim tjetër. Dimensionet e gërmimit në atë progresiv, janë pikërisht ato që duhen për të arritur në kuotën e duhur. Projekti I zbatimit (prejra tërthore e urës) nuk reflekton vendndodhjen (kuotën) e tombinëve ekzistuese dhe lartësia e gërmimit është marrë e plotë, siç tregohet në vizatime. Ky pretendim nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

**Pretendimet e subjektit: 2. Zëri 3 “Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës”.**

Mbushjet me material të gërmuar janë hartuar sipas profileve piketa 30 deri në piketen 34 me gjatësi 80 m (të matshme në vend gjatësia), të paraqitur në librezat e masave, në fletën nr.9 dhe profilet tërthore para dhe pas urës së re.

Për rakordimin e niveletës së rrugës me urën e re, janë sipas faktit me permasa topografikisht të nxjerra dhe janë paraqitur në librezat e masave. Llogaritja jone  $6.8 \times 5 \times 4.5$  m është e saktë sepse parametrat e urës janë faktikisht aq sa është bërë llogaritja jone.

Llogaritja e bërë nga ana juaj me gjerësi 13m nuk është e qarte nga ka ardhur kjo permase.

Përmasa e vendosur nga ana juaj për gjerësi 13 m pothuajse përfshin hapësirën dritë të urës 5 m dhe krahët rakordues të urës në njërin anë, por sqarojmë se në volumin negativ (të zbritshëm), hynë vetëm gabaritet e urës (hapësira e dritës + trashësia e dy shpatullave, shumëzuar me gjerësinë e urës, saktësisht  $L = (5 + (2 \times 0.9)) \times 5 \times 4.5$ ). Pjesa rakorduese e krahëve të urës nga ballnat para dhe pas hapësirës, janë volume mbushje të realizuara faktike, të vërtetuara me tabelë volumesh hartuar topografikisht dhe hedhur në librezat.

Zbritja në gjatësi 13 m sipas jush përfshin zbritjen e hapësirës së urës në një sasi mjaft më të madhe se sa zbritja reale sipas matjeve.

Nisur sa me siper, kërkojmë që nga ana juaj të rishikohet konkluzioni.

**Qëndrimet e Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të këtij observacioni grupi i auditimit sqaron:

Përmasat e mbushjes të cituara në aktkonstatimin nr. 10 dhe në Projektraport, janë ato që u matën në terren në prezencë të mbikëqyrësit dhe të përfaqësuesit të Bashkisë. Ndërsa volumi që duhet të ishte zbritur, është volumi I marrë si mbushje në pjesën e urës, I cili, siç ramë dakord edhe gjatë verifikimit në terren, nuk është marrë I plotë me gjithë skarpatat, por është zbritur vetëm volumi I urës. Sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron, nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në Projektraportin e auditimit.

#### **4. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve në objektin: “Sistemim Asfaltim rruga Gjuraj – Koplík i Sipërm”, Bashkia Malësi e Madhe.**

##### Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 633/10 prot datë 28.04.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. T.M dhe Operatorit Ekonomik L ShPK, me përfaqësues z. B.L, me licencë profesionale NZ 0804/10. Vlera e kontratës është 14,115,708 lekë me tvsh. Financimi është 3,201,281 lekë për vitin 2023, vlera prej 5,000,000 lekë për vitin 2024 dhe vlera prej 5,914,427 në vitin 2025. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 60 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 900/17 prot, datë 28.04.2023, është lidhur kontrata me OE “N Studio” SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1846/7.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 2175/1 prot, datë 12.09.2023 është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria L ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0985/7.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, në dosje nuk administrohet ndonjë urdhër për ngritjen e grupit të punës. Është hartuar Certifikata e Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., datë 01.08.2023, i nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi, kolaudatori i punimeve, si dhe nga ing. J.N dhe Kryetari i Bashkisë z. T.M për Investitorin.

##### Projektpreventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Deklaratë për kryerje punimesh me nr. 1109/1, datë 25.04.2023. Ky veprim është në mospërputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 11/1, “Punime që duhet t’u kërkohet leja e ndërtimit”, sipas të cilit ky objekt duhet të ishte pajisur me leje ndërtimi infrastrukture.

Në dosjen e zbatimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...**”.

Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Malësi e Madhe, z. T.M.

- Projekti i zbatimit është hartuar nga OE “N Studio” në vitin 2023. Zbatimi i punimeve  
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 28.04.2023 dhe kanë përfunduar me datë 26.06.2023, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

- Në dosjen teknike administrohet projekti i azhurnuar dhe korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Pas kërkesë propozimit të Mbikëqyrësit të punimeve me nr. 633/14 prot., datë 26.05.2023, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen/pakësohen prej 3,202,713 / 3,209,895 lekë pa TVSH.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Sistemim Asfaltim rruga Gjuraj – Koplík i Sipërm”, Bashkia Malësi e Madhe				
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 633/10 prot datë 28.04.2023	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 14,115,708 lekë <b>OE fitues L ShPK</b>		<b>16.Likuiduar deri dt</b>	
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> <b>-Vlera me tvsh 14,107,090 lekë</b> <b>-Vlera pa tvsh 11,755,908 lekë</b>	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 60 ditë , Zbatuar 59 ditë. Fillimi punimeve: 28.04.2023 Përfundimi punimeve : 26.06.2023		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Nuk ka	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE “N Studio” SHPK	Licenca Nr: MK 1846/7	Kontrata me nr. 900/17 prot, datë 28.04.2023	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> LShPK	Licenca Nr: MK 0985/7	Kontrata nr. 2175/1 prot, datë 12.09.2023	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
<b>22.Akt Kolaudimi</b> Datë 15.0.2023	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim</b> , datë 15.09.2023		<b>24. Fletë Hyrja</b> Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **186,614 lekë pa tvsh.**

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

1. Z. E.N me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. N me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

*Nga ana e subjektit, përse trajtuar në lidhje me zbatimin e kontratës për këtë objekt, nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

## **5. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve në objektin: “Sistemim Asfaltim rruga Koplík-Stërbeq-Jubicë-Kamicë”, Bashkia Malësi e Madhe.**

### Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 735/10 prot datë 10.07.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. T.M dhe BOE fitues L ShPK & N ShPK, me përfaqësues z. B.L, me licencë profesionale respektivisht NZ 0804/10 dhe NZ 2798/16. Vlera e kontratës është 70,681,782 lekë me tvsh. Financimi është 40,842,716 lekë për vitin 2023, vlera prej 12,000,000 lekë për vitin 2024 dhe vlera prej 17,839,066 në vitin 2025. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 90 ditë nga data e lidhjes së kontratës. Është hartuar Amendament nr. 1, datë 06.10.2023, me shtyrje afati 46 ditë (deri në datën 22.11.2023) dhe Amendament

nr. 2, datë 22.11.2023, me shtyrje afati 26 ditë (deri në datën 18.12.2023, për shkak të ndërprerjes së punimeve dy herë, për shkak të nga motit të papërshtatshëm.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 571/32 prot, datë 10.07.2023, është lidhur kontrata me OE L SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0985/7 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 648,521 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 3470/1 prot, datë 26.12.2023 është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi G L PF, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0913/3.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, në dosje nuk administrohet ndonjë urdhër për ngritjen e grupit të punës. Është hartuar Certifikata e Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., datë 28.12.2023, i nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi, kolaudatori i punimeve, si dhe nga ing. J.N dhe Kryetari i Bashkisë z. T.M për Investitorin.

#### Projektpreventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Deklaratë për kryerje punimesh me nr. 1520/1, datë 27.06.2023. Ky veprim është në mospërputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 11/1, “Punime që duhet t’u kërkohet leja e ndërtimit”, sipas të cilit ky objekt duhet të ishte pajisur me leje ndërtimi infrastrukurore.

Në dosjen e zbatimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike**, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...”.

Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Malësi e Madhe, z. T.M.

- Projekti i zbatimit është hartuar nga BOE “Z& Co” dhe “EStudio” ShPK” në vitin 2022.

#### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 10.07.2023 dhe kanë përfunduar me datë 18.12.2023, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentet.

- Në dosjen teknike administrohet projekti i azhurnuar dhe korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Pas kërkesë propozimit të Mbikëqyrësit të punimeve pa nr. prot., datë 28.06.2023, sipërmarrësi i punimeve L ShPK & N SHPK, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen/pakësohen prej 11,871,880/11,897,475 lekë pa TVSH.

Është miratuar zëri i ri (FV tuba të brinjëzuar HDPE SN8 me d=500 mm), konform manualit të çmimeve në fuqi.

Me shkresën datë 18.07.2023, nga ana e kontraktorit është kërkuar ndërprerje e punimeve për shkak të temperaturave të larta dhe trafikut. Është mbajtur në po këtë datë një procesverbal konstatimi ndërmjet kontraktorit dhe mbikëqyrësit, në të cilën citohet miratimi i mbikëqyrësit për ndërprerjen e punimeve për 45 ditë.

Në datën 01.09.2023, është bërë njoftimi për rifillimin e punimeve.

Me shkresën e datë 31.10.2023, nga ana e kontraktorit është kërkuar ndërprerje e punimeve për shkak të motit me shumë shi dhe trafikut. Është mbajtur në po këtë datë një procesverbal konstatimi ndërmjet kontraktorit dhe mbikëqyrësit, në të cilën citohet miratimi i mbikëqyrësit për ndërprerjen e punimeve për 23 ditë.

Në datën 22.11.2023, është bërë njoftimi për rifillimin e punimeve.

Këto dy ndërprerje punimesh janë formalizuar me amendamentet Nr. 1 dhe nr. 2, duke bërë shtyrjen e punimeve me 68 ditë gjithsej.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

<b>Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Sistemim Asfaltim rruga Koplik-Stërbeq-Jubicë-Kamicë”, Bashkia Malësi e Madhe</b>			
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 735/10 prot datë 10.07.2023	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 70,681,782lekë <b>BOE fitues L ShPK &amp; N ShPK</b>		<b>16.Likuiduar deri dt</b>
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> <b>-Vlera me tvsh 70,651,068 lekë</b> <b>-Vlera pa tvsh 58,875,890 lekë</b>	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 90 ditë , Zbatuar 158 ditë. Fillimi punimeve: 10.07.2023 Perfundimi punimeve : 18.12.2023		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Amendament nr. 1, datë 06.10.2023, me shtyrje afati 45ditë Amendament nr. 2, datë 22.11.2023, me shtyrje afati 23 ditë
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE “L” SHPK	Licenca Nr: MK 0985/7	Kontrata me nr. 571/32 prot, datë 10.07.2023	Likuiduar lekë
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> G L	Licenca Nr: MK 0913/3	Kontrata nr. 3470/1 prot, datë 26.12.2023	Likuiduar (.....lekë)
<b>22.Akt Kolaudimi</b> Datë 28.12.2023	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim,</b> datë 28.12.2023		<b>24. Fletë Hyrja</b> Nr.... datë .....lekë (për mallrat)

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **268,760 lekë pa tvsh.**

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:a***

1. Z. N me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. G.L me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Për këtë objekt është paraqitur observacioni me nr. 1385/65 prot., datë 29.08.2024, protokolluar në KLSH me nr. 701/6, datë 02.09.2024, nga ing. N.P, si administratori dhe drejtuesi teknik i mbikëqyrësit të punimeve L, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

Të hiqet sasia prej 8250 ml e zërit ‘’ Prerje asfalti me frezë ‘’ me vlerë 742,500 lekë si dëm ekonomik.

**Arsyetimi:** Kjo sasi prerje asfalti është parashikuar nga projektuesi, për të realizuar detajin e lidhjes së asfaltit ekzistues me shtresën e asfaltit për zgjerim rruge. Ky zë punë është në shërbim të mbërritjes së cilësisë. Sipërmarrësi e ka kryer edhe me prereje me sharrë me frezë, por edhe me metoda alternative manuale. AK ( investitori ) dhe Konsulenti e kanë pranuar këtë lloj punimi.

**Qëndrimet e Grupit të Auditimit:** Në lidhje me këtë zë pune, Grupi i auditimit, pas verifikimit të fotove të bëra në këtë objekt, merr në konsiderat observacionin dhe do ta reflektojë në tabelën e dëmit ekonomik.

**Pretendimet e subjektit:**

Të reduktohet vlera e dëmit ekonomik për zërin ‘’Strukturë monolite betoni C20/25 (kanal i hapur ) nga 25 m<sup>3</sup> në 15 m<sup>3</sup> dhe respektivisht nga vlera 250,000 lekë si dëm ekonomik, në vlerën 150,000 lekë.

**Qëndrimet e Grupit të Auditimit:** Në lidhje me këtë zë pune, Grupi i auditimit sqaron se nga ana e observuesit, nuk është paraqitur asnjë arsyetim për të plotësuar kërkesën e bërë

prej tij. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

## **6. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve në objektin: “Sistemim Asfaltim rruga Kastrat - Rrapshë”, Bashkia Malësi e Madhe.**

### Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 2658/6 prot datë 21.10.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. T.M dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë L ShPK & S ShPK, me përfaqësues z. B.L, me licencë profesionale NZ 0804/10 dhe me licencë profesionale NZ 1354/20. Vlera e kontratës është 69,096,177.6 lekë me tvsh. Financimi është 31,510,588 lekë për vitin 2022, vlera prej 4,754,000 lekë për vitin 2023 dhe vlera prej 32,831,589.6 në vitin 2024. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 120 ditë nga data e lidhjes së kontratës. Është hartuar Amendament nr. 1, datë 16.02.2023, me shtyrje afati 62 ditë, për shkak të ndërprerjes së punimeve dy herë, për shkak të tanga motit të papërshtatshëm..

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 2736/30 prot, datë 14.10.2022, është lidhur kontrata me OE L SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0985/7 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 752,989 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1675/1 prot, datë 28.07.2023 është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria “N Studio” ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1846/7 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 25,064 lekë me tvsh.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, në dosje nuk administrohet ndonjë urdhër për ngritjen e grupit të punës. Është hartuar Certifikata e Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., datë 01.08.2023, i nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi, kolaudatori i punimeve, si dhe nga ing. J.N dhe Kryetari i Bashkisë z. T.M për Investitorin.

### Projektpreventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Deklaratë për kryerje punimesh me nr. 297, datë 16.02.2023. Ky veprim është në mospërputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 11/1, “Punime që duhet t’u kërkohet leja e ndërtimit”, sipas të cilit ky objekt duhet të ishte pajisur me leje ndërtimi infrastrukture.

Në dosjen e zbatimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike**, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...”.

Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Malësi e Madhe, z. T.M.

- Projekti i zbatimit është hartuar nga shoqëria L & “I” & “Aa” ShPK në vitin 2022.

### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 21.10.2022 dhe kanë përfunduar me datë 19.04.2023, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve.

Me shkresën e protokolluar me nr. 2658/12, datë 03.11.2022, nga ana e kontraktorit është kërkuar ndërprerje e punimeve për shkak të temperaturave të ulëta (nën 0 gradë) deri në përmirësimin e kohës. Është mbajtur në po këtë datë një procesverbal konstatimi ndërmjet kontraktorit dhe mbikëqyrësit, në të cilën citohet miratimi i mbikëqyrësit për ndërprerjen e punimeve për 22 ditë.

Në datën 25.11.2022, është bërë njoftimi për rifillimin e punimeve.

Me shkresën e protokolluar me nr. 2658/16, datë 15.12.2022, nga ana e kontraktorit është kërkuar ndërprerje e punimeve për shkak të temperaturave të ulëta (nën 0 gradë) deri në përmirësimin e kohës. Është mbajtur në po këtë datë një procesverbal konstatimi ndërmjet kontraktorit dhe mbikëqyrësit, në të cilën citohet miratimi i mbikëqyrësit për ndërprerjen e punimeve për 40 ditë.

Në datën 24.01.2023, është bërë njoftimi për rifillimin e punimeve.

- Në dosjen teknike administrohet korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Pas kërkesë propozimit të Mbikëqyrësit të punimeve me nr. 270/4 prot., datë 13.02.2023, sipërmarrësi i punimeve L ShPK & "St" SHPK, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen/pakësohen prej 8,364,170 lekë pa TVSH. Ky ndryshim, që përbën rreth 12% të vlerës totale të objektit të projektuar nga mbikëqyrësi i punimeve, është i paargumentuar teknikisht.

Gjithashtu është bërë në mënyrë të paargumentuar edhe ndryshimi i trashësisë së shtresës së zhavorrit nga 20 cm që është relacionin teknik të projektit në 30 cm në preventiv.

Nga ana e grupit të auditimit është cituar që është kryer realizimi i kësaj shtrese, por nuk është e justifikuar teknikisht (më shumë se 2 herë, 4700 m<sup>2</sup>) shtesa e bërë në projektin e azhurnuar. Nisur edhe nga fotot e aneksit 1 që shoqërojnë observacionin, struktura natyrale e gjurmës së rrugës është shkëmbore dhe sasia e zhavorrit, e llogaritur për tu hedhur në vepër, duhet të ishte vetëm për të siguruar niveletën (siç citohet edhe në Aneksin 2 për piketën 72) dhe hedhja e tij në gjatësinë e paraqitur në librezë, mbi atë të parashikuar në projektin e zbatimit, është përdorim pa efektivitet i fondeve publike në vlerën 2,044,500 lekë pa TVSH.

Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësin e punimeve

Janë miratuar dy zëra të rinj (FV tuba të brinjëzuar HDPE SN8 me d=400 mm dhe d=500 mm), konform manualit të çmimeve në fuqi.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

<b>Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Sistemim Asfaltim rruga Kastrat - Rrapshe", Bashkia Malësi e Madhe</b>				
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 2658/6 prot datë 21.10.2022	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 69,096,177.6 lekë <b>BOE fitues L ShPK &amp; "St" ShPK</b>		<b>16.Likuiduar deri dt</b>	
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> <b>-Vlera me tvsh 69,095,880 lekë</b> <b>-Vlera pa tvsh 57,579,900 lekë</b>	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 120 ditë, Zbatuar 182 ditë. Fillimi punimeve: 21.10.2022 Përfundimi punimeve : 19.04.2023		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Amendament nr. 1, datë 16.02.2023, shtyrje afati 62 ditë.	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE "L" SHPK	Licenca Nr: MK 0985/7	Kontrata me nr. 2736/30 prot, datë14.10.2022	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> "N Studio" ShPK	Licenca Nr: MK 1675/1	Kontrata nr. 1675/1 prot, datë 28.07.2023	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
<b>22.Akt Kolaudimi</b> Datë 01.08.2023	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim, datë</b> 01.08.2023		<b>24. Fletë Hyrja Nr.... datë</b> .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **482,700 lekë pa tvsh.**

Gjithashtu ka përdorim të fondeve pa efektivitet në vlerën prej 2,044,500 lekë pa TVSh, që I përket hedhjes së shtresës së zhavorrit me t=30 cm në një sipërfaqe të panevojshme.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

1. Z. N me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. E.N me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Për këtë objekt është paraqitur observacioni me nr. 1385/65 prot., datë 29.08.2024, protokolluar në KLSH me nr. 701/6, datë 02.09.2024, nga ing. N.P, si administratori dhe drejtuesi teknik i mbikëqyrësit të punimeve L, si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

**1. Zëri kryesor : Gërmim shkëmb mesatar me çekiç,**

(1)Të hiqet sasia prej 436 m<sup>3</sup> e zërit “Gërmim shkëmb mesatar me çekiç”, me vlerë 1,264,400 lekë si dëm ekonomik.

Arsyetimi: Kjo sasi shkëmbi është gërmuar për të krijuar trupin e rrugës me gjerësinë aktuale në të cilën rruga është tashmë në përdorim. Nuk kemi zhvilluar procedurë për ta paguar me një zë të ri punë “Gërmim Shkëmb i fortë “, me çmim me të lartë se çmimi i zërit ” Gërmim shkëmb mesatar me çekiç”, sepse do të tejkalohet vlera e kontratës.

Sqarime për Librezën e masave.

Ne librezën e masave janë pasqyruar 2532 m<sup>3</sup> Gërmim shkëmb mesatar me çekiç ne nje gjatesi prej 1800 ml, ku duhet te mbahet parasysh se germimi I shkembit mesatar me cekic eshte detajuar sipas progresivave ne terren, ku krahi I germimit te shkembit mesatar me cekic ka ndryshuar sipas nevojave per zgjerimin e rruges. Ky ze pune shtrihet ne nje gjatesi prej 2500ml ( nga PK2 deri ne piketen PK97 ) ku gjate gjithë kesaj gjatesie eshte germuar, por ne libreze jane paraqitur vetem 1800ml germime shkembi mesatar me cekic sipas piketave qe korespondojne ne 2532 m3 germim shkembi mesatar me cekic. Pra rreth 700ml nga Pk2 - Pk97 nuk jane situacionuar per shkak te fondit limit te kufizuar, megjithese germimet jane kryer ne gjithe kete segment.

Duhet te mbahet parasysh se trupi I rruges ka pasur nje gjeresi maximale prej 3-3.5m, dhe kudo ka qene e dosmosdoshme germimi I shkembit anesor ne nje gjeresi 1-2m per te arritu nje gjeresi rruge minimale prej 4.5-5m.

Eshte lehtesisht e provueshme ne terren se I gjithë segmenti rrugor nga PK2-Pk199 perbehet nga shkëmb mesatar madje kryesisht I forte.

Germimet jane realizuar ne periudhen e fundit te vitit 2022 dhe fillim te vitit 2023, pra qe nga kjo periudhe deri ne momentit e aktkonstatimit ka kaluar nje periudhe prej 1 viti e gjysem, dhe gjate kesaj periudhe padyshim ka pasur rritje te bimesise dhe dekantime delivionesh, dhe si rrjedhoje germimet nuk jane shume te dallueshme dhe jep pershtypjen se nuk jane kryer ne 350 ml te kesaj gjatesie prej 1800 ml. Kjo gjatesi prej 350 ml qe I zbritet gjatesise se thyerjes se shkembit mesatar prej 1800 ml nga PK2 – PkK7 ne nje gjatesi prej 2500 ml nuk eshte argumentuar me progresiva dhe nuk gjykohet dot nga ana vizuale.

Gjate zbatimit te punimeve dhe nga ankesat e banoreve eshte evidentuar se dalja nga aksi rrugor I objektit : Sistemim Asfaltim rruga Kastrat – Rrapshe ne PK 197- PK 199 perbente nje rrezikshmeri te larte per drejtuesit e mjeteve. Mungesa e shikueshmerise, lakorja e vershtire e daljes ne rruge dhe ngushtesia e madhe e daljes ne rrugen kryesore Hot - Vermosh perbente nje problem te madh per banoret e zones dhe per turistet frekuentues te kesaj zone. Pas kembenguljes se madhe te banoreve dhe Autoritetit Kontraktor Bashkia Malesi e Madhe, sipërmarrësi eshte zotuar te realizoje nje zgjerim rruge me te gjere se ne projekt dhe ne pjesen tjeter te rruges, duke thyer masivin e shkembit ne PK 197-PK199 dhe duke realizuar nje gjeresi rruge prej 6m.Ky zgjerim eshte realizuar duke thyer shkembim me cekic

sic evidentohet ne materialin fotografik dhe eshte realizuar me dy skrapata . Kto punime nuk jane situacionuar per shkak te fondit limit te kufizuar, vetem jane reflektuar sasite e mureve mbajtes dhe shtresave rrugore. Germimet ne kete segment jane realizuar me eskavator me cekic ne nje sasi te konsiderueshme dhe te paparashikuar ne projektin fillesatar dhe ju lutemi te merrni parasysh keto veshtiresi ne punime. Me poshte materiali fotografik per kete segment.

**Qëndrimet e Grupit të Auditimit:** Në lidhje me këtë zë pune, Grupi i auditimit pas shqyrtimit të dokumentacionit shoqërues të observacionit, merr në konsiderat observacionin dhe do ta reflektojë në tabelën e dëmit ekonomik.

**Pretendimet e subjektit: 2. Zëri i punës “Transport dheu I gërmuar me skreper me L=100 metra në trupin e rrugës”.**

Të hiqet sasia prej 1220 m<sup>3</sup> e zërit me analizë 3.160/a ” Transport dheu i gërmuar me skreper , me L=100 metra ...” , i cili korespondon me zërin me analizë 3.125 /a “Gërmim shkëmb i copëtuar me eskavator 1.0 m<sup>3</sup>... “ me vlerë 207 400 lek si dëm ekonomik.

Arsyetimi : Në vitin 2022, Autoriteti Kontraktor (Bashkia Malësi e Madhe ) dhe konsulenti kanë hartuar preventivin e këtij investimi duke pasë si bazë projekt-preventivin e plotë të vitit 2017 ,si dhe duke inspektuar gjatë gjithë gjatësisë së rrugës aluvionet ( gurët dhe dheu ) e grumbulluar në trasenë e rrugës ekzistuese. Në fillim kjo sasi është vlerësuar për 3800 m<sup>3</sup> . Gjatë zbatimit të punimeve kjo sasi rezultoj të jetë më pak dhe është vlerësuar 1220 m<sup>3</sup> . Në preventivin fillestar është konceptuar se këto aluvione gërmohen dhe shkriftohen për tu përshtatur për tu transportuar( lëvizur , shtyrë ) në drejtimin e anës së e poshtme të skarpatës . Këto dy zëra punë janë konceptuar prej fillimit dhe janë bërë pjesë integrale e kontratës. Ne argumentojmë se ka qënë një arsyetim i drejtë konceptimi i kryerjes së këtyre dy zërave pune, dhe gjatë zbatimit bëhet çeshtje mos-marrëveshje me kontraktorin . Në observacionin për A-kons.nr.13 kemi shpjeguar se ky zë pune nuk lidhet me intepretimin e Kapitulli 6 të Specifikimeve teknike për transportin brenda kantjerit.

**Qëndrimet e Grupit të Auditimit:** Pas shqyrtimit të këtij observacioni, grupi i auditimit, ashtu si edhe në Projektraport, sqaron se ka arritur në konkluzionin e cituar në aktkonstatimi, nisur nga Specifikimet Teknike të hartuara nga projektuesi (njëherësh edhe mbikëqyrës) në lidhje me transportin brenda kantierit. Ky zë pune (transporti) nuk mund të pranohet, kur në specifikimet teknike është e shkruar e kundërta. Sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron, nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

**Pretendimet e subjektit: 3. Zëri i punës “Shtresë zhavorr lumi me t=30 cm , me cilindrim ( për profilim )”.**

Të hiqet sasia prej 4700 m<sup>2</sup> e zërit” shtresë zhavorr lumi .. “ me vlerë 2 044 500 lek si dëm ekonomik

Arsyetimi. Ky zë pune në preventivin fillestar ishte parashikuar me 4500 m<sup>2</sup> .Gjatë zbatimit të punimeve ky zë pune është realizuar me sasinë 2760 m<sup>3</sup> ose 9200 m<sup>2</sup> . Krijimi i trupit të rrugës duke kaluar në zona suargjilore ( përcaktuar edhe në relacionin gjeologjik), e ka të domosdoshme përdorimin e shtresavë të zhavorrit për të garantuar jetë-gjatësinë dhe qendrueshmërinë e paketës së rrugës. Krijimi i trupit të rrugës duke hequr ( kursyer) një pjesë të mureve të parashikuar në projektin fillestar ka bërë që të jetë i domosdoshëm përdorimi i shtresës së zhavorrit. **Falenderojmë grupin e audituesve që kanë marrë në konsideratë observacionin përse lidhet me këtë zë punë.**

**Qëndrimet e Grupit të Auditimit:** Grupi I auditimit vëren se kjo pikë e observacionit nuk është e qartë, pasi edhe kërkon heqjen e dëmit ekonomik, edhe falenderon grupin e auditimit për marrjen në konsideratë të observacionit në fazën e Projektraportit të Auditimit. Gjithashtu sqarojmë se ky zë pune, edhe pse është kryer, është trajtuar nga grupi I auditimit,

si përdorim pa efektivitet I fondeve publike, pasi është realizuar një shtresë mbi një strukturë shkëmbore .

**Pretendimet e subjektit: 4. Zëri I punës: “Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës”.**

Të hiqet sasia prej 200 m<sup>3</sup> e zërit” Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës .. “ me vlerë 120,000 lek si dëm ekonomik.

Arsyetimi. Ky zë punë në preventivin fillestar ishte parashikuar me 600 m<sup>3</sup>. Gjatë zbatimit të punimeve ky zë punë është realizuar me sasinë 200 m<sup>3</sup>.

**Oëndrimet e Grupit të Auditimit:** Për këtë zë pune, nga ana e observuesit nuk janë sjellë detaje dhe volume sipas dimensioneve, apo ndonje dokument tjetër, që të justifikojnë edhe mungesën e librit të masave për këtë zë pune. Sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron, nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Gjithashtu, në observacion është bërë edhe një analizë për realizimin “sfida” të këtij objekti, i cili nuk ka lidhje direkte me sa është trajtuar nga grupi i auditimit në Aktkonstatimin nr. 13 dhe në Projektraportin e Auditimit.

**7. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve në objektin: “Sistemim Asfaltim rruga Sterkuje”, Bashkia Malësi e Madhe.**

**Kontratat**

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 983/8 prot datë 29.06.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. T.M dhe Operatorit Ekonomik C Sh P K, me përfaqësues z. F, me licencë profesionale NZ 0.....2. Vlera e kontratës është 18,039,216 lekë me tvsh. Financimi është 4,221,799 lekë për vitin 2023, vlera prej 5,917,417 lekë për vitin 2024 dhe vlera prej 7,900,000 në vitin 2025. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 60 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1344/1 prot, datë 29.06.2023, është lidhur kontrata me OE LSHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0985/7.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 2844/1 prot, datë 10.11.2023 është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria “B” ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2205/5.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, në dosje nuk administrohet ndonjë urdhër për ngritjen e grupit të punës. Është hartuar Certifikata e Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., datë 13.11.2023, i nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi, kolaudatori i punimeve, si dhe nga ing. J.N dhe Kryetari i Bashkisë z. T.M për Investitorin

**Projektpreventivi**

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Deklaratë për kryerje punimesh me nr. 1522/1, datë 27.06.2023. Ky veprim është në mospërputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 11/1, “Punime që duhet t’u kërkohet leja e ndërtimit”, sipas të cilit ky objekt duhet të ishte pajisur me leje ndërtimi infrastrukture.

Në dosjen e zbatimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet**

**publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...”

Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Malësi e Madhe, z. T.M.

- Projekti i zbatimit është hartuar nga BOE “L” dhe “Invictus” në vitin 2023.

#### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 14.07.2023 dhe kanë përfunduar me datë 11.09.2023, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

- Në dosjen teknike administrohet projekti i azhurnuar dhe korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Pas kërkesë propozimit të Mbikëqyrësit të punimeve me nr. 270/4 prot., datë 13.02.2023, sipërmarrësi i punimeve C SHPK, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen/pakësohen prej 156,200/160,580 lekë pa TVSH.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

<b>Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Sistemim Asfaltim rruga Sterkuje”, Bashkia Malësi e Madhe</b>				
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 2658/6 prot datë 21.10.2023	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 18,039,216 lekë <b>BOE fitues L ShPK &amp; “St” ShPK</b>		<b>16.Likuiduar deri dt</b>	
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> -Vlera me tvsh 18,033,960 lekë -Vlera pa tvsh 15,028,300 lekë	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 600 ditë , Zbatuar 59 ditë. Fillimi punimeve: 14.07.2023 Përfundimi punimeve : 11.09.2023		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Nuk ka	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE “L” SHPK	Licenca Nr: MK 0985/7	Kontrata me 1344/1 prot, datë 29.06.2023	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> “B” ShPK	Licenca Nr: MK 2205/5	Kontrata nr. 2844/1 prot, datë 10.11.2023	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
<b>22.Akt Kolaudimi</b> Datë 13.11.2023	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim,</b> datë 13.11.2023		<b>24. Fletë Hyrja</b> Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, nuk rezultuan diferenca në volume apo punime të kryera në mospërputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

*Nga ana e subjektit, përsa trajtuar në lidhje me zbatimin e kontratës për këtë objekt, nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

## **8. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve në objektin: “Sistemim Asfaltim rruga Linaj Kurte”, Bashkia Malësi e Madhe.**

### Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 2659/6 prot datë 14.10.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe, të përfaqësuar nga

Kryetari i Bashkisë z. T.M dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “A & “K ShPK, me përfaqësues respektiv z. E.R, me licencë profesionale NZ 0404/10, datë 03.02.2020 dhe z. H.s me licencë profesionale NZ. 0485/23, datë 06.12.2018. Vlera e kontratës është 30,480,000 lekë me Tvsh. Financimi është 16,000,000 lekë për vitin 2022, vlera prej 2,000,000 lekë për vitin 2023 dhe vlera prej 12,480,000 në vitin 2024. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 80 ditë nga data e lidhjes së kontratës. Është hartuar Amendament nr. 1, me nr. 2659/11 prot., datë 30.12.2023, me shtyrje afati 36 ditë (nga data 01.01.2023, për shkak të ndërprerjes së punimeve dy herë, për shkak të motit të papërshtatshëm dhe lirimit të sheshit të ndërtimit.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 2736/18 prot., datë 14.10.2022, është lidhur kontrata me OE L Shpk, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. MK 0985/7, datë 18.06.2021, dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 411,346.2 lekë me Tvsh. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1676/1 prot, datë 28.07.2023 është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria “N Studio” ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1846/7, datë 31.12.2019 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 21,332.40 lekë me Tvsh.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, më datë 29.09.2023, nga përbërje ing. J.N, në prani të mbikëqyrësit të punimeve, kolaudatorit të punimeve dhe drejtuesit teknik të kontraktorit.

#### Projektpreventivi

- Projekti i zbatimit është hartuar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik L Shpk “A” Shpk “& “I” Shpk në vitin 2022. Në dosje administrohet projekti i zbatimit i panëshkruar nga titullari i Bashkisë Malësi e Madhe, në bazë të të cilit është shqyrtuar edhe kërkesa për leje ndërtimi.

#### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 14.10.2022 dhe kanë përfunduar me datë 07.04.2023, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve.

Me shkresën e hartuar nga mbikëqyrësi i punimeve me nr. 3571/1 prot., datë 04.11.2022 është kërkuar ndërprerje e punimeve për shkak të kushteve atmosferike dhe lirimit të sheshit të ndërtimit. Është mbajtur në po këtë datë një procesverbal konstatimi ndërmjet kontraktorit dhe mbikëqyrësit, në të cilën citohet miratimi i mbikëqyrësit për ndërprerjen e punimeve.

Me nr. 3571/2 prot., datën 01.12.2022, është bërë njoftimi për rifillimin e punimeve.

Me shkresën nr 3571/3 prot., datë 22.12.2022 të mbikëqyrësit të punimeve, është kërkuar ndërprerje e punimeve për shkak të lirimit të sheshit të ndërtimit (pengesës nga banorët). Është mbajtur në po këtë datë një procesverbal konstatimi ndërmjet kontraktorit dhe mbikëqyrësit, në të cilën citohet miratimi i mbikëqyrësit për ndërprerjen e punimeve.

Në datën 02.03.2023, është bërë njoftimi për rifillimin e punimeve.

- Në dosjen teknike administrohet projekti i azhurnuar dhe korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Pas kërkesë propozimit të mbikëqyrësit të punimeve me nr. 3571/5 prot., datë 15.03.2023, sipërmarrësi i punimeve “A & “K” Shpk, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen/pakësohen prej 2,975,118 lekë pa Tvsh.

Punime që shtohen

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

<b>b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Sistemim Asfaltim rruga Linaj Kurte”, Bashkia Malësi e Madhe</b>				
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 2659/6 prot datë 14.10.2022	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 30,480,000 lekë BOE fitues “A & “Karl G” Shpk		<b>16.Likuiduar deri dt</b>	
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> <b>-Vlera me tvsh 30,475,752 lekë</b> <b>-Vlera pa tvsh 57,579,900 lekë</b>	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 80 ditë , Zbatuar 80 ditë. Fillimi punimeve: 14.10.2022 Përfundimi punimeve : 07.04.2023		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Amendament nr. 1, me nr. 2659/11 prot., datë 30.12.2023, shtyrje afati 36 ditë.	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE “L” SHPK	Licenca Nr: MK 0985/7	Kontrata me nr. 2736/18 Prot., datë 14.10.2022	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> “N Studio” ShPK	Licenca Nr: MK 1846/7	Kontrata nr. 1675/1 prot, datë 28.07.2023	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
<b>22.Akt Kolaudimi</b> Datë 01.08.2023	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim</b> , datë 21.09.2023		<b>24. Fletë Hyrja</b> Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **784,000 lekë pa tvsh.**

Tabela nr. 1

	Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
								Vol.	Vlera
1	8	Shtresë stabilizanti t=5cm bankinë	m <sup>2</sup>	280	3200	2900	0	3200	784,000
<b>Total</b>									<b>784,000</b>

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

## **II- Punime gjërmimi**

**1. Zëri 8 Shtresë stabilizanti t=5cm bankinë.** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 3200 m<sup>2</sup>. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 3,200 m<sup>2</sup>. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 2900 m<sup>2</sup> (sasia dhënë në situacion 2800 m<sup>2</sup> sipas librezës së masave), i detajuar sipas seksioneve të rrugës së gjërmuar nga piketa 3+985 deri në piketën 6+085. Nga verifikimi i realizimit të zërit shtresë stabilizanti në bankinë në objekt u konstatua që ky zë pune nuk është realizuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 784,000 lekë pa Tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

1. Z. N me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. E.N me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Për procedurën e zbatimit të punimeve me objekt: “Sistemim Asfaltim rruga Linaj Kurte”, nga Bashkia Malësi e Madhe, është paraqitur observacioni me nr. 1385/65 prot., datë 29.08.2024, e nr. 701/6 prot., datë 02.09.2024 në KLSH, nga ing. N.P, si administratori dhe drejtuesi teknik i mbikëqyrësit të punimeve L, si më poshtë:

**Prendimet e subjektit:** Kjo sasi shtresë stabilizanti është kryer në fakt, gjatë zbatimit të punimeve. Është pasqyruar në Librezën e Masave. Është dokumentuar me proces-verbal si zë punë edhe lloji i materialit. Është miratuar situacioni për këtë zë punë nga investitori,

Bashkia Malësi e Madhe. Nëse ky zë punë vlerësohet i dëmtuar, jemi në periudhën e garancisë së difekteve dhe mund të riparohet.

Përfundimisht, pas argumentave për gjetjen e audituesve në observacionin e derguar me datë 29 Korrik, dhe pas kësaj **përgjigje** me arsyetime plotësuese kërkojmë që në projekt-raport të mos përkruhet dëmi ekonomik për këtë kontratë.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit dhe dokumentacionit shoqërues, merr në konsideratë këtë observacion, me kushtin që Bashkia Malësi e Madhe, të detyrojë sipërmarrësin dhe të ndjekë punimet për riparimin e bankinave me materialin e parashikuar në projektpreventiv. **Për sa më sipër grupi auditimit do të reflektojë dëmin ekonomik në hartimin e Raportit Përfundimtar i Auditimit.**

## **9. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve në objektin: “Ndërtim i impjantit të ngrohjes në shkollat e Mesme Koplík- Bajzë - Gruemirë”, Bashkia Malësi e Madhe.**

### Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 2411/6 prot., datë 05.10.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. T.M dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë M& ‘E’ ShPK, me përfaqësues respektiv z. V.M, me licencë profesionale NZ. 5373/3, datë 06.06.2019 dhe z. S.Cme licencë profesionale NZ. 2657/17, datë 07.07.2022. Vlera e kontratës është 38,884,235 lekë me Tvsh. Financimi është 15,299,55 lekë për vitin 2022, vlera prej 2,000,000 lekë për vitin 2023 dhe vlera prej 21,584,683.8 në vitin 2024. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 60 ditë nga data e lidhjes së kontratës. Është hartuar Amendament nr. 1, datë 16.02.2023, me shtyrje afati 62 ditë, për shkak të ndërprerjes së punimeve dy herë, për shkak të nga motit të papërshtatshëm..

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 2157/21 prot., datë 05.10.2022, është lidhur kontrata me OE “N S” ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1846/7, datë 31.12.2019 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 487,437.6 lekë me Tvsh. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1675/1 prot, datë 28.07.2023 është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi OE “A” ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1997/4, datë 30.01.2023 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 25,064 lekë me tvsh.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, në zbatim të Urdhrit të TAK me nr. 753/2 prot., datë 28.03.2023, nga grupi i punës me përbërje ing. Sh Gj, administratori i NjA Kryeviidh, topograf K.B dhe arkitekthe M.T, është hartuar Akti i Marrjes së Përkohshme në dorëzim me nr. 753/3 prot., datë 11.04.2023.

### Projektpreventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Deklaratë për kryerje punimesh me nr. 297, datë 16.02.2023. Ky veprim është në mospërputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 11/1, “Punime që duhet t’u kërkohej leja e ndërtimit”, sipas të cilit ky objekt duhet të ishte pajisur me leje ndërtimi infrastrukture.

Në dosjen e zbatimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...**”.

Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Malësi e Madhe, z. T.M.

- Projekti i zbatimit është hartuar nga OE “N S” në vitin 2022 (M.T Ing. Ndërtimi; K.N Ing. Hidroteknik; A.B Ing. Gjeolog; N.D Ing. Mekanik; M.Sh Ing Elektrik. Në dosje administrohet projekti i zbatimit i panënskruar nga titullari i Bashkisë Malësi e Madhe, në bazë të të cilit është shqyrtuar edhe kërkesa për leje ndërtimi.

### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 05.10.2022 dhe kanë përfunduar me datë 27.04.2023, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve.

Me shkresën nr. 2411/11, datë 21.10.2022, nga ana e mbikëqyrësit të punimev është kërkuar ndërprerje e punimeve për shkak të zhvillimit të procesit mësimor në ambientet e shkollës. Është mbajtur në po këtë datë një procesverbal konstatimi ndërmjet kontraktorit dhe mbikëqyrësit, në të cilën citohet miratimi i mbikëqyrësit për ndërprerjen e punimeve për 22 ditë.

Me shkresën nr. 2411/14 prot., datë 16.03.2023, është bërë njoftimi për rifillimin e punimeve. Është mbajtur në po këtë datë një procesverbal konstatimi ndërmjet kontraktorit dhe mbikëqyrësit, në të cilën citohet miratimi i mbikëqyrësit për rifillimin e punimeve.

Nga auditimi i preventivit të punimeve konstatohet që vlera e pajisjeve është llogaritur me TVSH, në kundërshtim me Udhëzimin nr.1, datë 16.6.2011, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e koston së punimeve të ndërtimit.

Vlera 13,725,000 lekë e pajisjeve për sistemin e ngrohjes (për të tre shkollat) nuk duhej të llogaritej me TVSH. Sa më sipër është shtuar vlera e fondit limit në shumën 2,453,543.4 lekë. Vlera 2,453,543.4 lekë, përbën dëm ekonomik për Bashkinë Malësia e Madhe, shkaktuar nga përllogaritja e pajisjeve me TVSH, nga projektuesi OE “N S” Shpk..

- Në dosjen teknike Projekti i azhonuar dhe praktika për zërat e rinj dhe korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Pas kërkesë propozimit të mbikëqyrësit të punimeve me nr. Extra prot., datë 21.03.2023, sipërmarrësi i punimeve M.E, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen/pakësohen prej 8,364,170 lekë pa TVSH.

Janë miratuar 3 (tre) zëra të rinj, konform manualit të çmimeve në fuqi.

F.V Tubo çeliku i zi pategel (Mannesmann,ose ekuivalente me të) Ø 1/2"

F.V Tubo çeliku i zi pategel (Mannesmann,ose ekuivalente me të) Ø 1"

F.V Tubo çeliku i zi pategel (Mannesmann,ose ekuivalente me të) Ø 3/4"

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

<b>b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Ndërtim i impjantit të ngrohjes në shkollat e Mesme Koplík- Bajzë - Gruemirë”, Bashkia Malësi e Madhe</b>		
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 2411/6 prot., datë 05.10.2023	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 38,884,235 lekë <b>BOE fitues M&amp; E. Shpk</b>	<b>16.Likuiduar deri dt</b>
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> -Vlera me tvsh 39,884,285 lekë -Vlera pa tvsh 57,579,900 lekë	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 60 ditë , Zbatuar 182 ditë. Fillimi punimeve: 05.10.2023 Përfundimi punimeve : 27.04.2023	<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Amendament nr. 1, datë 16.02.2023, shtyrje afati 62 ditë.

<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE "N S" ShPK	Licenca Nr: MK. 1846/7	Kontrata nr. 2157/21 prot, datë 05.10.2022	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> OE "A" SHPK	Licenca Nr: MK 1997/4	Kontrata me pa nr. prot, pa datë	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
<b>22.Akt Kolaudimi</b> Datë 04.08.2023	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim, datë</b> 04.08.2023		<b>24. Fletë Hyrja Nr.... datë</b> .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **3,866,772 lekë pa Tvsh.**

Tabela nr. 1

Nr	Zëri i punimeve	Njësi	Çmimi ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri masave	Fakt i	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
<b>I</b>	<b>SHKOLLA E MESME KOPLIK</b>							
<b>C</b>	<b>SISTEMI I NGROHJES</b>							
<b>1</b>	<b>Rrjeti shpërndares tubacioneve të zeza çelikut</b>							
5	F.V Armafleks për tubo çeliku pategel Ø 2" x 13 mm, i veshur me fletë PVC-je	ml	280	24				6,720
6	F.V Armafleks për tubo çeliku pategel Ø 1½" x 13 mm, i veshur me fletë PVC-je	ml	240	78				18,720
7	F.V Armafleks për tubo çeliku pategel Ø 1¼" x 13 mm, i veshur me fletë PVC-je	ml	180	56				10,080
8	F.V Armafleks për tubo çeliku pategel Ø 1" x 9 mm, i veshur me flete PVC-je	ml	160	28				4,480
<b>2</b>	<b>Ambienti teknik për prodhimin e ujit të ngrohtë</b>							
2	F.V Kanal i tymrave me llamarinë çeliku , me shtresë izoluese 250/350 mm .	kg	310					40,300
								<b>69,772</b>
	<b>FURNIZIM DHE VENDOSJE PAISJE PËR SISTEMIN E NGROHJES</b>							
	<b>Radiatorët</b>							
1	F.V Element radiator alumin, kapaciteti në ngrohje për çdo element 146Ë (ose në përputhje me të dhënat e prodhuesit), interaksi 600 mm, ΔT=50 °C. (61 radiatorë të kompletuar sipas projektit) F.V Element radiator alumin, kapaciteti në ngrohje për çdo element 146Ë (ose në përputhje me të dhënat e prodhuesit), interaksi 600 mm, ΔT=50 °C. (61 radiatorë të kompletuar sipas projektit)	copë	1,300	1220	1220	720	500	<b>650,000</b>
	<b>Pompat, enë zgjerimi, ndarës hidraulik</b>							
2	Pompë qarkullimi binjake për terminalet ngrohëse të katit dytë (Inverter). - prurja 4.0 m <sup>3</sup> /h; - prevalenca 120 kPa; - lidhjet DN 32, Pn 10; - fuqia elektrike 2x0.55kË, rryma 2x2.3A; - ushqimi 1F/230V/50Hz.	copë	180,000	1	1	1		<b>150,000</b>
3	Pompë qarkullimi binjake për terminalet ngrohëse të katitpare (Inverter). - prurja 4.0 m <sup>3</sup> /h; - prevalenca 90 kPa; - lidhjet DN 32, Pn 10; - fuqia elektrike 2x0.55kË, rryma 2x2.3A; - ushqimi 1F/230V/50Hz	copë	175,000	1	1	1		150,000
4	Pompë qarkullimi binjake për terminalet ngrohëse të katit përdhe (Inverter). - prurja 4.0 m <sup>3</sup> /h; - prevalenca 60 kPa; - lidhjet DN 32, Pn 10; - fuqia elektrike 2x0.55kË, rryma 2x2.3A; - ushqimi 1F/230V/50Hz	copë	170,000	1	1	1		150,000
5	F.V Pompë antikondense - prurja 2.0 m <sup>3</sup> /h; - prevalenca 20 kPa; - lidhjet DN 32, Pn 10; -	kompl	30,000	2	2	1	1	30,000

	fuqia elektrike 2x0.55kË, rryma 2x2.3A; - ushqimi 1F/230V/50Hz							
6	F.V Ena e zgjerimit të kaldajës është: - Kapaciteti: 80 litra; - Dimensionet: 400 mm; - Lartësia: 820 mm; - Presioni maksimal: 6 bar; - Temperatura e sistemit: -10°C deri në +90°C; - Lidhja: Ø	copë	33,000	2	2	1	1	33,000
								<b>513,000</b>
								<b>1,232,772</b>
II	<b>SHKOLLA E MESME BAJZE</b>							
C	<b>SISTEMI I NGROHJES</b>							
1	<b>Rrjeti shpërndares tubacioneve të zeza çelikut</b>							
5	F.V Armafleks për tubo çeliku pategel Ø 2" x 13 mm, i veshur me fletë PVC-je	ml	280	60	60	0	60	16,800
6	F.V Armafleks për tubo çeliku pategel Ø 1½" x 13 mm, i veshur me fletë PVC-je	ml	240	42	42	0	42	10,080
7	F.V Armafleks për tubo çeliku pategel Ø 1¼" x 13 mm, i veshur me fletë PVC-je	ml	180	18	18	0	18	3,240
								<b>30,120</b>
2	<b>Ambienti teknik për prodhimin e ujit të ngrohtë</b>							
2	F.V Kanal i tymrave me llamarinë çeliku , me shtresë izioluese 250/350 mm .	kg	310	130	130	0	130	<b>40,300</b>
	<b>FURNIZIM DHE VENDOSJE PAISJE PËR SISTEMIN E NGROHJES</b>							
	<b>Radiatorët</b>							
1	F.V Element radiatorit alumin, kapaciteti në ngrohje për cdo element 106Ë (125Ë) (ose në përputhje me te dhënat e prodhuesit), interaksi 500 (600) mm, ΔT=50 °C. (48 radiatorë të kompletuar sipas projektit)	copë	1,300	960	960	480	480	<b>624,000</b>
	<b>Pompat, enë zgjerimi, ndarës hidraulik</b>							
2	F.V.Pompë qarkullimi binjake për terminalet ngrohëse të objektivit (Inverter). - prurja 10.0 m³/h; - prevalenca 90 kPa; - lidhjet DN 32, Pn 10; - fuqia elektrike 2x0.55kË, rryma 2x2.3A; - ushqimi 1F/230V/50Hz.	copë	1750,000	1			1	150,000
	F.V Pompë antikondense - prurja 2.0 m³/h; - prevalenca 60 kPa; - lidhjet DN 32, Pn 10; - fuqia elektrike 2x0.55kË, rryma 2x2.3A; - ushqimi 1F/230V/50Hz	copë	34,000	2	2	1	1	34,000
	F.V Ena e zgjerimit të kaldajës është: - Kapaciteti: 80 litra; - Dimensionet: 400 mm; - Lartësia: 820 mm; - Presioni maksimal: 6 bar; - Temperatura e sistemit: -10°C deri në +90°C; - Lidhja: Ø	kompl	33,000	2	2	1	1	33,000
								<b>217,000</b>
								<b>911,420</b>
	<b>SHKOLLA E MESME GRUEMIRË</b>							
	<b>SISTEMI I NGROHJES</b>							
	<b>Rrjeti shpërndares tubacioneve të zeza çelikut</b>							
5	F.V Armafleks për tubo çeliku pategel Ø 2" x 13 mm, i veshur me fletë PVC-je	ml	280	52	52	0	52	14,560
6	F.V Armafleks për tubo çeliku pategel Ø 1½" x 13 mm, i veshur me fletë PVC-je	ml	240	100	100	0	100	24,000
7	F.V Armafleks për tubo çeliku pategel Ø 1¼" x 13 mm, i veshur me fletë PVC-je	ml	180	104	104	0	104	18,720
								<b>57,280</b>
2	<b>Ambienti teknik për prodhimin e ujit të ngrohtë</b>							
2	F.V Kanal i tymrave me llamarinë çeliku , me shtresë izioluese 250/350 mm .	kg	310	130	130	0	130	<b>40,300</b>
	<b>FURNIZIM DHE VENDOSJE PAISJE PËR SISTEMIN E NGROHJES</b>							
	<b>Radiatorët</b>							

	F.V Element radiatori alumin, kapaciteti në ngrohje për çdo element 146Ë (ose në përputhje me të dhënat e prodhuesit), interaksi 500(600;700) mm, ΔT=50 °C. (86 radiatore te kompletuar sipas projektit)	copë	1,300	1,680	1,680	860	820	1,066,000
<b>Pompat, enë zgjerimi, ndarës hidraulik</b>								
3	Pompë qarkullimi binjake për terminalet ngrohëse të katit dytë (Inverter). - prurja 5.3 m <sup>3</sup> /h; - prevalenca 120 kPa; - lidhjet DN 32, Pn 10; - fuqia elektrike 2x0.55kË, rryma 2x2.3A; - ushqimi 1F/230V/50Hz.	copë	180,000	1	1	1		<b>150,000</b>
	Pompë qarkullimi binjake për terminalet ngrohëse të katit parë (Inverter). - prurja 5.3 m <sup>3</sup> /h; - prevalenca 90 kPa; - lidhjet DN 32, Pn 10; - fuqia elektrike 2x0.55kË, rryma 2x2.3A; - ushqimi 1F/230V/50Hz.	copë	175,000	1	1	1		150,000
	Pompë qarkullimi binjake për terminalet ngrohëse të katit perdhe (Inverter). - prurja 5.3 m <sup>3</sup> /h; - prevalenca 60 kPa; - lidhjet DN 32, Pn 10; - fuqia elektrike 2x0.55kË, rryma 2x2.3A; - ushqimi 1F/230V/50Hz	copë	170,000	1	1	1		150,000
	F.V Pompë antikondense - prurja 2.0 m <sup>3</sup> /h; - prevalenca 60 kPa; - lidhjet DN 32, Pn 10; - fuqia elektrike 2x0.55kË, rryma 2x2.3A; - ushqimi 1F/230V/50Hz	kompl	34,000	2	2	1	1	34,000
	F.V Ena e zgjerimit të kaldajës është: - Kapaciteti: 100 litra; - Dimensionet: 400 mm; - Lartësia: 820 mm; - Presioni maksimal: 6 bar; - Temperatura e sistemit: -10°C deri në +90°C; - Lidhja: Ø	copë	35,000	2	2	1	1	35,000
								<b>519,000</b>
								<b>1,642,280</b>
							<b>Total</b>	<b>3,826,772</b>

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

## OBJEKTI I: SHKOLLA E MESME KOPLIK

### C. SISTEMI I NGROHJES

#### Zëri 1. "Rrjeti shpërndarës tubacioneve të zeza çelikut"

**Nënzëri 4 "F.V Armafleks për tubo çeliku pategel Ø 2" x 13 mm, i veshur me fletë PVC-je".** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 24ml. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 24ml. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 24ml, i detajuar sipas tubacioneve (që në objekt janë zing). Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se tubacionet e vendosura nuk kanë të mbivendosur armafleks. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Nënzëri 5 "F.V Armafleks për tubo çeliku pategel Ø 1½" x 13 mm, i veshur me fletë PVC-je".** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 78ml. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 78ml. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 78ml, i detajuar sipas tubacioneve (që në objekt janë zing). Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se tubacionet e vendosura nuk kanë të mbivendosur armafleks. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Nënzëri 6 "F.V Armafleks për tubo çeliku pategel Ø 1¼" x 13 mm, i veshur me fletë PVC-je".** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 152ml. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 56ml. Në librin e masave volumi i

këtij zëri pune është 56ml, i detajuar sipas tubacioneve (që në objekt janë zing). Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se tubacionet e vendosura nuk kanë të mbivendosur armafleks. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Nënzëri 7 “F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø 1” x 9 mm, i veshur me flete PVC-je”.** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 158ml. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 24ml. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 26ml, i detajuar sipas tubacioneve (që në objekt janë zing). Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se tubacionet e vendosura nuk kanë të mbivendosur armafleks. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

## **2. Ambienti teknik për prodhimin e ujit të ngrohtë**

**Nënzëri 2 “F.V Kanal i tymrave me llamarinë çeliku , me shtresë izioluese 250/350 mm”.**

Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 130kg. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 130kg. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 130kg, i detajuar në vazhdim të pjesës inoks të oxhakut. Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se në objekt nuk është vendosura ky element. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Zëri 3 “Furnizim dhe vendosje paisje për sistemin e ngrohjes” - “Radiatorët”**

**Nënzëri 1“F.V Element radiatori alumin, kapaciteti në ngrohje për çdo element 146W (ose në përputhje me të dhënat e prodhuesit), interaksi 600 mm,  $\Delta T=50$  °C. (61 radiatorë të kompletuar sipas projektit)”** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 850copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 1200copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1200, i detajuar në ambientet e shkollës. Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se në objekt janë vendosur 72 radiatorë me nga 10 elementë. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Zëri 3 “Furnizim dhe vendosje paisje për sistemin e ngrohjes” - “Pompat, enë zgjerimi, ndarës hidraulik”**

**Nënzëri 2 “Pompë qarkullimi binjake për терминаlet ngrohëse të katit dytë (Inverter). – prurja 4.0 m<sup>3</sup>/h; - prevalenca 120 kPa; - lidhjet DN 32, Pn 10; - fuqia elektrike 2x0.55kW, rryma 2x2.3A; - ushqimi 1F/230V/50Hz”.** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 1 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 1 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1copë, i instaluar në dhomën teknike. Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se në objekt është vendosur pompë qarkullimi vlera maksimale e të cilës përlllogaritet 30,000 lekë. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Nënzëri 3 “Pompë qarkullimi binjake për терминаlet ngrohëse të katitpare (Inverter). - prurja4.0 m<sup>3</sup>/h; - prevalenca90 kPa; - lidhjet DN 32, Pn 10; - fuqia elektrike 2x0.55kW, rryma 2x2.3A; - ushqimi 1F/230V/50Hz”.** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 1 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 1 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1copë, i instaluar në dhomën teknike. Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se në objekt është vendosur pompë qarkullimi vlera maksimale e të cilës përlllogaritet 25,000 lekë. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Nënzëri 4 “Pompë qarkullimi binjake për terminalët ngrohëse të katit përdhe (Inverter). - prurja 4.0 m<sup>3</sup>/h; - prevalenca 60 kPa; - lidhjet DN 32, Pn 10; - fuqia elektrike 2x0.55kË, rryma 2x2.3A; - ushqimi 1F/230V/50Hz”.** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 1 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 1 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1 copë, i instaluar në dhomën teknike. Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se në objekt është vendosur pompë qarkullimi vlera maksimale e të cilës përlogaritet 20,000 lekë. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Nënzëri 5 “F.V Pompë antikondense - prurja 2.0 m<sup>3</sup>/h; - prevalenca 20 kPa; - lidhjet DN 32, Pn 10; - fuqia elektrike 2x0.55kW, rryma 2x2.3A; - ushqimi 1F/230V/50Hz”.** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 2 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 2 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1 copë, i instaluar në dhomën teknike. Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se në objekt është vendosur vetëm 1 pompë. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Nënzëri 6 “F.V Ena e zgjerimit të kaldajës është: - Kapaciteti: 80 litra; - Dimensionet: 400 mm; - Lartësia: 820 mm; - Presioni maksimal: 6 bar; - Temperatura e sistemit: -10°C deri në +90°C; - Lidhja: Ø”** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 2 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 2 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 2 copë, i instaluar në dhomën teknike. Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se në objekt është vendosur vetëm 1 copë enë zgjerimi. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

## **OBJEKTI I: SHKOLLA E MESME BAJZË**

### **C. SISTEMI I NGROHJES**

#### **Zëri 1. “Rrjeti shpërndarës tubacioneve të zeza çelikut”**

**Nënzëri 5 “F.V Armafleks për tubo çeliku pategel Ø 2" x 13 mm, i veshur me fletë PVC-je”.** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 60ml. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 60ml. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 60ml, i detajuar sipas tubacioneve (që në objekt janë zing dhe pvc). Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se tubacionet e vendosura nuk kanë të mbivendosur armafleks. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Nënzëri 6 “F.V Armafleks për tubo çeliku pategel Ø 1½" x 13 mm, i veshur me fletë PVC-je”.** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 42ml. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 42ml. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 42ml, i detajuar sipas tubacioneve (që në objekt janë zing dhe pvc). Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se tubacionet e vendosura nuk kanë të mbivendosur armafleks. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Nënzëri 7 “F.V Armafleks për tubo çeliku pategel Ø 1¼" x 13 mm, i veshur me fletë PVC-je”.** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 18ml. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 18ml. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 18ml, i detajuar sipas tubacioneve (që në objekt janë zing dhe pvc). Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se tubacionet e vendosura nuk kanë të mbivendosur armafleks. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

#### **2. Ambienti teknik për prodhimin e ujit të ngrohtë**

**Nënzëri 2 “F.V Kanal i tymrave me llamarinë çeliku , me shtresë izioluese 250/350 mm”.** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 130kg. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 130kg. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 130kg, i detajuar në vazhdim të pjesës inoks të oxhakut. Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se në objekt nuk është vendosura ky element. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Zëri 3 “Furnizim dhe vendosje paisje për sistemin e ngrohjes” - “Radiatorët”**

**Nënzëri 1“F.V Element radiatori alumin, kapaciteti në ngrohje për çdo element 146w (ose në përputhje me të dhënat e prodhuesit), interaksi 600 mm,  $\Delta T=50$  °C. (61 radiatorë të kompletuar sipas projektit)”** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 720copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 960copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 960, i detajuar në ambientet e shkollës. Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se në objekt janë vendosur 48 radiatorë me nga 10 elementë. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Nënzëri 2 “Pompë qarkullimi binjake për termialet ngrohëse të katitpare (Inverter). - prurja 4.0 m<sup>3</sup>/h; - prevalenca 90 kPa; - lidhjet DN 32, Pn 10; - fuqia elektrike 2x0.55kw, rryma 2x2.3A; - ushqimi 1F/230V/50Hz”.** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 1 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 1 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1copë, i instaluar në dhomën teknike. Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se në objekt është vendosur pompë qarkullimi vlera maksimale e të cilës përlllogaritet 25,000 lekë. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Nënzëri 5 “F.V Pompë antikondense - prurja 2.0 m<sup>3</sup>/h; - prevalenca 20 kPa; - lidhjet DN 32, Pn 10; - fuqia elektrike 2x0.55kw, rryma 2x2.3A; - ushqimi 1F/230V/50Hz”.** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 2 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 2 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1copë, i instaluar në dhomën teknike. Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se në objekt është vendosur vetëm 1 pompë. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Nënzëri 6 “F.V Ena e zgjerimit të kaldajës është: - Kapaciteti: 80 litra; - Dimensionet: 400 mm; - Lartësia: 820 mm; - Presioni maksimal: 6 bar; - Temperatura e sistemit: -10°C deri në +90°C; - Lidhja: Ø”** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 2 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 2 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 2 copë, i instaluar në dhomën teknike. Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se në objekt është vendosur vetëm 1copë enë zgjerimi. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

## **OBJEKTI I: SHKOLLA E MESME GRUEMIRË**

### **C. SISTEMI I NGROHJES**

**Zëri 1. “Rrjeti shpërndarës tubacioneve të zeza çelikut”**

**Nënzëri 5 “F.V Armafleks për tubo çeliku pategel Ø 2" x 13 mm, i veshur me fletë PVC-je”.** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 52ml. Në preventivin e rishikuar

dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 52ml. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 52ml, i detajuar sipas tubacioneve (që në objekt janë zing dhe pvc). Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se tubacionet e vendosura nuk kanë të mbivendosur armafleks. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Nënzëri 6 “F.V Armafleks për tubo çeliku pategel Ø 1½" x 13 mm, i veshur me fletë PVC-je”.** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 100ml. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 100ml. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 100ml, i detajuar sipas tubacioneve (që në objekt janë zing dhe pvc). Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se tubacionet e vendosura nuk kanë të mbivendosur armafleks. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Nënzëri 7 “F.V Armafleks për tubo çeliku pategel Ø 1¼" x 13 mm, i veshur me fletë PVC-je”.** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 104ml. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 104ml. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 104ml, i detajuar sipas tubacioneve (që në objekt janë zing dhe pvc). Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se tubacionet e vendosura nuk kanë të mbivendosur armafleks. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

## **2. Ambienti teknik për prodhimin e ujit të ngrohtë**

**Nënzëri 2 “F.V Kanal i tymrave me llamarinë çeliku , me shtresë izioluese 250/350 mm”.**

Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 130kg. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 130kg. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 130kg, i detajuar në vazhdim të pjesës inoks të oxhakat. Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se në objekt nuk është vendosura ky element. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

## **Zëri 3 “Furnizim dhe vendosje paisje për sistemin e ngrohjes” - “Radiatorët”**

**Nënzëri 1“F.V Element radiatorin alumin, kapaciteti në ngrohje për çdo element 146w (ose në përputhje me të dhënat e prodhuesit), interaksi 600 mm, ΔT=50 °C. (61 radiatorë të kompletuar sipas projektit)”** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 1250copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 1680copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1680, i detajuar në ambientet e shkollës. Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se në objekt janë vendosur 86 radiatorë me nga 10 elementë. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Nënzëri 2 “Pompë qarkullimi binjake për terminalet ngrohëse të katit dytë (Inverter). – prurja 4.0 m³/h; - prevalenca 120 kPa; - lidhjet DN 32, Pn 10; - fuqia elektrike 2x0.55kË, rryma 2x2.3A; - ushqimi 1F/230V/50Hz”.** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 1 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 1 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1copë, i instaluar në dhomën teknike. Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se në objekt është vendosur pompë qarkullimi vlera maksimale e të cilës përlogaritet 30,000 lekë. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Nënzëri 3 “Pompë qarkullimi binjake për terminalet ngrohëse të katitpare (Inverter). - prurja 4.0 m³/h; - prevalenca 90 kPa; - lidhjet DN 32, Pn 10; - fuqia elektrike 2x0.55kw, rryma 2x2.3A; - ushqimi 1F/230V/50Hz”.** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 1 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 1 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1copë, i instaluar në dhomën

teknike. Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se në objekt është vendosur pompë qarkullimi vlera maksimale e të cilës përlllogaritet 25,000 lekë. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Nënzëri 4 “Pompë qarkullimi binjake për terminalët ngrohëse të katit përdhe (Inverter). - prurja 4.0 m<sup>3</sup>/h; - prevalenca 60 kPa; - lidhjet DN 32, Pn 10; - fuqia elektrike 2x0.55kE, rryma 2x2.3A; - ushqimi 1F/230V/50Hz”.** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 1 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 1 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1 copë, i instaluar në dhomën teknike. Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se në objekt është vendosur pompë qarkullimi vlera maksimale e të cilës përlllogaritet 20,000 lekë. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Nënzëri 5 “F.V Pompë antikondense - prurja 2.0 m<sup>3</sup>/h; - prevalenca 20 kPa; - lidhjet DN 32, Pn 10; - fuqia elektrike 2x0.55kw, rryma 2x2.3A; - ushqimi 1F/230V/50Hz”.** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 2 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 2 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1 copë, i instaluar në dhomën teknike. Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se në objekt është vendosur vetëm 1 pompë. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Nënzëri 6 “F.V Ena e zgjerimit të kaldajës është: - Kapaciteti: 80 litra; - Dimensionet: 400 mm; - Lartësia: 820 mm; - Presioni maksimal: 6 bar; - Temperatura e sistemit: -10°C deri në +90°C; - Lidhja: Ø”** Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 2 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 2 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 2 copë, i instaluar në dhomën teknike. Nga verifikimi i librit të masave dhe relacionit për ndryshime në projektpreventiv dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se në objekt është vendosur vetëm 1 copë enë zgjerimi. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 3,866,772 lekë pa Tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

#### ***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

1. Z. E.N me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. N me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Për procedurën e zbatimit të punimeve me objekt: është paraqitur observacioni me nr. 214/1 prot., datë 20.08.2024, e nr. 701/5 prot., datë 29.08.2024 në KLSH, nga ing. E.N, si administratori dhe drejtuesi teknik i mbikëqyrësit të punimeve “N S” ShPK, si më poshtë:

**Qëndrimi i Audituesve të KLSH-së:** Gjithë observimi Juaj për projektraportin e auditimit është identik me obsevacioni nr. 193 prot., datë 24.07.2024 në lidhje Akt-Kontatimin nr 15, datë 19.07.2024 Referuar analizave për zërat faktike të përdorura në objekt për zërat e pajisjeve:

Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova të reja dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar i Auditimit.

## **2.6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e**

## Pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM

Në zbatim të pikës 6 mbi “Auditim mbi organizmin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (aseteve, pyje dhe kullota)”, të programit të auditimit nr.701/1 datë 31.05.2024,i ndryshuar për auditimin financiar ushtruar në Bashkinë Malësi e Madhe, janë administruar evidencat si mëposhtë:

- Lista e pasurive të paluajtshme të transferuar në Bashkinë Malësi e Madhe
- Lista e pasurive të paluajtshme të regjistruar në kadastrë
- Inventari i fondit pyjor
- Kontratat e lidhura për dhënien me qira të fondit pyjor

### I. PASURITË E PALUAJTSHME

#### 6.1. Auditim mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit të tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës

Sipas ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, bashkitë ishin të detyruara të paraqisnin në Këshillin e Ministrave listën e pronave që kërkonin t’u transferoheshin, një proces që përfshinte hartimin e inventarit paraprak, afishimin dhe përditësimin e pasurive dhe në fund miratimin e listës përfundimtare të pronave me vendim të Këshillit të Ministrave.

Nr.	Bashkia/Njësitë	Nr. Pronave në Inventar	Prona të regjistruara në Kadastrë
1	Bashkia Malësi e Madhe	723	Nuk ka listë përfundimtare
2	Ish Komuna Qendër		Nuk ka listë përfundimtare
3	Ish Komuna Kelmend		Nuk ka listë përfundimtare
4	Ish Komuna Shkrel		Nuk ka listë përfundimtare
5	Ish Komuna Kastrat		Nuk ka listë përfundimtare
6	Ish Komuna Gruemirë		Nuk ka listë përfundimtare

*Burimi: Bashkia malësi e madhe, Përpunuar nga grupi i i auditimit.*

Bashkia Malësi e Madhe me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB nr. 36, datë 05.01.2023 ka miratuar numrin e përgjithshëm punonjësve dhe strukturën organizative sipas drejtorive/sectorëve për vitin 2023. Struktura e cila merret me administrimin e pasurive është Sektori i Aseteve, ku ka në përbërje Përgjegjësin dhe Specialistin e Aseteve.

Kërkesë VKM për miratimin e listës paraprake numëri i tyre sipas inventarit bashkëlidhur.

Nr.		VKM		Në pronësi Në numër	Në përdorim Në numër
		Numër	Datë		
1	Bashkia Kopluk	93	07.02.2012	20	86
2	Ish Komuna Qendër	301	14.04.2011	-	98
3	Ish Komuna Kelmend	130	20.02.2013	1	41
4	Ish Komuna Shkrel	245	20.03.2013	3	88
5	Ish Komuna Kastrat	246	20.03.2013	-	115
6	Ish Komuna Gruemirë			-	295
	<b>Totali</b>			<b>24</b>	<b>723</b>

*Burimi : Bashkia Malësi e Madhe*

#### Kërkesa me VKM Përkatëse:

VKM Nr. 301, datë 14.4.2011, Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Qendër, Malësi e Madhe të Qarkut të Shkodrës, është miratuar lista inventarit me 98 pasuri në përdorim.

VKM Nr. 93, datë 7.2.2012, Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Koplik të Qarkut të Shkodrës, me 20 pasuri në pronësi dhe 86 pasuri në përdorim.

VKM Nr. 130, datë 20.2.2013, Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Kelmend, të Qarkut të Shkodrës, konkretisht është miratuar 1 pasuri në pronësi dhe 41 pasuri në përdorim.

VKM Nr. 245, datë 20.3.2013, Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Shkrel, të Qarkut të Shkodrës, konkretisht janë miratuar 3 pasuri në pronësi dhe 88 pasuri në përdorim.

VKM Nr. 246, datë 20.3.2013, Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Kastrat, të Qarkut të Shkodrës, janë miratuar 115 pasuri në përdorim.

Konstatohet se ,Ish Komuna Gruemirë nuk ka VKM për inventarizimin e pronave publike, është në fazën fillestare.Gjithashtu rezulton se, listat e inventarit të pronave publike nuk kanë kaluar në fazën përfundimtare.

*Pronat e regjistruara sipas objekteve dhe certifikatës se pronësisë ne tabelën sa me poshtë:*

Nr.	Emërtimi i pronës	Nr. pas	Nr. dok. hipotekor	Data e regjistrimit	ZK	Adresa	Sip truall m <sup>2</sup>	Sip nd. m <sup>2</sup>
1.	Zyra Bujqesia	47		03.03.2010	2220	Koplik	508	145.9
2.	Zyra Arsimore	7/34		03.03.2010	2220	Koplik	1027	140
3.	Shkolla e Mesme	1/6	02	03.03.2010	2220	Koplik	3166	370
4.	Shesh	6/171		15.04.2010	2220	Koplik	507	-
5.	Zyra e PS-se	7/10		07.01.2010	2220	Koplik	814	137
6.	Shesh	6/117		12.01.2010	2220	Koplik	387	
7.	Spitali	7/7		03.03.2010	2220	Koplik	1845	345
8.	Truall	2/83		03.03.2010	2220	Koplik	226	
9.	Shkolla 9-vjeçare	7/111		03.03.2010	2220	Koplik	5173	700
10.	Zyra e Pyjores	970/7		03.03.2010	2220	Koplik	431	62
11.	Zyra Sig.Shoqerore	7/152		03.03.2010	2220	Koplik	566	143
12.	Shesh	6/169		15.04.2010	2220	Koplik	851	
13.	Shesh	6/170		15.04.2010	2220	Koplik	15	
15.	Shesh	6/167		15.04.2010	2220	Koplik	27	
16.	Shesh	6/175		15.04.2010	2220	Koplik	878	
17.	Apartament	2/42+3-5		09.02.2016	2220	Koplik		59.8
18.	Apartament	2/42+3-4		09.02.2016	2220	Koplik		59.8
19.	Apartament	2/42+2-14		09.02.2016	2220	Koplik		49.1
20.	Apartament	2/42+3-20		09.02.2016	2220	Koplik		63.1
21.	Apartament	2/42+3-8		09.02.2016	2220	Koplik		59.8
22.	Cerdhe Tamare	37/1	24	03.11.2020	3560	Tamare	736.13	236.17
23.	PMNZSH- jarrefikese	7/24		13.08.2020	2220	Koplik	1013.8	277.2
24.	Fushe Sporti	211/20		04.11.2020	3834	Vrith	6500	
25.	Are	160/7		02.03.2021	1237	Boge	800	
26.	Are	160/5		04.03.2021	1237	Boge	700	
27.	Shesh	6/306		15.07.2021	2220	Koplik	483.9	

*Burimi Bashkia Malësi e Madhe*

### **Për Bashkinë Malësi e Madhe.**

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në Bashkinë Malësi e Madhe nuk administrohet baza e të dhënave të pasurive të paluajtshme të ish-komunave, aktualisht njësi administrative, në formatin e një regjistri të integruar të inventarit të pronave të bashkisë. Ushtrimi i funksioneve në lidhje me inventarin dhe regjistrimin bëhet vetëm përmes një specialisti dhe nuk ka një strukturë të posaçme funksionale me qëllim mbulimin e një fushe komplekse sikurse është inventari i pasurive të paluajtshme.

Nga verifikimi i evidencave, rezulton se:

Bashkia Malësi e Madhe dhe ish-komunat që i janë bashkuar territorit administrativ të saj nuk kanë të miratuar inventarin përfundimtar me Vendim të Këshillit të Ministrave e si pasojë në mungesë të këtij akti, ASHK nuk mund të kryejë regjistrime bazuar në listën e inventarit

paraprak. Inventarët e pasurive të paluajtshme nuk përfaqësojnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Malësi e Madhe nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si rrjedhojë, inventari rezulton i papërditësuar, në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se “bashkitë kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Procedura e përditësimit mbështetet në verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren dhe verifikimit juridik, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së. Po ashtu, bashkia i kërkon ASHK-së informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administron, përfshirë edhe informacionin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligji”.

Në bashkinë Malësi e Madhe nuk ka në strukturë një specialist kadastrë që mbulon çështjen e pasurive të paluajtshme të transferuara.

Në veçanti konstatohet vërehet se nuk janë regjistruar pasuritë e shërbimeve arsimore, ndonëse për to ka realizuar investime përgjatë viteve.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në Bashkinë Malësi e Madhe nuk administrohet baza e të dhënave të pasurive të paluajtshme të ish-komunave, aktualisht njësi administrative, në formatin e një regjistri të inventarit të pronave të Bashkisë. Ushtrimi i funksioneve në lidhje me inventarin dhe regjistrimin bëhet vetëm përmes një specialisti dhe nuk ka një strukturë të posaçme funksionale me qëllim mbulimin e një fushe komplekse sikurse është inventari i pasurive të paluajtshme.

Nga Bashkia Malësi e Madhe nuk është krijuar struktura e posaçme e bashkëpunimit me drejtorinë përkatëse të ASHK-së, të cilat rakordojnë ndërmjet tyre, me qëllim realizimin e procedurave të parashikuara nga neni 37, i ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, sikurse parashikohet në VKM nr. 28 datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve”.

## II.Fondi Pyjor

### 6.2. Auditim mbi procedurat e dhënies me qira dhe likuidimin e kontratave të lidhura

Kërkese VKM nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyje dhe kullota publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave e Bashkive”, i janë kaluar në pronësi sipërfaqe:

Gjithsej 66167.94 ha, nga këto:

- Pyje 45494.6 ha,
- Kullotë 12019.76 ha
- Toka joproductive 45.26 ha

Shkëmbore dhe ujore 8608.32 ha.

Sipërfaqe pyjore e kullosore e transferuar është regjistruar në ASHK për pyje janë regjistruar 7175.2 ha, për kullota janë regjistruar 253.3 ha dhe shkëmbore Shkëmbore 1064.9 ha.

Nr.	Ekonomia pyjore	Forma e planit		Viti	Përdorimi i teritorit (ha)			Sip. Totale (ha)
		Mbarështrim	Inventarizim		Pyll	Kullota	Inproduktive	
1	Livadhi Harushes	2375.23		1989	957.59	1170.49	247.15	2375.23
2	Kershë Djegur	2607.19		1990	1631.48	790.97	184.74	2607.19
3	Lugina Vermoshit	2835.88		1989	2692.34	78.27	65.27	2835.88
4	Lëpushë - Budaç	1766.05		1988	1612	150.77	3.28	1766.05
5	Gropat e Selcës	2153.82		1988	1869.78	197.55	86.49	2153.82
6	Lugina e Cemit	4165.51	3922.7	1985	2201.49	666	1298.02	4165.51

7	Vukël - Nikç	9628.62	9628.62	1985	4590.16	3526.29	1512.17	9628.62
8	Brojë 1	3047.61	3047.01	1985	1939.12	356.52	751.97	3047.61
9	Brojë 2	2057.21	2057.2	1985	1198.83	174.43	683.95	2057.21
10	Bogë	3317.04	3317.04	1985	2503.97	301.62	511.45	3317.04
11	Fushë Zezë	7032.22		2003	6017.54	927.71	86.97	7032.22
12	Kastrat Zagorë	5140.5	5140.5	1985	4435.83	164.5	540.17	5140.5
13	Bajzë - Hot	3277.15	3277.15	1985	2452.21	687.84	146	3277.15
14	Bzhëtë - Dedaj	7685.31	7685.31	1985	5279.05	1713.77	692.49	7685.31
15	Koplik - Gruemirë	3548.54	3548.54	1985	2496.76	368.48	683.3	3548.54
16	Lugina e Rrjollit	3531.72	3531.72	1985	2476.16	192.69	862.87	3531.72
17	Rrepisht	1814.04	1814.04	1985	1090.63	471.38	252.03	1814.04
18	Rosek - Drisht	184.3	184.3	2008	49.66	134.64	-	184.3
<b>TOTALI</b>		<b>66167.94</b>			<b>45494.6</b>	<b>12065.02</b>	<b>8608.32</b>	<b>66167.94</b>

**Burimi: Bashkia Malësi e Madhe**

Me Vendim Nr. 59, datë 26.1.2022 “Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore park kombëtar (kategoria II) të zonave të mbrojtura mjedisore” disa prej ekonomive pyjore si ajo Livadhi Harushës, Kershë Djegur, Lugina Vermoshit, Lepushë Budac, Gropat e Selces, Vukel Nikç si dhe Bogë janë në proces për tu kaluar në administrim të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe konkretisht të ADZM Shkodër.

Në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor, sipas detyrimeve të nenit 17 të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, Bashkia Malësi e Madhe nuk ka hartuar plane mbarështimi për ekonomitë pyjore.

**Administrimi i aseteve pronë e bashkisë dhe realizimi i të ardhurave nga dhënia me qera e tyre.**

Nga auditimi i dokumentacionit për kontratat e qiradhënies së aseteve, lidhur ndërmjet Bashkisë Malësi e Madhe me palë të treta konstatohet që:

Bashkia Malësi e Madhe në procesin e ligjshëm të administrimit të aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qera të tyre, për vitin 2023 ka gjithësej 13 kontrata qiraje aktive, nga të cilat, 7 kontrata janë lidhur me operatorët e telefonive celulare, 6 kontrata janë lidhur për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore për funksionimin e HEC-eve.

**Kontratat e qiradhënies së aseteve në pronësi të Bashkisë Malësi e Madhe.**

Nr.	Qiramaresi	Zona	Objekti i kontratës (HEC, gurore, agrikulturë, etj)	Afati Vjet	Kontrate	Debia progresive 31.12.2022	Detyrim vjetor lek/ha për vitin 2023	Paguar 2023	Debia Progressive 31.12.2023
				KOHEZ GJATJA	Nr., Datë				
1	V.SHA	Nj. Ad. Shkrel	Dhenie me Qera trualli	5 vite	nr. 4962 date 06.08.2018	-	-	-	110,000
2	V.SHA	Nj. Ad. Kelmend	Dhenie me Qera trualli	5 vite	NR. 4963 date 06.08.2018	-	-	-	
3	Al. sha	Nj. Ad. Shkrel	Dhenie me qira Trualli	5 vite	nr. 319. prot date 15.01.2019	-	225,000	225,000	
4	S. Energy	Nj. Ad. Kelmend	Dhenie me Qera per perdorim te fondit pyjor	5 vite	nr. 5101 prot date 10.08.2018	628,140	314,070	942,210	-
5	M.& CO shpk	Nj. Ad. Kelmend	Dhenie me Qera per perdorim te fondit pyjor	5 vite	Nr. 6418 Prot. date 08.10.2018		320,326	320,326	-
6	Ë.T.S. Energji	Nj. Ad. Kelmend	Dhenie me Qera per perdorim te fondit pyjor	5 vite	Nr. 320 Prot. date 16.01.2019		94,250	94,250	-
7	R.- Plast	Nj. Ad. Shkrel	Dhenie me qira toke pyll trungshte	10 vite	nr. 533/ date 06.07.2022		60,000		60,000
8	C. SHPK	Nj. Ad. Shkrel	Dhenie me qira toke pyll	10 vite	nr rep. 3014, nr. kol 1641 date 04.10.2022		301,585		301,585
9	T.A ENERGY	Nj. Ad. Kelmend	Dhenie me qira per perdorim toke	10 vite	nr.rep. 7064, nr. koleksioni 1131 date 13.10.2022		1,659,192	1,659,192	-
10	O. ALBANIA	Razma, Nj. Ad. Shkrel	dhënie ne perdorim te fondit pyjor/ kullosor publik	10 vite	nr. 715/13 Prot date 30.12.2023		246,690	246,690	-

		Detyrim i prapambetur			7,310	-	7,310	-	
11	O. ALBANIA	Boge, Nj. Ad. Shkrel	Dhënie ne perdorim te fondit pyjor/ kullosor publik	10 vite	nr. 715/14prot. date 30.12.2022		326,600	326,600	
			Detyrim i prapambetur			154,932	-	154,932	
12	O. ALBANIA	Bzhete Dedaj, Nj. Ad. Shkrel	dhënie ne perdorim te fondit pyjor/ kullosor publik	10 vite	nr. 715/ 15 prot date 30.12.2023		167,000	167,000	
			Detyrim i prapambetur			820,833	-	820,833	
13	O. ALBANIA	Lugina e Vermoshit, Nj. Ad. Kelmend	dhënie ne perdorim te fondit pyjor/ kullosor publik	10 vite	nr. 715/16 prot date 30.12.2023		305,000	305,000	
			Detyrim i prapambetur			59,583	-	59,583	
<b>TOTALI</b>						<b>1,670,798</b>	<b>4,019,713</b>	<b>5,328,926</b>	<b>471,585</b>

#### *Burimi: Bashkia Malësi e Madhe*

Sa më sipër konstatohet se:

Në 1 rast nuk është bërë likuidimi i detyrimit vjetor të qirasë, konkretisht nga subjekti “C Shpk”, në vlerën 301,585 lekë, ndërsa subjekti “R.P” ka qenë debitorë në vitin 2023 dhe ka likuiduar detyrimin në vitin 2024. Nga subjekti VSH.A është likuiduar detyrim vjetor por pa përfshirë kamtavesën në vlerën 110,000 lekë, detyrimi në fund të vitit 2023 nga mos pagesa e kontratës së qirasë është në vlerën 411,585 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Malësi e Madhe. Ndaj subjekteve të mësipërm nuk janë marrë masa për arkëtimin e detyrimit të krijuar si dhe të ndjekin rrugën ligjore për t’i detyruar subjektet për zbatimin rigoroz të kontratës. Këto veprime janë në kundërshtim me nr rep. 3014, nr. kol 1641 datë 04.10.2022, nr. 533/ date 06.07.2022. Gjithashtu konstatohet se, nga auditimi i dosjeve të kontratave, me afat 10 vjeçar, rezultoi se nuk ka inventare të dosjeve, për 4 nga kontratat janë hartuar në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” Neni 51 Regjistrimi i kontratës së qirasë pika 1, Çdo kontrate qiraje e bërë, për një pasuri të paluajtshme, me zgjatje kohore më shumë se 9 vjet, duhet të regjistrohet në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë së paluajtshme të qiradhënësit. Kontrata e qirasë, duhet bërë me akt noterial, për një pasuri të paluajtshme, me një zgjatje kohore mbi një vit, mund të regjistrohet në regjistrin e pasurisë së paluajtshme. Këto kontrata nuk janë nënshkruar përpara noterit siç e parashikon ligji i sipërcituar. Në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor, sipas detyrimeve të nenit 17 të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, Bashkia Malësi e Madhe nuk ka hartuar plane mbarështimi për ekonomitë pyjore.

-Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar më sipër, llojin e mangësive të identifikuar si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, mbajnë përgjegjësi, Kryetari i Bashkisë z. T.M, Drejtori Juridik dhe Drejtor i Aseteve z. E.A. Drejtori i Drejtorisë së Administrimit Pyjor Gj.GJ.  
(Sa më sipër, është trajtuar më gjerësisht në Akt Konstatimin nr. 3 datë 05.04.2024).

#### **2.6 Të ndryshme të dala gjatë auditimit.**

Në periudhën e auditimit në terren, nuk kemi patur për të trajtuar problematika jashtë programit të auditimit.

### **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME**

#### **Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:**

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi kontrollin e brendshëm financiar publik për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 u konstatua se:

-Ka mangësi të njohurive nga ana e punonjësve mbi kuadrin rregullator ligjor mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli III, pika 3.1.

-Nuk ka përshkrime detyrash individuale e cila do të evidentonte ngarkesën konkrete me punësi dhe kërkesat lidhur me kualifikimet e nevojshme për secilin nëpunës.

Bashkia Malësi e Madhe nuk ka miratuar plan pune vjetor lidhur me veprimtarinë e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), si dhe nuk administrohen procesverbale për të dokumentuar funksionimin e këtij grupi.

-Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut.

-Në lidhje me “Menaxhimin e Riskut” Bashkia Malësi e Madhe nuk ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut, si pasojë e mungesës së një structure të posaçme dhe një koordinatori të deleguar për vlerësimin e riskut. Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mosvlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e Bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. -Në lidhje me “Aktivitetet e Kontrollit” Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 4, pika 20. Në rregulloren e brendshme nuk janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë të Drejtorëve dhe Përgjegjësve të sektorëve, ku vihen re mbivendosje/mbingarkesë të funksioneve. -Në lidhje me “Informimin dhe Komunikimin” Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin e prokurimeve, raporte të auditimit, institucionet e varësisë.

-Në lidhje me “Monitorimin dhe Raportimin” Proçedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion nuk konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, nuk administrohen plotësisht raportimet e drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.1, faqe 15-27 të Raportit të Auditimit).*

**1.1.Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Malësi e Madhe, me atributet e Kryetarit të GMS dhe Koordinatorit të Riskut të institucionit, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin, identifikimin, analizën, kontrollin dhe përditësimin e risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura u konstatua se, nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk janë marrë masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, pasi planet vjetore nuk janë hartuar bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, veprime në kundërshtim me nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Nuk është realizuar plani i auditimeve sipas numrit të miratuar. Gjithashtu konstatohet se, nuk mbahen elektronikisht dosjet e përhershme për çdo njësi publike të audituar me qëllim për t’i shërbyer auditimit pasardhës, veprim që bie në kundërshtim me MAB, Kapitulli nr. VI, pika 6.3.

Mungon dhënia e opinionit në Projekt Raport dhe Raportin Përfundimtar të Auditimeve për të gjithë auditimet e kryera sipas Standardi 2450 - Opinionet e Përgjithshme, në kundërshtim me Urdhërin nr.4, datë 10.01.2020 i Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”. Nga Përgjegjësi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm nuk është vepruar konform me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin III, pika 3.2 “Plani vjetor i

Auditimit”, që kryhet nga vetë nga kjo njësi. (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.1, faqe 15-27 të Raportit të Auditimit)

**2.1.Rekomandimi:** Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të merren masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse ti jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave.

*Menjëherë në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se, vlera e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2022 janë në vlerën 92,178 mijë lekë, janë krijuara gjatë vitit 2023 detyrime në vlerën 44,512 mijë lekë dhe janë shlyer në vlerën 37,687 mijë lekë. Duke rezultuar detyrime të prapambetura deri 31.12.2023 në vlerën 99,003 mijë lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", neni 34, pika 1, neni 40, pika 3; Udhëzimi nr. 1, datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit", pika 5 dhe pika 8. Udhëzimi i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 101. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-41 të Raportit të Auditimit).

**3.1.Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe, Drejtoria e Financës, të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plane të detajuara për këtë qëllim dhe të raportojë periodikisht në MFE vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Malësi e Madhe kryhet në programin Excel. Drejtoria e të ardhurave nuk kryhen regjistrim manual të të dhënave (nuk disponon regjistri fizik). Çdo informacion që grumbullon nga njësitet administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Malësi e Madhe i administron në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Drejtorisë së të ardhurave dhe në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Drejtorisë së të ardhurave për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të DTTV. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, neni 4, pika 7. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrisë së Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar". (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.3, faqe 27-41 të Raportit të Auditimit).

**4.1.Rekomandim:** Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Malësi e Madhe të marrin masa për hartimin e regjistrit të taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

*Menjëherë në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi, rezulton se nuk janë mbajtur akt-rakordimet çdo muaj me agjentët tatimorë. Të ardhurat nga ASHK-ja nuk derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Malësi e Madhe. Gjithashtu rakordimi nuk është mbajtur dhe me DRSHTRR Shkodër në lidhje me numrin e mjeteve që ka në përdorim kjo njësi vendore, sa nga këto mjete janë aktiv në gjendje pune, sa nuk janë në gjendje pune, sa paguajnë dhe sa nuk paguajnë dhe nëse derdhjet në buxhet bëhen sipas afateve ose jo. Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave të cilat vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, u konstatua se Bashkia Malësi e Madhe, nuk ka marrë masa për evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj. Gjithashtu nuk ka filluar procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura. Këto veprime janë në kundërshtim me Neni 117 të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore”, ku parashikohet se “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave” (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.3, faqe 27-41 të Raportit të Auditimit).

**5.1.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Malësi e Madhe , të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga agjentët tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për penalizmin e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

- Të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat, të cilat mblidhen nga agjentët tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucioni e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave në Bashkinë Malësi e Madhe nga Taksat dhe Tarifatat Vendore, bazuar në dokumentet e mbajtur nga inspektorët e taksave konkretisht akt-konstatimet, mbi kontrollin e ushtruar në terren ka rezultuar se, në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe ushtrojnë aktivitetet 13 subjekte me objekt veprimtarie të ndryshme pa u regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB). Nga inspektimet e kryera me datë, 18.09.2023 nga sektori i taksave dhe i tarifave vendore pranë Bashkisë Malësi e Madhe u konstatua se 4 (katër) subjekte ushtrojnë veprimtarinë e tyre pa u regjistruar në QKB. Nga grupi i auditimit është konstatuar se, nga Drejtoria e të Ardhurave nuk është hartuar një shkresë zyrtare me lëndën kërkesë për bashkëpunim drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, për marrjen e masave ligjore për subjektet informale të konstatuara, që kryejnë aktivitet ekonomik në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 5, 40, 41. Ligjin Nr.9632, Datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 4. Ligji Nr. 9723, Datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, neni 22, Rregulloren e Brendshme miratuar me vendim të Kryetarit nr. 36 datë 05.01.2023, neni 80 pika 5, 6, 8 dhe 9, neni 81, pika 3 (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.3, faqe 27-41 të Raportit të Auditimit).

**6.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe dhe Drejtoria e të Ardhurave të marrin masa që të ushtrohen rikontrolle për subjektet e konstatuara, të cilët kanë ushtruar veprimtarinë e tyre pa u regjistruar pranë QKB-së përgjatë vitit 2023 dhe në vijim, dhe në varësi të akt-konstatimeve të mbajtura të përcillet lista me subjektet e identifikuar si subjekte informale, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër me qëllim bashkëpunimin për vazhdimin e marrjes së masave ligjore për subjektet e konstatuara të cilët ushtrojnë aktivitet ekonomik në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe.

*Menjëherë*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i analizave të llogarive të Aktiveve Afatgjata në pasqyrat financiare në mbyllje të vitit 2021 rezultuan veprime të gabuara kontabël, të cilat ndikojnë në pasqyrimin e pasaktë dhe të pa plotë të gjendjes së këtyre aktiveve në llogaritë:

- Llog. 210 *“Toka, Troje, Terrene”* e paraqitur në mbyllje të vitit 2023 në vlerë historike 9,342,194 lekë konstatohet se në gjendjen e kësaj llogarie janë përfshirë në mënyrë të gabuar vlera prej 2,179,103 lekë e aktivitetit “Projektim sistemim asfaltim rruga Gruemire - Limaj” dhe vlera prej 1,781,904 lekë e aktivitetit “Projekti sistemim-asfaltim rruga Kastrat - Rrapsh”, të cilat sipas verifikimit të investimeve të kryera i përkasin llogarisë 202 *“Studime dhe kërkime”*,

- Llog. 211 *“Pyje, Plantacione”* e paraqitur në mbyllje të vitit 2023 në vlerë historike 15,388,760 lekë konstatohet se, në gjendjen e kësaj llogarie janë përfshirë 4 aktive me vlerë 10,743,076 lekë, që nuk kanë emërtime të plota dhe të sakta se kuj NJA apo apo objekt investimi i përkasin, si dhe mungojnë të dhëna të detajuara inventariale për to.

- Llog. 213 *“Rrugë, rrjete, vepra ujore”* e paraqitur në mbyllje të vitit 2023 në vlerë historike 613,910,478 lekë konstatohet se, në gjendjen e kësaj llogarie janë përfshirë në mënyrë të gabuar vlera prej 2,524,911 lekë e aktivitetit “Projekt i urës lidhëse te fshatrave Vermosh-Velan-Velipoje”, vlera prej 780,000 lekë e aktivitetit “Projektet” dhe vlera prej 360,000 lekë e aktivitetit “Projekt rruga fundi i Brinjes”, të cilat sipas verifikimit të investimeve të kryera i përkasin llogarisë 202 *“Studime dhe kërkime”*. Gjithashtu në këtë gjendje janë përfshirë 11 aktive me vlerë 105,767,829 lekë, që nuk kanë emërtime të plota dhe të sakta se kuj NJA apo objekt investimi i përkasin, si dhe mungojnë të dhëna të detajuara inventariale për to.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”* Kreu II pika 5, pika 11, aneksi 1, pika 2/1 gërma (e), Klasa 2, Kreu III, pika 30 dhe me Nomenklaturën e Llogarive të planit kontabël publik (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, në faqet 41-61 të Raportit të Auditimit*).

**7.1. Rekomandim:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Malësi e Madhe nëpërmjet inventarit fizik dhe kontabël të plotësorë të dhënat e aktiveve apo grupaktiveve AA të llogarive 210 *“Toka, Troje, Terrene”*, 211 *“Pyje, Plantacione”* dhe 213 *“Rrugë, rrjete, vepra ujore”* dhe të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2024, për kalimin e vlerave të aktiveve sipas llojit përkatës, duke i evidentuar në llogaritë e përshtatshme sipas klasifikimit të Nomenklaturës së Llogarive të Planit Kontabël Publik, si dhe të bëhen korrektimet e nevojshme në llogaritjen e amortizimit.

***Deri me datë 31.03.2025***

**8. Gjetje nga auditimi:** Bazuar në VKM nr.302, datë 11.05.2023 *“Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura”* dhe marrëveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësjellës Kanalizime Shkodër, Ujësjellës Kanalizime sha Malësi e Madhe i është bashkëngjitur Ujësjellës Kanalizime Shkodër. Referuar analizës të gjendjes së llogarisë 213 *“Rrugë, rrjete, vepra ujore”* rezulton se, nuk është zbritur vlera e investimeve të kryera në ujësjellës që duhej të transferohej tek Ujësjellës Kanalizime SHA Shkodër, për 24 aktive dhe pjesë aktivesh në vlerën 1,524,931,322 lekë (përfshirë investime në ujësjellës e rrjetin shpërndarës, KUZ, depo dhe pompa uji) në kundërshtim me VKM nr.153, datë 03.04.1993 *“Për kalimin e objekteve, të mjeteve kryesore, të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”* i ndryshuar, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 *“Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”* i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu

II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, në faqet 41-61 të Raportit të Auditimit*).

**8.1. Rekomandimi:** Strukturat Drejtuese në Bashkinë Malësi e Madhe dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë procedurat ligjore për transferimin tek “Ujësjetllës Kanalizime Shkodër” Sha të AAGJM që i përkasin gjendjes së llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” të ish-Ujësjetllës Kanalizime Sha Malësi e Madhe, dhe më pas të kryhen veprimet sistemuese kontabël, duke i reflektuar ato në pasqyra financiare të mbylljes së vitit 2024.

*Deri me datë 31.03.2025*

**9. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë 475 “*Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhëse*” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 116,204,628 lekë, vlerë e cila i përket llogarisë kundërparti 468 “*Debitorë të ndryshëm*” në aktiv të bilancit. Në fakt në llogarinë 475 “*Të ardhura për tu regjistruar vitet pasardhëse*” evidentohen të ardhurat që janë arkëtuara përpara ngjarjes ose veprimit që krijon të ardhura, prandaj vlera prej 116,204,628 lekë e debitorëve duhej të ishte pjesë e llogarisë 4341 “*Operacione me shtetin (detyrime)*”. Llogaria 4341 “*Operacione me shtetin (detyrime)*” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që kanë të tretët ndaj institucionit/shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022, Kreu III, pika 3.1, nënpika 32, Aneksi nr.1, pika 3.3 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, në faqet 41-61 të Raportit të Auditimit*).

**9.1. Rekomandim:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Malësi e Madhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2024 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për drejtat e konstatuara në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

*Deri me datë 31.03.2025*

**10. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 8,335,985 lekë të 28 faturave të papaguara të hershme, ndërkohë që gjendja e llogarisë 401-404 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 233,514,778 lekë, e cila përbëhet nga vlera prej 99,003,050 lekë e 27 faturave detyrime të prapambetura të raportuara dhe në MF, nga vlera prej 132,242,857 lekë e 25 faturave të investimeve të buxhetuara për financim në periudhën 3-vjeçare (PBA), si dhe vlera prej 2,268,871 lekë e 13 faturave të pa likuiduara për mallra dhe shërbime të periudhës së fundvitit ushtrimor. Vlera pjesore prej 99,003,050 lekë e detyrimeve të krijuara në periudha kohe para nëntor-dhjetorit të vitit ushtrimor të mbyllur, duhet të jetë pjesë e gjendjes e llogarisë 467 “*Kreditorë të ndryshëm*”, pasi klasifikohen si detyrime të prapambetura. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” Kreu III pika 3.1 nënpik 42, Aneksi 1 pika 3.3/c (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, në faqet 41-61 të Raportit të Auditimit*).

**10.1. Rekomandim:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Malësi e Madhe në kontabilizimin e faturave nga furnitorët për blerje mallrash, shërbimesh dhe investimesh, të jetë e kujdesshme në klasifikimin e tyre, sipas afateve 60 ditore, duke i ndarë ato në detyrime të prapambetura dhe detyrime brenda afatit të likuidimit në thesar dhe duke i kontabilizuar në llogaritë përkatëse të klasës 4 sipas këtij klasifikimi.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 12 procedurave të prokurimit me vlerë totale të fondit limit 311,595 mijë lekë, të vlerësuar për auditim për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, janë konstatuar në shkëlqje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej në 11 procedura prokurimi, me fond limit 290,427,411 lekë pa TVSh, në lidhje me aplikimin e kriterëve të paargumentuara dhe/ose jo të lidhura ngushtë me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet, në objektet “Rikonstruksion i shkollës "Muhamet Hasmuja", Ktosh”, “Sistemim asfaltim rruga Sterkuje”, “Sistemim Asfaltim Rruga Koplik-Sterbeq-Jubice-Kamice”, “Ura lidhëse për fshatrat Vermosh-Velan-Velipojë”, “Sistemim asfaltim rruga çulaj - Skaq”, “Sistemim Asfaltim Rruga “Degëzim rruga Koplik-Razëm, për tek rruga e Reçit”, “Sistemim asfaltim rruga Rrash - Vorfe”, “Sistemim asfaltim rruga Rohes, Faza 2”, “Sistemim asfaltim rruga Koplik Sipër – Lujs”, “Sistemim asfaltim Fermentimit Hotajve dhe Kurtaj në lagjen Palvar”, “Blerje kosha (kontenier) për mbetje. Aplikimi i kriterëve jo të mirëargumentuara, për shkak të moszbatimit të kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve nga personat përgjegjës, çon në mos pjesëmarrjen e OE në garë ose në skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 2 dhe 82, pika 5 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, në faqet 61-143 të Raportit të Auditimit).

**11.1. Rekomandimi:** Sektori i Prokurimit Publik në Bashkinë Malësi e Madhe, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet t'i argumentojë teknikisht dhe ligjërish ato duke pasur gjithmonë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, fondin limit të planifikuar, grafikun e punimeve, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre, harmonizimin me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike, me qëllim për të garantuar trajtim të barabartë të OE dhe duke nxitur konkurrencën midis tyre.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga 14 proceduara të audituara u konstatua se në blerjet e realizuara me procedurë “Vlerë e vogël”, për 6 raste janë realizuar procedura prokurimi të ngjashme por të ndara, duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 56, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 56, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, në faqet 61-143 të Raportit të Auditimit).

**12.1.Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), të marrë masa që sasisë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi, me qëllim përcaktimin e kufirit monetar, duhet të llogariten si grup - mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure.

*Në vijimësi*

**13. Gjetje nga auditimi:** Për procedurat e prokurimi të realizuara me “vlerë e vogël” u konstatua se, në 7 raste të blerjeve mall, shërbime e punë publike, me OE të shpallur fitues, është lidhur kontrata e shërbimit dhe blerjes me afate dhe kushte të realizimit ndërsa në rastet për procesin e marrjes në dorëzim të mallrave nuk është ngritur komision nga titullari dhe në përputhshmëri me kërkesat ligjore. Mallrat e blera kanë kaluar nga furnitori duke u bërë hyrje në magazinë pa pasur një hallkë kontrolli mbi sasinë, llojin dhe cilësinë e kërkuar sipas kërkesave së procedurës e prokuruar, në kundërshtim me Pikën 42, 43, 52, 53, 54 të UMF 30 datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, në faqet 61-143 të Raportit të Auditimit).

**13.1. Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa që të miratojë për çdo rast urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues.

Komisioni të përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision duhen të bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.

*Në vijimësi*

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të 9 kontratave për punë publike, konstatohet se në 8 prej tyre nuk është marrë Oponenca Teknike, nga organet e përcaktuara për kryerjen e tyre, në mospërputhje me Ligjin Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 6 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5.2, faqe 123-168 të Raportit të Auditimit).

**14.1. Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe dhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit të marrin masa, që në të ardhmen, për të gjitha objektet publike që prokurohen dhe zbatohen në këtë bashki, të merret nga institucionet e ngarkuara me ligj, Oponenca Teknike për çdo projekt zbatimi, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të 9 kontratave për punë publike, konstatohet se në 6 prej tyre është dhënë “Deklaratë për kryerje punimesh” dhe jo “Leje ndërtimi infrastrukurore”, në mospërputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit”, neni 11/1 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5.2, faqe 123-168 të Raportit të Auditimit).

**15.1. Rekomandimi:** Bashkia Malësi e Madhe të marrë masa që në të ardhmen, për të gjitha objektet publike që prokurohen dhe zbatohen në këtë bashki, të aplikojnë për lejen e ndërtimit, konform legjislacionit të planifikimit të territorit, me qëllim miratimin e projekteve cilësorë.

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i evidencave, u konstatua se Bashkia Malësi e Madhe dhe ish-komunat që i janë bashkuar territorit administrativ të saj, nuk kanë të miratuar inventarin përfundimtar me Vendim të Këshillit të Ministrave e si pasojë në mungesë të këtij akti, ASHK nuk mund të kryejë regjistrime bazuar në listën e inventarit paraprak. Inventarët e pasurive të paluajtshme nuk përfaqësojnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Malësi e Madhe nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si rrjedhojë, inventari rezultoi i papërditësuar, në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Nga Bashkia Malësi e Madhe nuk është krijuar struktura e posaçme e bashkëpunimit me drejtorinë përkatëse të ASHK-së, të cilat rakordojnë ndërmjet tyre, me qëllim realizimin e procedurave të parashikuara, sikurse parashikohet në VKM nr. 28 datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve” (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.6 faqe 168-173 të Raportit të Auditimit).

**16.1.Rekomadimi:** Kryetari i Bashkisë të marrë masa për ngritjen e një strukture të posaçme për ushtrimin e funksioneve në lidhje me përditësimin e inventarëve të pasurive të paluajtshme, duke krijuar një inventar të integruar për ish-komunat dhe për të koordinuar me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës me qëllim miratimin e inventarëve përfundimtarë dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

*Menjëherë*

**17. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi i dosjeve të kontratave me afat 10 vjeçar, konstatohet se për 4 kontrata të lidhura me kompaninë O Albania nuk ka inventare të dosjeve dhe këto

kontrata janë hartuar në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” Neni 51 Regjistrimi i kontratës së qirasë pika 1. Në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor, sipas detyrimeve të nenit 17 të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, Bashkia Malësi e Madhe nuk ka hartuar plane mbarështimi për ekonomitë pyjore. (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.6 faqe 168-173 të Raportit të Auditimit).

**17.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Aseteve Bashkia Malësi e Madhe të kontrollojë përmbushjen e dispozitave ligjore për lidhjen e kontratave të qerasë me afat mbi 9 vjet, duke kërkuar që të regjistrohet në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë së paluajtshme të qiradhënësit, si dhe të bëjnë inventarizimin e dosjeve të këtyre kontratave. Drejtoria e Administrimit të Pyjeve Bashkia Malësi të hartojë planet e mbarështimit, operacionale dhe të shfrytëzimit (përfshirë planet e rehabilitimit), nga ana e subjekteve (persona juridikë dhe fizikë) që kryejnë veprimtari në sipërfaqet pyjore të dhëna me qira, dhe në rast të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale të ndjekin rrugët administrative dhe ligjore, për t’i detyruar subjektet për zbatimin rigoroz të kontratës.

**Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2025**

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Sistemim Asfaltim rruga Linaj Kurte”, Bashkia Malësi e Madhe, me vlerë të kontratës 30,480,000 lekë me Tvsh, realizuar nga OE fitues “A, rezultuan volume pune të kryera jo sipas projektpreventivit dhe me difekte në zërin “Shtresë stabilizanti t=5cm bankinë” me vlerë 784,000 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2659/6 prot datë 14.10.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe dhe OE fitues “A, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.5.2, faqe 123-168, të Raportit të Auditimit).

**18.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Malësi e Madhe, nisur nga fakti që objekti është brenda afartit të garancisë së punimeve, të merren masa për detyrimin e sipërmarrësin dhe të ndiqen realizimi i punimeve për riparimin e bankinave me materialin e parashikuar në projektpreventiv. Në rast të mosrealizimit të këtij zëri, vlera prej 784,000 lekë pa TVSh të mbahet nga garancia e difekteve.

**Menjëherë**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja “b” dhe “c” “Të drejtat e KLSH”, në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30/4/2015, “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, në nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Malësi e Madhe), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohej në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **5,773,546 lekë pa Tvsh**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Rikonstrukcion godina e Zjarrëfikëses”, Bashkia Malësi e Madhe, me vlerë të kontratës 9,462,023 lekë me Tvsh, realizuar nga BOE M & “N” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 292,925 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 990/10 prot datë 29.06.2023 të lidhur

mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe dhe BOE M & “N” ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.5.2, faqe 123-168 të Raportit të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Malësi e Madhe të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **292,925 lekë pa TVSh** nga BOE M & “N” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. . 990/10 prot datë 29.06.2023, me objekt: “Rikonstruksion godina e Zjarrëfikëses”, Bashkia Malësi e Madhe, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Sistemim Asfaltim rruga Koplík i Sipërm - Lujs”, Bashkia Malësi e Madhe, me vlerë të kontratës 13,613,724 lekë me Tvsh, realizuar nga L, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 201,000 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 447/8 prot datë 18.04.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe dhe L, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4 (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.5.2, faqe 123-168, të Raportit të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Malësi e Madhe të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **201,000 lekë pa TVSh** nga L, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 447/8 prot datë 18.04.2023, me objekt “Sistemim Asfaltim rruga Koplík i Sipërm - Lujs”, Bashkia Malësi e Madhe, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës me objekt: “Sistemim Asfaltim rruga “Degezim i rrugës Koplík Razëm, për tek rruga e Reçit”, me vlerë të kontratës 23,678,688 lekë me Tvsh, realizuar nga OE “S” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 474,775 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 651/10 prot datë 09.05.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe dhe OE “S” ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.5.2, faqe 123-168, të Raportit të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Malësi e Madhe të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **474,775 lekë pa Tvsh** nga OE “S” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 651/10 prot datë 09.05.2023, me objekt: “Sistemim Asfaltim rruga “Degezim i rrugës Koplík Razëm, për tek rruga e Reçit”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Menjëherë*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Sistemim Asfaltim rruga Gjuraj – Koplík i Sipërm”, Bashkia Malësi e Madhe, me vlerë të kontratës 14,115,708 lekë me Tvsh, realizuar nga L, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 186,614 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 633/10 prot datë 28.04.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe dhe L, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.5.2, faqe 123-168, të Raportit të Auditimit).

**4.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Malësi e Madhe të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **186,614 lekë pa TVSh** nga L, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 633/10 prot datë 28.04.2023, me objekt: “Sistemim Asfaltim rruga Gjuraj – Koplík i Sipërm”, Bashkia Malësi e Madhe, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Menjëherë*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Sistemim Asfaltim rruga Koplík-Stërbeq-Jubicë-Kamicë”, Bashkia Malësi e Madhe, me vlerë të kontratës 70,681,782 lekë me Tvsh, realizuar nga BOE fitues L ShPK & N ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 268,760 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 735/10 prot datë 10.07.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe dhe BOE fitues L ShPK & N ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.5.2, faqe 123-168, të Raportit të Auditimit).

**5.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Malësi e Madhe të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **268,760 lekë pa TVSh** nga BOE fitues L ShPK & N ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 735/10 prot datë 10.07.2023, me objekt: “Sistemim Asfaltim rruga Koplík-Stërbeq-Jubicë-Kamicë”, Bashkia Malësi e Madhe, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Menjëherë*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Sistemim Asfaltim rruga Kastrat - Rrapshe”, Bashkia Malësi e Madhe, me vlerë të kontratës 69,096,177.6 lekë me Tvsh, realizuar nga BOE fitues L ShPK & N ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 482,700 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2658/6 prot datë 21.10.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe dhe BOE fitues L ShPK & N ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.5.2, faqe 123-168, të Raportit të Auditimit).

**6.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Malësi e Madhe të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **482,700 lekë pa TVSh** nga BOE fitues L ShPK & N ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2658/6 prot datë 21.10.2022, me objekt “Sistemim Asfaltim rruga Kastrat - Rrapshe”, Bashkia Malësi e Madhe, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Menjëherë*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Ndërtim i impjantit të ngrohjes në shkollat e Mesme Koplík- Bajzë - Gruemirë”, Bashkia Malësi e Madhe, me vlerë të kontratës 38,884,235 lekë me Tvsh, realizuar nga BOE fitues M& “E” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 3,866,772 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2411/6 prot., datë 05.10.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe dhe BOE fitues M& “E” ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.5.2, faqe 123-168, të Raportit të Auditimit).

**7.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia Malësi e Madhe të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **3,866,772 lekë pa TVSh** nga BOE fitues M& “E” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2411/6 prot., datë 05.10.2022, me objekt “Ndërtim i impjantit të ngrohjes në shkollat e Mesme Koplik- Bajzë - Gruemirë”, Bashkia Malësi e Madhe, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Menjëherë*

## **C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi dhe sipas dokumenteve të paraqitura nga zyra e prokurimeve dhe nga Sektori i të Ardhurave Vendore, Bashkia Malësi e Madhe, nga subjektet e ndërtimit, (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Malësi e Madhe), të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike, u konstatua se në territorin e Bashkisë Malësia e Madhe, kanë kryer punime ndërtimi 29 subjekte, nga të cilët 8 subjekte ndërtimi janë me seli administrative në këtë bashki, dhe 21 subjekte janë me adresë sekondare. Nga auditimi konstatohet se për 29 subjektet është faturuar vlera prej 301,261 lekë nga e cila është arkëtuar vlera prej 95,265 lekë, duke mbetur vlera debitore progresive prej 205,996 lekë vlerë e cila nuk është kontabilizuar dhe përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Malësia e Madhe. Këto veprime janë në kundërshtim me Shkronjën “a” e pikës 5 të nenit 35 në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Pikën 10 e nenit 3 dhe pika 2 në nenin 18 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”. (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.3 faqe 33-41 të Raportit të Auditimit).

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Malësi e Madhe të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës prej **205,996** lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë.

*Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2025*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nga 8 dosje të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, të vëna në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, në 6 (gjashtë) raste licencat janë dhënë me një afat vlefshmërie deri në 1 (një) vit, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në Kreun II.12., në paketën fiskale të vitit 2023, ku është përcaktuar se afati i vlefshmërisë së licencës është 5 vite nga momenti i lëshimit, për të cilin aplikohet tarifa prej 1,000,000 lekë. Gjithashtu duke iu referuar të dhënave të paraqitura nga sektori i Taksave konstatohet se, janë 7 subjekte të cilët kanë ushtruar aktivitet për tregtimin e karburanteve përgjatë vitit 2023, të cilët nuk kanë qenë të pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit. Si pasojë e situatës së krijuar janë krijuar detyrime nga 14 (katërmëdhjetë) subjekte në vlerën 10,000,000 lekë vlerë e cila nuk është e njohur në kontabilitet, dhe përbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Malësi e Madhe.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, i ndryshuar me ligjin nr. 71.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4 “Neni 20-Autorizimet pika 2. VKM nr. 344, Datë 19.4.2017 Për Disa Ndryshime Në VKM nr. 970, Datë 2.12.2015, neni 15.1 dhe neni 15.2. (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.3 faqe 33-41 të Raportit të Auditimit).

**2.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masat e nevojshme, për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve, me qëllim aplikimin dhe licencimin e aktivitetit të tyre. Gjithashtu Drejtoria e të Ardhurave të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës prej **10,000,000** lekë.

*Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2025*

**3.Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit për kontratat e qiradhënies së aseteve, lidhur ndërmjet Bashkisë Malësi e Madhe me palë të treta, konstatohet se Bashkia Malësi e Madhe në procesin e ligjshëm të administrimit të aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qera të tyre, për vitin 2023 ka gjithsej 13 kontrata qiraje aktive, nga të cilat, 7 kontrata janë lidhur me operatorët e telefonive celulare, 6 kontrata janë lidhur për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore për funksionimin e HEC-eve. Konstatohet se në 1 rast nuk është bërë likuidimi i detyrimit vjetor të qirasë, konkretisht nga subjekti “C Shpk”, në vlerën 301,585 lekë dhe nga subjekti V.SH.A është likuiduar detyrim vjetor por pa përfshirë kamtavonesën në vlerën 110,000 lekë, detyrimi në fund të vitit 2023 nga mos pagesa e kontratës së qirasë është në vlerën 411,585 lekë, vlerë e pa kontabilizuar e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhe. Ndaj subjekteve të mësipërm nuk janë marrë masa për arkëtimin e detyrimit të krijuar, si dhe zgjidhjen e kontratës. Këto veprime janë në kundërshtim me Kontratën me nr rep. 3014, nr. kol 1641 datë 04.10.2022, nr. 533/ date 06.07.2022. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.3 faqe 33-41 të Raportit të Auditimit).*

**3.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa për kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës **411,585** lekë ndaj subjektit C Shpk për vlerën 301,585 lekë dhe VSH.A për vlerën 110,000 lekë. Drejtoria e të Ardhurave të përcjellë në Drejtorinë së Financës detyrimet nga qiradhënia me qëllim njohjen e detyrimeve nga ky burim i të ardhurave.

*Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2025*

## **D. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE,**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i objekteve informale, u konstatua se në fund të vitit 2022 vlera debitore nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 19,118,724 lekë për 260 subjekte, nga të cilat janë krijuar gjatë vitit 2023 për 39 subjekte në vlerën 1,296,614 lekë, dhe në fund të vitit 2023 progresive është për 299 subjekte në vlerën **20,263,481** lekë detyrim i cili është i njohur në kontabilitet, duke mbetur detyrim i pa arkëtuar. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Sektori i të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore Bashkia Malësi e Madhe, nuk janë marrë masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe Drejtorisë së të Ardhurave Bashkia Malësi e Madhe, me qëllim që subjektet të cilët rezultojnë debitorë si rrjedhojë e mospagesës së TNI, t'i përcillen në sektorët përkatës me qëllim mbledhjen e borxhit, për të ndjekur procedurat ligjore përkatëse, për arkëtimin e TNI nga legalizimi i objekteve informale. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3.c dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.3 faqe 33-41 të Raportit të Auditimit).*

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë nga

ndërtimet informale”, të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me vlerë **20,263,481 lekë**.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se debitorët nga taksat vendore familjare dhe taksave të paarkëtuara të biznesit në Bashkinë Malësi e Madhe në 01.01.2023 paraqiten në vlerën 26,546,820 leke, dhe në 31.12.2023 në vlerën **86,560,990 lekë**. Shtesa e vitit 2023 është 6,417,970 lekë, nga të cilat 50,439,387 lekë i përkasin taksave vendore familjare. Konkretisht: -debitorëve progresivë për *subjektet fizikë/juridikë*, në fund të vitit 2022 rezulton në një numër prej 323 subjekte në vlerën 31,431,616 lekë. Në fund të vitit 2023 konstatohet një numër debitorësh prej 319 subjektsh me vlerë prej *36,121,603 lekë*, për rrjedhojë detyrimi i krijuar gjatë vitit 2023 rezulton në vlerën 4,689,987 lekë.

-në fund të vitit 2022 janë 10,243 *familje debitore* në vlerën 35,885,390 lekë dhe për vitin 2023 janë krijuar detyrime gjatë në vlerën 14,553,997 lekë, ndërsa në total debitorë në fund të vitit 2023 janë 10,826 familje në vlerën *50,439,387 lekë*.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Tatim Taksave lidhur me zbatimin e hapave që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar bizneset debitorë që kryejnë aktivitetin e tyre pranë Bashkisë Malësi e Madhe.

Nga auditimi konstatohet se, pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2023, nuk janë nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të sipër cituar ndaj debitorëve të Bashkisë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94. (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.3 faqe 33-41 të Raportit të Auditimit).

**2.1.Rekomandimi:** Drejtoria e të ardhurave në bashkëpunim me sektorët e tjerë të Bashkisë Malësi e Madhe, si Drejtoria e Aseteve, Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit, Drejtorinë Juridike, Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë Financës, të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për një numër debitorësh prej 3,948 debitorë në vlerën **86,560,990 lekë**, nga e cila debitorë të shtuar përgjatë vitit 2023 në vlerën 66,432,140 lekë, për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.

*Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2025*

**3.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare të viti 2023 rezulton se në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” përfshihen edhe debitorë të ndryshëm të bashkisë, në vlerën totale prej **9,380,149 lekë**, të cilët përfshijnë subjekte të rekomandimeve “shpërblim dëmi” të lëna nga KLSH ndër vite, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërimit; si dhe gjoba IVMT. Për këta debitorë nuk ka patur shtesa përgjatë vitit 2023. Nga auditimi konstatohet se, pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2023, nuk janë nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të sipër cituar ndaj debitorëve të bashkisë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94 (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 38-57 të Raportit të Auditimit).

**1.1.Rekomandimi:**Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë Financës të marrin masat për arkëtimin e detyrimeve të kontabilizuara, dhe të pa shlyera nga të ardhurat vendore gjendje 31.12.2023 në vlerën **9,380,149 lekë** .

**1.2.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin

e vlerave debitore.

*Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2025*

## **E. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 12 procedurave të prokurimit me vlerë totale të fondit limit 311,595 mijë lekë, të vlerësuar për auditim për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, janë konstatuar në shkëlqje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej në 11 procedura prokurimi, me fond limit 298,940,951 lekë pa TVSh, pasi është konstatuar kualifikimi I OE fitues, pa plotësuar kriteret e kualifikimit të vendosura në DT, në objektet “Blerje karburanti”, “Rikonstruksion i shkollës "Muhamet Hasmuja", Ktosh”, “Sistemim asfaltim rruga Sterkuje”, “Sistemim Asfaltim Rruga Koplík-Sterbeq-Jubice-Kamice”, “Ura lidhëse për fshatrat Vermosh-Velan-Velipojë”, “Sistemim asfaltim rruga çulaj - Skaq”, “Sistemim Asfaltim Rruga “Degëzim rruga Koplík-Razëm, për tek rruga e Reçit”, “Sistemim asfaltim rruga Rrash - Vorfe”, “Sistemim asfaltim rruga Rohes, Faza 2”, “Sistemim asfaltim rruga Koplík Sipër – Lujs”, “Blerje kosha (kontenier) për mbetje. Në zbatim të ligjit “Për prokurimin publik”, KVO-ja duhet të kishte skualifikuar OE të kualifikuar dhe shpallur fitues, duke shpallur përfundimisht fitues OE të rradhës, i cili i plotëson të gjitha kriteret e DT-ve, edhe pse realizimi i punëve do të kryej me një vlerë më të lartë monetare, ose të anulonte procedurën dhe të zhvillonte një procedurë tjetër. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Neni 92, pika 3, (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, në faqet 61-123 të Raportit të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Titullari I AK Bashkia Malësi e madhe, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e OE, të cilët nuk plotësojnë kriteret kualifikuese të përcaktuara në DT, me pasojë lidhjen e kontratës me OE të shpallur fitues në kundërshtim me legjislacionin e Prokurimit Publik, për vlerën **298,940,951** lekë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Sistemim Asfaltim rruga Kastrat - Rrapshe”, Bashkia Malësi e Madhe, me vlerë të kontratës 69,096,177.6 lekë me Tvsh, realizuar nga BOE fitues L ShPK & N ShPK, rezultuan se është kryer zëri i punimeve “Shtresë Zhavorri t=30 cm” me vlerë 2,044,500 lekë pa TVSh në një sipërfaqe të panevojshme, punime të cilat mund të ishin shmangur dhe vlera e tyre të ishte përdorur në zëra të tjerë pune. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2658/6 prot datë 21.10.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe dhe BOE fitues L ShPK & N ShPK, duke shkaktuar përdorim pa efektivitet të fondeve të bashkisë. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.5.2, faqe 123-168, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Malësi e Madhe, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë në lidhje me përdorimin pa efektivitet të vlerës prej **2,044,500 lekë** dhe nëpërmjet strukturave të kontrollit të zbatimit të investimeve, të merren masa për eliminimin e këtyre rasteve në të ardhmen, me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve publike.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Ndërtim i impjantit të ngrohjes në shkollat e Mesme Koplík- Bajzë - Gruemirë”, Bashkia Malësi e Madhe, me vlerë të kontratës 38,884,235 lekë me Tvsh, realizuar nga BOE fitues M& “Et” ShPK, rezultoi që në preventivin e punimeve vlera e pajisjeve është llogaritur me TVSH,

në kundërshim me Udhëzimin nr.1, datë 16.6.2011, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”. Vlera 13,725,000 lekë e pajisjeve për sistemin e ngrohjes (për të tre shkollat) nuk duhet të ishte llogaritur me TVSH. Sa më sipër është shtuar vlera e objektit në shumën 2,453,543.4 lekë, e cila përbën përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, shkaktuar nga përlllogaritja e gabuar e fondit limit nga projektuesi OE “N S” ShPK (Më hollësisht trajtuar në nën pikën 2.5.2, faqe 123-168, të Raportit të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Malësi e Madhe, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë në lidhje me përdorimin pa ekonomikitet të vlerës prej **2,453,543.4 lekë**, për shkak të vendosjes së pajisjeve me TVSh në preventivin e punimeve dhe nëpërmjet strukturave të kontrollit të zbatimit të preventivave në fazën e prokurimit, të merren masa për eliminimin e këtyre rasteve në të ardhmen, me qëllim përdorimin me ekonomikitet të fondeve publike.

**Menjëherë**

#### **F. MASA ADMINISTRATIVE:**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë, Kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe të kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë për 2 mbikëqyrës/kolaudatorë punimesh, si më poshtë:

**1. Z. E.N**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin “Ndërtim i impjantit të ngrohjes në shkollat e Mesme Koplik- Bajzë - Gruemirë”, Bashkia Malësi e Madhe, me sipërmarrës punimesh BOE M& “E” shpk, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 3,866,772 lekë pa tvsh si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

**2. Z. N.P**, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin “Ndërtim i impjantit të ngrohjes në shkollat e Mesme Koplik- Bajzë - Gruemirë”, Bashkia Malësi e Madhe, me sipërmarrës punimesh BOE M& “E” shpk, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 3,866,772 lekë pa tvsh si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

#### **G. MASA DISIPLINORE.**

Kontrulli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 “Llojet e masave disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, nenit 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, dhe kontratës individuale, si dhe shkronja (k) e nenit 64, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe të vlerësojë shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje”, për **13 (trembëdhjetë)** punonjësit, si më poshtë:

#### **I. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:**

**1. Z. A.R**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave:

Për moszbatim të nenit 92, pika 3 dhe nenit 98, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në procedurat “Blerje karburanti (Gazoil 10 ppm), për vitin 2024”, “Rikonstruksion i shkollës "Muhamet Hasmuja", Ktosh”, “Sistemim asfaltim rruga Sterkuje”, “Sistemim Asfaltim Rruga Koplík-Sterbeq-Jubice-Kamice”, “Ura lidhëse për fshatrat Vermosh-Velan-Velipojë”, “Sistemim asfaltim rruga Çulaj - Skaq”, “Sistemim Asfaltim Rruga “Degëzim rruga Koplík-Razëm, për tek rruga e Reçit”, “Sistemim asfaltim rruga Rrash - Vorfe”, “Sistemim asfaltim rruga e Lohes, Faza 2”, “Sistemim asfaltim rruga Koplík Sipër - Ljus” dhe “Blerje kosha (kontenier) për mbetje”, pasi KVO nuk duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për lidhjen e kontratës me atë OE të shpallur fitues;

**2. Z. J.N**, me detyrë Përgjegjës I Sektorit të Projekteve, në cilësinë e antarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave:

Për moszbatim të nenit 92, pika 3 dhe nenit 98, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në procedurat “Blerje karburanti (Gazoil 10 ppm), për vitin 2024”, “Rikonstruksion i shkollës "Muhamet Hasmuja", Ktosh”, “Sistemim asfaltim rruga Sterkuje”, “Sistemim Asfaltim Rruga Koplík-Sterbeq-Jubice-Kamice”, “Ura lidhëse për fshatrat Vermosh-Velan-Velipojë”, “Sistemim asfaltim rruga Çulaj - Skaq”, “Sistemim Asfaltim Rruga “Degëzim rruga Koplík-Razëm, për tek rruga e Reçit”, “Sistemim asfaltim rruga Rrash - Vorfe”, “Sistemim asfaltim rruga e Lohes, Faza 2”, “Sistemim asfaltim rruga Koplík Sipër - Ljus” dhe “Blerje kosha (kontenier) për mbetje”, pasi KVO nuk duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për lidhjen e kontratës me atë OE të shpallur fitues;

**3. Z. P.C**, me detyrë Përgjegjës I Sektorit të Rrugëve Rurale, në cilësinë e antarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave:

Për moszbatim të nenit 92, pika 3 dhe nenit 98, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në procedurat “Blerje karburanti (Gazoil 10 ppm), për vitin 2024”, “Sistemim asfaltim rruga Sterkuje”, “Sistemim Asfaltim Rruga Koplík-Sterbeq-Jubice-Kamice”, “Sistemim Asfaltim Rruga “Degëzim rruga Koplík-Razëm, për tek rruga e Reçit”, “Sistemim asfaltim rruga Rrash - Vorfe”, “Sistemim asfaltim rruga e Lohes, Faza 2”, “Sistemim asfaltim rruga Koplík Sipër - Ljus” dhe “Blerje kosha (kontenier) për mbetje”, pasi KVO nuk duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për lidhjen e kontratës me atë OE të shpallur fitues;

**4. Z. R.C**, me detyrë Administrator i Njësisë Administrative Qendër, në cilësinë e antarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave:

Për moszbatim të nenit 92, pika 3 dhe nenit 98, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në procedurat “Rikonstruksion i shkollës "Muhamet Hasmuja", Ktosh”, “Ura lidhëse për fshatrat Vermosh-Velan-Velipojë” dhe “Sistemim asfaltim rruga Çulaj - Skaq”, pasi KVO nuk duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për lidhjen e kontratës me atë OE të shpallur fitues;

**5. Zj. E L**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave,

**6. Zj. D Sh**, me detyrë Përgjegjëse i Drejtorisë së Taksave;

**7. Zj. K H**, me detyrë Inspektor Taksash;

**8. Z. V V**, me detyrë Inspektor Taksash ;

**9. Zj. A R**, me detyrë Inspektor Taksash NJA Gruemire;

**10. Z. E B** me detyrë Inspektor Taksash NJA Qendër.

**11. Z. T B**, me detyrë Inspektor Taksash NJA Shkrel;

**12. Z. E S**, me detyrë Inspektor Taksash NJA Kelmend.

Për mangësitë e konstatuara në fushën e të ardhurave, sa i takon mungesës së marrjes së masave shtrënguese për arkëtimin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në kundërshtim ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

## **II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta:**

“Vërejtje”, sipas shkeljeve të konstatuara, për:

**1. Z. T V**, me detyrë Inspektor Taksash NJA Kastrat

Për mangësitë e konstatuara në fushën e të ardhurave, sa i takon mungesës së marrjes së masave shtrënguese për arkëtimin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në kundërshtim ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

## **III. Për punonjësit e larguar.**

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

a. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “Vërejtje” përkatësisht:

**1. Z. G**, me detyrë ish-specialist në Sektorin e Ujitjes dhe Kullimit, në cilësinë e specialistit të fushës në Njësinë e Prokurimit:

Për moszbatim të nenit 77, pika 1, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në procedurat “Rikonstruksion i shkollës "Muhamet Hasmuja", Ktosh”, “Sistemim asfaltim rruga Sterkuje”, “Sistemim Asfaltim Rruga Koplík-Sterbeq-Jubice-Kamice”, “Ura lidhëse për fshatrat Vermosh-Velan-Velipojë”, “Sistemim asfaltim rruga Çulaj - Skaq”, “Sistemim Asfaltim Rruga “Degëzim rruga Koplík-Razëm, për tek rruga e Reçit”, “Sistemim asfaltim rruga Rrash - Vorfe”, “Sistemim asfaltim rruga e Lohes, Faza 2”, “Sistemim asfaltim rruga Koplík Sipër - Ljus” dhe “Blerje kosha (kontenier) për mbetje”, pasi në cilësinë e specialistit të fushës në NjP, duhet të kishte vendosur kritere që të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës;

**2. Zj. E.S**, me detyrë ish-Inspektor Taksash;

**3. Z. E L**, me detyrë ish-Inspektor Taksash NJA Kastrat;

Për mangësitë e konstatuara në fushën e të ardhurave, sa i takon mungesës së marrjes së masave shtrënguese për arkëtimin e Taksave dhe Tarifave Vendore, në kundërshtim ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

## **H. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore në pikën “G” më sipër, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

**1.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit për punonjësit e listuar në pikën “G.I”, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

**2.** Ti kërkojë Departamentit të Administratës Publike kryerjen e verifikimeve nëse punonjësit e listuar në pikën “G.II” janë pjesë e shërbimit civil dhe të marrë masat e nevojshme për ndjekjen e procedurës disiplinore, mbi bazën e fakteve të paraqitura në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

3. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

**Në vijimësi**

Për sa më sipër paraqitet Raporti Përfundimtar i Auditimit.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**